

SIGURIA ENERGJETIKE NË KONTEKSTIN EUROPIAN – MIDIS VARËSISË SI KËRCËNIM DHE DIVERSIFIKIMIT SI PRIORITET

FATRI MORINA

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Sociale,
me profil Marrëdhënie Ndërkombëtare, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: PROF. DR. PËRPARIM FUGA

Numri i fjalëve: 59,207

Tiranë, Mars 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje dhe nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

ABSTRAKT

Ky punim fokusohet në analizimin e situatës energjetike në kontekstin europian dhe implikimeve të saj në nivelin e sigurisë së aktorëve, duke u ndalur në shkaqet që kanë ndikuar në nivelin e sigurisë energjetike dhe masën e prioritizimit të kësaj çështje në tre nivele analize; BE, Ballkan dhe Shqipëri. Objektivat e paracaktuar fokusohen në identifikimin dhe analizimin e (a) treguesve kryesor energjetik në të tre nivelet e analizës dhe i shkaqeve që kanë përcaktuar situatën energjetike; (b) faktorët që kanë përcaktuar masën e prioritizimit të çështjeve energjetike në funksion të garantimit të sigurisë energjetike dhe implikimeve të saj në sigurinë kombëtare të aktorëve; dhe (c) nivelin e bashkëpunimit midis aktorëve në funksion të garantimit të sigurisë energjetike.

Pyetjet kërkimore të punimit janë: Cilët janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në situatën energjetike në kontekstin europian? A ndikon niveli i sigurisë energjetike në nivelin e sigurisë së aktorëve dhe cilat janë shkaqet që përcaktojnë nivelin e sigurizimit të çështjeve energjetike? Metodologjia e përdorur për t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe për të përmbushur qëllimin e punimit, është metodologjia analitike e bazuar tek rasti studimor (konteksti europian), duke kombinuar qasjen cilësore dhe atë sasiore. Korniza teorike e punimit bazohet kryesisht tek Shkolla e Kopenhagenit; me një theks të veçantë në sektorët e sigurisë, 'security complexes' dhe procesi i sigurizimit. Të dhënat fokusohen në treguesit energjetik, dokumentet strategjike dhe diskuri i aktorëve.

Hipotezat kryesore të punimit janë: 1) Resurset energjetike të kufizuara, varësia e lartë dhe nevoja për diversifikim, mos ekzistenca e një tregu të brendshëm energjetik të unifikuar, problematikat e brendshme dhe marrëdhëniet midis aktorëve janë ndër faktorët kryesorë të cilët kanë ndikuar në situatën energjetike në kontekstin europian. 2) Niveli i sigurisë energjetike ndikon në nivelin e sigurisë kombëtare të aktorëve, por pavarësisht se çështjet energjetike janë artikuluar dhe prioritizuar në axhendën e aktorëve, sigurizimi ose jo i tyre është përcaktuar nga mënyra e perceptimit të varësisë energjetike, problematikat e brendshme, vizioni dhe politikat energjetike të ndjekura. Pavarësisht diferencave, si në nivelin e BE-së, ashtu dhe atë të Ballkanit dhe Shqipërisë, karakteristika kryesore e përbashkët është varësia e lartë dhe nevoja për diversifikimin e burimeve. Nëse në rastin e BE-së çështjet e energjisë janë përfshirë në procesin e sigurizimit, në Ballkan dhe në Shqipëri diçka e tillë nuk ka ndodhur, si pasojë e ndërthurjes midis elementëve vizion, kohë dhe çmim.

ABSTRACT

This study focuses on analyzing the energy situation in the European context and its implications at the level of actors' security, emphasizing the causes affecting the energy security and the extent of prioritization of this issue on three levels of analysis; EU, the Balkans and Albania. Predetermined objectives aim at identifying and analyzing (a) key energy indicators regarding three levels of analysis, as well as the causes underlying the energy situation; (b) factors that have determined the extent of prioritizing energy issues for guaranteeing the energy security and its implications on actors national security; and (c) the level of cooperation between actors for guaranteeing energy security.

Thesis research questions are: Which are the main factors influencing the energy situation in the European context? To what extent does the energy security have an impact on the level of security actors and what are the causes determining the level of securitization of energy issues? The methodology used to answer the research questions and to fulfill the goal of this study is the analytical methodology, referring to the case study (European context), combining qualitative and quantitative approaches. The theoretical framework of this study is mainly based on the Copenhagen School, having a particular emphasis on the sectors of security, "security complexes" and the securitization process. The data are derived from energetic indicators, strategic documents and actors discourse.

The hypothesis of this study are: 1) limited energy resources, high dependence and the need for diversification, non-existence of an internal unified energy market, domestic issues and relations between actors are among the main factors influencing the energy situation in the European context; 2) the level of energy security affects the level of actors national security, but, despite that energy issues are articulated and prioritized within the actors agenda, their securitization or non- securitization is determined from the perception of energy dependence, the internal issues, vision and implemented energy policies. Despite the differences, at EU, the Balkans and Albania levels, the main common feature is the high dependence and the need for sources diversification. As in the EU case energy issues are involved in securitization process, in the Balkans and Albania such a phenomenon has not happened due to the combination of three elements: vision, time and price.

FALENDERIME

Fillimisht dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për udhëheqësin shkencor, Prof. Dr. Përparim Fuga i cili ka qenë i pranishëm në çdo moment gjatë procesit të këtij punimi. Disponueshmëria, njohuritë dhe profesionalizmi i tij kanë ndikuar në realizimin e këtij punimi.

Një mirënjohje e veçantë i takon kolegut Prof. Dr. Kristaq Xharo, dashamirësia dhe mbështetja e të cilit kanë qenë një shtysë e rëndësishme për finalizimin e punimit.

Në listën e falënderimeve nuk mund të mungojë as kolegja dhe shoqja ime Vilma Spahiu, me të cilën kemi ndarë shqetësimet dhe kënaqësitë e rrugëtimit që kemi ndërmarrë.

Falenderimi më i veçantë i kushtohet familjes sime, prindërve dhe bashkëshortes, mbështetja e pakushtëzuar e të cilëve mbetet motivimi kryesor për realizimin e këtij punimi.

FALEMINDERIT!

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Deklarata e autorësisë.....	2
Abstrakt.....	3
Abstract.....	4
Falenderime.....	5
Lista e tabelave, grafikëve dhe figurave.....	8
Lista e shkurtimeve.....	10

Kapitulli I: Hyrje..... 12

1.1. Qëllimi dhe objektivat e punimit.....	13
1.2. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza/t.....	14
1.3. Modeli analitik & Metodologjia.....	16
1.3.1. Modeli i hulumtimit.....	17
1.3.2. Operacionalizimi i koncepteve.....	21
1.3.3. Mbledhja dhe analizimi i të dhënave.....	23
1.4. Kufizimet dhe risitë e punimit.....	27
1.5. Struktura e punimit.....	30

Kapitulli II: Evoluimi i konceptit, terminologjia dhe dimensionet e

sigurinë energjetike33

2.1. Evoluimi i konceptit të sigurisë - thellimi dhe zgjerimi i tij.....	33
2.2. Terminologjia dhe rëndësia e sigurisë energjetike.....	41
2.3. Dimensionet dhe parimet e sigurisë energjetike.....	48
2.4. Konkluzione.....	56

Kapitulli III: Qasjet mbi sigurinë energjetike - nga determinizmi realist

tek konstrukti social i realitetit..... 58

3.1. Realizmi & neorealizmi - energjia si burim konflikti dhe komponent i sigurisë kombëtare.....	60
3.2. Qasja liberale & neoliberales - dimensionet ekonomik i energjisë si promotor i bashkëpunimit dhe garantimit të sigurisë.....	63
3.3. Shkolla e Kopenhagenit - drejt një kornize analitike për sigurinë energjetike.....	66
3.3.1. Sektorët e sigurisë - energjia si një fenomen ndër sektorial.....	70
3.3.2. Regional Security Complex Theory - siguria energjetike si një fenomen përtej kufijve.....	75
3.3.3. Teoria e sigurizimit - prioritizimi i energjisë në axhendat ndër/kombëtare.....	81
3.4. Konkluzione.....	88

Kapitulli IV: Siguria energjetike në BE.....	92
4.1. Një vështrim mbi situatën dhe aktorët kryesor energjetik në nivel global.....	92
4.1.1. <i>Rezervat, prodhimi dhe konsumi i energjisë në nivel global.....</i>	92
4.1.2. <i>Siguria energjetike në perceptimin dhe diskurin e aktorëve të sistemit global.....</i>	103
4.2. Një vështrim i përgjithshëm mbi situatën e sigurisë energjetike të BE-së.....	110
4.3. Kriza Rusi - Ukrainë si dëshmi e domosdoshmërisë së diversifikimit të burimeve energjetike të BE-së.....	118
4.3.1. <i>Rajoni i Kaspikut si alternativë e diversifikimit të burimeve energjetike të BE-së...</i>	121
4.4. Siguria energjetike në diskurin dhe dokumentet kryesor strategjik të BE-së.....	123
4.5. Konkluzione.....	133
 Kapitulli V: Siguria energjetike në Ballkan.....	 136
5.1. Një qasje analitike mbi situatën energjetike në rajonin e Ballkanit.....	136
5.2. Ndikimi i Rusisë në sigurinë energjetike të Ballkanit.....	148
5.3. Implikimet e Trans Adriatic Pipeline (TAP) në sigurinë energjetike rajonale.....	152
5.4. Drejtë integritetit energjetik rajonal apo vazhdimësi e fragmentarizmit?.....	161
5.5. Konkluzione.....	165
 Kapitulli VI: Siguria energjetike në Shqipëri.....	 168
6.1. Analizë e situatës energjetike në Shqipëri.....	168
6.1.1. <i>Treguesit kryesor energjetik.....</i>	168
6.1.2. <i>Karakteristikat e sektorit të energjisë.....</i>	179
6.2. Vendi dhe roli i Shqipërisë në gjeopolitikën rajonale të energjisë.....;	186
6.2.1. <i>Anëtarësimi i Shqipërisë në Komunitetin Energjetik.....</i>	186
6.2.2. <i>Implikimet e projekteve energjetike në sigurinë energjetike të Shqipërisë.....</i>	189
6.3. Siguria energjetike në dokumentet kryesore strategjike.....	194
6.3.1. <i>Siguria energjetike në Strategjinë Kombëtare të Energjisë.....</i>	194
6.3.2. <i>Siguria energjetike në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare.....</i>	199
6.3.3. <i>Siguria energjetike në Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë.....</i>	211
6.4. (Mos) Sigurizimi i çështjeve energjetike.....	215
 Konkluzione	 221
 Referenca.....	 226

LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE & FIGURAVE

Tabela 1: Gazi Natyror: Rezervat dhe prodhimi në rajonin e Kaspikut.....	122
Tabela 2: Treguesit kryesor ekonomik (2012).....	137
Tabela 3: Treguesit kryesor energjetik (2011)	138
Tabela 4: Treguesit e energjisë elektrike (2011)	144
Tabela 5: Treguesit kryesor të Nabucco West dhe TAP	154
Tabela 6: Treguesit kryesor energjetik në Shqipëri.....	169
Tabela 7: Bilanci i përgjithshëm i energjisë (në ktoe)	175
Tabela 8: Pavarësia energjetike kombëtare	175
Tabela 9: Bilanci i energjisë elektrike, 2000 – 2014 (në MWh)	176
 Grafiku 1: Sistemet ekonomike të orientuara nga shteti (c, d) dhe tregu (a, b)	79
Grafiku 2: Spektri i sigurizimit	72
Grafiku 3: Shpërndarja e rezervave të naftës në 1993, 2003 dhe 2013	94
Grafiku 4: Prodhimi dhe konsumi i naftës sipas rajoneve	95
Grafiku 5: Shpërndarja e rezervave të gazit natyror në 1993, 2003 dhe 201	98
Grafiku 6: Prodhimi dhe konsumi i gazit sipas rajoneve.....	99
Grafiku 7: Projektioni për popullsinë, GDP dhe energjinë në dekadat e ardhshme.....	101
Grafiku 8: Kërkesa totale për energji në vendet e BE-së (në ktoe).....	113
Grafiku 9: Treguesit e importit neto në raport me kërkesën totale për energji (në %).....	114
Grafiku 10: Burimet e importit të gazit natyror (2012).....	116
Grafiku 11: Ecuria e GDP-së dhe konsumit të energjisë.....	140
Grafiku 12: Furnizimi primar me energji.....	173
Grafiku 13: Konsumi final i burimeve energjetike sipas çdo sektori (ktoe).....	178

Figura 1: Procesi i sigurizimit.....	83
Figura 2: Skema e aplikimit të sigurizimit dhe RESC në sigurinë energjetike.....	86
Figura 3: Tregtia e naftës në 2013 (milion ton).....	97
Figura 4: Tregtia e gazit në 2013 (milion ton).....	100
Figura 5: Gazsjellësi i Europës së Veriut.....	111
Figura 6: Varësia e vendeve Europiane nga gazi rus.....	115
Figura 7: Harta e gazsjellësve rus që kalojnë nëpërmjet Ukrainës.....	119
Figura 8: Harta e gazsjellësve Rus drejtë Europës	119
Figura 9: Rezervat e gazit natyror, 2012 (tcm).....	122
Figura 10: Korridori Jugor i Gazit.....	159

LISTA E SHKURTIMEVE

IEA – International Energy Agency

BP – British Petroleum

KE – Komisioni European

EUROSTAT – Instituti European i Statistikave

APERC – Asia Pacific Energy Research Center

BE – Bashkimi European

NATO – North Atlantic Treaty Organization

TAP – Trans Adriatic Pipeline

SKE – Strategjia Kombëtare e Energjisë

SU – Strategjia Ushtarake

SSK – Strategjia e Sigurisë Kombëtare

UNDP – United Nations Development Program

USDoE – United States Department of Energy

OPEC – Organization of the Petroleum Exporting Countries

ASEAN – Association of Southeast Asian Nations

OAU – Organization of African Unity

OECD – Organization for Economic Cooperation and Development

RCST – Regional Security Complex Theory

RESC – Regional Energy Security Complex

US EIA – United States Energy Information Administration

b/d – barrels per day

LNG – Liquefied Natural Gas

TTIP – Transatlantic Trade and Investment Partnership

ktoe - kilotonne of oil equivalent

tcm - Thousand cubic meters

SESE – Strategjia Europiane e Sigurisë Energjetike

Mtoe - Million Tonnes of Oil Equivalent

TANAP – Trans Anatolian Gas Pipeline

Kwh – kilowatt-hour

Mwh – megawatt-hour

Gwh – gigawatt-hour

ITGI – Interconnector Turkey-Greece-Italy

IAP – Ionian Adriatic Pipeline

ERE – Enti Rregullator i Energjisë

BB – Banka Botërore

ESMAP – Energy Sector Management Assistance

TFESSD – Trust Fund for Environmentally and Socially Sustainable Development

OSHEE – Operatori Shpërndarjes Energjisë Elektrike

Kapitulli I: Hyrje

“Çështjet e energjisë do të përcaktojnë politikat e shek. XXI. Duke ditur se energjia është një e mirë e kufizuar në një ekonomi botërore gjithnjë e në rritje, beteja për energjinë mund të kthehet në një betejë për mbijetesë; e luftës dhe e paqes” (Rompy, 2008: paragrafi I). Ky është një pasazh i shkëputur nga deklarata e Presidentit të Këshillit Europian, Herman Van Rompy në konferencën ‘Siguria e furnizimit me energji në BE’ e vitit 2008 i cili shpreh qartë rëndësinë e energjisë në periudhën tonë. Çështjet e energjisë janë jetësore jo vetëm për superfuqi si SHBA, BE, Kina apo Rusia por për çdo vend të botës pavarësisht pozicionit gjeografik, përmasave apo demografisë së tij. Shumë aspekte të periudhës bashkëkohore si ekonomike, sociale ashtu dhe ato të marrëdhënieve midis shteteve formësohen nga zhvillimi i burimeve energjetike dhe teknologjisë. Mbështetja tek energjia në çdo fushë të jetës e ka bërë sigurinë energjetike një çështje shumë të rëndësishme për shtetet dhe shoqëritë.

Identifikimi i rëndësisë së çështjeve energjetike nuk është diçka e re, por “aktorët global nisën sigurizimin e çështjeve energjetike në periudhën e pas krizës së 1973, duke e bërë në këtë mënyrë pjesë të politikave të larta” (Ozcan, 2013: 12). Kjo nënkupton, se çështjet e energjisë nisën të trajtohen përtej politikave normale, për shkak të perceptimit të tyre si kërcënim ekzistencial duke u fokusuar më shumë në aspektin politik sesa ekonomik të energjisë. Vendet eksportuese, nën këndvështrimin e sigurizimit, përdorin energjinë si instrument të politikës së jashtme. Vendet importuese, përdorin instrumentet politik, ekonomik dhe ushtarak për të garantuar aksesin në burimet ekzistuese por edhe për të garantuar burime të reja. Ndërsa vendet transit, fokusohen në vazhdimësinë e projekteve energjetike ekzistuese dhe përfshirjen në projekte të reja. Të gjithë këto objektiva, mund të bëhen pjesë e procesit të sigurizimit. “Sigurizimi i energjisë lidhet me sjelljet politike të shteteve drejtë tregjeve energjetike të pa balancuara, të cilat mund të konsiderohen si

kërcënime ekzistenciale për objektin referent në lidhje me politikat energjetike të aktorëve prodhues, konsumator dhe transit të energjisë” (Ozcan, 2013: 13).

Në këtë mënyrë, aktorët përballen me tre problematika kryesore për garantimin e sigurisë, të cilat lidhen me: Së pari, domosdoshmëria për të pasur akses në burime energjetike; Së dyti, nevojën për t’u përballur me shqetësimin në rritje lidhur me pasojat mjedisore të përdorimit të burimeve tradicionale fosile të energjisë dhe përdorimi i burimeve alternative; Së treti, mbrojtja e infrastrukturës energjetike nga kërcënimet tradicionale dhe ato jo – tradicionale, asimetrike. Praktika dëshmon se aktorët, pavarësisht problematikave të ngjashme mbi sigurinë energjetike, i qasen asaj në mënyra të ndryshme. Qasjet e ndryshme sjellin dhe pasoja të ndryshme, të cilat kanë si implikime kombëtare, rajonale ashtu edhe ndërkombëtare.

1.1. Qëllimi dhe objektivat e punimit

Ky punim fokusohet në analizimin e situatës energjetike në kontekstin european dhe implikimeve të saj në nivelin e sigurisë së aktorëve, duke u ndalur në shkaqet që kanë ndikuar në nivelin e sigurisë energjetike dhe masën e prioritizimit të kësaj çështje në tre nivele analize – BE, Ballkan dhe Shqipëri. Kjo është një çështje e rëndësishme pasi të gjithë e artikulojnë sigurinë energjetike, por jo të gjithë e përfshijnë atë në procesin e sigurizimit. Prandaj punimi ka një rëndësi të veçantë sepse identifikon dhe analizon mekanizmat shkakësor të cilët shpjegojnë përse edhe në kushte të njëjta, në nivele të ndryshme qasjet ndaj garantimit të sigurisë energjetike janë të ndryshme. Në këtë aspekt, një fokus të veçantë merr perceptimi i aktorëve, diskuret e tyre dhe dokumentet strategjik të hartuar dhe implementuar.

Objektivat e paracaktuar fokusohen në identifikimin dhe analizimin e:

- ***Treguesve kryesor energjetik në të tre nivelet e analizës dhe i shkaqeve që kanë përcaktuar situatën energjetike.*** Sjellja e aktorëve si në mjedisin e brendshëm, ashtu edhe të jashtëm, nuk mund të kuptohet pa ditur më parë situatën energjetike dhe karakteristikat e saj për secilin nivel.
- ***Faktorëve që kanë përcaktuar masën e prioritizimit të çështjeve energjetike në funksion të garantimit të sigurisë energjetike dhe implikimeve të saj në sigurinë kombëtare të aktorëve.*** Për të matur këto implikime, mbështetemi tek sjellja e aktorëve, diskuri i tyre dhe perceptimi mbi sigurinë energjetike, sikurse dhe në dokumentet e tyre kryesore strategjike. Masa e prioritizimit të çështjeve energjetike, apo sigurizimi i tyre, përcakton dhe efektet e brendshme dhe të jashtme të sigurisë energjetike dhe asaj ndër/kombëtare.
- ***Nivelit të bashkëpunimit midis aktorëve në funksion të garantimit të sigurisë energjetike.*** Aktorët, pavarësisht pozicionit të tyre në raport me burimet energjetike, duhet të hyjnë në marrëdhënie me aktorë të tjerë me qëllim garantimin e sigurisë energjetike. Për këtë arsye, është e rëndësishme të analizohet niveli i këtij bashkëpunimi në kontekstin Europian dhe cilat janë ndikimet e tij.

1.2. Pyetjet kërkimore dhe hipoteza/t

Pyetjet kërkimore bazë që ngre punimi janë:

- ***Cilët janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në situatën energjetike në kontekstin europian?***
- ***A ndikon niveli i sigurisë energjetike në nivelin e sigurisë së aktorëve dhe cilat janë shkaqet që përcaktojnë nivelin e sigurizimit të çështjeve energjetike?***

Hipotezat e punimit janë:

- *Resurset energjetike të kufizuara, varësia e lartë dhe nevoja për diversifikim, mos ekzistenca e një tregu të brendshëm energjetik të unifikuar, problematikat e brendshme dhe marrëdhëniet midis aktorëve janë ndër faktorët kryesorë të cilët kanë ndikuar në situatën energjetike në kontekstin europian.*
- *Niveli i sigurisë energjetike ndikon në nivelin e sigurisë kombëtare të aktorëve, por pavarësisht se çështjet energjetike janë artikuluar dhe prioritetizuar në axhendën e aktorëve, sigurizimi ose jo i tyre është përcaktuar nga mënyra e perceptimit të varësisë energjetike, problematikat e brendshme, vizioni dhe politikat energjetike të ndjekura.*

Implikimet për secilin nivel të analizës janë:

1. Resurset energjetike të kufizuara dhe mungesa e një tregu të brendshëm energjetik të unifikuar në BE, kanë ndikuar në rritjen e varësisë energjetike nga Rusia e cila për shkak se perceptohet si varësi negative dhe ndikon në nivelin e sigurisë së aktorëve, është përfshirë në procesin e sigurizimit.
2. Perceptimet e ndryshme ndaj varësisë energjetike, e kaluara historike dhe problematikat e brendshme në vendet e Ballkanit kanë ndikuar në nivelin e sigurisë energjetike të këtij rajoni.
3. Varësia e lartë, mungesa e diversifikimit, treguesit e ulët ekonomik dhe mungesa e politikave energjetike koherente kanë qenë faktorët kryesorë të cilët kanë ndikuar në nivelin e ulët të sigurisë energjetike në rastin e Shqipërisë.

1.3. Modeli analitik & Metodologjia

Punimi mbështetet kryesisht tek qasja apo metodologjia analitike e hulumtimit shkencor. Përzgjedhja e një metodologjie të caktuar, në raport me metodologjitë e tjera ka dy aspekte kryesore. Së pari, metodologjia e përzgjedhur duhet të përshtatet me qëllimin dhe objektivat e punimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat fillestare. “Ndryshimet midis llojeve të ndryshme të kërkimit shkencor (hulumtimeve) përcaktohen nga pyetjet që ngrihen. Kërkimi analitik synon të shpjegojë se përse një fenomen është në atë gjendje apo si ndodhi” (Yang, 2014: 2). Duke qenë se qëllimi i këtij punimi është ‘analizimi i situatës energjetike në kontekstin europian dhe implikimeve të saj në nivelin e sigurisë së aktorëve, duke u ndalur në shkaqet që kanë ndikuar në nivelin e sigurisë energjetike dhe masën e prioritizimit të kësaj çështje në tre nivele analize, atëherë metodologjia analitike është e përshtatshme. Në këtë mënyrë, pasqyrimi i situatës nuk është qëllimi, por instrumenti nëpërmjet të cilit mund të identifikohen dhe analizohen shkaqet që kanë formësuar situatën. Gjithashtu, metodologjia analitike është e përshtatshme edhe për të analizuar implikimet e sigurisë energjetike në sigurinë e aktorëve dhe masën e prioritizimit të kësaj çështje, duke u fokusuar në analizimin e sjelljes së aktorëve, dokumenteve strategjike dhe diskurin e tyre lidhur me çështjet energjetike.

Aspekti i dytë lidhet me metodologjitë e përdorura nga studiues të tjerë të cilët kanë trajtuar fenomene të ngjashme. Nga rishikimi i literaturës vihet re se qasja analitike ka rezultuar si një qasje e suksesshme dhe e përshtatshme për të studiuar fenomenet e lidhura me çështjet e sigurisë. Rishikimit të literaturës i kushtohet një kapitull më vetë në këtë punim, i cili duke u konsideruar si një instrument ndihmës për kërkimin shkencor hedh dritë mbi konceptet kryesore, teoritë ekzistuese dhe metodologjitë e përdorura në trajtime të ngjashme me subjektin e këtij punimi.

“Në qasjen (metodologjinë) analitike, kërkuesi shkencor duhet të përdorë faktet dhe informacionet në dispozicion, dhe t’i analizojë me qëllim kryerjen e një vlerësimi kritik të materialit/subjektit” (Yang, 2014: 4). Në këtë mënyrë, metodologjia analitike justifikon mos daljen në terren të kërkuesit shkencor, por të mbështetet tek ajo që ndryshe njihet dhe si ‘deskwork’. Burimet e të dhënave, të cilat do të diskutohen më në detaje në seksionet vijuese, bazohet tek informacionet dhe faktet e disponueshme. Të dhënat fokusohen në treguesit energjetik dhe dokumentet strategjik të aktorëve të ndryshëm, sikurse dhe në diskurin e tyre. Duke u fokusuar në këto element në kontekstin europian, bëhet e mundur përmbushja e qëllimit të punimit. Vetë konteksti europian shërben si një rast studimor, i cili ndahet në tre nivele analize. Për secilin nivel, zhvillohet një analizë e veçantë por gjithmonë në funksion të së tërës. Në seksionet vijuese të kapitullit, sqarohen disa element të rëndësishëm metodologjik të punimit, duke nisur nga modeli i hulumtimit, përkufizimi operacional i termave dhe lloji e natyra e të dhënave të përdorura.

1.3.1. Modeli i hulumtimit

Modeli i hulumtimit mbi të cilën mbështetet punimi është ai i rastit studimor, duke u fokusuar tek konteksti Europian. Rasti studimor përfshin një rast të vetëm, ose një numër të vogël rastesh... për të cilat mund të mblidhen lloje të ndryshme të dhënash... qasja është holistike sepse hulumtuesi është i interesuar si për marrëdhëniet midis pjesëve përbërëse të rastit, ashtu edhe për rastin si një i tërë (Matthws & Ross, 2010). Duke u nisur nga qëllimi i punimit, objektivat, pyetjet kërkimore dhe hipotezat, rasti studimor është një zgjedhje e përshtatshme sepse ndihmon në identifikimin dhe analizimin e mekanizmave shkakësor të cilët shpjegojnë përse edhe në kushte të njëjta, në nivele të ndryshme pasoja është e ndryshme. Për këtë arsye, rasti studimor (konteksti Europian) ndahet në tre nivele analize.


Kjo nënkupton se objekt i analizës është si BE-ja, ashtu edhe vendet e tjera të Europës të cilat kanë shprehur interesin dhe perspektivën integruese në BE, respektivisht rajoni i Ballkanit si niveli i mesëm i analizës dhe Shqipëria si niveli mikro.

Por a mund të konsiderohet konteksti europian si një rast studimor i përshtatshëm për studimin? A mund të jetë një përzgjedhje e tillë e përshtatshme si nga aspekti studimor dhe metodologjik ashtu dhe nga aspekti praktik në një kohë që midis aktorëve të kontekstit europian ka shumë dallime? Nëse vetë vendet e BE-së karakterizohen nga tregues dhe problematika të ndryshme, a munden ato të jenë pjesë e një rasti të vetëm studimor me vendet e Ballkanit të cilat nuk janë anëtare të BE-së? Përgjigja për këto pyetje është po dhe kjo për disa arsye.

Qasja analitike dhe rasti studimor janë një kombinim i përshtatshëm në aspektin metodologjik. Përzgjedhja e rastit studimor si model hulumtimi përshtatet mjaft mirë me qëllimin e këtij punimi, sikurse dhe me pyetjet kërkimore dhe hipotezat. “Kërkuesit shkencor të cilët përdorin rastin studimor, janë më shumë të interesuar në gjetjen e kushteve/shkaqeve prej të cilave ndodh një ‘outcome’ i caktuar dhe i mekanizmave nëpërmjet të cilëve ato ndodhin, sesa në zbulimin e frekuencave me të cilat këto kushte dhe pasoja ndodhin” (George & Benet, 2004: 20). Sikurse dhe në momentin e justifikimit të përzgjedhjes së metodologjisë analitike si më të përshtatshmen për punimin, edhe për justifikimin e rastit studimor si model hulumtimin, argumenti mbetet i njëjtë; pasqyrimi i situatës nuk është qëllimi, por instrumenti nëpërmjet të cilit mund të identifikohen dhe analizohen shkaqet që kanë formësuar situatën energjetike në kontekstin europian dhe implikimet e kësaj situatë në sigurinë kombëtare të aktorëve.

Përzgjedhja e kontekstit europian si një rast studimor mbështetet si në argumente teorik ashtu edhe në ato praktik. Ka një sërë kërkimesh shkencore të mirëfillta të cilat

pavarësisht se studiojnë subjekte të ndryshme, e konsiderojnë kontekstin europian si një rast studimor. Përveç tyre, ka edhe studime të tjera të cilat trajtojnë çështjet energjetike dhe të sigurisë të cilët po ashtu flasin për Europën si një kontest i vetëm, pavarësisht të gjithë dallimeve midis aktorëve përbërës të këtij konteksti. Kalicki dhe Goldwyn, në librin e tyre *'Energy & Security – Strategies for a World in Transition'*, e ndajnë globin në rajone të ndryshme të cilat pavarësisht dallimeve të brendshme, karakterizohen nga disa ngjashmëri të cilat krijojnë dhe koherencën e brendshme midis njësive të rastit studimor. Sipas tyre, në aspektin e situatës energjetike, globi ndahet në këto rajone: “Hemisfera perëndimore (e përbërë nga Amerika e Veriut dhe ajo e Jugut), Evropa dhe Euroazia, Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore, Afrika Sub-Sahariane, Azia dhe Paqësori (Kalicki & Goldwyn, 2013). Në të njëjtën linjë, edhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë në analizat e saj mbi situatën energjetike globale, operon duke e ndarë globin në rajone të ndryshme (shih: *World Energy Outlook 2008-2014*).



Duke qenë se qasja ndaj çështjeve energjetike duhet të jetë në terma afatgjatë, atëherë vendet aspirante për në BE duhet që të harmonizojnë politikat dhe strategjitë energjetike në kuadër të garantimit të sigurisë energjetike në nivel European. Kjo ndërvarësi, nënkupton se çështjet energjetike në kontekstin European janë aq të ndërlidhura sa nuk mund të kuptohen dhe analizohen si të ndara. Kjo është arsyeja përse punimi mbështetet në tre nivele analize. Niveli i parë është ai i BE-së, niveli i dytë është rajoni i Ballkanit dhe niveli i tretë është Shqipëria. Ky është një tjetër argument për të justifikuar përcaktimin e kontekstit european si një rast studimor.

Në këtë mënyrë, konteksti european si një rast studimor, justifikohet nga argumente të lidhura me: ndarjen e globit në rajone; problematikat e ndryshme nga rajonet e tjera; ndërvarësinë midis vendeve anëtare të BE-së; funksionimi i një tregu liberal, ndryshe nga rajonet e tjera (i ngjashëm me tregun e Amerikës së Veriut por jo i njëjtë); projekti i Komisionit Evropian për krijimin e tregut të unifikuar energjetik; karakteristika e përbashkët e perceptimit të varësisë si kërcënim dhe diversifikimit si prioritet; aspirata e vendeve të Ballkanit për t'u integruar në BE; implikimet gjeopolitike dhe rajonale si pasojë e kalimit të infrastrukturës kritike të energjisë nëpër territorin e Ballkanit; implikimet e energjisë në sektorët e tjerë të sigurisë dhe efekti '*spill over*'.

Çështjet e energjisë zënë një pjesë të rëndësishme si në diskurin e aktorëve ashtu dhe në dokumentet e tyre strategjike sikurse dhe në politikën e tyre të brendshme e të jashtme. Pavarësisht pozitës së aktorëve në raport me burimet energjetike, siguria energjetike është e rëndësishme për të gjithë. Por, si literatura ashtu edhe praktika dëshmon se aktorët edhe pse në kushte të njëjta (kërkesa për energji) i qasen çështjeve të energjisë në mënyra të ndryshme. Për këtë arsye, ky studim synon të identifikojë variablat që ndikojnë në situatat e ndryshme. Gjetjet e punimit kanë një synim të dyfishtë: nga njëra anë synohet të kontribuojë

në aspektin teorik, dhe nga ana tjetër synon të identifikojë ato variabla të cilat mund të aplikohen dhe në konteste të tjera të ngjashme. “Sqarimi i mekanizmave shkakësor në një rast do të ketë implikime për kuptimin e mekanizmave shkakësor në raste të tjera studimore” (McKeown, 2010: 163).

Qasja metodologjike është e kombinuar, pasi përfshin element si të qasjes cilësore ashtu dhe qasjes sasiore. Hulumtimet cilësore nënkuptojnë një fokus të zgjeruar mbi proceset me të cilat aktorët social formësojnë kuptimin dhe zhvillojnë interpretimet; ndërsa hulumtimet sasiore masin kuptimet sociale dhe kërkojnë të identifikojnë modele numerike në to, duke mos arritur të vëzhgojnë proceset me të cilat kuptimi është ndërtuar, negociuar dhe pranuar në bazë të ndërveprimit shoqëror (Philo & Happer, 2013). Duke qenë se punimi ka si objektiv si analizimin e situatës së sigurisë energjetike, ashtu edhe efekteve të saj atëherë qasja e kombinuar është më e përshtatshme. Ky moment sqarohet më në detaje në seksionin e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

1.3.2. Operacionalizimi i koncepteve

Duke qenë se siguria energjetike është një koncept ‘ombrellë’ e cila përfshin shumë dimensione dhe variabla, në lëmin e qasjes së sigurisë energjetike janë përzgjedhur dy koncepte operacionale, sikurse janë varësia energjetike dhe diversifikimi i burimeve energjetike. Varësia energjetike përcaktohet si raporti i diferencës midis importit dhe eksportit ndaj konsumit: $V = (\text{Import} - \text{Eksport}) / \text{Konsum}$. E thënë ndryshe, sa më e lartë vlera e V aq më e lartë është varësia energjetike e një vendi karshi vendeve të tjera. Problematika e një varësie të lartë, apo e një pavarësie të ulët si një tregues i zhvillimit dhe i sigurisë së një vendi, lidhet kryesisht me burimet e kufizuara të importit apo/dhe rritjen e mëtejshme të çmimit në nivele të papërballeshme për ekonominë e një vendi (APEREC, 2007).

Diversifikimi i burimeve, i njohur ndryshe dhe si energjia mix, lidhet me aksesin real apo potencial në një shumëllojshmëri burimesh energjetike, duke mos krijuar varësi nga një burim i vetëm, aksesin në të cilin për arsye dhe në rrethana të ndryshme mund të kufizohet apo edhe të ndërpritet plotësisht. Me diversifikim të kapaciteteve gjeneruese, nënkuptohet “një sistem energjetik i mirë balancuar, që përfshin teknologji të ndryshme të prodhimit të energjisë dhe kapacitete të përshtatshme që mundësojnë maksimizimin e avantazheve të secilit nga burimet, duke ruajtur një nivel të arsyeshëm çmimesh dhe që siguron një furnizim të vazhdueshëm për konsumatorin” (WCA, 2011, Paragrafi IV). Sa më i ulët numri i burimeve energjetike në dispozicion, aq më të larta janë kërcënimet ndaj sigurisë energjetike të një vendi apo rajoni. Siguria e furnizimit ndikohet dhe nga niveli i sigurisë në një rajon të caktuar, e lidhur kjo me faktorë të tillë si de-stabiliteti politik, risqet ekonomike dhe përdorimi i dhunës në shkallë të madhe, kryesisht në vendet e pasura me rezerva të mëdha dhe që janë eksportues të rëndësishëm të tregut global të energjisë.

Qasja e aktorëve ndaj varësisë energjetike përcaktohet nga:

- Së pari, marrëdhëniet midis aktorëve – nëse marrëdhënia e aktorëve janë bashkëpunuese dhe harmonike, atëherë varësia përcaktohet dhe perceptohet si pozitive. Të dy palët kanë përfitime reciproke nga varësia, vendet eksportuese garantojnë tregun ndërsa vendet importuese garantojnë aksesin në burime energjetike. Ndryshe ndodh nëse marrëdhëniet midis aktorëve nuk janë shumë pozitive. Në këto raste, varësia perceptohet si negative. Kjo ndodh kryesisht për shkak të përdorimit të energjisë si instrument në politikën e jashtme. Në këtë mënyrë, varësia energjetike perceptohet si problematike dhe mund të bëhet pjesë e procesit të sigurizimit, duke e perceptuar varësinë energjetike si kërcënim ekzistencial për sigurinë.

- Së dyti, vlerat e varësisë – sa më e lartë të jetë vlera e varësisë energjetike, aq më ekzistencial perceptohet dhe kërcënimi që vjen nga jo varësi. Ky aspekt është i lidhur dhe me llojin e varësisë, pozitive apo negative, e cila i jep kuptim dhe rëndësisë së një vlere të caktuar. Nëse një aktor ka një vlerë prej 40 % të varësisë dhe kjo varësi është pozitive, atëherë mund të mos përbëjë një kërcënim ekzistencial e për pasojë mund të mos sigurizohet. Por, nëse një aktor ka një vlerë prej 30 % të varësisë dhe kjo varësi është e llojit negativ, atëherë ajo përbën një situatë e cila mund të sigurizohet. Kjo nënkupton se pasojat e varësisë energjetike janë të varura në mënyrë të drejtpërdrejtë nga marrëdhënia midis aktorëve. Në këto raste, diversifikimi i burimeve shihet si faktor me ndikim në nivelin e sigurisë energjetike.
- Së treti, lloji i energjisë – varësia nga një lloj i vetëm i energjisë mund të jetë po aq problematike sa dhe varësia nga një burim i vetëm. Shterimi i resurseve apo varësia e prodhimit nga faktorë të ndryshëm mund të ndikojnë në nivelin e sigurisë energjetike. Varësia nga burime të tilla si nafta apo gaz, kërcënohet nga shterimi i këtyre resurseve ndërsa varësia nga burimet e energjisë alternative kërcënohet nga ndikimi që mund të vijë si pasojë e faktorëve klimaterik. Implikimet mjedisore të përdorimit të llojeve të ndryshme të burimeve energjetike, mund të përbëjnë një kërcënim për sigurinë energjetike. Në këto raste, diversifikimi i llojeve të energjisë në përdorim, e lidhur me atë që njihet si energjia mikse, shihet si faktor me ndikim të rëndësishëm.

1.3.3. Mbledhja dhe analizimi i të dhënave

Natyra e të dhënave dhe mënyrat e analizimit të tyre janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me pyetjet kërkimore dhe hipoteza/t e punimit. Bazuar në këto element,

sikurse dhe në modelin dhe strategjitë e hulumtimit, punimi bazohet mbi kombinimin e të dhënave sasiore dhe atyre cilësore. Qasja sasiore, lidhet me përdorimin e “të dhënave sasiore dytësore që janë në dispozicion për analizë të mëtejshme” (Matthws & Ross, 2010: 147). Të dhënat kryesore sasiore mbi treguesit energjetik mbështeten në burime të tilla si Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (International Energy Agency – IEA), British Petroleum (BP), Komisioni European (KE), Instituti European i Statistikave (EUROSTAT), INSTAT, etj.

Përdorimi i këtyre të dhënave është i rëndësishëm për identifikimin dhe analizimin e situatës energjetike në kontekstin European. Të dhënat mbështeten në totalin e rezervave energjetike, treguesit e prodhimit, kërkesës, konsumit, importit dhe eksportit të produkteve energjetike. Këto të dhëna shërbejnë si tregues të rëndësisë së energjisë për aktorët, sikurse dhe implikimet e sigurisë energjetike në sigurinë ndër/kombëtare. Të dhënat mbi treguesit energjetik, kombinohen dhe me të dhëna të tjera sasiore si treguesit ekonomik dhe demografik. Një kombinim i tillë bëhet për shkak të korrelacionit midis zhvillimit ekonomik dhe demografik nga njëra anë, dhe kërkesës për energji nga ana tjetër. Sa më i zhvilluar të jetë një vend, aq më e lartë është kërkesa për energji.

Analizimi i të dhënave sasiore zhvillohet nëpërmjet kombinimit të analizës statistikore dhe qasjes analitike. Analiza statistikore e të dhënave ndihmon në: përmbledhjen dhe përshkrimin e të dhënave të mbledhura; përshkrimin e tipareve të të dhënave në mënyrë që të ndihmojë në identifikimin e aspekteve që lidhen me pyetjet e hulumtimit; eksplorimin dhe testimin e marrëdhënieve midis grupeve të ndryshme të të dhënave (Matthws & Ross, 2010: 345). Qasja analitike, e bazuar në analizën e dokumenteve, ndihmon në identifikimin dhe analizimin e situatës energjetike në kontekstin European.

Për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave sasiore, punimi bazohet në disa pyetje?

- Cila është situata energjetike në kontekstin European (në të tre nivelet e analizës)?

- Si paraqitet situata e treguesve ekonomik dhe demografik?
- Cilët janë burimet (llojet) energjetike më të përdorura?
- Cilët janë projeksionet energjetike për dekadat e ardhshme?
- Cilët janë aktorët kryesor në sektorin energjetik në kontekstin European dhe çfarë raporti zënë ato në totalin e treguesve energjetik?

Për të përmbushur këtë objektiv, punimi bazohet në metodologjinë e *Asia Pacific Energy Research Center*, i cili mund të përmblihet në 4 A-të e energjisë (APEREC, 2007):

- *Availability* – Disponueshmëria e burimeve energjetike, qofshin këto burime tradicionale apo burime të reja alternative.
- *Accessibility* – Aksesit lidhet me kapacitetet reale dhe potenciale të një aktori për t'u furnizuar me burimet energjetike të disponueshme.
- *Affordability* – Përballueshmëria është e lidhur kryesisht me kostot financiare të aksesit në burimet e disponueshme energjetike.
- *Acceptability* – Pranueshmëria e përdorimit të burimeve dhe llojeve të ndryshme të energjisë, lidhet me impaktin e tyre social dhe mjedisor. Nëse një burim energjetik i disponueshëm dhe i aksesueshëm me një kosto financiare të përballueshme ka pasoja mbi sferën sociale dhe mjedisore, atëherë siguria energjetike e aktorit nuk mund të jetë e garantuar.

Përveçse në të dhënat sasiore, punimi bazohet dhe në të dhënat cilësore. Qasja cilësore lidhet me “mbledhjen e dokumenteve që lidhen me pyetjet e hulumtimit dhe bërja e pyetjeve për këto dokumente” (Matthws & Ross, 2010: 147). Dokumentet mund të jenë si të shkruar ashtu dhe në formën e deklaratave, fjalimeve apo intervistave. Dokumentet e rëndësishme për këtë punim, variojnë nga dokumentet strategjik të aktorëve kryesor e deri

tek deklaratat e tyre. Disa nga aktorët kryesor, tek të cilët mbështeten të dhënat cilësore të punimit, janë:

- Dokumente të Komisionit European, Këshillit European, institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare (në kontekstin European);
- Deklarata të krerëve të këtyre institucioneve dhe aktorëve të rëndësishëm në sistemin ndërkombëtar si SHBA, NATO dhe Rusi.

Për të identifikuar dhe analizuar implikimet e sigurisë energjetike në sigurinë ndër/kombëtare, punimi mbështetet tek analiza e tekstit, specifikisht tek diskuri i aktorëve dhe dokumentet e tyre strategjik. Një fokus i veçantë në punim i kushtohet sigurizimit të çështjeve energjetike, prandaj sikurse argumenton dhe Buzan: “Sigurizimi mund të studiohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk ka nevojë për indikatorë. Mënyra e studimit të sigurizimit është nëpërmjet studimit të diskurit dhe konstelacioneve politike” (Buzan et al., 1998: 25). Analiza e diskurit (ligjëritimit) mbështete në teorinë konstruktiviste, me premisat bazë: realiteti është një konstrukt social dhe individët nuk mund të jenë plotësisht objektivë. Qëllimi i përdorimit të analizës së diskurit lidhet me identifikimin e kuptimeve dhe ndërtimin e retorikës, nëpërmjet analizimit të ndërtimit të fjalive, llojit të fjalëve të përdorura, vendosjen e theksit, etj. (Obradovic & Wochnik, 2013: 33).

Ndërsa dokumentet shërbejnë si për mbledhjen e të dhënave ashtu edhe për analizimin e tyre. Sipas Atkinson et.al, “Dokumentet janë ‘fakte shoqërore’ në kuptimin se ato prodhohen, shkëmbehen dhe përdoren në mënyra të organizuara shoqërisht” (në Matthws & Ross, 2010: 277). Përdorimi i dokumenteve bëhet si për të përdorur të dhënat faktike që gjenden në to ashtu edhe për të analizuar kontekstin e krijimit të tyre dhe efektet që ato mund të kenë. Të dhënat që përfitohen nga përdorimi i dokumenteve janë si sasiore ashtu edhe cilësore, prandaj përdorimi i tyre është i përshtatshëm në funksion të punimit.

Për përdorimin e analizës së tekstit si metodë për analizimin e të dhënave, punimi ngre disa pyetje?

- Cili është burimi/autori i tekstit?
- Çfarë ndikimi ka ai në sistemin kombëtar apo ndërkombëtar?
- Cili është konteksti i hartimit të tekstit?
- Teksti, është pasqyrim i realitetit apo ndikon në krijimin e tij?
- Cilët janë interesat, qëllimet, objektivat apo mesazhet direkte dhe indirekte të tekstit?
Kujt i drejtohen ato?
- Si dhe kur përdoret një frazë? Përse?

Të gjithë këto element janë të rëndësishëm në analizimin e të dhënave të punimit, në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave të punimit, të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të tij. Përdorimi i të dhënave të kombinuara ndihmon jo vetëm në pasurimin e të dhënave të punimit, por edhe verifikimin e besueshmërisë dhe rëndësisë së tyre.

1.4. Kufizimet dhe risitë e punimit

Kufizimet e punimit, të cilat mund të përbëjnë dhe kufizime metodologjike, lidhen kryesisht me objektin e analizës, pasi përcaktimi i sigurisë energjetike në kontekstin European si objekt analize është relativisht i gjerë, duke qenë se përfshin shumë faktor dhe variabla të cilët nuk mund të trajtohen brenda një punimi të vetëm. Por duke marrë në konsideratë ndërvarësinë e aktorëve brenda këtij konteksti, studimi i sigurisë energjetike i një aktori nuk mund të jetë i plotë pa analizën e situatës në nivelin European. Mbledhja dhe analizimi i të dhënave shoqërohen gjithashtu me disa kufizime, të cilat janë kryesisht kufizime metodologjike. Këto kufizime kanë të bëjnë me sasinë e madhe të të dhënave në dispozicion, vështirësitë në përzgjedhjen e deklaratave apo dokumenteve më të

përshtatshme, ndikimin e variablave të jashtëm në situatën e sigurisë energjetike dhe larminë e dinamikave të brendshme në secilin nivel të analizës, të cilat ndikojnë në kontekstin energjetik European në tërësi.

Me qëllim minimizimin e pasojave që vijnë nga një kufizim i tillë, punimi e tejkalon këtë problematikë nëpërmjet:

- *Përdorimit të analizës në tre nivele* – duke e konsideruar kontekstin European si një rast studimor, përzgjedhja e tre niveleve (BE, Ballkan & Shqipëri) ndihmon në vendosjen e një koherence të brendshme të punimit.
- *Operacionalizimit të sigurisë energjetike* – pavarësisht se siguria energjetike përbëhet nga shumë dimensione dhe variabla, punimi fokusohet vetëm tek varësia energjetike dhe diversifikimi i burimeve energjetike.
- *Përzgjedhjes së një numri të vogël produktesh energjetike* – produktet energjetike janë të larmishme, nga ato tradicionale tek burimet e reja alternative, por punimi fokusohet kryesisht tek burimet fosile, si nafta dhe gazi natyror dhe burimet hidrike në nivelin e tretë të analizës, Shqipërisë.
- *Fokusimi tek një numër i kufizuar treguesish mbi implikimet e sigurisë energjetike në sigurinë ndër/kombëtare* – punimi fokusohet tek diskuri i aktorëve dhe dokumentet strategjike kryesore. Lidhur me aktorët e jashtëm që ndikojnë në sigurinë energjetike në kontekstin European, fokusi vendoset tek Rusia, e cila ka ndikimin më të madh në këtë aspekt, por që nuk është e vetmja.
- *Kufizimit kohor* – punimi fokusohet në një periudhë kohore nga 2005 deri në 2015. Viti 2005 përzgjidhet për shkak se në këtë moment siguria energjetike fillon të bëhet pjesë e politikave të larta në vendet Europiane, si pasojë e perceptimit të rrezikut që vinte nga varësia e lartë nga Rusia.

Risitë kryesore të këtij punimi, janë:

- Studimet e mëparshme mbi implikimet e sigurisë energjetike në sigurinë ndër/kombëtare (bazuar në rishikimin e literaturës) në aspektin disiplinës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe çështjeve të sigurisë ngrihen kryesisht në premisat e qasjeve neo/realiste, neo/liberale apo ato gjeopolitike. Risia e këtij punimi në aspektin teorik lidhet me aplikimin e Shkollës së Kopenhagenit, dhe konkretisht analizës sektoriale të sigurisë, RCST dhe sigurizimit. Kjo qasje ndërthur element nga qasjet e mësipërme.
- Studimet e mëparshme fokusohen kryesisht në një nivel të vetëm, ndërsa ky punim e fokuson analizën në tre nivele dhe konkretisht në nivel të BE-së, Ballkanit dhe Shqipërisë. Kjo përzgjedhje është bërë për shkak se pavarësisht diferencave midis njësive të analizës, ato ndikojnë dhe ndikohen nga njëra – tjetra.
- Punimi ndërthur të dhënat sasiore të cilat analizohen në kuadër të situatës energjetike në këto njësi analize, me të dhënat cilësore të bazuara në diskurin e aktorëve kryesor dhe dokumentet e tyre strategjike.
- Bazuar në rishikimin e literaturës ekzistuese mbi situatën energjetike në Shqipëri dhe implikimet e saj në sigurinë kombëtare, vihet re se studime të mirëfillta teoriko – aplikative janë të kufizuara, pasi ato ekzistuese ose janë në nivelin e artikujve ose mbështeten vetëm në të dhënat sasiore dytësore.
- Përdorimi i një qasje analitike mbi sigurinë energjetike në Shqipëri dhe i analizës kritike të dokumenteve kryesore strategjike, janë një vlerë e shtuar e këtij punimi.

1.5. Struktura e punimit

Punimi është i ndërtuar në shtatë kapituj, nga kapitulli i parë hyrës e deri tek kapitulli i fundit, konkluzione dhe rekomandime. Këto kapituj janë pjesë e një sistemi të vetëm, të lidhur me temën e punimit “*Siguria energjetike në kontekstin European – midis varësisë si kërcënim dhe diversifikimit si prioritet*”, në bazë të një koherence të brendshme. Kapitujt e analizës janë të konceptuar nga niveli makro (BE-ja) e deri tek niveli mikro i analizës (Shqipëria). Kjo nënkupton se paraqitja e të dhënave dhe analizimi i tyre zhvillohet në secilin kapitull, të cilët përkojnë me tre nivelet e analizës mbi të cilat mbështetet punimi.

Kapitulli i parë, i cili është dhe hyrja e punimit përfshin element të tillë si: parashtrimi i problematikës, përcaktimi i qëllimit dhe objektivave të punimit, ngritja e pyetjeve kërkimore dhe hipotezave, metodologjia e punimit, sikurse kufizimet dhe risitë e punimit.

Kapitulli i dytë, fokusohet në analizimin e evoluimit të konceptit të sigurisë, sikurse dhe në terminologjinë, rëndësinë dhe dimensionet e sigurisë energjetike. Koncepti i sigurisë energjetike, rëndësia dhe qasjes ndaj saj, nuk mund të kuptohen pa pasur një tablo të qartë të evoluimit të konceptit të sigurisë. Thellimi dhe zgjerimi i konceptit të sigurisë, ofroi kontekstin e përshtatshëm për përfshirjen e energjisë si çështje sigurie, duke e bërë atë pjesë të politikave të larta dhe procesit të sigurizimit. Në këtë kapitull zhvillohet etapa e rishikimit të literaturës, nëpërmjet përdorimit të një qasje analitike mbi sigurinë, me fokus tek ajo energjetike. Kapitulli mbyllet me një seksion i cili ka kryesisht karakterin e përmbledhjes.

Kapitulli i tretë përbën kuadrin teorik të punimit. Duke qenë se siguria energjetike mund të analizohet nëpërmjet qasjeve të ndryshme të marrëdhënieve ndërkombëtare, punimi nis me dy qasjet tradicionale – realizmin dhe liberalizmin. Qasja e tretë e analizuar në

funksion të sigurisë energjetike është qasja konstruktiviste, duke u fokusuar tek Shkolla e Kopenhagenit si një nën disiplinë e kësaj qasje. Në këtë kapitull, identifikohen dhe analizohen premiset bazë të këtyre qasjeve, dhe argumentohet përzgjedhja e Shkollës së Kopenhagenit si qasja më e përshtatshme për punimin.

Kapitulli i katërt, përkon me nivelin e parë të analizës së punimit, konkretisht me nivelin e BE-së. Kapitulli nis me një vështrim të përgjithshëm mbi situatën e sigurisë energjetike në nivel global, një kontekst i cili ndihmon në një identifikim dhe analizim më të mirë të sigurisë energjetike në nivelin e BE-së. Kapitulli fokusohet si në treguesit energjetik të BE-së, ashtu edhe në analizimin e implikimeve të sigurisë energjetike në sigurinë ndër/kombëtare, si në diskurin e aktorëve kryesorë ashtu edhe tek dokumentet strategjik të tyre. Analizimi i krizës midis Rusisë dhe Ukrainës dhe i implikimeve të saj për kontekstin European të sigurisë energjetike, përbën një rast studimor brenda këtij kapitulli. Për më tepër, në këtë kapitull identifikohet dhe ndikimi i sigurisë energjetike i BE-së në gadishullin e Ballkanit, i cili përbën dhe nivelin e dytë të analizës së këtij punimi.

Kapitulli i pestë, i fokusuar tek siguria energjetike në Ballkan paraqet fillimisht situatën energjetike në rajon, nëpërmjet përdorimit të një qasje analitike dhe më pas fokusohet tek identifikimi i aktorëve që ndikojnë në këtë situatë sikurse dhe niveli i bashkëpunimit midis aktorëve të këtij rajoni. Ndikimi i Rusisë dhe implikimet e Trans Adriatic Pipeline (TAP), si për rajonin ashtu dhe për të gjithë kontekstin European, përbëjnë analizën kryesore të kapitullit. Si niveli i mesëm i analizës, ky kapitull shërben si lidhje midis nivelit të BE-së dhe atij shqiptar të analizës, duke krijuar në këtë mënyrë koherencën e brendshme të punimit në funksion të temës kryesore.

Kapitulli i gjashtë, rasti i Shqipërisë si niveli mikro i analizës, fokusohet në analizimin e situatës energjetike, sfidave dhe mundësive të tij, sikurse dhe në implikimet

rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë energjetike. Varësia energjetike dhe diversifikimi i burimeve energjetike përbëjnë një moment të rëndësishëm në këtë kapitull. Analiza e dokumenteve kryesore strategjike si: Strategjia Kombëtare e Energjisë, Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, janë një vlerë e shtuar e punimit.

Punimi mbyllet me konkluzionet dhe rekomandimet finale, të cilat janë rrjedhoja logjike të kapitujve pararendës të punimit, në funksion të dhënies përgjigje për pyetjet kryesore dhe mbrojtjen e hipotezave fillestare.

Kapitulli II: Evoluimi i konceptit, terminologjia dhe dimensionet e sigurinë energjetike

2.1. Evoluimi i konceptit të sigurisë – thellimi dhe zgjerimi i tij

Përfundimi i Luftës së Ftohtë u shoqërua më një ri konfigurim tërësor, si të sistemit ndërkombëtar ashtu dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Çështjeve të Sigurisë si disiplina studimore. Koncepti i sigurisë është interpretuar prej një kohe të gjatë si: “siguri e territorit nga agresioni i jashtëm, si mbrojtje e interesit kombëtar në politikën e jashtme apo si siguri globale ndaj kërcënimit të një holokausti nuklear” (UNDP, 1994: 22). Në këtë periudhë, u vu re se një trajtim dhe përkufizim i tillë ishte i pa përshtatshëm me realitetin e ri të krijuar, prandaj këto disiplina studimore pësuan një transformim dy dimensional.

Dimensioni i parë – *dimensioni horizontal* – nënkupton zgjerimin e fokusit të studimeve, duke përfshirë dhe marrë në konsideratë një gamë të gjerë të kërcënimeve jo – tradicionale si terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi fetar, gjenocidi dhe spastrimet etnike, shtetet e dështuara, problemet mjedisore, degradimi dhe ezaurimi i resurseve, etj. Dimensioni i dytë – *dimensioni vertikal* – nënkupton përfshirjen në studime të një analize shumë nivelore; sistem, shtet, individ [sikurse dhe të disa nën niveleve të tjera të cilat do të trajtohen në vijim]. Nëse më parë studimi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Çështjeve të Sigurisë fokusohej kryesisht në nivelin shtetëror të analizës, pas viteve '90 fillon të marrë një rëndësi të veçantë si niveli sistematik ashtu dhe niveli individual i analizës, duke çuar deri në lindjen e qasjeve humano-centrike.

Pavarësisht rëndësisë dhe literaturës voluminoze që trajton këtë çështje, akoma mungon një përkufizim i gjithë pranuar lidhur me këtë term. Teoricienët që kanë pasur në fokus të punës së tyre konceptin dhe qasjet mbi sigurinë, mbajnë qëndrime të ndryshme lidhur me trajtimin që i është bërë këtij koncepti. Siguria ka shumë kuptime, disa prej të

cilave nuk janë domosdoshmërisht të lidhura logjikisht me kuptimin konvencional mbi të (Dalby, 1997: 6). Kjo ndodh për arsyen se aktorë të ndryshëm ndajnë kuptime të ndryshme lidhur me konceptin e sigurisë në bazë të bindjeve, preferencave dhe interesave të tyre. Nga një ‘subjektivizëm’ i tillë nuk përjashtohet asnjë nga aktorët, pavarësisht nëse ata vijnë nga sfera politike, ushtarake, ekonomike, mjedisore, sociale apo edhe akademike. Kjo tregon se është në interesin e aktorëve që një situatë e tillë të vijojë dhe në të ardhmen, si e vetmja mënyrë për të lënë hapësirë për interpretime dhe përdorime të ndryshme të këtij koncepti. Në këtë kontekst, argumentohet se fusha e studimeve të sigurisë vuan nga mungesa e një kuptimi të përbashkët, “duke ngritur pyetjen nëse ajo është një qëllim, koncept, program kërkimor apo një disiplinë” (Haftendorn, 1991: 3).

Barry Buzan është një ndër teoricienët kryesor që ka trajtuar konceptin e sigurisë dhe qasjeve ndaj saj. Ai argumenton se koncepti i sigurisë është shumë pak i zhvilluar dhe se “literatura ekzistuese mbi të fokusohet kryesisht në konceptin e fuqisë dhe të paqes” (1991: 1). Këto janë dy koncepte kyç të cilat qëndrojnë në themel të dy prej qasjeve kryesore të Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Fuqia është koncepti themelor i qasjes së realizmit tradicional, i përfaqësuar nga teoricienë të tillë si Carr dhe Morgenthau. Ndërsa paqja është një koncept themelor për qasjet idealiste. Mund të themi se koncepti i sigurisë është themelor në qasjen konstruktiviste, ku Buzan mund të konsiderohet si një ndër përfaqësuesit më dinjitoz të saj. Një nga tentativat më të rëndësishme në lidhje me zgjerimin e axhendës së sigurisë është përpunuar nga Buzan. Ai argumenton se siguria e njerëzimit ndikohet nga faktorë të përfshirë në pesë sektorë kryesorë: ushtarak, politik, ekonomik, shoqëror dhe mjedisor (Buzan, 1991: 20).

Në librin e tij *'People, States, and Fear – The National Security Problem in International Relations'* (1991), Buzan liston pesë arsye të mos zhvillimit të konceptit të sigurisë, pavarësisht përdorimit të gjerë të saj. Këto arsye sipas tij janë:

Së pari, koncepti i sigurisë është shumë kompleks, çka ka bërë që studiuesit të mos tërhiqen nga ai por të neglizhohet në favor të koncepteve të tjera më tërheqëse.

- *Së dyti*, është bërë një mbivendosje midis konceptit të sigurisë dhe konceptit të fuqisë, sikurse është argumentuar nga realistët. Siguria shikohej si një derivat i fuqisë, kryesisht i fuqisë ushtarake.
- *Së treti*, kundërshtimet ndaj paradigmës realiste çuan drejtë zhvillimit të konceptit të paqes, duke lënë mënjanë konceptin e sigurisë. Duke u fokusuar në politikat e paqes, kontrollit të përhapjes së armëve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, studiuesit e këtij grupimi nuk arritën të kuptonin dhe vlerësonin rëndësinë e konceptit të sigurisë.
- *Së katërti*, vetë natyra e Studimeve Strategjike, si e fokusuar në zhvillimet e reja dhe karakteristikë e vendeve të fuqishme, ndikoi në këtë drejtim. Duke u fokusuar në perspektivat afat – shkurtra dhe horizontet empirike, kjo nën disiplinë nuk përfshiu në fokusin e saj sigurinë si një koncept themelor.
- *Së pesti*, është në interesin e politik-bërësve për të ruajtur ambiguitetin e konceptit të sigurisë, pasi ai është një instrument i nevojshëm për justifikimin e veprimeve dhe politikave të ndryshme të cilat prekin interesa të ndryshme, në shtete dhe në momente të ndryshme.

Pavarësisht se me kalimin e viteve literatura mbi konceptin e sigurisë dhe qasjeve ndaj saj ka ardhur duke u pasuruar në mënyrë të vazhdueshme, ri shqyrtimi i literaturës dëshmon për vlefshmërinë e këtij konstatimi edhe në ditët e sotme. Fakti që mungon një konsensus i gjithë pranuar mbi një koncept, qoftë koncepti i sigurisë apo koncepte të tjera

thelore, nuk nënkupton se koncepti në fjalë nuk ka rëndësi analitike apo praktike. Një situatë e tillë vjen si pasojë e rëndësisë dhe ndikimit të elementëve kontekstual, bindjeve, preferencave dhe interesave mbi operacionalizimin e koncepteve. Një tjetër studiues i rëndësishëm i cili ka trajtuar konceptin e sigurisë dhe qasjeve ndaj saj është dhe David Baldwin, i cili bën një trajtesë të hollësishme të këtij koncepti në artikullin e botuar në *Review of International Studies*, ‘The concept of security’ (1997). Baldwin e nis analizën e tij duke konstatuar se “ri përkufizimi i sigurisë është përhapur gjerësisht...përpyqje të cilat janë të fokusuara më shumë në ri përkufizimin e axhendave politike të shteteve – kombe, sesa në konceptin e sigurisë në vetvete” (1997: 5). Në këtë moment, vihet re një pikë e përbashkët e tij me Buzan për sa i përket idesë se koncepti i sigurisë nuk është adresuar në mënyrën e duhur. Puna e Baldwin ka në themel të saj idetë e një tjetër studiuesi, Arnold Wolfers, i cili konstatonte ambiguitetin e këtij koncepti në esenë e tij klasike ‘National Security as an Ambiguous Symbol’.

Duke vazhduar në të njëjtën linjë dhe duke e thelluar akoma më tej analizën, Baldwin e përkufizon sigurinë si një gjendje “me një probabilitet të ulët të dëmtimit të vlerave të fituara” (1997: 9). Kjo nënkupton se qasja e tij nuk fokusohet në praninë apo mungesën e kërcënimeve, por e vë theksin në ruajtjen e vlerave të fituara [vlerat në këtë kuptim marrin trajta të ndryshme, si materiale ashtu edhe spirituale/identitare]. Ai argumenton për domosdoshmërinë e mbajtjes në konsideratë dhe dhënies përgjigje të disa pyetjeve në momentin kur duam të bëjmë analiza me në qendër konceptin e sigurisë, të formulojmë apo implementojmë politika dhe strategji (1997: 13 – 17).

- *Siguri për kë?* – Nëpërmjet dhënies përgjigje për këtë pyetje, specifikohet dhe objekti referues. Sikurse do të shihet dhe në vijim, identifikimi i objektit referues është shumë i rëndësishëm si në ato raste kur bëhen analizë konceptuale ashtu dhe në

ato raste kur formulohen strategji apo ndërmerren politika për të adresuar çështje apo probleme të caktuara. Kjo pyetje është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me nivelin në të cilën do të aplikohet analiza, strategjia apo politika. Objekti referues mund të jetë sistemi, shteti ose individ [ndërmjet këtyre kategorive kryesore gjenden dhe disa nën kategori të tjera sikurse mund të jenë rajone, grupe të caktuara, sektorë, etj.].

- *Siguri për cilat vlera?* – Aktorët shtetëror dhe ato jo shtetëror kanë vlera të ndryshme, implikimet e të cilave mund të jenë si bashkëpunuese dhe në harmoni me njëra – tjetrën, ashtu dhe në tension apo konfliktuale. Disa prej këtyre vlerave mund të jenë të qëndrueshme në kohë e disa të tjera mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe marrin formë e rëndësi në bazë të kontekstit, bindjeve dhe interesave. Në aspektin studimor, qasja teorike e përdorur apo e mbështetur përcakton në një farë mase dhe vlerat e aktorëve. Këto vlera variojnë nga siguria fizike, mirëqenia ekonomike, autonomia, mirëqenie psikologjike, etj. Tradicionalisht, koncepti i sigurisë kombëtare ka përfshirë pavarësinë politike dhe integritetin territorial si vlera të cilat duhen mbrojtur. Sikurse është theksuar dhe nga Wolfers (1952), është e nevojshme të bëhet dallimi midis dimensioneve objektive dhe dimensioneve subjektive të sigurisë. Ky dallim ka si analogji të tij kërcënimet reale dhe kërcënimet potenciale ndaj sigurisë apo vlerave të aktorëve të ndryshëm. Një ndarje e tillë i lejon aktorët të formulojnë dhe implementojnë strategjitë apo axhendat e tyre politike në bazë të vlerësimeve, bindjeve, perceptimeve dhe interesave të tyre.
- *Sa siguri?* – Kjo është një pyetje e cila përbën debat për studiues të ndryshëm. Nga ri shqyrtimi i literaturës mbi sigurinë dhe qasjet ndaj saj, vihet re një ndarje midis atyre të cilët e shohin sigurinë në terma sasior dhe atyre që e shohin sigurinë në terma

cilësor. Për studiues të tillë si Wolfers, siguria mund të trajtohet në terma sasior dhe ajo [siguria] “është një vlerë të cilën kombet mund ta kenë më shumë apo më pak dhe ata mund të aspirojnë që ta kenë atë në një masë më të madhe ose në një masë më të vogël” (1952: 484). Ndërsa studiues të tjerë argumentojnë se një aktor ose është i sigurtë ose nuk është, ato nuk mund të jenë pjesërisht të sigurtë (Buzan, 1991). Nëse këtë debat do ta zhvendosim brenda qasjes neorealiste të marrëdhënieve ndërkombëtare, analogjia do të ishte e njëjtë me debatin midis neorealistëve defensiv dhe ofensiv. Neorealistët defensiv, si Kenneth Waltz argumentojnë se shtetet kërkojnë të mbijetojnë dhe kanë pak interes për pushtime ushtarake pasi kostot përgjithësisht tejkalojnë përfitimet, “shqetësimi kryesor i shteteve nuk është maksimizimi i fuqisë por ruajtja e pozicionit në sistem” (1979: 126). Në këtë këndvështrim, lufta është më shumë e mundshme të ndodhë kur shtetet mund të pushtojnë lehtësisht njëri-tjetrin. Kur mbrojtja është më e lehtë se sulmi, siguria është më e mundshme dhe për pasojë mund të ndodhë dhe bashkëpunimi midis shteteve. Një situatë e tillë do të ndikonte në nivelin e sigurisë të aktorëve të përfshirë në këtë bashkëpunim. Në ndryshim nga neorealistët defensiv, për neorealistët ofensiv si John Mearsheimer, “kërkimi për fuqi dhe siguri është i vazhdueshëm dhe qëllimi përfundimtar i një shteti është hegjemonia në sistem” (2001: 21). Sikurse do të shihet dhe në vijim, koncepti i qasjes realiste mbi sigurinë shpeshherë është kritikuar si shumë i ‘ngushtë’ për të qenë i përshtatshëm me dimensionet e shumta të sigurisë. Shteto – centrizmi i qasjes tradicionale mbi sigurinë është produkt i faktit se qasja vetë është e bazuar mbi qasjen realiste të politikave ndërkombëtare.

- *Nga cilat kërcënime?* – Kjo pyetje lidhet me dy aspekte të diskutuara dhe më parë gjatë punimit.
 1. Aspekti i parë lidhet me dallimin midis kërcënimeve reale dhe kërcënimeve potenciale. Aktorët, në bazë të analizave të tyre sa objektive aq dhe subjektive, mund të klasifikojnë kërcënimet në njërën nga dy kategoritë e mësipërme. Është e nevojshme të theksohet se këto klasifikime nuk janë të ngurta pasi ato mund të ndryshojnë në bazë të faktorëve kontekstual, perceptimeve, bindjeve apo interesave të aktorëve.
 2. Aspekti i dytë lidhet me zgjerimin e fokusit të sigurisë. Nëse qasja tradicionale mbi sigurinë lidhej me mbrojtjen e integritetit territorial dhe pavarësinë politike, pas viteve '90, në axhendat e aktorëve të sistemit ndërkombëtar u përfshinë dhe kërcënime të tjera të reja të lidhura me terrorizmin, fundamentalizmin fetar, shtetet e dobëta, epidemitë, varfërinë, ndryshimet klimaterike, resurset energjetike, etj.
- *Me cilat mjete?* – Sikurse dhe në rastet e tjera, përgjigja për këtë pyetje varet si nga qasja teorike e përdorur kur zhvillohen analiza studimore ashtu dhe nga faktorët kontekstual, perceptimet apo interesat e aktorëve. Në këtë situatë, gama e mundshme e mjeteve të përshtatshme për të trajtuar çështjet e sigurisë mund të jetë shumë e larmishme. Sidoqoftë është e nevojshme të theksohet se në këtë moment, resurset në dispozicion, si kapacitete materiale ashtu edhe ato humane janë shumë të rëndësishme dhe vendimtare në këtë aspekt.
- *Me çfarë kostosh?* – Garantimi apo përpjekja për garantimin e sigurisë gjithmonë shoqërohet me kosto, me sakrifikimin e qëllimeve të tjera në emër të sigurisë. Kostot mund të jenë nga më të ndryshmet, nga ato materiale dhe financiare tek ato

njerëzore, morale apo të drejtat themelore të njeriut. Kostot janë element thelbësor të cilat duhen mbajtur në konsideratë në momentin e hartimit dhe implementimit të politikave apo strategjive.

- *Në çfarë periudhe?* – Koha është një tjetër element thelbësor në momentin që trajtohen çështjet e sigurisë. Si kërcënimet ashtu dhe masat, politikat apo strategjitë që trajtojnë çështjet e sigurisë mund të jenë në terma afat – shkurtër, afat – mesëm apo afat – gjatë. Shpeshherë midis këtyre periudhave kohore mund të lindin dhe konflikte; politikat afat – shkurtra të pa analizuara mirë mund të bien ndesh me politikat – afatgjata të një aktori, duke dëmtuar në këtë mënyrë interesat e tij.

Në mënyrë të përmblodhur mund të themi se mungesa e një përkufizimi të gjithë pranuar lidhur me konceptin e sigurisë përcaktohet nga katër faktor themelor:

- Së pari, niveli i analizës – individ, shtet, sistem; sikurse dhe kombëtar, rajonal apo global.
- Së dyti, sektori ku aplikohet – politik, ushtarak, ekonomik, shoqëror dhe mjedisor, apo sektor të tjerë të ndërmjetëm.
- Së treti, aktorët – aktorë shtetëror apo jo-shtetëror sikurse dhe interesat e tyre.
- Së katërti, qasjet teorike – qasjet teorike shpeshherë përcaktojnë si përkufizimin e konceptit të sigurisë ashtu dhe rëndësinë e elementëve themelor të tij.

Problematikat e mësipërme lidhur me konceptin e sigurisë dhe qasjeve ndaj saj, është e njëjtë dhe në rastin e sigurisë energjetike, koncept i cili është themelor në këtë punim doktoral. Si vështirësitë lidhur me arritjen e një përkufizimi të gjithë pranuar, ashtu dhe ndikimi që ka niveli i analizës apo bindjet, preferencat, faktorët kontekstual dhe interesat e aktorëve, janë prezent në literaturën por edhe praktikën e çështjeve të sigurisë

energjetike. Këto element do të trajtohen në mënyrë më të detajuar në seksionet vijuese të këtij punimi.

2.2. Terminologjia dhe rëndësia e sigurisë energjetike

Energjia qëndron në zemër të zhvillimit të çdo shoqërie, si në planin ekonomik, politik ashtu edhe në atë social. Impakti i sigurisë energjetike si në politikën e jashtme ashtu edhe në ekonominë globale është evidentuar si në aspektin teorik ashtu dhe në atë praktik. Industrializimi, rritja e popullsisë dhe e nivelit të jetesës janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me konsumin e energjisë. “Sa më komplekse dhe produktive të jetë një shoqëri, aq më e madhe është kërkesa për energji; pa një furnizim të përshtatshëm me energji, një shoqëri komplekse nuk mundet të zhvillojë industrinë e saj, të ofroj një nivel të përshtatshëm jetese për qytetarët e saj, apo të mbrohet nga fuqitë konkurruese” (Clare, 2013: 536).

Konsumi global i energjisë po rritet me ritme të shpejta dhe do vazhdojë këtë trend edhe në vitet në vazhdim. Për ato vende ku kërkesa për energji po rritet në mënyrë shumë të shpejtë, si Kina dhe India, aftësia e tyre për t’u përshtatur me rregullat e një varësie të re nga tregjet botërore do të jetë e rëndësishme për sigurinë e tyre energjetike (Yergin, 2006). Në të njëjtën kohë, burimet energjetike fosile të cilat përbëjnë rreth 80% të kësaj kërkesë, po shkojnë drejtë shterimit. Ky raport midis kërkesës dhe ofertës është një tregues i rëndësishëm për të dëshmuar nevojën e garantimit të sigurisë energjetike. Bazuar në të dhënat e Departamentit të Energjisë të SHBA-së, konsumi i energjisë pritet të rritet me 56 % deri në vitin 2035, ku rreth 65 % e kësaj rritje të konsumit do të jetë në vendet Aziatike. Vetëm Kina dhe India, mendohet se do të dyfishojnë konsumin e tyre të energjisë në këtë periudhë kohore (USDoE, 2010).

Por çfarë nënkuptohet me siguri energjetike? Tradicionalisht, siguria energjetike i është referuar garantimit të furnizimit me naftë. Kriza e naftës që preku botën në vitet 1970, ishte një nga moment kyçe në të cilin shtete të ndryshme, kryesisht shtetet e industrializuara perëndimore, filluan të shqetësohen në lidhje me sigurinë energjetike dhe rëndësinë e saj. Edhe pse nafta mbetet akoma një nga burimet më të rëndësishme të energjisë, është e domosdoshme të merret në konsideratë rritja e kompleksitetit të sistemeve dhe burimeve të energjisë. Pavarësisht se ekziston një literaturë voluminoze dhe janë zhvilluar një sërë debatesh mbi atë që i referohemi si siguri energjetike, akoma mungon një konsensus mbi përkufizimin e këtij termi. Rëndësia e një përkufizimi mbi konceptin e sigurisë energjetike, nuk lidhet vetëm me aspektet teorike por përcakton dhe aspektet praktike të trajtimit të kësaj çështje; nga formulimi dhe implementimi i strategjive dhe politikave energjetike efikase, deri tek masat konkrete që duhen ndërmarrë nga aktorët e përfshirë në këtë sistem.

Koncepti i sigurisë energjetike është një koncept ombrellë i cili përfshin një sërë variablash komplekse, të cilët marrin formë dhe rëndësi në bazë të pozicionit që ka secili shtet në raport me burimet energjetike. Siguria energjetike përbën sot një shqetësim kryesor për mbijetesën dhe mirëqenien si për vendet e zhvilluara, ashtu dhe për vendet në zhvillim. Siguria energjetike mund të përkufizohet si “një gjendje në të cilën një komb, shtetasit [pjesa më e madhe] dhe industria e tij të kenë akses në burime adekuate të energjisë me çmim të arsyeshëm për të ardhmen e parashikueshme, të lirë nga rreziqet serioze për mungesën e këtij shërbimi” (Hancher & Jansen, 2004: 5).

Pasiguria mund të jetë rrjedhojë e një sërë faktorësh, si: paqëndrueshmëria gjeopolitike, fatkeqësitë natyrore, terrorizmi apo mungesa e investimeve (Redegwell, 2004). Në thelbin e saj, “siguria energjetike nënkupton aksesin e sigurtë në burimet e nevojshme të energjisë me një çmim të përballueshëm, akses i cili duhet të jetë indiferent ndaj

ndërprerjeve – pasi burimet alternative të furnizimit duhet të jenë në dispozicion me një çmim të përballueshëm dhe në sasi të mjaftueshme” (Ebinger, 2011: Paragrafi I). Në një raport të Departamentit të Energjisë dhe Ndryshimeve Klimaterike të Parlamentit Britanik, siguria energjetike përkufizohet si “ekzistenca e një sistemi të sigurtë energjetik që është në gjendje për të përmbushur nevojat e njerëzve dhe organizatave për shërbimet e energjisë të tilla si ngrohje, ndriçim apo vënie në lëvizje të mjeteve të transportit, në mënyrë të besueshme dhe të përballueshme si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen” (2011: seksioni III). Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, i referohet sigurisë energjetike si “disponueshmëria e pandërprerë e burimeve të energjisë me një çmim të volitshëm” (IEA, 2008).

Një tjetër përkufizim i rëndësishëm është dhe ai i përdorur nga *Asia Pacific Energy Research Center*, i cili mund të përmbledhet në 4 A-të e energjisë (APERC, 2007). Sipas tyre, siguria energjetike përkufizohet si “aftësia e një ekonomie për të garantuar disponueshmërinë e furnizimit me burime energjetike në mënyrë të qëndrueshme dhe në kohën e duhur, me një nivel të çmimeve që nuk do të ndikonte në performancën e ekonomisë” (APERC, 2007: 6). E njëjta linjë mendimi lidhur me përkufizimin e sigurisë energjetike është e përhapur gjerësisht në literaturën që trajton këtë çështje (Kruyet, Vuuren, Vries & Groenenberg, 2009; Verrastro & Ladislav, 2007; Komisioni European, 2000).

Studimi i APERC liston dhe faktorët që mund të influencojnë sigurinë energjetike, sikurse janë:

- Disponueshmëria e rezervave të lëndëve djegëse, si nga prodhimi i brendshëm ashtu dhe nga furnizuesit e jashtëm;
- Aftësia e një ekonomie për të garantuar kërkesën e projektuar të energjisë;
- Niveli i diversifikimit të burimeve energjetike dhe të furnizuesve të energjisë;

- Aksesit në burimet e lëndëve djegëse, e lidhur me disponueshmërinë e infrastrukturës energjetike;
- Problematikat gjeopolitike të lidhura me përvetësimin e burimeve.

Kërcënimi për sigurinë energjetike të një vendi apo një rajoni të caktuar, mund t'i përfshijë të gjithë faktorët e lartpërmendur ose disa prej tyre, por çdo shtet duhet t'i marrë në konsideratë të gjithë këto element në momentin e formulimit të strategjisë së tij energjetike dhe politikave energjetike që ndërmerr, si mënyra e vetme për të qenë në gjendje për t'u përballur me to. Gupta (2008) ofron një analizë të sigurisë energjetike bazuar mbi ndarjen e kërcënimeve ndaj saj në tre kategori kryesore. *Kategoria e parë* lidhet me përdorimin e teknologjive të ndryshme, të cilat paraqesin kërcënime teknike. *Kategoria e dytë* lidhet me rajonet gjeografike, duke u fokusuar mbi kapacitetet e brendshme të prodhimit të energjisë. Ndërsa *kategoria e tretë* lidhet me shtetet e veçanta, duke u bazuar në kapacitetet njerëzore të përfshirë në sistemin energjetik.

Kur flasim për siguri energjetike, nuk duhet të fokusohemi vetëm tek siguria e furnizimit, por duhet mbajtur në fokus dhe prodhimi i brendshëm i energjisë, sikurse dhe infrastruktura e këtij sektori. Në ditët e sotme, siguria energjetike përfshin të gjithë infrastrukturën energjetike, që nga burimi, tranzitimi e deri tek konsumatori fundor. Ky rrjet kompleks [tubacionet, depozitat, rafineritë, facilitetet depozituese dhe gjeneruese, linjat e transmetimit dhe sistemet e shpërndarjes] “nuk u dizajnua duke pasur parasysh përçarjet dhe terrorizmin, por operimi i tyre tashmë duhet menaxhuar nën potencialin e këtyre kërcënimeve të vazhdueshme” (Yergin, 2013).

Duke qenë se disa vende janë eksportuese, ndërsa disa të tjerë vende importuese apo tranzitore, atëherë edhe qasja e tyre ndaj sigurisë energjetike do jetë e ndryshme. Nëse për vendet importuese, shqetësimet në lidhje me sigurinë energjetike fokusohen tek furnizimi,

për vendet eksportuese, ekonomitë e të cilave bazohen në eksportin e energjisë, shqetësimi kryesor është siguria e kërkesës për energji. Ndërsa vendet tranzitore, e lidhin sigurinë energjetike me vazhdimin e funksionimit të korridoreve ekzistuese të transportimit të energjisë, shtimin e këtyre korridoreve, apo përfshirja në këtë sistem të shteteve të cilat më parë nuk kanë qenë pjesë e tij. Të jesh një vend tranzitor për energjinë, ka ndikim të drejtpërdrejtë si në aspektin ekonomik, por edhe politik të këtyre vendeve, pasi përftojnë një status të privilegjuar brenda këtij sistemi.

Paqëndrueshmëria dhe rritja e çmimeve të energjisë, rritja e shpejtë e kërkesës për energji në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, ndërprerjet e furnizimit për shkak të mosmarrëveshjeve midis shteteve (Ukrainë-Rusi), nevoja për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe reduktimi i varfërisë janë disa nga treguesit e rëndësishëm që energjia ka për globin në tërësi në ditët tona por edhe në të ardhmen. Përveç ‘kërcënimeve normale’ ndaj sigurisë energjetike, ekzistojnë dhe një sërë kërcënimesh të tjera si terrorizmi, rivalitetet gjeopolitike dhe de-stabiliteti politik në vendet eksportuese të cilat kanë implikim të drejtpërdrejtë në garantimin e sigurisë energjetike (Yergin, 2006). Pre e kërcënimeve të ndryshme mund të jenë si burimet energjetike, ashtu edhe infrastruktura energjetike apo edhe përdoruesit fundorë si sektorët e ndryshëm të ekonomisë dhe industrisë, sikurse dhe konsumatori i thjeshtë.

Daniel Yergin (2013) ofron një analizë të hollësishme mbi rëndësinë e sigurisë energjetike në shekullin 21. Duke mbajtur në konsideratë rritjen e varësisë nga sistemet energjetike, kompleksitetin e këtyre sistemeve dhe nevojën për të kuptuar rreziqet dhe kërkesat e sigurisë energjetike, është e rëndësishme të evidentohen dhe analizohen si dimensionet e reja të sigurisë energjetike ashtu edhe principet kryesore të saj. Sipas tij, “rreziku kryesor ndaj sigurisë energjetike në dekadat e ardhshme nuk është gjeologjia, por

gjeopolitika” (2013: 69). Kjo nënkupton se burimet alternative të energjisë dhe mirëmenaxhimi i burimeve të energjisë konvencionale ekzistuese mund të jenë element themelor dhe deri diku të mjaftueshëm për garantimin e sigurisë energjetike, por janë dhe do të jenë problemet gjeopolitike ato që do të përbëjnë kërcënimin kryesor ndaj sigurisë energjetike. Kjo dëshmohet mjaft qartë dhe nga ngjarjet që po zhvillohen në rajone të pasura me burime energjetike. Situata në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën Veriore janë shembuj të cilët dëshmojnë për kërcënimet gjeopolitike ndaj sigurisë energjetike. Harta e shtrirjes së këtyre problematikave është akoma dhe më e gjerë, duke nisur që nga Amerika e Jugut, në vende si Nigeria dhe Venezuela të cilat janë prodhuese të rëndësishme të naftës, për të vazhduar deri në Lindjen e Largët, ku burimet energjetike të përqendruara në zonat detare përbëjnë objekt rivaliteti dhe tensioni midis vendeve të atij rajoni.

Rivalitetet rajonale, shtetet e dobëta dhe lëvizjet terroriste janë të gjithë element të cilët përbëjnë kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj sistemit të furnizimit me energji. Sjellja e Rusisë dhe përdorimi i energjisë nga ana e saj si instrument presioni në politikën e jashtme, si me fqinjët e saj ashtu edhe në planin ndërkombëtar, janë një tjetër dëshmi e konstatimit sipas së cilit faktorët gjeopolitik përbëjnë dhe do të vazhdojnë të përbëjnë kërcënimin kryesor ndaj sigurisë energjetike në planin global. Zhvillimi ekonomik dhe rritja demografike në vende të tilla si Kina dhe India kanë ndikim të drejtpërdrejtë në tregun ndërkombëtar të energjisë, duke ndikuar në këtë mënyrë në nivelin e sigurisë energjetike për pjesën më të madhe të aktorëve global. Këto situata kërkojnë një angazhim diplomatik të drejtpërdrejtë të aktorëve kryesor, si SHBA dhe Kina, duke bërë që çështjet e lidhura me sigurinë energjetike të renditen në krye të axhendave të tyre politike. Fatkeqësitë natyrore dhe aksidentet kanë dëshmuar si për ndërvarësinë midis vendeve [prodhuese – transit – konsumatorë] ashtu dhe varësinë e lartë të gjithë sferave të jetës njerëzore ndaj energjisë.

Uragani Katrina dhe Rita të cilat goditën SHBA-të, incidenti i Fukushima në Japoni, *black – out* –et në Kinë dhe Indi, janë disa nga shembujt më ilustrativ të rëndësisë së sigurisë energjetike dhe vulnerabilitetit të kësaj infrastrukture si nga kërcënimet njerëzore, qofshin ato të qëllimshme apo aksidentale, ashtu dhe ato natyrore.

Ekzistojnë një sërë studimesh mbi çështjen e sigurisë së furnizimit me energji por ato që kanë në fokus të tyre gazin natyror si faktor gjeopolitik janë në një numër të kufizuar (CIEP, 2004; Correlje, 2006; Victor, 2007). Ndër studimet më të rëndësishme mbi projektet energjetike mund të përmendim studimin e Holz (2009) i cili analizon furnizimin me gaz për BE deri në vitin 2025 nëpërmjet modelit strategjik GASMOT. Ai argumenton se çështja e gazsjellësve përbën një problematikë të rëndësishme me implikime gjeopolitike të konsiderueshme si për vendet prodhuese, vendet transit dhe vendet konsumatorë të gazit natyror. Stern (2002) analizon ndikimin e varësisë nga importet e gazit natyror dhe ndikimin e diversifikimit të furnizimit me gaz me qëllim parandalimin e ndërprerjes së këtij shërbimi për vendet konsumatorë. Ai bën dallimin midis sigurisë energjetike afatshkurtër dhe afatgjatë dhe rolit të gazsjellësve në këtë drejtim. Lidhur me varësinë nga importi ai bën një kategorizim midis varësisë nga burimet, varësisë nga transiti dhe varësisë nga facilitetet.

Duhet theksuar se siguria energjetike është një sistem kompleks dhe i ndërvarur, i cili përfshin si politikat kombëtare, institucionet ndërkombëtare ashtu dhe aktorë të ndryshëm. Duke qenë se aktorët e përfshirë në procesin e prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit të energjisë janë kryesisht aktorë privat, institucionet shtetërore ndërhyjnë në këtë sistem nëpërmjet politikave të tyre energjetike. Duhet theksuar se në këtë marrëdhënie, përfshihen dy kategori aktorësh të cilët veprojnë në bazë të dy logjikave të ndryshme nga njëra – tjetra. Nga njëra anë kemi aktorët jo – shtetëror, kryesisht kompani të cilat udhëhiqen në bazë të logjikës së fitimit dhe nga ana tjetër kemi aktorët shtetëror të cilët

udhëhiqen në bazë të logjikës së sigurisë. Marrëdhënia midis tyre duhet të koordinohet në mënyrë të atillë, me qëllim harmonizimin e interesave dhe prosperitetin e përbashkët. Të dy aktorët duhet të kuptojnë se bashkëpunimi është elementi që lidh suksesin e aktorëve në përmbushjen e interesave të tyre.

2.3. Dimensionet dhe parimet e sigurisë energjetike

Duke qenë një fenomen kaq kompleks, siguria energjetike përbëhet nga një sërë dimensionesh (Von Hippel, 2009; Sovacool, 2009; Baumann, 2008; Yergin, 2006 & 2013; Vivoda, 2010). Në analizën e tij, Baumann (2008) identifikon katër dimensionet e sigurisë energjetike, të cilat janë:

- *Dimensioni i politikës së brendshme* – ky dimension lidhet me situatat dhe veçoritë e secilit nga aktorët e sistemit, si në të tashmen ashtu dhe në të ardhmen, dhe ndahet në tre përbërës kryesor: 1 – investimet infrastrukturore dhe mirëmbajtja e tyre, 2 – planet e emergjencës dhe politikat / strategjitë energjetike, dhe 3 – efica energjetike dhe energjia mix. Ky dimension lidhet me një nga katër A e sigurisë energjetike – *Availability* – disponueshmëria e burimeve energjetike, qofshin këto burime tradicionale apo burime të reja alternative.
- *Dimensioni ekonomik* – fuqia ekonomike e një vendi është element shumë i rëndësishëm në garantimin e sigurisë energjetike, duke u lidhur me – *Affordability* – Përballueshmëria e kostove financiare të aksesit në burimet e disponueshme energjetike. Përbërësit e këtij dimensionit janë tregjet energjetike, tregtia ndërkombëtare [e lidhur me infrastrukturën energjetike] dhe lidhshipitë teknologjike.
- *Dimensioni gjeopolitik* – duke pasur në konsideratë shpërndarjen gjeografike të burimeve energjetike, marrëdhëniet midis aktorëve të sistemit [prodhues,

konsumator, transit] dhe infrastrukturën e transportit të energjisë, themi se gjeopolitika luan një rol shumë të rëndësishëm në garantimin e sigurisë energjetike. Përbërësit kryesor të këtij dimensionit janë: 1 – rrjetet ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare; 2 – ri nacionalizimi i infrastrukturës energjetike; 3 – përdorimi i *soft power* nga shtetet importuese, në marrëdhëniet me shtetet eksportuese dhe transit të energjisë.

- *Dimensioni i politikave të sigurisë* – lidhet kryesisht me përballjen me kërcënimet ndaj sigurisë energjetike, për të cilat *soft power* është i pa mjaftueshëm. Kërcënime të tilla lidhen kryesisht me kërcënimet që vijnë nga terrorizmi apo piratëria. Përbërësit kryesor të këtij dimensionit janë: 1 – Siguria e Infrastrukturës Energjetike; dhe 2 – përdorimi i *hard power*.

Pavarësisht se siguria energjetike mund të identifikohet si e përbërë nga këto katër dimensionet, është e nevojshme të theksohet se dimensionet nuk operojnë në mënyrë të pavarur nga njëra – tjetra. Për pasojë, me qëllim garantimin e sigurisë së tyre energjetike, aktorët duhet të hartojnë dhe implementojnë politika dhe strategji energjetike multidimensionale dhe multilaterale. Duke u bazuar në punën e Von Hippel dhe Sovacool, Vivoda (2010) ofron një tjetër analizë multidimensionale të sigurisë energjetike duke formuluar atë që njihet si Instrumenti i Vlerësimit të Sigurisë Energjetike. Dimensionet e sigurisë energjetike të cilat merr në konsideratë ky instrument janë:

- *Furnizimi me energji* – ky dimension ka si përbërës të tij fraksionet e energjisë primare të importuar; diversifikimin e burimeve, llojeve dhe rrugëve të transportit të energjisë, kualitetin e prodhimit dhe transmetimit të energjisë elektrike; rezervat dhe rafineritë; dhe mbështetja tek mekanizmat e tregut për të garantuar importin dhe/ose eksportin e energjisë.

- *Menaxhimi i kërkesës* – përbëhet nga reduktimi i kërkesës për burimet fosile të energjisë si rezultat i iniciativave të ndryshme; dhe ekspozimi nga risqet e kërkesës (rritja e saj).
- *Eficienta* – e përbërë nga eficienta energjisë; dhe raporti midis rritjes së konsumit dhe rritjes ekonomike.
- *Ekonomik* – kostot totale të energjisë në raport me GDP; raporti midis importit dhe eksportit përmbi GDP; dhe ekspozimi ndaj risqeve fiskale.
- *Mjedisor* – mbështetja mbi burimet fosile të energjisë; emetimi i gazrave serë (CO₂, CH₄); emetimi i gazrave acid (SO_x, NO_x), ndotjet e tjera (ajri, uji, mbetjet), mbetjet nukleare; ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të lidhura me mjedisin si rritja e nivelit të ujit, ngrohja globale, kushtet ekstreme të motit, etj.
- *Siguria njerëzore* – duke i'u referuar përqindjes së popullatës me akses në shërbimet bazike të energjisë (ngrohje, gatim).
- *Siguria ushtarake* – ekspozimi i infrastrukturës kritike të energjisë ndaj kërcënimeve të tilla si terrorizmi, konfliktet për burimet, pirateria, sabotazhi, përhapja e arëve bërthamore).
- *Kushtet e brendshme socio-kulturore dhe politikat* – ku përfshihen lëvizjet ambjentaliste apo lobing-u.
- *Marrëdhëniet me publikun* – akses i publikut në informacionet e lidhura me sigurinë energjetike; dhe pjesëmarrja e publikut në proceset vendimmarrëse mbi politikat energjetike.
- *Teknologjia* – akses, përdorimi dhe zhvillimi i teknologjive të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me infrastrukturën energjetike.

- *Marrëdhëniet ndërkombëtare* – angazhimi në bashkëpunime rajonale apo ndërkombëtare për çështjet e lidhura me sigurinë energjetike.
- *Politikat energjetike* – të lidhura me ekzistencën apo jo të politikave të sigurisë energjetike; transparenca e këtyre politikave; rishikimi periodik i politikave; dhe politikat energjetike në bazë të secilit nga dimensionet e mësipërme.

Sikurse vihet re, Instrumenti i Vlerësimit të Sigurisë Energjetike përbën një mekanizëm efikas për të vlerësuar situatën e sigurisë energjetike të një aktori, për të përcaktuar sfidat dhe mundësitë e tij, sikurse dhe për të përcaktuar hapat e mëtejshëm që duhen ndërmarrë me qëllim garantimin e sigurisë energjetike. Në vijim të logjikës së analizës multidimensionale të sigurisë energjetike, është e nevojshme të theksohen dhe parimet e saj. Siguria energjetike karakterizohet nga dhjetë parime kryesore (Yergin, 2013):

- *Rëndësia e diversifikimit* – diversifikimit i burimeve të energjisë, sikurse dhe i infrastrukturës energjetike, janë element themelor në garantimin e sigurisë energjetike. Mbështetja në një burim të vetëm energjetik rrit vulnerabilitetin ndaj kërcënimeve të mundshme, qofshin ato reale apo potenciale. Diversifikimi i burimeve [burimet mund të nënkuptojnë si lloje të ndryshme të burimeve energjetike si nafta, gaz, qymyrguri, energjitë e rinovueshme, etj., ashtu dhe burime nga vende apo rajone të ndryshme] duhet të jetë një prioritet në politikat energjetike të aktorëve të ndryshëm.
- *Pozita në tregun ndërkombëtar* – aksesimi në tregun global të energjisë dhe qëndrueshmëria e këtij tregu ka ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë energjetike të të gjithë aktorëve. Luhatjet e çmimeve, sasi të burimeve energjetike që janë të aksesueshëm, problematikat gjeopolitike, kërcënimet natyrore sikurse dhe ato njerëzore, janë disa nga elementët që ndikojnë në nivelin e sigurisë energjetike.

- *Nevoja për rezerva të sigurisë* – nënkupton se aktorët, me qëllim garantimin e sigurisë energjetike, duhet të posedojnë rezerva të energjisë për të përballuar çdo përçarje apo kërcënim të mundshëm ndaj burimeve të zakonshme të energjisë. Ndërtimi i kapaciteteve depozituese, shkëmbimi me aktorë të tjerë dhe depozitat financiare me destinacion blerjen e energjisë në moment krizash, janë disa nga alternativat e mundshme në funksion të përmbushjes së nevojës për rezerva të sigurisë.
- *Roli i mirë funksionimit të tregjeve* – tregjet e liberalizuara, në të cilin aktorët operojnë në bazë të rregullave të mirë përcaktuara dhe në transparencë të plotë, janë një faktor i rëndësishëm në garantimin e sigurisë energjetike. Vetëm një treg që karakterizohet nga këto parime, është i aftë të reagojë në mënyrë të shpejtë dhe efektive ndaj kërcënimeve apo rreziqeve që i kanosen sigurisë energjetike.
- *Rëndësia e ndërtimit të marrëdhënieve të mira me vendet eksportuese* – ndërtimi i marrëdhënieve bashkëpunuese, të bazuara në interesin reciprok, është një tjetër parim i rëndësishëm i sigurisë energjetike. Historia ka treguar se vendet që bashkëpunojnë midis tyre, janë në gjendje të kapërcejnë problematikat e momentit në bazë të dialogut, mirëkuptimit dhe ndihmës reciproke. Nga ana tjetër, vendet të cilat janë karakterizuar nga një marrëdhënie e tensionuar apo edhe konfliktuale midis tyre, nuk kanë arritur të gjejnë rrugën e mirëkuptimit edhe në ato raste kur bashkëpunimi do të kishte qenë në interesin reciprok të palëve. Gjithashtu vlen të theksohet se, siguria energjetike mund të shërbejë si një urë komunikimi për të vendosur themelet e bashkëpunimit edhe ndërmjet atyre vendeve të karakterizuara nga një armiqësi historike. Bashkëpunimi midis Francës dhe Gjermanisë, e cila çoi

në krijimin e Bashkimit European, nisi pikërisht si një marrëveshje për çelikun dhe qymyrgurin.

- *Nevoja për të garantuar marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet vendeve importuese* – është e nevojshme që bashkëpunimi midis vendeve importuese të jetë i shtrirë në kohë dhe i institucionalizuar. Vetëm në këtë mënyrë konsumatorët e nivelit të mesëm apo edhe të vogël mund të bëhen pjesë e një tregu rajonal apo edhe global. Nëpërmjet këtij institucionalizimi, këto vende mund të shkëmbejnë midis tyre përvojat më të mira, informacion, të ofrojnë asistencë teknike, të ndihmojnë në rishikimin e politikave ekzistuese dhe në formulimin dhe implementimin e strategjive të reja.
- *Rëndësia e informacionit me cilësi të lartë* – posedimi, aksesimi apo shpërndarja e informacionit ka ndikuar në të gjithë historinë e njerëzimit. Nga një konstatim i tillë nuk bën përjashtim as informacioni lidhur me energjinë. Duke qenë se aktorët operojnë brenda një tregu energjetik, qoftë ai rajonal apo global, transparenca dhe informacioni janë dy element thelbësor me ndikim në mirëfunksionimin e tij. Mashtrimet, spekulimet financiare apo përhapja e informacioneve të gabuara ndikon si në ecurinë e tregut ashtu dhe mund të çojë në përhapjen e panikut tek konsumatorët.
- *Rëndësia e një industrie energjetike të zhvilluar* – një industri energjetike kombëtare e zhvilluar, është element shumë i rëndësishëm në garantimin e sigurisë energjetike. Është e nevojshme që kjo industri të bazohet mbi zhvillimin e teknologjive të reja, inovacionin, diversifikimin dhe mbrojtjen e mjedisit.
- *Roli i kërkimit dhe zhvillimit* – këto janë dy aspekte shumë të rëndësishme në garantimin e sigurisë energjetike. Nëpërmjet tyre, në funksion të inovacionit, aktorët

do të jenë në gjendje të formulojnë politika dhe strategji afat – gjata, efikase në përballimin e sfidave të së ardhmes.

- *Rëndësia e planifikimit të ‘përçarjes’* – përçarja e sistemit energjetik nënkupton rënien e tij dhe pa mundësinë për t’u përballur me rreziqet e mundshme. Në funksion të garantimit të sigurisë energjetike, aktorët duhet të jenë në gjendje të mendojnë për të gjithë rreziqet e mundshme ndaj sistemit energjetik dhe të identifikojnë mënyrat e përshtatshme për t’u përballur me këto kërcënime.

Nëpërmjet përdorimit të modeleve të ndryshme të analizimit të sigurisë energjetike, është e mundur që shtetet të “kuptojnë profilin e tyre të sigurisë energjetike me qëllim identifikimin e prioriteteve të politikave të tyre energjetike” (Jewell, 2011: 7). Politikat energjetike kanë një sërë qëllimesh (Holdren, 2007):

- *Qëllimet ekonomike*
 1. Garantimi i furnizimit të besueshëm për kërkesat bazike dhe rritjen ekonomike.
 2. Reduktimi i kostove të energjisë për konsumatorët.
 3. Reduktimi i kostove dhe dobësisë nga importi i energjisë.
- *Qëllimet mjedisore*
 1. Përmirësimi i kualitetit të ajrit në nivel kombëtar dhe rajonal.
 2. Shmangia e aksidenteve në infrastrukturën energjetike dhe menaxhimi i mbetjeve.
 3. Kufizimi i impaktit të zhvillimit energjetik mbi ekosistemet e brishta.
 4. Kufizimi i emetimit në atmosferë të gazrave me impakt në ndryshimet klimaterike.

- *Qëllime sigurie*

1. Minimizimi i rreziqeve të konflikteve për burimet energjetike.
2. Shmangia e përhapjes së armëve bërthamore nga përdorimi i energjisë bërthamore.
3. Reduktimi i vulnerabilitetit të sistemeve energjetike nga sulmet terroriste.
4. Shmangia e gabimeve energjetike të cilat mund të shkaktojnë kufizimin e aksesit në burimet energjetike.

Këto qëllime duhet të kombinohen me njëra – tjetrën me qëllim shmangien e tensioneve të ndryshme që mund të krijojnë midis tyre. Fokusimi vetëm tek njëri nga qëllimet dhe mos marrja në konsideratë e qëllimeve të tjera mund të çonte në një zgjidhje afat – shkurtër të problemeve të lidhura me çështjet e energjisë, por në planin afat – mesëm dhe afat – gjatë do të shkaktonin problematika të cilat do të ishin vështirësisht të zgjidhshme. Për shembull, nëse në funksion të përmbushjes së qëllimit ekonomik të politikave energjetike aktorët do të fokusoheshin në përdorimin e burimeve të tilla si qymyrguri për prodhimin e energjisë, në terma afat – shkurtër ato do të garantonin një nivel të caktuar të sigurisë energjetike. Por në terma afat – mesëm dhe afat – gjatë, ato jo vetëm që nuk kanë garantuar sigurinë energjetike, por për më tepër kanë krijuar disa problematika të reja me impakt të drejtpërdrejtë në sigurinë mjedisore të tyre.

Prandaj, për të përballuar sfidat e ndryshme që i kanosen sigurisë energjetike është e domosdoshme identifikimi dhe analizimi i këtyre qëllimeve dhe kërcënimeve në mënyrë rigoroze dhe sistematike, si e vetmja mundësi për të tejkaluar problematikat që ato mund të krijojnë. Përdorimi i analizës multidimensionale të sigurisë energjetike është një instrument i përshtatshëm për garantimin e sigurisë energjetike të një vendi.

2.4. Konkluzione

Në këtë kapitull, i cili në vetvete është një lloj përmbledhje e literaturës ekzistuese mbi zgjerimin dhe thellimin e konceptit të sigurisë, me fokus tek siguria energjetike, ofrohet një analizë kritike e këtij fenomeni. Koncepti i sigurisë dhe qasjet ndaj saj kanë evoluuar me kalimin e kohës, si pasojë e ndryshimeve të ndodhura si në rrafshin global ashtu dhe atë rajonal apo kombëtar. Pas viteve '90, disiplina studimore pësoi një transformim dy dimensional, horizontal dhe vertikal, duke shkuar përtej konceptimeve tradicionale të cilat e shikonin sigurinë në terma të mbrojtjes së territorit dhe integritetit politik. Dalja në skenë e fenomeneve por edhe aktorëve të rinj në sistemin ndërkombëtar, dëshmoi faktin se si disiplina studimore por edhe politik – bërja, duhej të zgjeronte fokusin e tyre mbi çështjet e sigurisë për të trajtuar gamën e gjerë të kërcënimeve të reja asimetrike. Si pasojë, literatura mbi çështjet e sigurisë dhe qasjet ndaj saj u pasurua ndjeshëm, por pa arritur në një përkufizim të gjithë pranuar mbi konceptin e sigurisë. Arsyt kryesore të mungesës së një përkufizimi të gjithë pranuar lidhen me:

- Qasjen teorike të përdorur – qasjet e ndryshme të disiplinës së marrëdhënieve ndërkombëtare e shohin sigurinë në mënyra të ndryshme.
- Interesat e aktorëve – aktorët, si ata shtetëror ashtu dhe ata jo – shtetëror, e përkufizojnë termin 'siguri' në bazë të interesave, bindjeve apo perceptimeve të tyre.
- Niveli i analizës dhe sektori ku aplikohet – duke qenë se analiza e lidhur me çështjet e sigurisë është multi sektoriale dhe mund të aplikohet në nivele të ndryshme, atëherë dhe përkufizimi i konceptit do të varet nga këto element.

Në funksion të këtij punimi, siguria përkufizohet si një “gjendje me një probabilitet të ulët të dëmtimit të vlerave të fituara” (Baldwin, 1997: 9). Si vështirësitë lidhur me arritjen e një përkufizimi të gjithë pranuar, ashtu dhe ndikimi që ka niveli i analizës apo bindjet,

preferencat, faktorët kontekstual dhe interesat e aktorëve mbi përkufizimin e ‘sigurisë’, janë prezent edhe në literaturën por edhe praktikën e çështjeve të sigurisë energjetike, koncept i cili është themelor në këtë punim. Rëndësia e një përkufizimi mbi konceptin e sigurisë energjetike, nuk lidhet vetëm me aspektet teorike por përcakton dhe aspektet praktike të trajtimit të kësaj çështje; nga formulimi dhe implementimi i strategjive dhe politikave energjetike efikase, deri tek masat konkrete që duhen ndërmarrë nga aktorët e përfshirë në këtë sistem. Pozita e aktorit në raport me burimet energjetike – eksportues, importues apo transit – përcakton dhe qasjen e tij mbi sigurinë energjetike. Në funksion të këtij punimi, siguria energjetike përkufizohet si “aftësia e një ekonomie për të garantuar disponueshmërinë e furnizimit me burime energjetike në mënyrë të qëndrueshme dhe në kohën e duhur, me një nivel të çmimeve që nuk do të ndikonte në performancën e ekonomisë” (APEREC, 2007: 6). Duke qenë se energjia qëndron në zemër të zhvillimit të çdo shoqërie, si në aspektin ekonomik, politik ashtu edhe në atë social, siguria energjetike dhe qasja ndaj saj merr një rëndësi jetike për aktorët e sistemit energjetik. Si dimensionet, ashtu edhe kërcënimet ndaj sigurisë energjetike lëvizin në një spektër shumë të gjerë, përfshijnë shumë aktorë dhe aplikohen në shumë nivele.

Të gjithë këto element janë shumë të rëndësishëm në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij studimi, ku konteksti European shërben si hapësira gjeografike e shtrirjes së këtij punimi. Duke u nisur nga situata aktuale e sigurisë energjetike në këtë hapësirë dhe nëpërmjet identifikimit të faktorëve dhe aktorëve që ndikojnë në këtë aspekt, studimi përfshin disa nga premisat, dimensionet dhe parimet kyçe të sigurisë energjetike.

Kapitulli III: Qasjet mbi sigurinë energjetike – nga determinizmi realist tek konstrukti social i realitetit

Siguria energjetike zë një vend të rëndësishëm në disiplinën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Një nga pyetjet kryesore që ngrihet është: Si e shohin aktorë të ndryshëm të sistemit global sigurinë energjetike? Nga kjo pikëpamje, janë një sërë faktorësh të cilët përcaktojnë sigurinë energjetike të një vendi. Ndër më kryesorët mund të përmendim pozitën gjeografike, siguria e brendshme dhe e jashtme, niveli i zhvillimit ekonomik, sistemi qeverisës, burimet natyrore dhe marrëveshjet dypalëshe apo shumëpalëshe në fushën energjetike. Disa vende mund të prodhojnë sasi të mjaftueshme të energjisë për kërkesat e tyre të brendshme, ndërsa disa vende të tjera janë të varura nga importet e energjisë. Si konsumatorët ashtu edhe prodhuesit synojnë të diversifikojnë tregun e energjisë. Konsumatorët synojnë të sigurojnë sa më shumë furnizues me qëllim shmangien e bllokadave të mundshme, dhe nga ana tjetër prodhuesit synojnë të garantojnë sa më shumë hapësirë për shitjen e produkteve të tyre. A do të jetë e mundur për njerëzimin balancimi paqësor i interesave të të gjithë aktorëve në sistemin e sigurisë energjetike apo bota do të shkojë drejtë përplasjeve diplomatike, konkurrencës së ashpër ekonomike dhe luftërave energjetike?

Kjo është një pyetje së cilës qasje të ndryshme të marrëdhënieve ndërkombëtare i japin përgjigje të ndryshme¹. Teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare synojnë identifikimin e ‘rregullave’ dhe ofrimin e modeleve për të shpjeguar natyrën dhe mekanizmat shkakësor të fenomeneve që ndodhin në sistemin ndërkombëtar (Dannreuther, 2010). Qasjet tradicionale të marrëdhënieve ndërkombëtare janë realizmi dhe liberalizmi. Me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe daljen në pah të fenomeneve të reja, për të cilat qasjet tradicionale

¹ Për qasjet e marrëdhënieve ndërkombëtare mbi sigurinë energjetike, punimi është bazuar kryesisht në punën e Dannreuther (2010), Belyi (2012) & Alsaad (2014), të cilët kanë bërë një përmbledhje të teorive kryesore.

nuk arrinin të jepnin shpjegimet e duhura, qasja konstruktiviste u kthye në një qasje dominuese. Përveç këtyre qasjeve dominuese, ekzistojnë dhe një sërë teorish të tjera të cilat janë kryesisht teori të nivelit të mesëm. Belyi (2012), argumenton se siguria energjetike në perspektivën e marrëdhënieve ndërkombëtare mund të analizohet nga katër këndvështrime të ndryshme. Qasja e parë është qasja realiste, duke u fokusuar në gjeopolitikën dhe aktorët e sistemit energjetik, duke analizuar trendet në gjeopolitikën e naftës dhe gazit në periudhën e pas Luftës së Irakut. Qasja e dytë është qasja institucionaliste, duke u bazuar në institucionet ndërkombëtare që trajtojnë çështjet energjetike, sikurse Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, OPEC, Energy Charter Treaty dhe Bashkimin Europian (Komisioni Europian dhe aktorët privat). Qasja e tretë, mund të konsiderohet si '*New Economics of Energy*', duke u fokusuar tek ndërvlerësia energjetike ndërkombëtare dhe tregjet energjetike. Qasja e katërt, '*Critical Political Economy*', fokusohet në analizën strukturore të sigurisë energjetike, analizën agent-strukturë dhe këndvështrimet e prodhuesve mbi liberalizimin.

Sikurse u përmend dhe më lart, qasjet kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare në nivel makro të fokusuar mbi sigurinë energjetike, mund të klasifikohet në tre grupe kryesore. Në grupin e parë bëjnë pjesë ata autorë dhe punime, të cilët bazohen në qasjen neo/realiste të marrëdhënieve ndërkombëtare. Argumenti i tyre kryesor fokusohet në rolin e aktorëve shtetëror të cilët synojnë maksimizimin e pozicionit të tyre në raport me burimet energjetike. Në grupin e dytë, bëjnë pjesë autorët e qasjes neo/liberale, argumenti kryesor i të cilëve fokusohet në rolin e institucioneve ndërkombëtare, bashkëpunimit dhe tregjeve liberale, të cilat ofrojnë kushtet e mjaftueshme për bashkëpunimin midis aktorëve. Në grupin e tretë, bëjnë pjesë autorët e qasjes konstruktiviste të cilët kombinojnë element të dy

qasjeve të mësipërme. Në seksionet vijuese do të pasqyrohen dhe analizohen në mënyrë më të detajuar argumentet dhe qëndrimet themelore të këtyre tre qasjeve.

3.1. Realizmi & neorealizmi – energjia si burim konflikti dhe komponent i sigurisë kombëtare

Realizmi ka qenë qasja dominonte në marrëdhëniet ndërkombëtare për një periudhë të gjatë kohore, e përfaqësuar nga autorë të tillë si Carr dhe Morgenthau. Rrënjët e kësaj qasje mund të gjurmohen që në veprat e Tukididit, Hobsit dhe Makiavelit. Qasja realiste e shikon sistemin ndërkombëtar të mbushur me sfida të cilat sa vijnë e shtohen, dhe shtetet janë të predispozuar të ndjekin përmbushjen e interesit të tyre kombëtar duke përdorur çdo aspekt të fuqisë së tyre. Në një sistem ndërkombëtar anarkik, shtetet si aktorët e këtij sistemi, janë vazhdimisht në një gjendje konkurrueshmërie midis tyre. Për pasojë, bashkëpunimi është vështirësisht i arritshëm në një kohë kur aktorët karakterizohen nga mosbesimi reciprok dhe konkurrenca për përfitime relative (Morgenthau, 1960).

Duke ruajtur parimet bazë, por duke e përpunuar akoma dhe më shumë këtë qasje, Waltz (1979) themeloi atë që njihet si qasja neorealiste (apo realizmi strukturor) në marrëdhëniet ndërkombëtare. Argumenti kryesor i kësaj qasje është se sistemi ndërkombëtar është anarkik dhe struktura e sistemit përcaktohet nga shpërndarja e fuqisë midis shteteve (e lidhur me konceptin e balancës së fuqisë) dhe natyra e brendshme e shtetit (sistemi i tij qeverisës demokratik apo autoritar) nuk ka impakt në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Premisat kryesore të realizmit janë (Snyder, 2004):

- Shteti është aktori kryesor në politikën ndërkombëtare. Aktorët e tjerë, sikurse organizatat ndërkombëtare, ose nuk janë të rëndësishëm ose janë instrument i politikës së jashtme të aktorëve të fuqishëm.

- Sistemi ndërkombëtar karakterizohet nga anarkia. Mungon një autoritet qendror i cili të parandalojë konfliktet dhe luftërat.
- Për t'i bërë ballë pasojave që mund të vijnë nga anarkia [sulmet, ndërhyrjet, kërcënimi i mbijetesës], shtetet duhet të forcojnë kapacitetet ushtarake dhe ekonomike.
- Balanca e fuqisë shihet si mënyra e vetme për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë.
- Bashkëpunimi në sistemin ndërkombëtar është shumë i vështirë pasi shtetet nuk kanë besim tek njëri – tjetri dhe secili synon promovimin e fuqisë së tij në raport me të tjerët dhe përmbushjen e interesit kombëtar.

Ata e shohin energjinë si një komponent të fuqisë dhe si një instrument legjitim të politikës së jashtme (Luft, 2009: 340). Sipas tyre, siguria energjetike është pjesë e sigurisë kombëtare dhe nuk mund të ndahen nga njëra – tjetra. Kjo është një nga arsyet që shpjegon faktin se qasja realiste nuk fokusohet në trajtimin e sigurisë energjetike si një koncept apo fenomen më vete. Trajtimi më i detajuar gjendet në qasjen neorealiste të marrëdhënieve ndërkombëtare. Sipas Clare, “bota po evoluon në një sistem të rritjes së fuqive/reduktim të planetit duke çuar në një kërcënim potencial për luftëra energjetike” (2007: 35). Sipas tij, me përfundimin e përplasjeve ideologjike në periudhën e pas Luftës së Ftohtë, politikat ndërkombëtare janë fokusuar në aksesin në burimet natyrore, e cila qëndron në themel të rivalitetit midis aktorëve më të fuqishëm të sistemit ndërkombëtar. Kjo situatë ndikohet nga rritja e kërkesës për burime energjetike, të cilat janë të lokalizuara kryesisht në rajone të karakterizuara nga paqëndrueshmëria e brendshme dhe rivalitetet rajonale.

Në ditët e sotme, politika e jashtme varet në politikat e energjisë por neo/realistët argumentojnë se duhet të jetë e kundërta – politikat e energjisë duhet të varen në politikën e jashtme. Shtetet mund të garantojnë sigurinë energjetike nëpërmjet mendimit të thellë

strategjik dhe ndërtimit të bazave ushtarake në rajonet e pasura me burime energjetike për të mbrojtur importet dhe për t'u angazhuar në çdo konflikt të mundshëm për këto burime të kufizuara. Pavarësisht se theksojnë vështirësitë e bashkëpunimit, ata nuk e përjashtojnë në mënyrë absolute një mundësi të tillë, duke i dhënë prioritet bashkëpunimeve bilaterale. Për përkufizimin e termit siguri energjetike, realistët fokusohen sigurinë e furnizimit me energji. Duke pasur në konsideratë faktin se burimet energjetike janë të kufizuara, ata e shohin diversifikimin e burimeve si element shumë të rëndësishëm në garantimin e sigurisë energjetike.

Premisat kryesore të qasjes realiste lidhur me sigurinë energjetike janë (Alsaad, 2014):

- Siguria energjetike është pjesë përbërëse e sigurisë kombëtare. Prandaj ajo duhet mbrojtur me të gjitha mënyrat e mundshme, ku fuqia ushtarake është instrumenti kryesor i cili do të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm.
- Për shkak të natyrës anarkike të sistemit ndërkombëtar dhe konkurrencës së vazhdueshme për burime energjetike, shtetet duhet të synojnë përmbushjen e interesit kombëtar në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet marrëdhënieve bilaterale.
- Konfliktet dhe luftërat për burime energjetike kanë shumë gjasa për të ndodhur dhe janë të pa shmangshme.
- Shtetet, nëpërmjet mendimit strategjik dhe kontrollit të burimeve, mund të garantojnë sigurinë e tyre energjetike.
- Objektivi kryesor nuk është pasja e një sasive sa më të madhe të burimeve energjetike në një periudhë të caktuar, por pasja e sasive të mjaftueshme në çdo kohë. Kjo mund të arrihet nëpërmjet diversifikimit të burimeve energjetike dhe mos krijimi i varësisë nga një burim i vetëm energjetik.

- Burimet energjetike globale janë të limituara, janë të lokalizuara në pak zona gjeografike dhe sa vjen dhe po bëhen më të pa sigurtë.

Pavarësisht rëndësisë së tyre, këto premisa dhe qëndrime të qasjes neo/realiste lënë vend për kritika. Kritika e parë lidhet me faktin se realistët fokusohen vetëm në kapacitetet ushtarake për garantimin e sigurisë energjetike, në një kohë që dimensionin ekonomik është një element thelbësor në mbrojtjen e interesit kombëtar të shteteve (Gilpin, 1976), së bashku me kulturën dhe ideologjinë (Strange, 1991). Këto dimensione, sipas Nye (2004), janë element përbërës të *soft power*, në një kohë që faktori ushtarak është element i *hard power*. Një kritikë tjetër ndaj qasjes realiste fokusohet dhe në mos vlerësimin e rëndësisë dhe rolit të aktorëve jo – shtetëror, si kompanitë shumëkombëshe apo institucionet ndërkombëtare, në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe për pasojë dhe në sigurinë energjetike.

Duke qenë një qasje deterministe, e cila argumenton se si pasojë e reduktimit të burimeve energjetike konfliktet për këto burime do të jenë të pashmangshme, neo/realizmi nuk merr në konsideratë rëndësinë e zhvillimeve teknologjike dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë. Nga ana tjetër, realistët nuk marrin në konsideratë influencën pozitive të ndërvlerësimit në garantimin e paqes, duke mos vlerësuar në këtë mënyrë rëndësinë e bashkëpunimit midis aktorëve të përfshirë në sigurinë energjetike. Kritikat ndaj qasjes realiste në marrëdhëniet ndërkombëtare pasqyrohen dhe në premisat kryesore të dy qasjeve të tjera, si liberalizmi dhe konstruktivizmi, të cilat do të trajtohen në vijim.

3.2. Qasja liberale & neoliberale – dimensionin ekonomik i energjisë si promotor i bashkëpunimit dhe garantimit të sigurisë

Qasja liberale në marrëdhëniet ndërkombëtare, rrënjët e së cilës lidhen me Kantin, ngrihet në disa premisa të cilat shpeshherë janë të kundërta me ato të qasjes realiste, duke çuar në

zhvillimin e debatit midis këtyre dy paradigmave. Duke nisur që nga aktorët kryesor të sistemit ndërkombëtar, qasja liberale në ndryshim nga ajo realiste, argumenton se aktorët jo – shtetëror janë po aq të rëndësishëm në sistemin ndërkombëtar sa dhe aktorët shtetëror. Sipas tyre, përhapja e parimeve demokratike shihet si mënyra e duhur për arritjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare (Moravcsik, 2001). Kjo premisë është përpunuar akoma më shumë, duke krijuar atë që njihet si teoria e Paqes Demokratike, argumenti kryesor i së cilës është se shtetet demokratike nuk luftojnë midis tyre.

Për më tepër, parimet, vlerat dhe normat demokratike jo vetëm që mund të eksportohen por edhe duhet të eksportohen me qëllim garantimin e paqes, sigurisë dhe stabilitetit. Kjo çon në premisën tjetër të kësaj qasje, sipas së cilës politika e brendshme nuk mund të shihet si e ndarë nga politika e jashtme e aktorëve të sistemit ndërkombëtar. Sipas qasjes liberale, faktori ekonomik është thelbësor në garantimin e bashkëpunimit midis vendeve, duke minimizuar në këtë mënyrë mundësitë e konflikteve të armatosura.

Duke mos e mohuar gjendjen anarkike të sistemit ndërkombëtar, qasja neo liberale (e njohur ndryshe dhe si institucionalizmi liberal) argumenton se ndërvarësia midis shteteve, krijimi i rrugëve të komunikimit dhe kompleksiteti i komunitetit ndërkombëtar, janë element të cilët e ‘zbehin’ anarkinë në sistemin ndërkombëtar (Keohane, 1984). Ata e shohin konkurrencën si promotor të zhvillimit, në ndryshim nga realistët të cilët e shohin atë si element të konfliktualitetit dhe luftërave. Sipas tyre, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe koordinimi janë të mundshëm nëpërmjet organizatave rajonale dhe ndërkombëtare. Teoria e regjimeve, e cila argumenton mbi rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar si stimuluese e bashkëpunimit politik (Krasner, 1983), së bashku me tezat funksionaliste të lidhura me efektin ‘*spillover*’ (Haas, 1958), dhe koncepti i sigurisë kolektive, janë disa nga komponentët kryesor të kësaj qasje.

Lidhur me sigurinë energjetike, qasja neo/liberale fokusohet kryesisht në aspektin ekonomik. Për ta, siguria energjetike mund të përkufizohet si akses në burime energjetike me një çmim të pranueshëm. Duke qenë koshient për faktin se burimet energjetike janë të kufizuara, ata argumentojnë se siguria energjetike mund të garantohet nëpërmjet bashkëpunimit rajonal dhe global në organizata të ndryshme, sikurse është Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë. “Mekanizmi kolektiv rajonal dhe ndërkombëtar ofron mundësi të përshtatshme për bashkëpunimin, koordinimin dhe shkëmbimit të informacioneve dhe eksperiencave, me qëllim garantimin e sigurisë energjetike” (Alsaad, 2014: 74) . Duke qenë se aktorët i kanë të gjitha mundësitë për të bashkëpunuar dhe për të komunikuar midis tyre, për një zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve, atëherë çdo luftë që mund të zhvillohet është një pretekst për të vendosur kontrollin mbi burimet energjetike (Turner, 2008). Në një kohë që realistët fokusohen në përfitimet relative, qasja liberale fokusohet në përfitimet absolute si për aktorët importues ashtu dhe për ata eksportues të energjisë. Në këtë mënyrë, të gjithë aktorët e përfshirë në infrastrukturën energjetike, mund të përmbushin interesat e tyre në harmoni me aktorët e tjerë.

Për të arritur një gjendje të tillë faktorët kryesor, sipas qasjes liberale, mbeten institucionet rajonale dhe ndërkombëtare sikurse dhe një treg liberal funksional. Ata e shikojnë të ardhmen më pozitivisht dhe besojnë se lufta për kontrollin e resurseve energjetike do të jetë një fenomen i rrallë pasi të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e energjisë, si konsumatorët ashtu edhe prodhuesit kanë përfitime më të mëdha nga stabiliteti, pa të cilin asnjë nuk mund të përfitojë (Luft, 2009). Nga kjo pikëpamje, siguria energjetike do të jetë mjeti i funksionimit të shteteve dhe marrëdhënieve të tyre pa dëmtuar integritetin e sigurisë shtetërore, dhe burimet energjetike do të zhvillohen në akordancë me marrëdhëniet ndërkombëtare. Parimi kryesor i sigurisë energjetike sipas qasjes neo/liberale është besimi

tek fuqia e tregut dhe konceptit të ndërvarësisë, si garantues të sigurisë energjetike. Gjithashtu ata theksojnë rëndësinë e transparencës dhe informacionin e hapur, si element kyç në mirë funksionimin e tregut dhe për pasojë garantimin e bashkëpunimit.

Sikurse dhe në rastin e qasjes neo/realiste në marrëdhëniet ndërkombëtare, edhe qasja neo/liberale është bërë objekt i kritikave të ndryshme. Kritika e parë lidhet me mbivlerësimin që kjo qasje i bën institucioneve dhe tregut, duke mos u ndalur tek pasojat e pozicionimit gjeografik të burimeve energjetike. Historia ka treguar se burimi i konflikteve gjendet kryesisht në kushtet e brendshme të aktorëve sesa në një nivel rajonal apo global. Përdorimi i energjisë si instrument presioni në politikën e jashtme, dëshmon se mbështetja tek tregu dhe institucionet nuk janë kushte të mjaftueshme për të shpjeguar sigurinë energjetike nën perspektivën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Argumenti se institucionet, si ato rajonale ashtu dhe ato ndërkombëtare, janë instrumente të politikës së jashtme të aktorëve më të fuqishëm, është një tjetër kritikë që mund t'i bëhet qasjes neo/liberale.

3.3. Shkolla e Kopenhagenit – Drejt një kornize analitike për sigurinë energjetike

Qasjet tradicionale – realizmi dhe liberalizmi – fokusohen në nivelin makro të sistemit ndërkombëtar dhe janë 'të ngurtë' pasi fokusohen vetëm në element dhe dimensione të veçanta, duke përjashtuar në këtë mënyrë dimensionet e reja të marrëdhënieve ndërkombëtare në përgjithësi dhe çështjeve të sigurisë në veçanti. Si pasojë, ato nuk adresojnë në mënyrë të përshtatshme ato fenomene të cilat zhvillohen në nivelin e mesëm apo nivelin mikro të analizës. Kjo mangësi e tyre, u plotësua nga qasja konstruktiviste e marrëdhënieve ndërkombëtare, kryesisht nga nën disiplinat e saj, të cilat dhanë kontribut të vyer në transformimin dy dimensional të disiplinë – dimensionin vertikal dhe ai horizontal.

Konstruktivizmi në vetvete është një kombinim midis premisave bazë të dy qasjeve tradicionale, e cila pasurohet me një sërë premisash të tjera të cilat shkojnë përtej këtij kombinimi. Ndër përfaqësuesit më kryesor të konstruktivizmit mund të përmendim Wendt, Onuf, Finnemore dhe Katzenstein. Një ndër premisat kryesore të kësaj qasje konstaton se sjellja e shtetit formësohet nga bindjet e elitës, identitetet dhe normat shoqërore. Idetë dhe praktikrat e individëve që jetojnë në një bashkësi, janë elementët të cilët krijojnë, formësojnë dhe ndryshojnë kulturën. Për ta, shteti dhe interesi kombëtar janë rezultat i identitetit shoqëror të këtyre aktorëve. Kjo është arsyeja se përse për qasjen konstruktiviste objekti i studimit janë normat dhe praktikrat e individëve dhe bashkësive. Për konstruktivizmin, anarkia nuk është një gjendje e pa ndryshueshme, përkundrazi është një gjendje e ndërtuar nga aktorët e sistemit ndërkombëtar.

Duke e ruajtur fuqinë si një komponent të rëndësishëm në qasjen e tyre, ata e lidhin fuqinë me idetë, kulturën dhe gjuhën, në ndryshim nga qasjet tradicionale të cilat e shohin fuqinë në terma materiale. Për ta, realiteti është një konstrukt social, është një produkt i ndërveprimit të aktorëve në bazë të identiteteve të tyre (McDonald, 2013). Sipas Fierke, “të ndërtosh diçka është një akt i cili i jep ‘jetë’ një subjekt ose objekt i cili në të kundërt nuk do të ekzistonte” (McDonald, 2013: 65). Për të shmangur universalizimin e konceptit, për konstruktivistët rëndësi të veçantë merr konteksti ku aplikohet koncepti në fjalë. Kjo tregon se konstruktivistët, duke njohur rëndësinë e identitetit për sigurinë, fokusohen tek ideja se faktorët jo material apo identitar janë qendror për praktikrat e sigurisë dhe dinamikat e politikave botërore (McDonald, 2013). Përveç identitetit [perceptimi se cilët jemi], normat janë aspekti tjetër themelore i kësaj qasje. Lidhur me marrëdhënien agjent – strukturë, sipas qasjes konstruktiviste ato ndërtohen në sajë të ndërveprimit midis tyre. Kjo çështje është trajtuar në mënyrë specifike nga Wendt, i cili duke analizuar konceptin e anarkisë

argumenton se një situatë e tillë është në vetvete një konstrukt social pasi janë aktorët, në sajë të ndërveprimit të tyre, që çojnë në këtë produkt (Wendt, 1992).

Në funksion të studimeve të sigurisë, problematikat e lidhura me qasjet tradicionale, u trajtuan kryesisht nga ajo rrymë e cila njihet si Studimet Kritike të Sigurisë. Sipas Mutimer (2013), axhenda fillestare e Studimeve Kritike të Sigurisë u themelua si një sfidë ndaj konceptimit tradicional të sigurisë: shteti nuk ishte një objekt referues i mjaftueshëm; nevoja për konceptim më të gjerë rreth burimeve të pasigurisë dhe sigurisë dhe nevoja për ri konceptim epistemologjik të çështjeve të sigurisë. Nëse qasjet tradicionale fokusohen kryesisht në ontologjinë e fenomeneve, duke ngritur pyetjen *Çfarë?* dhe duke përcaktuar në mënyrë objektin, qasja konstruktiviste dhe nën disiplinat e saj fokusohen në epistemologjinë e fenomeneve duke ngritur pyetjen *Si?*, duke u fokusuar në këtë mënyrë në identifikimin e mënyrës së ndërtimit të fenomenit.

Nën ndikimin e qasjes konstruktiviste dhe Studimeve Kritike të Sigurisë, janë zhvilluar një sërë ‘nën qasjesh’, ku shkolla e Kopenhagenit ka rëndësi kryesore në funksion të këtij punimi. Shkolla e Kopenhagenit, pavarësisht rrënjëve të saj fillestare, mund të konsiderohet si një qasje *sui generis* në marrëdhëniet ndërkombëtare, e cila ka në fokusin e saj studimet e sigurisë. Korniza teorike e kësaj shkolle, e lidhur me sigurizimin, “është përpjekja më e rëndësishme për të zhvilluar një teori të sigurisë ndërkombëtare bazuar në premisën bazë të konstruktivizmit sipas së cilës siguria është një konstrukt social” (McDonald, 2013: 71). Përfaqësuesit më dinjitoz të kësaj shkolle janë Buzan, Waever & de Wilde, të cilët identifikojnë dhe analizojnë tre komponentët kryesor të kësaj qasje: analiza sektoriale e sigurisë; regional security complexes dhe sigurizimit.

Sipas kësaj qasje, siguria e njerëzimit ndikohet nga faktorë të përfshirë në pesë sektorë kryesorë; ushtarak, politik, ekonomik, shoqëror dhe mjedisor. Një përkufizim bazik i

sigurisë, sipas kësaj qasje është ekzistenca e një gjendje me probabilitet të ulët të dëmtimeve ndaj vlerave të arritura. E thënë ndryshe, kjo qasje e vendos fokusin e saj tek ruajtja e vlerave të arritura të aktorëve dhe jo tek prania apo mungesa e kërcënimeve. Kjo për shkakun se sipas tyre kërcënimet ekzistojnë në raport me vlerat dhe identitetin e aktorëve. Nëse vlerat ndryshojnë, atëherë një fenomen i caktuar mund të mos konsiderohet më si kërcënim dhe anasjelltas. Në këtë mënyrë siguria përkufizohet në termat: *Siguri për kë* (individët, grupet, shtetet, sistemin ndërkombëtar)? dhe *Siguri për cilat vlera* (siguria fizike, zhvillimi ekonomik, autonomia, mirë-qenia psikologjike)? Siguria mund të specifikohet në raport me aktorin vlerat e të cilit duhet të sigurohen, vlerat përkatëse, shkalla e sigurisë, llojet e kërcënimeve dhe mjetet për përballimin e tyre, kostot e mundshme dhe periodha kohore e volitshme.

Rëndësia e kësaj qasje lidhet dhe me nivelet e analizës në teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare. Nivelet kryesore sipas Buzan et al. (1998) janë:

- *Sistemi ndërkombëtar*, i cili nënkupton konglomeratin më të madh njësie ndërvepruese apo të ndërvarura, të cilat nuk kanë një nivel sistemi mbi veten.
- *Nënsistemet ndërkombëtare*, përfshijnë grupe të njësie brenda sistemit ndërkombëtar, të cilat mund të diferencohen nga sistemi ndërkombëtar për shkak të natyrës së veçantë apo intensitetit të ndërveprimit të tyre. Këto mund të jenë nënsisteme territoriale (si Association of Southeast Asian Nations [ASEAN] dhe Organization of African Unity [OAU]) ose jo territoriale (si the Organization for Economic Cooperation and Development [OECD] dhe Organization of Petroleum Exporting Countries [OPEC]).

- *Njësitë*, të cilat përfshijnë aktorë të përbërë nga nëngrupe, organizata, komunitete dhe individë, mjaftueshëm koheziv dhe të pavarur sa për t'u diferencuar nga të tjerët (shtetet, kombet, firmat multinacionale).
- *Nën njësitë*, grupe të organizuara të individëve brenda njësive të cilat janë të aftë të ndikojnë sjelljen e njësisë (burokracia, lobing-u).
- *Individët*, si njësia më e ulët e analizës.

Përdorimi i nivelit të analizës, si instrument për të kuptuar dhe shpjeguar fenomenet e lidhura me marrëdhëniet ndërkombëtare, është i një rëndësie të veçantë pasi ndikon si në identifikimin e burimit të kërcënimeve ashtu dhe në strategjitë e përshtatshme për të trajtuar këto problematika. Sikurse do të trajtohet dhe në vijim, Shkolla e Kopenhagenit ofron një kornizë analitike për studimin e çështjeve të sigurisë në përgjithësi dhe sigurisë energjetike në veçanti. Nëpërmjet kësaj qasje tejkalohen problematikat e evidentuara nëse për studimin e sigurisë energjetike do të mbështeteshim tek qasjet tradicionale të marrëdhënieve ndërkombëtare. Siguria energjetike është një fenomen i cili lidhet me të gjithë nivelet e analizës të paraqitura më lart. Për të analizuar rëndësinë e kësaj shkolle në analizimin e sigurisë energjetike, është i nevojshëm trajtimi i tre komponentëve kryesor dhe mënyrat sesi ato mund të aplikohen në rastin e sigurisë energjetike.

3.3.1. Sektorët e sigurisë – energjia si një fenomen ndër sektorial

Një komponent i rëndësishëm i Shkollës së Kopenhagenit është dhe analiza sektoriale e sigurisë, e lidhur kryesisht me punën e Buzan (1991). Nëse nivelet e analizës do të konsiderohen si element të thellimit të disiplinës së sigurisë apo dimensionit vertikal, studimi i sigurisë në bazë të sektorëve është element i zgjerimit apo dimensionit horizontal i disiplinës së çështjeve të sigurisë. Është e nevojshme të theksohet se sektorët e sigurisë

(Politik, Ekonomik, Ushtarak, Shoqëror dhe Mjedisor) nuk veprojnë të izoluar nga njëri – tjetri, përkundrazi ata janë në një ndërveprim të vazhdueshëm brenda kuadrit të sigurisë në tërësi. Sikurse u përmend dhe më lart, siguria mund të ndahet në pesë sektor kryesor, të cilët janë (Buzan, 1991):

- *Siguria ushtarake* e cila fokusohet në marrëdhënien e ndërsjellët midis kapaciteteve ofensive dhe defensive të shteteve dhe perceptimin e shteteve për qëllimet e të tjerëve përkundrejt tyre. Kërcënimet ushtarake janë të një rëndësie të veçantë për shkak se ndikojnë të gjithë komponentët e shtetit, që zhvillimi dhe deri tek mbijetesa. Këto kërcënime mund të bëjnë pjesë në të gjithë nivelet e analizës.
- *Siguria politike* e cila fokusohet në stabilitetin organizativ të shteteve, sistemeve të qeverisjes dhe ideologjive që i japin atyre legjitimitet. Shteti, duke qenë një entitet politik, konsideron si kërcënim politik çdo kërcënim i cili mund të dobësojë këtë entitet.
- *Siguria ekonomike* e cila fokusohet në aksesin në resurse, financë dhe tregje të domosdoshme për të ruajtur një nivel të caktuar të mirëqenies dhe fuqisë shtetërore. Sikurse vihet re, komponentët e sigurisë ekonomike janë të larmishëm, për pasojë edhe kërcënimet ndaj saj janë të larmishme dhe komplekse. Kërcënimet shtrihen në një spektër shumë të gjerë, nga ekonomia personale deri tek ajo ndërkombëtare duke qenë pjesë në të gjitha nivelet e analizës. Siguria ekonomike nuk mund të shihet e ndarë nga siguria ushtarake dhe ajo politike.
- *Siguria shoqërore* e cila fokusohet në qëndrueshmërinë, duke përfshirë dhe kushtet e evoluimit, të vlerave tradicionale si gjuha, kultura, besimi, zakonet dhe identiteti kombëtar. Siguria shoqërore është ngushtësisht e lidhur me sigurinë politike të një

vendi. Nëse do të analizonim shtete e dobëta, një konstatim i tillë do të vërtetohej më së miri.

- *Siguria mjedisore* e cila fokusohet në ruajtjen e biosferës lokale dhe globale si një pasuri e përbashkët prej të cilës ndikohet i gjithë njerëzimi. Kërcënimet ndaj sigurisë mjedisore mund të kenë burim të tyre si faktorët natyror ashtu edhe ata njerëzor. Përmbytjet, tërmetet, ndryshimi i klimës dhe ngrohja globale, ndotja e ajrit, ujit dhe e tokës, janë të gjithë kërcënime ndaj sigurisë mjedisore. Edhe ky sektor i sigurisë, lidhet me sektorët e lart përmendur, duke ndikuar në mënyrë të ndërsjellët në sigurinë në tërësi.

Sikurse vihet re, sektorët e sigurisë janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërcënimet respektive të cilat shfaqen në nivele të ndryshme. Këto sektorë nuk operojnë të izoluar nga njëri-tjetri, por janë në një marrëdhënie të vazhdueshme të ndërsjellët. Sipas Buzan, siguria energjetike nuk është një sektor i veçantë por sikurse do të analizohet në vijim, ajo ndikon dhe ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sektorët e tjerë të sigurisë, duke qenë në këtë mënyrë një fenomen ndër sektorial. Dimensioni ushtarak i sigurisë energjetike, i cili është një ndër premisat bazë dhe në qasjen neo/realiste, lidhet kryesisht me energjinë si burim për të vënë në lëvizje infrastrukturën ushtarake nga njëra anë, dhe nga ana tjetër lidhet me përdorimin e kapaciteteve ushtarake për të garantuar aksesin në burime energjetike dhe ruajtjen e infrastrukturës furnizuese. Një ide e tillë, është parë nga shumë studiues dhe si faktori kryesor që justifikon ndërhyrjen e SHBA-ve në Irak në 2003.

Siguria politike, sikurse dhe siguria shoqërore, lidhet me sigurinë energjetike për faktin se paqëndrueshmëria politike dhe institucionale mund të shërbejë si një kërcënim i drejtpërdrejtë për vazhdimësinë e infrastrukturave energjetike, si në vendet prodhuese, vendet konsumatore dhe vendet transit të burimeve energjetike. Situatat problematike në

disa rajone të cilat janë prodhuese të energjisë, që karakterizohen nga element të shteteve të dobëta, kanë demonstruar se kanë efekt të drejtpërdrejtë në sigurinë energjetike të aktorëve në përgjithësi. Si pasojë e kësaj situate, burimet dhe sistemet e transportit të energjisë, janë më vulnerabël ndaj kërcënimeve të tilla si terrorizmi, sabotazhi apo pirateria.

Dimensioni ekonomik i sigurisë energjetike, i trajtuar dhe si premisa kryesore në qasjen neo/liberale, ndikon si në vendet prodhuese ashtu dhe ato konsumatore, për pasojë dhe në vendet transit. Ndryshimi i çmimeve të produkteve energjetike dhe funksionimi i tregjeve energjetike, janë dy element shumë të rëndësishëm në garantimin e sigurisë energjetike. Ky konstatim është trajtuar gjerësisht nga Yergin (2013), Holdren (2007), dhe APERC (2007). Yergin e identifikon dimensionin ekonomik të sigurisë energjetike, kryesisht funksionimin e tregjeve, si një ndër parimet kryesore të sigurisë energjetike. Duke e etiketuar këtë parim si *Roli i mirë funksionimit të tregjeve*, ai argumenton se tregjet e liberalizuara, në të cilin aktorët operojnë në bazë të rregullave të mirë përcaktuara dhe në transparencë të plotë, janë një faktor i rëndësishëm në garantimin e sigurisë energjetike. Vetëm një treg që karakterizohet nga këto parime, është i aftë të reagojë në mënyrë të shpejtë dhe efektive ndaj kërcënimeve apo rreziqeve që i kanosen sigurisë energjetike (Yergin, 2013).

Nga ana tjetër, Holdren (2007) i konsideron qëllimet ekonomike, si të lidhura ngushtë me garantimin e furnizimit të besueshëm për kërkesat bazike dhe rritjen ekonomike; reduktimin e kostove të energjisë për konsumatorët dhe reduktimin e kostove dhe dobësisë nga importi i energjisë, të cilat janë dhe ndër qëllimet kryesore të politikave energjetike. Në të njëjtën linjë, Baumann (2008); Vivoda (2010); APERC (2007) theksojnë rëndësinë e dimensionit ekonomik në sigurinë energjetike. Sipas tyre, fuqia ekonomike e një aktori është element shumë i rëndësishëm në garantimin e sigurisë energjetike, duke u lidhur në këtë

mënyrë me *Affordability*, përballueshmëria e kostove financiare të aksesit në burimet e disponueshme energjetike. Përbërësit e këtij dimensionit janë tregjet energjetike, tregtia ndërkombëtare [e lidhur me infrastrukturën energjetike] dhe lidhshipi teknologjik.

Sikurse dhe në rastin e katër sektorëve të mësipërm të sigurisë, edhe siguria mjedisore është e lidhur ngushtë me sigurinë energjetike. Studiuesit i konsiderojnë qëllimet mjedisore si themelore në politikat energjetike dhe sigurinë energjetike në tërësi. Ndër komponentët kryesor të kësaj simbioze janë: përmirësimi i kualitetit të ajrit në nivel kombëtar dhe rajonal; shmangia e aksidenteve në infrastrukturën energjetike dhe menaxhimi i mbetjeve; kufizimi i impaktit të zhvillimit energjetik mbi ekosistemet e brishta; dhe kufizimi i emetimit në atmosferë të gazrave me impakt në ndryshimet klimaterike (Holdren, 2007). Vivoda (2010) në Instrumentin e Vlerësimit të Sigurisë Energjetike e përcakton dimensionin mjedisor si një ndër dimensionet kryesore, duke e lidhur me mbështetjen mbi burimet fosile të energjisë; emetimin e gazrave serë dhe acid; ndotjet e tjera të ajrit, ujit, dhe mbetjeve nukleare; ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të lidhura me mjedisin si rritja e nivelit të ujit, ngrohja globale apo kushtet ekstreme të motit. APERC (2007) e lidh dimensionin mjedisor të sigurisë energjetike me *Acceptability*, duke argumentuar se pranueshmëria e përdorimit të burimeve dhe llojeve të ndryshme të energjisë, lidhet me impaktin e tyre social dhe mjedisor. Nëse një burim energjetik i disponueshëm dhe i aksesueshëm me një kosto financiare të përballueshme ka pasoja mbi sferën sociale dhe mjedisore, atëherë siguria energjetike e aktorit nuk mund të jetë e garantuar.

Nga këto konstatime vihet re se, pavarësisht se siguria energjetike nuk është një sektor i veçantë sipas Buzan, ajo mund të shihet si një fenomen ndër sektorial. Siguria energjetike ndikon dhe ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pesë sektorët e sigurisë. Kjo dëshmon rëndësinë e sigurisë energjetike, jo vetëm në aspektin teorik dhe studimor, por

ka një rëndësi të veçantë dhe në aspektin praktik. Politika, si ajo e brendshme ashtu dhe ajo e jashtme, ndikohen nga komponentët e sigurisë energjetike. Në këtë mënyrë, siguria energjetike jo vetëm që aplikohet në të gjithë sektorët e sigurisë, por shtrihet dhe në të gjithë nivelet e analizës. Pavarësisht pozitës së një aktori në infrastrukturën ndërkombëtare të energjisë, si vend prodhues, importues apo transit, siguria energjetike përbën një nga çështjet kryesore të cilat duhen prioritetizuar dhe adresuar në mënyrën më efektive që është e mundur.

3.3.2. Regional Security Complex Theory – siguria energjetike si një fenomen përtej kufijve

Tradicionalisht çështjet e sigurisë janë trajtuar në nivelin e shtetit ose të sistemit, duke krijuar në këtë mënyrë disa hapësira të cilat nuk adresohen në mënyrën e duhur nga asnjëri prej niveleve të mësipërme. Por sikurse argumenton dhe Buzan, “siguria përfshin si faktor objektiv ashtu dhe faktor subjektiv, dhe për pasojë është më e rëndësishme të analizohet natyra e marrëdhënieve midis shteteve sesa të krahasohen atributet e tyre, e cila është karakteristikë e analizës së fuqisë” (1991: 105). Duke qenë se sistemi ndërkombëtar përballet me sfida dhe kërcënime, të cilat shfaqen në forma dhe momente të ndryshme në zona të caktuara të globit, atëherë si analiza në nivel shtetëror ashtu dhe ajo në nivel sistemi nuk janë të mjaftueshme.

Duke u nisur nga një mangësi e tillë, Buzan paraqet idenë e ‘security complex’, e cila përkufizohet si “një grup shtetesh për të cilat perceptimet dhe shqetësimet kryesore mbi sigurinë janë aq shumë të ndërlidhura, sa siguria kombëtare e secilit nuk mund të analizohet apo të zgjidhet si e ndarë nga të tjerët” (1998: 12). Sjellja e aktorëve brenda këtij ‘rajoni’ zhvillohet në një spektër nga armiqësia e vazhdueshme në limitin negativ, në krijimin e regjimeve të sigurisë në mesin e spektrit, deri në limitin pozitiv të tij që është krijimi i

komuniteteve pluraliste të sigurisë. Integrimi i plotë rajonal do të shërbente për eliminimin e këtij ‘security complex’, duke transformuar në këtë mënyrë të gjithë rajonin. Elementët që lidhin bashkë një ‘security complex’ mund të jenë si gjeografik, politik, strategjik, historik, ekonomik apo kulturor.

Në fazat fillestare të saj, Security Complex Theory, apo ajo që njihet si ‘teoria klasike’ fokusohej tek shteti si aktori kryesor i sistemit ndërkombëtar. Por si pasojë e thellimit dhe zgjerimit të konceptit të sigurisë, kjo teori u ripërpunua sërish nga krijuesit e saj, duke krijuar dy kategori; komplekset homogjene dhe komplekset heterogjene (Buzan et. al., 1998: 16 – 17). *Komplekset homogjene* – formohen duke ruajtur logjikën bazë të teorisë klasike, pasi aplikohen në sektorë të veçantë. Për shembull, komplekset ushtarake, komplekset shoqërore, etj. Ndërsa *komplekset heterogjene* – shkojnë përtej logjikës së teorisë klasike dhe argumentohet se logjika rajonale mund të integrojë lloje të ndryshëm të aktorëve të cilët ndër veprojnë në dy apo më shumë sektor. Për shembull, shtete, kombe dhe firma private ndër veprojnë midis tyre në sektorët politik, ekonomik dhe shoqëror.

Pyetjet kryesore që adreson kjo qasje janë: çfarë e shkakton ngritjen e një ‘security complex’? Cilat janë rrugët apo mënyrat e krijimit të tij? Duke mos qenë struktura permanente, cilat janë opsionet për evoluimin e tyre? (Buzan, 1991: 114). Përgjigjet e këtyre pyetjeve lidhen me kontekstet specifike në të cilat ata aplikohen. Security Complex Theory, ka një rëndësi të veçantë pasi duke qenë një teori e cila aplikohet në nivelin e mesëm të analizës, lidh bashkë dy nivelet e tjera, nivelin mikro dhe makro, ku një kombinim i tyre do të ofronte një qasje analitike më të përshtatshme. Kjo tregon se midis niveleve ka një ndërveprim të ndërsjellët, problematikat lokale mund të transformohen në ndërkombëtare dhe anasjelltas, ku niveli i mesëm është mediumi kryesor i këtij ndërveprimi. Në një kohë që sistemi ndërkombëtar sa vjen dhe decentralizohet, aktorë dhe fenomene të reja ndikojnë në

këtë sistem, Regional Security Complex Theory është një qasje analitike shumë e rëndësishme, si në nivelin teorik të analizës ashtu dhe në nivelin praktik të politik bërjes dhe vendimmarrjes.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e saj, kjo teori mund të aplikohet dhe në studimin e sigurisë energjetike (Palonkorpi, 2009; Dempsay, 2006; Attila, 2012; Zelensky, 2009). Në këtë rast, me ‘energy security complex’ do të kuptonim një grup aktorësh të vendosur në një zonë gjeografike të caktuar, të karakterizuar nga një marrëdhënie e varësisë energjetike, varësi e cila perceptohet si rrezik dhe duhet sigurizuar (Palonkorpi, 2009). Varësia energjetike mund të ketë burim si prodhimin por dhe konsumin apo transitin e energjisë. Vendet prodhuese të energjisë, të cilat e bazojnë ekonominë e tyre në eksportin e energjisë, janë shumë të varura nga kërkesa e konsumatorëve. Nëse ato nuk kanë akses në tregje të ndryshme, atëherë rënia e kërkesës do të ndikonte në gjendjen e tyre ekonomike, politike dhe sociale. Në këtë mënyrë, vendet prodhuese krijojnë varësi nga kërkesa, e cila në vetvete përbën një kërcënim si për sigurinë energjetike ashtu dhe për sigurinë kombëtare.

E njëjta logjikë aplikohet dhe për rastin e vendeve eksportuese. Vendet eksportuese krijojnë varësi nga burimet energjetike të disponuara nga aktorët e tjerë. Ndërpërprja e këtij furnizimi, e cila mund të ndodhë për shkak të faktorëve të cilët variojnë nga ata natyror dhe aksidental e deri tek faktorët politik. Nëse këto vende nuk kanë diversifikuar burimet e tyre të furnizimit, siguria e tyre energjetike kërcënohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Varësia energjetike mund të përbëjë kërcënim edhe për vendet transit. Këto vende janë vulnerabël nga të dy kategoritë e kërcënimeve me të cilat mund të përballen vendet prodhuese dhe konsumatore të energjisë. Këto problematika bëjnë që vendet të përfshihen në një marrëdhënie komplekse në themelin e së cilës është energjia, duke i dhënë formë në këtë mënyrë asaj që njihet si ‘energy security complex’.


Kryesisht këto formacione krijohen në zona të caktuara gjeografike, ku mund të përmendim varësinë e vendeve Europiane nga gazi rus, por sikurse u përmend dhe më lart, ‘security complex’ mund të krijohen pavarësisht distancave gjeografike, për shkaqe të tjera si ekonomike, politike, kulturore dhe energjetike. Si shembull mund të përmendim varësinë energjetike të vendeve perëndimore nga burimet energjetike të Lindjes së Mesme. E thënë ndryshe, ‘energy security complex’ lidhur me naftën si burim energjetik krijohen dhe midis aktorëve të pozicionuar gjeografikisht larg njëri – tjetrit. Kjo si pasojë e infrastrukturës energjetike, e cila është më fleksibël si pasojë e përdorimit të transportuesve detar. Ndryshe ndodh me gazin, për të cilën infrastruktura është më e ngurtë si pasojë e përdorimit të gazsjellësve, të cilat kalojnë kryesisht nëpërmjet rrugëve tokësore. Transporti i gazit të lëngshëm, i cili mund të kryhet nëpërmjet transportit detar, është më i kufizuar si pasojë e kostove të larta.

Për të identifikuar dhe analizuar një ‘energy security complex’, është e nevojshme të “vlerësohet fuqia relative e varësisë energjetike nëpërmjet matjes së indikatorëve të tillë si balancat e tregtisë energjetike, niveli i burimeve të brendshme dhe mundësitë për diversifikimin e energjisë” (Palonkorpi, 2009: 3). Në këtë mënyrë, sa më e lartë vlera e varësisë energjetike aq më e kërcënuar është siguria energjetike dhe kombëtare e një aktori. Varësia energjetike mund të jetë pasojë e varësisë nga një burim i vetëm ose varësi nga një lloj i vetëm i burimit energjetik, e lidhur kjo me atë që njihet si energjia mikse. Në qasjet tradicionale të marrëdhënieve ndërkombëtare, varësia lidhet me ekonominë (qasja neo/liberale) dhe politikën (qasja neo/realiste). Sistemet ekonomike, për pasojë dhe operimi në sektorin energjetik, mund të drejtohet nga dy logjika themelore (GEC, 2005).

Logjika e parë, ajo neo/realiste, lidhet me sistemet ekonomike të drejtuara nga shteti apo faktori politik. Në këtë sistem, aktorët që operojnë në sektorin energjetik janë nën

varësinë e shtetit. Ky sistem fokusohet tek fuqia shtetërore dhe konkurrenca ndërmjet aktorëve, dhe është karakteristikë e aktorëve të tillë si Rusia, Kina apo India. Logjika e dytë, ajo neo/liberale, lidhet me sistemet ekonomike të drejtuara nga tregu dhe fokusohet në fuqinë ekonomike të aktorëve dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar. Në këtë sistem, aktorët jo shtetëror luajnë një rol shumë të rëndësishëm në sektorin energjetik. Ky sistem është karakteristikë e aktorëve të tillë si SHBA, BE dhe Japonia.

Grafiku 1: Sistemet ekonomike të orientuara nga shteti (c, d) dhe tregu (a, b)



Burimi: GEC, 2005: 22

Por çfarë ndodh nëse aktorë nga dy sisteme të ndryshme krijojnë një marrëdhënie varësie? Si mund të analizohet një marrëdhënie në të cilën qasjet tradicionale ofrojnë një kuadër teorik të pjesshëm? “Pa një ndarje analitike të këtyre dy aspekteve të ndryshme, siguria energjetike do të interpretohej ose si plotësisht e orientuar nga tregu, ekuilibri midis kërkesë dhe ofertës për energji, ose si plotësisht e orientuar nga rivalitetet gjeopolitike midis shteteve për kontrollin e resurseve energjetike dhe rrugët e transitit të tyre” (Palonkorpi,

2009: 5). Konteksti ndërkombëtar bashkëkohor dëshmon se asnjëra nga qasjet e mësipërme e vetme, nuk është e mjaftueshme.

Shkolla e Kopenhagës, duke shkuar përtej këtyre burimeve të varësisë argumenton se për të krijuar një ‘security complex’ është e domosdoshme që varësia të perceptohet dhe artikullohet si një kërcënim ekzistencial, për pasojë të bëhet pjesë e procesit të sigurizimit. Struktura e ‘energy security complex’ është fleksibël, pasi mund të ndryshojë si pasojë e faktorëve të tillë si “ndryshimeve relative në nivelin e varësisë energjetike apo si rezultat i zhvendosjes së perceptimit nga varësia energjetike drejtë ndërvarësisë energjetike ose anasjelltas” (Palonkorpi, 2009: 10). Ndryshimi në marrëdhëniet midis shteteve, zbulimi i burimeve të reja energjetike, ndërtimi i kapaciteteve të reja, zhvillimet teknologjike apo përfshirja në projekte të tubacioneve rajonale/ndërkombëtare të transportit të burimeve energjetike, janë të gjithë faktor të rëndësishëm të cilët mund të ri konfigurojnë një ‘energy security complex’.

Duke qenë se marrëdhëniet midis aktorëve mund të jenë si të mira ashtu edhe problematike, edhe varësia mund të jetë si pozitive ashtu edhe negative. Varësia mund të jetë pozitive për ata aktorë të cilët karakterizohen nga marrëdhënie të mira, e për pasojë varësia ka efekt pozitiv si për vendet prodhuese ashtu edhe konsumatore të energjisë. Të dy palët dalin të fituara nga një marrëdhënie e tillë, sepse aktori importues i energjisë garanton sigurinë e tij energjetike nëpërmjet garantimit të furnizimit. Nga ana tjetër, aktori eksportues garanton sigurinë e tij energjetike duke garantuar aksesin në treg për produktin e tij. Një përfitim i tillë i ndërsjellët shoqërohet me përfitime dhe për vendet transit të energjisë.

Ndryshe paraqitet situata nëse varësia energjetike krijohet midis aktorëve të cilët nuk kanë një historik pozitiv të marrëdhënieve të tyre. Varësia negative, e cila vjen kryesisht si pasojë e përdorimit të energjisë si instrument i politikës së jashtme, krijon premisat për

varësinë politike të aktorit konsumator ndaj aktorit prodhues të energjisë. Varësia energjetike e vendeve Europiane nga gazi rus, sikurse do të trajtohet dhe më poshtë në mënyrë më të detajuar, karakterizohet si një varësi negative. Lloji i dytë i varësisë, ai negativ, është në pjesën më të madhe pjesë e procesit të sigurizimit, duke qenë se varësia energjetike perceptohet dhe artikullohet si kërcënim ekzistencial sigurie për aktorin importues.

Varësia pozitive mund të çojë në krijimin e komuniteteve të sigurisë ndërsa varësia negative mund të çojë në krijimin e ‘energy security complex’ dhe për pasojë të bëhet pjesë e procesit të sigurizimit. Por çfarë nënkupton sigurizimi i një fenomeni? Cilat janë etapat e tij? Si mund të aplikohet ai në rastin e energjisë? Cilët janë aktorët, shkaqet dhe implikimet e sigurizimit të energjisë? Këto pyetje do të trajtohen në mënyrë të detajuar në seksionin vijues të këtij punimi.

3.3.3. Teoria e sigurizimit – prioritizimi i energjisë në axhendat ndër/kombëtare

Teoria e sigurizimit, e njohur ndryshe dhe si procesi i sigurizimit, u prezantua nga Buzan, Waeber & de Wilde, në librin e tyre: *Security: A New Framework for Analysis* (1998). Sipas tyre, “sigurizimi është zhvendosja që e çon politikën përtej rregullave të themeluara të lojës dhe e inkuadron çështjen ose si një lloj të veçantë politike ose si mbi politikën dhe përtej saj” (Buzan et al., 1998: 23). Sigurizimi është procesi i inkuadrimit si çështje sigurie, dhe zhvendosjes nga skaji i politizimit drejtë atij të sigurizimit të spektrit nëpërmjet një akti sigurizimi, të një problematike të caktuar. E thënë ndryshe, është e nevojshme që një aktor sigurizues të artikulojë një çështje, paraprakisht të politizuar, si kërcënim ekzistencial për një objekt referues.

Grafiku 2: Spektri i sigurizimit




Burimi: Emmers, 2013: 153

Sikurse vihet re dhe nga diagrami e mësipërme, spektri i sigurizimit nëpër të cilën mund të kalojë një fenomen, ka tre stade kryesore. Në stadin e parë, fenomeni është i pa politizuar, çështja nuk është e përfshirë në debatin publik. Kjo nuk nënkupton se fenomeni në fjalë nuk ekziston, por ai nuk artikullohet në debatin publik dhe aktorët, kryesisht shteti, nuk merren me të. Në stadin e dytë, fenomeni politizohet, duke u përfshirë në debatin publik, por menaxhohet brenda sistemit politik standard. Trajtimi i fenomenit bëhet nëpërmjet politikave publike dhe kërkon vendimmarrje qeveritare dhe alokim resursesh. Në stadin e tretë, atë të sigurizimit, fenomeni në fjalë inkadrohet si problem sigurie përmes një akti sigurizimi.

Një aktor sigurizues, artikulon dhe paraqet një çështje paraprakisht të politizuar si kërcënim ekzistencial për një objekt referues (Emmers, 2013). Në këtë mënyrë, siguria kthehet në një praktikë vetë referenciale, sepse nuk është e rëndësishme të ekzistojë një kërcënim ekzistencial, e rëndësishme është që një fenomen i caktuar të prezantohet si i tillë, si një kërcënim ekzistencial. Ky është një element i cili dëshmon qartë konstruktin social të sigurisë, një premisë themelore e qasjes konstruktiviste. Teoria e sigurizimit përcakton dhe metodologjinë e studimit të saj. “Sigurizimi mund të studiohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk ka nevojë për indikatorë. Mënyra e studimit të sigurizimit është nëpërmjet studimit të diskurit dhe konstelacioneve politike” (Buzan et al., 1998: 25).

Aplikimi i teorisë së sigurizimit shoqërohet me dy implikime kryesore; kohore dhe gjeografike. Implikimi kohor nënkupton se, pavarësisht se një fenomen i caktuar mund të jetë prezent prej një kohe të gjatë, vetëm kur ai i prezantohet publikut si një kërcënim ekzistencial, trajtohet si i tillë. Nëse nuk ndodh një proces i suksesshëm sigurizimi, fenomeni mund të vazhdojë të jetë në kahun e depolitizuar apo të politizuar të spektrit. Implikimi gjeografik nënkupton se edhe nëse fenomeni është prezent në sistemin ndërkombëtar apo rajonal, ai mund të sigurizohet në disa zone dhe të jetë i depolitizuar apo i politizuar në disa zona të tjera gjeografike. Sipas kësaj qasje, kërcënimet nuk janë ‘aty jashtë’ në mënyrë objektive, por marrin jetë në saj të një procesi të ndërtimit inter – subjektiv. Kjo nënkupton se, në ndryshim nga determinizmi i qasjes realiste, për këtë qasje rëndësi primare ka procesi i ndërtimit të sigurisë dhe i kërcënimeve ndaj saj. Në mënyrë skematike, procesi i sigurizimit mund të paraqitet sipas skemës së mëposhtme.

Figura 1: Procesi i sigurizimit



Procesi i sigurizimit kryhet në dy etapa. Etapa e parë lidhet me identifikimin e një problematike apo fenomeni si kërcënim ekzistencial për një objekt referues. Në këtë mënyrë fenomeni duhet të lëvizë drejtë skajit fundor të spektrit të sigurizimit. Në të njëjtën kohë është e nevojshme të përcaktohet dhe objekti referues, për të cilin fenomeni në fjalë mund të përbëjë një kërcënim ekzistencial. “Objektet referues mund të jenë individët, grupet e ndryshme (refugjatët, viktimat) si dhe fusha (si sovraniteti, mjedisi, etj.) që zotërojnë një pretendim legjitim për të mbijetuar dhe ekzistenca e të cilëve duket se kërcënohet” (Emmers, 2013: 154). Si identifikimi i fenomenit ashtu edhe objekti referues, kryhet nga një aktor sigurizues. “Aktorët sigurizues mund të jenë qeveria, elita politike, ushtria dhe shoqëria civile. Ata sigurizojnë një çështje duke artikuluar ekzistencën e një ose disa kërcënimeve për mbijetesën e objekteve specifike referuese” (Emmers, 2013: 154).

Kjo etapë e procesit të sigurizimit, nuk është e mjaftueshme. Për të pasur një sigurizim të suksesshëm, është e domosdoshme të përmbushen kriteret e stadi të dytë. Duhet që “aktorët sigurizues të përdorin aktin ligjërues për të bindur një audiencë specifike për natyrën ekzistenciale të kërcënimit që u kanoset” (Emmers, 2013: 154). Vetëm nëse aktori sigurizues, nëpërmjet aktit të ligjërimit, arrin të bindë audiencën atëherë mund të thuhet se çështja është sigurizuar dhe për pasojë merren masa të jashtëzakonshme të cilat shkojnë përtej rregullave standarde. Pasi përfundon ky proces, zhvillohet procesi i desigurizimit, i cili është procesi i zhvendosjes së një fenomeni apo aktori nga spektri i sigurisë drejt spektrit të politikave normale (McDonald, 2013: 73).

Sikurse shprehet dhe McDonald, “sigurizimi mund të përkufizohet si një proces në të cilin një aktor deklaron një çështje, një dinamikë apo një aktor specifik si kërcënim ekzistencial për një objekt referues specifik. Nëse pranohet si i tillë nga një audiencë e caktuar, kjo mundëson pezullimin e politikave normale dhe përdorimin e masave emergjente

për t'iu përgjigjur kërcënimit të perceptuar. Sigurizimi, në këtë kuptim, është një medium negocimi midis ligjëruesit dhe audiencës, i kushtëzuar nga autoriteti i ligjëruesit brenda një grupi specifik...artikulimi i kërcënimit kryhet nëpërmjet aktit të ligjërimit” (2013: 72). Por si mund të aplikohet procesi i sigurizimit në rastin e energjisë? Cili apo cilët mund të jenë objekt referues? Po aktori sigurizues? Cila do të jetë audienca, e cila duhet të bindet për natyrën ekzistenciale të kërcënimit energjetik që u kanoset, me qëllim sigurizimin e çështjes? Cila mund apo duhet të jetë gjuha e përdorur nga aktorët?

“Politikat energjetike duhet të sigurizohen dhe duhet të trajtohen si çështje sigurie” (Buzan, 1991: 52). Sikurse u përmend dhe më lart, objekt referues mund të jenë individët, grupet e caktuara apo fusha të ndryshme, një prej të cilave mund të jetë dhe energjia. Varësia energjetike, ajo negative, mund të perceptohet si kërcënim ekzistencial e për pasojë të sigurizohet. Varësia negative mund të krijohet si nga një burim i vetëm (një shtet apo rajon) ashtu dhe nga një lloj i vetëm energjetik (nafta, gazi, hidrik, bërthamor, etj.). Duke qenë një çështje kaq komplekse, në të cilën përfshihen aktorë të ndryshëm si shtetëror ashtu edhe jo shtetëror, të cilët operojnë në nivele dhe me logjika të ndryshme, sigurizimi i energjisë kërkon një vëmendje të veçantë.


Duke qenë se aktorët shtetëror veprojnë në bazë të logjikës së interesit kombëtar, ndërsa aktorët jo shtetëror veprojnë në bazë të interesit personal, atëherë është e vështirë të identifikohet si objekti referues ashtu edhe aktori sigurizues në rastin e sigurisë energjetike. Kur akti i ligjërimit artikulohet nga aktorët shtetëror, siguria kombëtare kthehet në temën kryesore, ndërsa kur akti i ligjërimit artikulohet nga aktorët jo shtetëror atëherë ekonomia, e lidhur me raportin kërkesë/ofertë dhe çmimin, kthehen në temën kryesore. Por në një kohë që zhvillimi ekonomik ashtu edhe mbijetesa e një aktori është e varur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga siguria energjetike, atëherë aktorët e përfshirë në këtë sistem duhet të

harmonizojnë interesat e tyre. Është e domosdoshme të mbahet në konsideratë fakti se rezervat energjetike janë të kufizuara, ndërsa kërkesa sa vjen dhe rritet. Sa më shumë të thellohet ky hendek, aq më shumë do të intensifikohet konkurrenca midis aktorëve dhe për pasojë do të rritet nevoja për sigurizimin e energjisë.

Nëse i referohemi nivelit të analizës, sigurizimi mund të ndodhë në nivelin kombëtar, rajonal dhe global. Në dy nivelet e para, sigurizimi është relativisht më i thjeshtë krahasuar me nivelin global. Kjo për faktin se aktorët e sistemit global, të cilët kanë karakteristika dhe interesa të ndryshme, për më tepër janë dhe gjeografikisht larg njëri – tjetrit, e kanë thuajse të pamundur ndërgjegjësimin kolektiv lidhur me rëndësinë e sigurisë energjetike. Kjo është dhe një nga arsyet kryesore përse RCST ka një rëndësi të veçantë, dhe kryesisht kur aplikohet në sigurinë energjetike.

Në varësi të nivelit të analizës, mund të përcaktohen dhe aspektet të cilat mund apo duhet të sigurizohen. Në nivelin shtetëror, mund të sigurizohen marrëdhëniet bilaterale në fushën energjetike, në nivelin rajonal varësia dhe ndërvarësia, ndërsa në nivelin global mund të sigurizohet raporti midis kërkesës dhe ofertës globale. Aplikimi i sigurizimit dhe Regional Energy Security Complex në sigurinë energjetike, janë paraqitur mjaft qartë dhe në mënyrë skematike nga Palonkorpi.

Figura 2: Skema e aplikimit të sigurizimit dhe RESC në sigurinë energjetike



Burimi: Palonkorpi, 2009: 16

Si procesi i sigurizimit ashtu dhe procesi i desigurizimit janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me perceptimin e aktorëve ndaj njëri – tjetrit. Në ato raste, kur aktorët perceptojnë një raport normal të marrëdhënieve, atëherë kemi të bëjmë me varësinë pozitive dhe çështjet e sigurisë energjetike trajtohen brenda desigurizimit, nën kornizën e tregjeve energjetike rajonale. Ndryshe paraqitet situata në ato raste kur marrëdhëniet midis aktorëve perceptohen në mënyrë armiqësore. Në këto raste, varësia konsiderohet negative duke u perceptuar si rrezik. Në një situatë të tillë, çështjet e sigurisë energjetike mund të bëhen pjesë e procesit të sigurizimit duke çuar drejt krijimit të RESC. Këto procese nuk ndodhin vetvetiu, por është e nevojshme që aktori sigurizues, nëpërmjet aktit ligjërimit, të identifikojë rrezikun që i kanoset objektit referues, dhe audienca të bindet për ‘vërtetësinë’ e kësaj situatë.

Kritikat kryesore që i bëhen sigurizimit, lidhen me vështirësinë në përcaktimin e kufirit të qartë midis politizimit dhe sigurizimit (Percival, 2008) dhe si një qasje euro centriste (Emmers, 2013). Duke pasur në konsideratë këto kritika, është e vërtetë se nuk mund të përcaktohen kritere matëse universale për të bërë një ndarje të tillë, por kjo nuk nënkupton se teoria e sigurizimit nuk është e rëndësishme, por thjeshtë nënkupton se vija ndarëse mund të qartësohet në bazë të konteksteve në të cilat ajo aplikohet. Pavarësisht faktit nëse kritika për euro centrizmin e qasjes është apo jo e vërtetë, duke qenë se objekti i këtij punimi lidhet me kontekstin European, kjo kritikë nuk ndikon në vlefshmërinë e përdorimit të kësaj qasje.

Lidhur me kritikën e dytë mund të themi se, nëse në mënyrë arbitrare do të vendosnim një linjë ndarëse midis politizimit dhe sigurizimit të çështjeve energjetike, për aq kohë sa shkëmbimet energjetike operojnë brenda kushteve të tregjeve, atëherë çështjet e energjisë mund të trajtohen brenda kuadrit të politizimit. Në ato raste, ku tregu nuk arrin të

rregullojë këto marrëdhënie, dhe aktorë të tjerë ndërhyjnë në këtë situatë, atëherë çështja trajtohet brenda sigurizimit. Në këto raste, aktorët sigurizues janë kryesisht aktorët shtetëror, qofshin këto qeveritë, elitat politike apo kompanitë energjetike kombëtare. Kërcënimi që mund të identifikohet mund të jetë si varësia nga importi ashtu edhe nga eksporti. Kjo ndodh kryesisht në ato raste kur varësia nga importi, ekziston për shkak të mbështetjes në një burim të vetëm ose në një lloj të vetëm të energjisë.

Si shterimi i burimit ashtu dhe përdorimi i energjisë si instrument i politikës së jashtme, mund të identifikohen si kërcënim ekzistencial. Objekti referues në këto raste është vetë mbijetesa e shtetit. Aktorët shtetëror mund të përdorin një akt ligjërimit i cili të bindë audiencën për rreziqet energjetike që i kanosen, dhe për pasojë të ndërmarrë masa të jashtëzakonshme. Masat mund të jenë të natyrës ekonomike, politike ose të kombinuara. Varësia energjetike nga Rusia, e analizuar në kuadrin e konfliktit në Ukrainë, mund të shërbejë si një rast i përshtatshëm studimor në këtë drejtim. Një analizë e tillë, do të paraqitet në një ndër seksionet vijues të këtij punimi.

3.4. Konkluzione

Në këtë kapitull ofrohet një pasqyrë e teorive kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mund të aplikohen në identifikimin dhe analizimin e implikimeve të sigurisë energjetike në sigurinë ndër/kombëtare. Pas pasqyrit të aspekteve dhe premisave teorike, zhvillohet një qasje kritike për të identifikuar avantazhet dhe disavantazhet e teorive specifike, kur aplikohen në studimin e sigurisë energjetike, me qëllim argumentimin e përzgjedhjes së njërës nga këto qasje në raport me qasjet e tjera.

Çështjet e energjisë kanë fituar një rëndësi të veçantë për shkak të sfidave të ndryshme me të cilat përballen tregjet energjetike, të cilat variojnë nga burimet e kufizuara,

rritja e kërkesës, varësia e lartë dhe paqëndrueshmëria në rajonet e pasura me burime energjetike. Të gjitha këto sfida kërkojnë një qasje multidimensionale dhe të integruar, me qëllim garantimin e sigurisë energjetike në terma afat-shkurtër dhe afat-gjatë. Duke qenë se shpeshherë tregjet nuk arrijnë të rregullojnë këto problematika, atëherë është e domosdoshme që aktorë të tjerë të angazhohen për të përmirësuar situatën në sistemin energjetik. Për aq kohë sa energjia qëndron në themel të zhvillimit, çështjet e lidhura me të duhet të bëjnë pjesë në hierarkinë e axhendave të aktorëve.

Qasjet tradicionale të marrëdhënieve ndërkombëtare, neo/realizmi dhe neo/liberalizmi pavarësisht rëndësisë së tyre, kanë një sërë mangësish nëse aplikohen në studimin e sigurisë energjetike. Argumenti kryesor i qasjes neo/realiste fokusohet në rolin e aktorëve shtetëror të cilët synojnë maksimizimin e pozicionit të tyre në raport me burimet energjetike. Duke e lidhur energjinë me kapacitete ushtarake, kjo qasje nuk vlerëson ndikimin e dimensionit ekonomik dhe identitar, në raport me sigurinë energjetike. Për më tepër, duke qenë një qasje shteto – centrike, nuk merr parasysh rolin dhe ndikimin e aktorëve jo – shtetëror, në sistemin energjetik. Nga ana tjetër, qasja neo/liberale fokusohet në rolin e institucioneve ndërkombëtare, bashkëpunimit dhe tregjeve liberale, të cilat i konsideron si kushte të mjaftueshme për bashkëpunimin midis aktorëve. Kritika që mund t'i bëhet kësaj qasje, lidhet me mbivlerësimin e institucioneve dhe tregut, duke mos u ndalur tek impakti që gjeografia e burimeve energjetike ka në sistemin ndërkombëtar dhe përdorimi i energjisë si instrument në politikën e jashtme. Këto mangësi, dëshmojnë se qasjet tradicionale janë të rëndësishme, por jo të mjaftueshme për studimin e sigurisë energjetike.

Qasja konstruktiviste kombinon element të dy qasjeve të mësipërme. Duke e ruajtur fuqinë si një komponent të rëndësishëm në qasjen e tyre, ata e lidhin fuqinë me idetë, kulturën dhe gjuhën, në ndryshim nga qasjet tradicionale të cilat e shohin fuqinë në terma

materiale. Shkolla e Kopenhagenit ka rëndësi kryesore në funksion të këtij punimi, dhe bazohet në tre komponentë kryesor: analiza sektoriale e sigurisë; regional security complexes dhe sigurizimit. Një përkufizim bazik i sigurisë, sipas kësaj qasje është ekzistenca e një gjendje me probabilitet të ulët të dëmtimeve ndaj vlerave të arritura. E thënë ndryshe, kjo qasje e vendos fokusin e saj tek ruajtja e vlerave të arritura të aktorëve dhe jo tek prania apo mungesa e kërcënimeve. Në këtë mënyrë siguria përkufizohet në termat: *Siguri për kë?* dhe *Siguri për cilat vlera?*

Sipas kësaj qasje, siguria e njerëzimit ndikohet nga faktorë të përfshirë në pesë sektorë kryesorë; ushtarak, politik, ekonomik, shoqëror dhe mjedisor. Siguria energjetike nuk është një sektor i veçantë por ajo ndikon dhe ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sektorët e tjerë të sigurisë, duke qenë në këtë mënyrë një fenomen ndër sektorial. Pavarësisht pozitës së një aktori në infrastrukturën ndërkombëtare të energjisë, si vend prodhues, importues apo transit, siguria energjetike përbën një nga çështjet kryesore të cilat duhen prioritetizuar dhe adresuar në mënyrë efikase. Duke qenë se sistemi ndërkombëtar përballet me sfida dhe kërcënime, të cilat shfaqen në forma dhe momente të ndryshme në zona të caktuara të globit, atëherë si analiza në nivel shtetëror ashtu dhe ajo në nivel sistemi nuk janë të mjaftueshme.

Për të tejkaluar një mangësi të tillë, Buzan paraqet idenë e ‘security complex’, dhe nëse kjo aplikohet në sigurinë energjetike, me ‘energy security complex’ do të kuptonim një grup aktorësh të vendosur në një zonë gjeografike të caktuar, të karakterizuar nga një marrëdhënie e varësisë energjetike, varësi e cila perceptohet si rrezik dhe duhet sigurizuar. Varësia negative, është në pjesën më të madhe pjesë e procesit të sigurizimit, duke qenë se ajo perceptohet dhe artikullohet si kërcënim ekzistencial sigurie për aktorin importues. Këto procese nuk ndodhin vetvetiu, por është e nevojshme që aktori sigurizues, nëpërmjet aktit

ligjërimor, të identifikojë rrezikun që i kanoset objektit referues, dhe audienca të bindet për ‘vërtetësinë’ e kësaj situate, dhe të legjitimohet përdorimi i masave ekstreme. Varësia negative mund të krijohet si nga një burim i vetëm (një shtet apo rajon) ashtu dhe nga një lloj i vetëm energjetik (nafta, gazi, hidrik, bërthamor, etj.).

Si përfundim, qasja multi – dimensionale mbi sigurinë e Shkollës së Kopenhagenit ofron një kornizë të përshtatshme analitike dhe teorike për studimin e sigurisë energjetike, ku hapësira gjeografike e studimit do të jetë në kontekstin European. Kjo është një qasje e përshtatshme për këtë punim, qëllimi i të cilit është të identifikojë dhe analizojë implikimet e sigurisë energjetike në politikat kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, me një fokus të veçantë në perceptimin e aktorëve, diskursat e tyre dhe dokumentet strategjik të hartuar dhe implementuar. Përparësitë e aplikimit të kësaj qasje, lidhen me zgjerimin e fokusit të çështjeve të sigurisë duke përfshirë kërcënime jo – tradicionale, të cilat janë prezent në ditët e sotme dhe kanë impakt të drejtpërdrejt në sigurinë globale.

Si procesi i sigurizimit, ashtu dhe ai i desigurizimit, shërbejnë për të kuptuar sjelljen e shteteve në raport me burimet energjetike, si në nivelin rajonal ashtu dhe atë ndërkombëtar. Kjo qasje ofron një kornizë të përshtatshme analitike, për të shpjeguar implikimet e varësisë energjetike, nevojën për diversifikimin e burimeve, përdorimin e energjisë si instrument në politikën e jashtme por edhe përdorimin e instrumenteve ekonomik, politik dhe ushtarak për të garantuar aksesin në burime energjetike. Të gjithë këto element janë të pranishëm në momentin kur analizohet siguria energjetike në kontekstin European, karakteristika kryesore e së cilës është varësia (kryesisht nga Rusia) si kërcënim dhe diversifikimi si prioritet.

Kapitulli IV: Siguria energjetike në BE

4.1. Një vështrim mbi situatën dhe aktorët kryesor energjetik në nivel global

Për të identifikuar dhe analizuar situatën globale të sigurisë energjetike është e nevojshme që të ndalemi në disa momente kyçe. Cila është situata e sigurisë energjetike në rrafshin global dhe cilat janë parashikimet për të ardhmen? Cilët janë aktorët kryesor të këtij sistemi? Po përse siguria energjetike merr një rëndësi të veçantë në tërësinë e politikave ndër/kombëtare? Si ndikon shpërndarja e burimeve energjetike në këtë drejtim? Çfarë vendi zë siguria energjetike në diskurin dhe vendimmarrjen e aktorëve kryesor të sistemit ndërkombëtar? Të gjitha këto janë disa pyetje të cilat prekin problematika shumë të rëndësishme lidhur me sigurinë energjetike dhe politikat ndër/kombëtare. Sikurse do të shikohet dhe në vijim, si shpërndarja e pabarabartë e burimeve energjetike ashtu edhe perceptimi i aktorëve mbi sigurinë energjetike, luajnë rol vendimtar në hartimin dhe implementimin e politikave ndër/kombëtare.

4.1.1. Rezervat, prodhimi dhe konsumi i energjisë në nivel global

Janë disa institucione, agjenci dhe kompani të cilat ofrojnë në mënyrë periodike të dhëna mbi shpërndarjen e burimeve energjetike, prodhimin, transitin, konsumin e energjisë dhe gjithashtu kryejnë projeksione për të ardhmen. Ndër më të rëndësishmit mund të përmendim publikimet e International Energy Agency (IEA), US Energy Information Administration (EIA), ExxonMobil, British Petroleum (BP) dhe OPEC. Burim tjetër i të dhënave janë dhe institucionet kombëtare, të cilat kanë në fokusin e tyre statistikën e përgjithshme ose ato institucione që janë të fokusuara kryesisht në çështjet e energjisë. Elementi themelor që theksohet nga të gjitha burimet e të dhënave mbi treguesit energjetik është fakti se si shpërndarja e burimeve energjetike ashtu dhe niveli i kërkesës në rang global, kanë një

shpërndarje të pabarabartë në rajone të ndryshme. IEA, në World Energy Outlook 2007², ndër të tjera theksonite kërcënimet që vinin si pasojë e rritjes së varësisë për furnizimin me naftë nga një numër në ulje i vendeve prodhuese; rrezikun nga ndërprerja e furnizimit për shkak të rritjes së tregtisë ndërkombëtare të naftës dhe gazit; rreziqet nga paqëndrueshmëria politike në vendet prodhuese dhe transit të energjisë.

Para se të zhvillojmë një analizë të përgjithshme mbi situatën globale të energjisë, është e nevojshme të ndalemi tek IEA, si institucioni ndërkombëtar më i rëndësishëm i cili ka në fokusin e tij sigurinë energjetike. Në faqen zyrtare të Agjencisë³ sikurse dhe në raportin e saj të 2014⁴, ndër të tjera pasqyrohet historiku, misioni dhe objektivat e saj. IEA u themelua në Nëntor 1974, me një mandat fillestar të dyfishtë: promovimi i sigurisë energjetike midis vendeve anëtare nëpërmjet reagimit kolektiv ndaj ndërprerjeve fizike të furnizimit me naftë dhe ofrimi i kërkimeve dhe analizave serioze për mënyrat e garantimit të furnizimit të besueshëm, të përbalueshëm dhe të pastër me energji për 29 vendet anëtare e më gjerë. Shtysa kryesore për krijimin e Agjencisë ishin ndryshimet themelore ekonomike dhe politike të lidhura me tregun ndërkombëtar të naftës, pas konflikteve në Lindjen e Mesme në vitet 1973-74. Rritja e rëndësisë së naftës për vendet e OECD-s në raport me qymyrgurin, rritja e kërkesës për të si promotor i zhvillimit, varësia e lartë nga vendet Arabe ishin arsyet kryesore që ndikuan në perceptimin si kërcënim nga ana e tyre e vendimit të vendeve Arabe për ta përdorur naftën si ‘armë’ ekonomike dhe politike. Vendimi lidhej me reduktimin e prodhimit dhe rritjen e menjëhershme të çmimit të naftës.

2 http://www.worldenergyoutlook.org/media/weowebiste/2008-1994/WEO_2007.pdf

3 Faqja zyrtare e Agjencisë Ndërkombëtare e Energjisë <http://www.iea.org/>


4 Energy Supply Security – Emergency Response of IEA Countries 2014.

Duhet theksuar se Agjencia ka mision këshillues dhe jo vendimmarrës. Ndër objektivat kryesore të saj janë:

- Sigurimi i aksesit në burime të mjaftueshme dhe të besueshme të të gjithë formave të energjisë;
- Promovimi i politikave të qëndrueshme të energjisë që nxisin zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit në një kontekst global;
- Përmirësimi i transparencës së operimit të tregjet ndërkombëtare;
- Fokusimi te zhvillimi i teknologjive që aplikohen në sektorin e energjisë.

Rëndësia e përmbushjes së misionit dhe objektivave të Agjencisë, bëhet akoma më e qartë kur pasqyrohet situata globale e energjisë. Gjithashtu, të dhënat mbi shpërndarjen, prodhimin dhe kërkesën globale për energji, do të ndihmonin për të treguar nevojën për sigurizimin e energjisë.

Grafiku 3: Shpërndarja e rezervave të naftës në 1993, 2003 dhe 2013




Burimi: BP Statistical Review of World Energy, Qershor 2014

Sikurse shihet nga grafiku i mësipërm, rezervat e njohur të naftës janë të shpërndara në mënyrë të pa barabartë në rajone të ndryshme. Lindja e Mesme është rajoni me pasuritë

më të mëdha të naftës, me një normë prej 47.9 % të totalit të përgjithshëm. Në vend të dytë renditet Amerika Qendrore dhe Jugore me 19.5 %, e ndjekur nga Amerika Veriore me 13.6 %. Europa & Euroazia disponojnë rreth 8.8 % të rezervave globale të naftës. Këto të dhëna tregojnë pozitën e aktorëve (rajoneve) në sistemin energjetik ndërkombëtar, në raport me rezervat e disponueshme. Ky është një tregues i rëndësishëm së rajonit të Lindjes së Mesme, i cili shpjegon dhe fokusin e aktorëve kryesor të sistemit ndërkombëtar (si SHBA, BE, Rusia dhe Kina) ndaj këtij rajoni. Duke qenë një aktor i rëndësishëm në sistemin energjetik ndërkombëtar, situata në Lindjen e Mesme dhe kërcënimet me të cilat ajo përballet, kanë ndikim në sigurinë energjetike në rrafshin global. Si luhatjet e çmimit, ashtu dhe ndërprerja e mundshme e prodhimit për shkaqe të ndryshme, kanë impakt të drejtpërdrejt në tregun ndërkombëtar të energjisë.

Grafiku 4: Prodhimi dhe konsumi i naftës sipas rajoneve




Burimi: BP Statistical Review of World Energy, Qershor 2014

Në grafikët e mësipërm paraqiten të dhënat mbi prodhimin dhe konsumin e naftës sipas rajoneve. Sikurse vihet re, rajoni i Lindjes së Mesme, përveçse disponon rezervat më

të mëdha të njohura të naftës, është dhe prodhuesi kryesor i saj në rang global. Grafiku mbi prodhimin e naftës dëshmon për tendencat rritëse të prodhimit të saj. Nëse do i referohemi grafikut të konsumit të naftës vihet re se konsumatorët kryesor janë Azia, Europa dhe Amerika e Veriut. Grafiku demonstroi lidhjen midis zhvillimit ekonomik dhe konsumit të energjisë. Europa dhe Amerika e Veriut, të cilat janë rajonet më të zhvilluara të globit, janë gjithashtu konsumatorët kryesor të energjisë. Ndërsa Afrika dhe Amerika Qendrore & Jugore, karakterizohen nga një nivel i ulët i zhvillimit ekonomik dhe konsumit të energjisë në të njëjtën kohë. Disproporcioni më i madh midis prodhimit dhe konsumit, çka dëshmon një varësi të lartë nga importi i naftës, është rajoni i Azisë. Sikurse është evidentuar dhe nga Yergin, për ato vende ku kërkesa për energji po rritet në mënyrë shumë të shpejtë, si Kina dhe India, aftësia e tyre për t'u përshtatur me rregullat e një varësie të re nga tregjet botërore do të jetë e rëndësishme për sigurinë e tyre energjetike (Yergin, 2006).

Bazuar në të dhënat e BP, prodhimi global i naftës në vitin 2013 u rrit me 550.000 b/d, më pak se gjysma e rritjes së konsumit global i cili shënoi një rritje prej 1.4 milion b/d. Rritja e kërkesës lidhet me vendet në zhvillim (BP, 2014: 19). Grafiku mbi konsumin e naftës, sikurse dhe ai i prodhimit, shfaq tendencat rritëse për të ardhmen. Duke qenë se burimet e naftës janë të kufizuara dhe po shkojnë drejt shterimit, atëherë tendenca e rritjes së konsumit paraqet një sfidë për sigurinë energjetike në të ardhmen. Sfidat nuk prek vetëm vendet konsumatore, të cilët nuk do të arrijnë të përmbushin kërkesat e tyre, por do të përbëjnë kërcënim dhe për sigurinë e vendeve prodhuese, të cilët e kanë naftën si burimin kryesor të të ardhurave për ekonominë e tyre. Problemet ekonomike do të shoqërohen me probleme sociale dhe politike. Ky është një tregues i energjisë [naftës] si një fenomen ndër sektorial, i cili ndikon dhe ndikohet nga të gjithë sektorët e sigurisë.

Figura 3: Tregtia e naftës në 2013 (milion ton)



Burimi: BP Statistical Review of World Energy, Qershor 2014

Sikurse vihet re nga figura e mësipërme, aktorët e sistemit ndërkombëtar janë të përfshirë në një tregti intensive të naftës. Implikimet e drejtpërdrejta të kësaj janë:


- dimensionin ekonomik i energjisë – energjia si një fenomen ndër sektorial;
- krijimi i marrëdhënieve të varësisë dhe ndërvarensisë – mundësitë e krijimit të ‘regional energy security complexes’;
- energjia si një fenomen shumë nivelor – shtetëror, rajonal dhe ndërkombëtar.

Të gjithë këto element ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë sigurinë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe për pasojë përforcojnë idenë e rëndësisë jetike të energjisë për aktorët e sistemit ndërkombëtar, pavarësisht pozitës së tyre brenda këtij sistemi. Këto të dhëna dëshmojnë për rëndësinë e energjisë në ditët e sotme por edhe në të ardhmen. Në dekadën e fundit, një kujdes i veçantë i është kushtuar dhe implikimeve mjedisore të energjisë, të lidhura me efektet negative që vijnë nga emetimi në atmosferë i gazrave të dëmshëm dhe prishja e ekosistemeve. Një ndërgjegjësim i tillë është i dukshëm kryesisht në vendet perëndimore. Politik-bërësit, industria energjetike dhe grupet e interesit synojnë të

fokusohen në reduktimin e nivelit të emetimit të gazrave, si mënyra e duhur për të arritur objektivat ekonomik, mjedisor dhe ato të sigurisë energjetike (Newell & Iler, 2013).

Në një situatë të ngjashme me naftën si burim i rëndësishëm i energjisë, dhe implikimet e saj, ndodhet dhe burimi tjetër po aq i rëndësishëm i energjisë, gazi natyror. Por nëse tregu i naftës është disi më i strukturuar, përfshirë dhe çmimet e saj, për gazin natyror situata është akoma më problematike. Mungon një treg ndërkombëtar i gazit natyror, për pasojë dhe çmimi i tij është më shumë produkt i marrëveshjeve bilaterale sesa i rregulluar nga raporti kërkesë – ofertë. Rregullimi i tregtisë së gazit në bazë të marrëveshjeve bilaterale, dhe jo në bazë të një tregu liberal, rrit mundësitë e përdorimit të energjisë [gazit natyror] si instrument i politikës së jashtme. Një përdorim i tillë identifikohet në literaturën ekzistuese por edhe praktikën ndërkombëtare, si i lidhur kryesisht me Rusinë. Ky është një fenomen i cili do të trajtohet në mënyrë më të detajuar në vijim të këtij punimi. Sikurse dhe në rastin e naftës, edhe shpërndarja globale e rezervave të gazit natyror është e pa barabartë midis rajoneve.


Grafiku 5: Shpërndarja e rezervave të gazit natyror në 1993, 2003 dhe 2013



Burimi: BP Statistical Review of World Energy, Qershor 2014

Sikurse vihet re nga grafiku i mësipërm, rajoni i Lindjes së Mesme është më i pasuri me rezerva të provuara të gazit natyror, me një normë prej 43.2% të totalit global, e ndjekur nga Europa & Euroazia me 30.5 %. Sikurse vihet re, dy rajonet së bashku kanë mbi 70 % të rezervave të gazit. Në këtë mënyrë, ato kthehen në aktorët kryesor të sistemit ndërkombëtar, referuar rezervave të disponueshme. Pjesa më e madhe e burimeve të gazit, në rajonin e Europës & Euroazisë, i përket Rusisë.

Grafiku 6: Prodhimi dhe konsumi i gazit sipas rajoneve




Burimi: BP Statistical Review of World Energy, Qershor 2014

Për sa i përket gazit natyror sipas rajoneve, të dhënat tregojnë se Europa & Euroazia dhe Amerika e Veriut, janë prodhuesit kryesor sikurse dhe konsumatorët kryesor të këtij produkti energjetik. SHBA, në sajë të rezervave të brendshme dhe aplikimit të teknologjive të reja në nxjerrjen e gazit, kanë njohur ‘një periudhë të artë’ të prodhimit dhe konsumit të gazit natyror. Për SHBA, pasuritë në rezerva të gazit natyror përbëjnë një faktor që ndikon në garantimin e sigurisë energjetike. Ndryshe paraqitet situata në vendet Europiane, të cilët për shkak të varësisë nga gazi rus, nuk arrijnë të garantojnë sigurinë e tyre energjetike. Një varësi e tillë, e cila perceptohet si varësi negative, është shqetësuese për BE e cila ka

përfshirë energjinë në procesin e sigurizimit, ku diversifikimi i burimeve shihet si një nga zgjidhjet e kësaj problematike.

Figura 4: Tregtia e gazit në 2013 (milion ton)




Burimi: BP Statistical Review of World Energy, Qershor 2014

Sikurse dhe në rastin e naftës, edhe tregtia e gazit shfaqet në shumë dimensionë, me implikim të drejtpërdrejtë në sigurinë energjetike. Bazuar në të dhënat e mësipërme, duke u përqendruar tek Europa e cila ka rëndësi për këtë punim, vihet re se pavarësisht se importi i gazit natyror kryhet nga tre rajone të ndryshme, importi i gazit nga Rusia zë volumn më të madh të këtij importi. Transporti i gazit kryhet në dy mënyra. Mënyra e parë, është ajo e LNG (Liquefied Natural Gas – i cili është gaz natyror i konvertuar në lëng për lehtësi të depozitimit dhe transportimit) ndërsa mënyra e dytë është ajo nëpërmjet gazsjellësve. Mënyra e dytë, e cila është dhe infrastruktura më e përdorur, zhvillohet me intensitet më të lartë në zona gjeografike të afërta. Një karakteristikë e tillë, paraqet dimensionin e argumentuar nga Regional Complex Theory, e cila thekson rëndësinë e pozitës gjeografike

në formimin e ‘security complexes’ në tërësi dhe ‘energy security complexes’ në veçanti, e cila është dhe në fokus të këtij punimi.

Emëruesi i përbashkët i publikimeve të agjencive/ institucioneve që kryejnë studime mbi projeksionin e treguesve energjetik për dekadat e ardhshme, është konstatimi se konsumi global i energjisë, bazuar në projeksionet për të ardhmen, pritet të ketë një rritje me rreth 30 – 35 % në dy dekadat e ardhshme. Duke pasur në konsideratë se burimet tradicionale si nafta dhe gazi, të cilat zënë pjesën kryesore në energjinë mix, po shkojnë drejtë shterimit atëherë përqindja e parashikuar e rritjes në të ardhmen është akoma dhe më problematike. Ndër faktorët kryesor të cilët ndikojnë në nivelin e konsumit të energjisë janë GDP, intensiteti energjetik i aktiviteteve ekonomike (e shprehur me raportin e energjisë për njësi të GDP) dhe popullsia (Newell & Iler, 2013).

Grafiku 7: Projeksioni për popullsinë, GDP dhe energjinë në dekadat e ardhshme



Burimi: BP Energy Outlook 2030

Në raportin studimor të Komisionit European ‘*World Energy, Technology and Climate Policy Outlook 2030*’⁵, analizohen projeksionet e treguesve energjetik për dy dekadat e ardhshme. Disa nga konkluzionet kryesore të këtij raporti, janë:

⁵ ec.europa.eu/research/energy/pdf/weto_final_report.pdf

- Kërkesa globale për energji projektohet të ketë një rritje prej 1.8% në vit, e ndikuar nga rritja ekonomike dhe e popullsisë. Kjo rritje pritet të vijë kryesisht nga vendet në zhvillim, ku në 2030 më shumë se gjysma e kërkesës globale do të vijë nga këto vende, krahasuar me 40% që është sot.
- Sistemi global i energjisë do të vijojë të dominohet nga burimet fosile, me rreth 90% të totalit në 2030. Nafta do të mbetet burimi kryesor (34%), e ndjekur nga qymyrguri (28%) dhe gazi (25%). Përdorimi i qymyrgurit do të vijojë kryesisht në vendet aziatike, ndërsa për BE pritet që gazi natyror të jetë burimi i dytë më i rëndësishëm, pas naftës.
- Përdorimi i burimeve fosile do të shoqërohen me rritjen globale të nivelit të emetimit të CO₂. Në BE, emetimi pritet të ketë një rritje prej 18%, ndërsa vendet në zhvillim do të jenë përgjegjës për mbi 50% të emetimit global.

Në mënyrë të përmbledhur, si për naftën ashtu edhe për gazin natyror, mund të argumentohet se rritja e kërkesës është në proporcion të zhdrejtë me ofertën. Duke qenë se burimet energjetike janë të kufizuara dhe po shkojnë drejtë shterimit, atëherë projeksioni për të ardhmen duket shumë pesimist. Në mungesë të një produkti të domosdoshëm, energjia në rastin konkret, aktorët do të rrisin rivalitetin midis tyre për të garantuar aksesin në burimet energjetike ekzistuese. Një problematikë e tillë mund të tejkalohet, ose të paktën të menaxhohet në një mënyrë më të përshtatshme, në varësi të:

- Nivelit të bashkëpunimit midis aktorëve – duke u ndërgjegjësuar për një shqetësim të përbashkët, aktorët mund të përfshihen në marrëdhënie midis tyre duke krijuar ‘energy complexes’.

- Prioritizimit të çështjeve energjetike – nëse energjia bëhet pjesë e sigurizimit, atëherë aktorët do të mund të kufizojnë pasojat negative që vijnë nga rritja e kërkesës për energji.
- Niveli i diversifikimit dhe energjia mix – mund të shihen si objektivat kryesore të strategjive afatgjata për garantimin e sigurisë energjetike.
- Përdorimi i burimeve alternative – përdorimi i burimeve energjetike të kësaj kategorie do të ndikonte në uljen e varësisë nga burimet energjetike tradicionale dhe reduktimin e nivelit të gazrave të dëmshme të emetuara në atmosferë.
- Zhvillimet teknologjike dhe efienca energjetike – e cila lidhet me një përdorim optimal të energjisë. Këtu mund të përfshihen politikat mbi termo-izolimin, reduktimi i humbjeve teknike dhe jo teknike, mos shpërdorimi i energjisë, etj.

4.1.2. Siguria energjetike në perceptimin dhe diskurin e aktorëve të sistemit global

Koncepti i sigurisë energjetike është bërë pjesë integrale e diskurit politik në të gjithë globin. Për SHBA-të, të cilat konsumojnë rreth 1/5 e energjisë në rang global, siguria energjetike qëndron në krye të axhendave politike. Ish Presidenti George W. Bush, do të deklaronte se *“Amerika duhet të ketë një politikë energjetike e cila planifikon për të ardhmen, por përmbush nevojat e sotme. Unë besoj se ne mund të zhvillojmë burimet tona natyrore dhe të mbrojmë mjedisin tonë”*⁶. Një deklaratë e tillë thekson perceptimin e SHBA-ve për rëndësinë e sigurisë energjetike, si një ndër kushtet kryesore për përmbushjen e kërkesave të momentit por edhe ato të së ardhmes. Si tregues për rëndësinë e sigurisë energjetike për SHBA-të, në shkurt 2001 Administrata Bush themeloi Grupin Kombëtar të

⁶ Fjalim i Presidentit Bush mbi Sigurinë Energjetike, Mars 2001. Aksesuar në: <http://www.wtrg.com/EnergyReport/National-Energy-Policy.pdf>

Zhvillimit të Politikave Energjetike [National Energy Policy Development Group – NEPDG], detyra kryesore e të cilit do të ishte rishikimi i kërkesave afat – gjata kombëtare për energji dhe të formulonin një strategji e cila të garantonte përmbushjen e nevojave themelore në dekadat e ardhshme (Klare, 2013).

Konkluzioni kryesor i këtij grupi ishte se “SHBA-të nuk po i zhvillonin në mënyrën e duhur burimet e brendshme të energjisë dhe po rritej varësia nga burimet e jashtme, duke e ekspozuar vendin ndaj kërcënimeve të reja. Por duke qenë të vetëdijshëm për pamundësinë e eliminimit të mbështetjes në burimet e huaja, siguria energjetike duhet të jetë prioritet në politikën e jashtme” (NEPDG, 2001). Këto konkluzione do të artikuloreshin edhe publikisht nga ana e Presidentit Bush, i cili do të deklaronte se: *“siguria energjetike duhet të jetë një prioritet në politikën e jashtme [të SHBA-së] dhe ndikon në elementët thelbësor të politikës së brendshme”* (Bush, 2001).

Në të njëjtën linjë, në një fjalim në Shtëpinë e Bardhë më 26 Janar 2009, Presidenti Obama do të shprehej se: *“Në një kohë sfidash të tilla për Amerikën, asnjë çështje nuk është aq themelore për të ardhmen tonë sa energjia. Varësia e Amerikës tek nafta është një nga kërcënimet më serioze me të cilat kombi ynë duhet të përballet. Ajo financon diktatorët, pague për përhapjen bërthamore dhe financon të dy anët e luftës tonë kundër terrorizmit. Ajo vë popullin amerikan në mëshirë të ndryshimit të çmimit të gazit, pengon inovacionin dhe kufizon aftësinë tonë për të konkurruar”*⁷. Sikurse theksohet dhe në këtë fjalim, çështjet e energjisë janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë si me sigurinë kombëtare ashtu edhe atë ndërkombëtare. Energjia qëndron në themel të zhvillimeve të politikave ndërkombëtare duke prekur një spektër të gjerë problematikash, nga ekonomia e deri tek fenomene të tilla si

7 Fjalim i Presidentit Obama, 26 Janar 2009. Aksesuar në:
<http://www.americanenergyindependence.com/security.aspx>

terrorizmi, përhapja e armëve bërthamore apo regjimet diktatoriale. Varësia e lartë nga importi dhe përdorimi i energjisë si instrument presioni në politikën e jashtme, janë dy element të cilët ndikojnë në zhvillimin dhe prosperitetin e një vendi.

Për shkak të rëndësisë së sigurisë energjetike në sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, ajo zë një pjesë të rëndësishme dhe në fokusin e NATO-s, e cila ka përgjegjësi për garantimin e sigurisë së vendeve anëtare e më gjerë. Në Nenin IV të Traktatit të Washingtonit, siguria energjetike përfshihet brenda kompetencave ekzistuese të Aleancës kur përcakton se palët “do të konsultohen së bashku sa herë që, perceptimi i përbashkët apo edhe njërit prej tyre lidhur me pavarësinë, sigurinë e integritetin e tyre territorial është i kërcënuar”⁸. Megjithatë Neni V nuk bën dallim të energjisë nga objektiva të tjera, dhe ka të ngjarë se natyra e kërcënimit të energjisë, pa marrë parasysh burimin, mund të jenë ata nga terroristë, piratët e madje edhe shtetet, në fund ato kanë gjasa të jenë në formë e sulmeve të armatosura të cilat mund të përcaktohen si një shkak për konsiderimin e Nenit V.

Zakonisht, përfshirja e NATO-s është konsideruar si një përgjigje ushtarake dhe duket të jetë nxitur nga pasiguria rreth qëllimeve aktuale të Aleancës, por kjo nuk është veçori në këtë rast. Është e rëndësishme që të ketë një vizion strategjik, pasi rasti në diskutim, siguria energjetike duhet të jetë pjesë e axhendës së përgjithshme. Në Samitin e Bukureshtit në Prill 2008, përfaqësuesit e shteteve anëtare përmendën një raport mbi ‘Rolin e NATO-s në Sigurinë Energjetike’, i cili identifikon parimet udhëheqëse dhe nënvizon mundësi dhe rekomandime për aktivitetet e së ardhmes⁹. Elementi thelbësor të cilin e thekson ky raport është varësia e lartë, kryesisht e vendeve Europiane, nga gazi Rus. Këto lidhje ndërmjet vendeve anëtare të NATO-s dhe Ruisë në sektorin e energjisë janë një pjesë

8 Traktati i NATO-s, 4 Prill 1949. Aksesuar në: http://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_17120.htm

9 Roli i NATO-s në sigurinë energjetike. Aksesuar në: http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49208.htm#

integrale e marrëdhënieve politike, ekonomike dhe të sigurisë të cilat po bëhen gjithnjë e më tepër komplekse dhe të vështira. Kjo inkurajon ndërgjegjësimin mbi nevojën për të diversifikuar burimet e energjisë së vendeve anëtare të aleancës, veçanërisht atyre të BE-së.

Aleanca e njeh rëndësinë dhe efektet e sigurisë energjetike në sigurinë e shoqërive të vendeve anëtare dhe implikimet në operacionet e saj ushtarake, prandaj *“synon të forcojë përpjekjet e saj strategjike mbi zhvillimet energjetike me implikime sigurie; të zhvillojë kompetencat e saj mbrojtjen e infrastrukturës kritike të energjisë”*¹⁰. Përfshirja e parë ‘serioze’ e sigurisë energjetike në axhendën e NATO-s identifikohet me Samitin e Bukureshtit në 2008, ku u vendosën parimet e përgjithshme të angazhimit të Aleancës në këtë drejtim. Një fokusim akoma më i qartë, lidhet me Konceptin e Ri Strategjike (Samiti i Lisbonës, 2008), në të cilën vendet anëtare vendosën të *“integrojnë sigurinë energjetike në politikat dhe aktivitetet e NATO-s”*¹¹. Në këtë mënyrë, siguria energjetike u bë pjesë integrale e axhendës së NATO-s, dhe konsiderohet si një ndër sfidat kryesore të sigurisë në shekullin XXI.

Përveçse në kuadrin e NATO-s, çështjet energjetike midis SHBA-së dhe BE-së zënë një vend të rëndësishëm dhe në kuadrin e ‘Transatlantic Trade and Investment Partnership’ (TTIP). “Për BE-në, forcimi i Unionit Energjetik dhe marrja e një angazhimi të prekshëm nga SHBA-të për garantimin e sigurisë energjetike Europiane, është kritike. Ndërsa SHBA e sheh energjinë më shumë si çështje diplomatike dhe teknike sesa një çështje tregtie” (Hengel, 2015: Paragrafi I). BE, duke dashur të theksojë rëndësinë strategjike të energjisë, ka kërkuar një kapitull të veçantë brenda TTIP në të cilën të parashikohen rregulla dhe parime mbi transparencën mbi çështjet energjetike, në disiplinimin e kompanive shtetërore

10 Roli i NATO-s në sigurinë energjetike. Aksesuar në: http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49208.htm#

11 Po aty

dhe përfshirjen e aktorëve të tretë në tubacionet energjetike. Arsyeja kryesore e kërkesës së BE-së lidhet me unifikimin e tregut të brendshëm dhe uljen e varësisë nga Rusia (Hengel, 2015). Duke marrë në konsideratë ‘revolucionin energjetik’ dhe zhvillimin e teknologjisë për këtë sektor, SHBA-të mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në diversifikimin e burimeve energjetike për BE-në, duke ulur varësinë nga Rusia e për pasojë ndihmon në garantimin e sigurisë energjetike për Europën. Siguria energjetike është një çështje jetike për vendet Europiane.

Ish Presidenti i Komisionit Evropian, Barroso do të shprehej se *“Nëse më pyesin sot se cila është çështja më e rëndësishme për sigurinë globale dhe zhvillimin, çështja me potencialin më të lartë për t’u trajtuar por dhe shumë problematike nëse ne nuk veprojmë në mënyrën e duhur, është energjia dhe ndryshimet klimaterike. Energjia sot nuk konsiderohet si një sfidë e madhe vetëm nga perspektiva ekonomike... për shkak të rritjes së konkurrencës mbi burimet e kufizuara, ajo përbën një sfidë serioze për sigurinë globale... ajo është sfida serioze e gjeneratës tonë”*¹² (Barroso, 2007). Vendet anëtare, sikurse dhe institucionet e BE, kanë përfshirë në diskurin e tyre sfidat ndaj sigurisë energjetike, duke i identifikuar ato si kërcënime ekzistenciale për zhvillimin dhe prosperitetin e BE-së. Në terma të procesit të sigurizimit, vendet anëtare dhe institucionet e BE janë aktorët sigurizues në këtë proces. Autoriteti dhe legjitimiteti që kanë, u mundëson atyre të klasifikohen si aktorë sigurizues. Objekti referues është popullata, por dhe vetë stabiliteti i BE-së dhe shteteve anëtare. Një ndër kërcënimet kryesore, e cila identifikohet si kërcënim ekzistencial, është varësia e lartë nga importi i energjisë nga Rusia. Një varësi e tillë, perceptohet si varësi negative dhe për të

12 Fjalimi i Presidentit të Komisionit Evropian Barroso në Kongresin Global të Energjisë, 12 Nëntor 2007. Aksesuar në: http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-07-703_en.htm?locale=en

tejkualuar këtë problematikë, vendet e BE kanë vendosur theksin në rëndësinë e diversifikimit të burimeve energjetike.

Përfshirja e sigurisë energjetike në diskurin politik, zë një vend të rëndësishëm edhe në deklaratat, fjalimet dhe intervistat e Presidentit rus Vladimir Putin. Në fjalën e tij të hapjes së ‘Takimi i Këshillit të Sigurisë mbi Çështjen e Rolit të Rusisë në Garantimin e Sigurisë Energjetike Ndërkombëtare’¹³ (2005), ndër të tjera ai do të deklaronte se: *“Sot duhet të diskutojmë një çështje shumë të rëndësishme... si në politikën e brendshme ashtu edhe atë të jashtme. Si një ndër liderët në tregun energjetik botëror, Rusia kupton plotësisht problemet globale në këtë sektor dhe kujdeset shumë për zhvillimin e resurseve të saj. Sot është energjia ajo që garanton zhvillimin e ekonomisë botërore... dhe ekspozohet nga rreziqe të shumta jo vetëm të natyrës ekonomike dhe mjedisore... Disponueshmëria e burimeve energjetike është një nga kushtet për stabilitetin ndërkombëtar... dhe faktor në sigurinë globale... Në lidhje me këtë Rusia mbështet përpjekjet e përbashkëta të komunitetit ndërkombëtar për zgjidhjen e problemeve... nevoja për diversifikimin dhe sigurinë e furnizimit me energji, ku terrorizmi mund të jetë një ndër kërcënimet... Rusia ofron një kontribut të rëndësishëm në garantimin e sigurisë energjetike në nivel rajonal dhe global... Vendi ynë ka disa avantazhe të cilat duhet t’i përdorim në interes të komunitetit ndërkombëtar por duke u fokusuar tek interesi ynë kombëtar... Ne duhet të zhvillojmë infrastrukturën transportuese dhe të diversifikojmë rrugët e shpërndarjes së burimeve energjetike... duke u orientuar drejtë tregut të rajonit Azi-Paqësor”* (Putin, 2005).

13 Fjala hapëse e Presidentit Putin në ‘Takimi i Këshillit të Sigurisë mbi Çështjen e Rolit të Rusisë në Garantimin e Sigurisë Energjetike Ndërkombëtare’. Aksesuar në: <http://www.rusembassy.ca/ru/node/318>

Kur analizojmë këtë deklaratë duhet që fillimisht të kemi parasysh kontekstin. Deklarata është bërë në vitin 2005, periudhë në të cilën Rusia akoma nuk kishte arritur pozitën dhe rëndësinë që ajo ka sot në sistemin ndërkombëtar, dhe konfliktet me disa shtete pranë saj (Ukraina) nuk kishin ndodhur akoma. Deklarata thekson disa nga dimensionet kryesore të sigurisë energjetike:

- Dimensioi politik i energjisë – sikurse evidentohet dhe nga vetë Putin, energjia ndikon si politikën e brendshme, ashtu dhe atë të jashtme.
- Dimensioi ekonomik – duke qenë se energjia konsiderohet si promotori kryesor i zhvillimit.
- Dimensioi i sigurisë – energjia mund të jetë si kërcënim ashtu edhe objekt i cili duhet sigurizuar,
- Dimensioi i implikimeve shumë nivelore – duke u evidentuar ndikimi kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar i sigurisë energjetike.

Në këtë fjalim, gjenden të konkretizuara disa nga premisat teorike të Shkollës së Kopenhagenit, si: analiza sektoriale e sigurisë, qasja shumë nivelore, element të sigurizimit dhe multi dimensionaliteti i sigurisë energjetike. Diversifikimi është një fjalë kyç në këtë deklaratë, element i cili është thelbësor në garantimin e sigurisë energjetike. Sigurizimi i energjisë mund të fokusohet si në aksesin në tregjet e reja ashtu dhe në mbrojtjen nga kërcënime, ku terrorizmi perceptohet si një sfidë ndaj sigurisë energjetike, për pasojë dhe asaj ndër/kombëtare. Nga kjo deklaratë del në pah dhe kuptimi që aktori i jep sigurisë energjetike, në raport me burimet energjetike (konsumator, prodhues apo transit). Rusia, duke qenë ndër aktorët kryesor të prodhimit të naftës dhe gazit në nivel global, sigurinë energjetike e lidh me diversifikimin e tregjeve për eksportimin e produkteve energjetike.

Kjo është arsyeja përse Putin evidenton rëndësinë e aksesit në tregjet e rajonit të Azi-Paqësorit.

Vlen për t'u theksuar fakti se në mungesë të koordinimit ndërkombëtar, masat e një aktori për të garantuar sigurinë e tij energjetike mund të përbëjnë kërcënim për sigurinë energjetike të aktorëve të tjerë. Në kontekstin e marrëdhënieve energjetike midis BE-së dhe Rusisë, fokusimi i Rusisë drejt tregjeve të reja mund të perceptohet si kërcënim për vendet e BE, të cilët janë në një marrëdhënie të 'varësisë negative' nga energjia Ruse. Si kundërpërgjigje, BE ka vendosur si prioritet të saj diversifikimin e burimeve energjetike. Kjo çështje do të trajtohet në mënyrë më të hollësishme në seksionet vijuese të punimit.

4.2. Një vështrim i përgjithshëm mbi situatën e sigurisë energjetike të BE-së

Siguria energjetike është një ndër prioritetet themelore të BE-së, duke u renditur në majat e axhendave politike Europiane kryesisht që në periudhën e pas krizës së parë Rusi-Ukrainë të vitit 2006. Ndikimi i BE-së në politikat energjetike individuale të shteteve anëtare, tradicionalisht ka qenë i kufizuar, pasi shtetet kanë hezituat të çedojnë sovranitetin e tyre në këtë sektor. Një ndër arsyet kryesore lidhet me rëndësinë e sigurisë energjetike në sigurinë kombëtare të aktorëve. Por, të gjendur përballë presionit publik dhe kërcënimeve që vinin nga nivelet e larta të varësisë, në vitin 2007 vendet e BE-së ranë dakord për krijimin e një 'Politike të Energjisë për Europën' (Belkin, 2010). Kriza Rusi-Ukrainë, rriti ndërgjegjësimin e BE-së lidhur me kërcënimin potencial dhe real që sillte një varësi e lartë nga importi i energjisë nga Rusia, sikurse dhe nga burime të tjera të 'paqëndrueshme'.

Pavarësisht se niveli i varësisë nga burimet ruse të energjisë variojnë nga një vend tek tjetri, duke u nisur nga Perëndimi drejt Lindjes varësia sa vjen dhe rritet, për Europën në tërësi një situatë e tillë është problematike. "Varësia në rritje e Europës prej energjisë

ruse dhe marrëveshjet afatgjata energjetike ndërmjet firmave ruse dhe disa qeverive europiane kanë krijuar spekulime sipas të cilave, Moska po përdor ‘armën e saj energjetike’ në përpjekje për të ndikuar politikën e jashtme dhe atë ekonomike europiane” (Belkin, 2010: 7). Këtu mund të kujtojmë marrëveshjen e vitit 2005 midis Gjermanisë dhe Rusisë për ndërtimin e gazsjellësit të Europës së Veriut [NEGP].

Figura 5: Gazsjellësi i Europës së Veriut



Burimi: Sweet, 2011

Ndërtimi i këtij gazsjellësi u bë objekt debatesh brenda vendeve Europiane. Nga njëra anë Gjermania argumentonte se projekti do të shërbente për diversifikimin e rrugëve të transportit të energjisë, e cila do të ndikonte si në sigurinë energjetike të Gjermanisë ashtu edhe BE-së. Nga ana tjetër, vende të tilla si Polonia, Lituani dhe Suedia deklarorin se ky vendim i Gjermanisë, i cili nuk ishte diskutuar paraprakisht dhe as nuk kishte konsensusin e vendeve përreth, ishte një kërcënim për sigurinë e tyre energjetike dhe justifikonte prezencën Ruse në një rajon me një rëndësi të veçantë strategjike (Belkin, 2010). Një ndikim i tillë u shfaq dhe në periudhën e krizës Rusi-Ukrainë të 2014, ku disa vende të BE-së, hezituan në shtimin dhe ashpërsimin e sanksioneve ndaj individëve dhe kompanive Ruse. Duke u fokusuar më shumë tek siguria kombëtare, sesa ajo në nivel të BE-së, këto vende


shërbyen për amortizimin e ‘goditjeve’ të diplomacisë imponuese të disa vendeve perëndimore ndaj Rusisë.

Nëse paraqesim një tablo të përgjithshme të arsyeve kryesore të cilat e bënë pjesë të politikave të larta energjinë në Europë, duke e bërë në këtë mënyrë pjesë të procesit të sigurizimit, mund të themi se ato ishin:

- Rritja e shpejtë e konsumit të gazit natyror;
- Rritja e importeve, si pasojë e rritjes së kërkesës dhe uljes së prodhimit vendas;
- Mbështetja tek një numër i vogël furnizuesish;
- Dominanca e kontratave bilaterale afat – gjata midis aktorëve shtetëror;
- Varësia asimetrike e vendeve të Europës Lindore dhe Qendrore nga Rusia;
- Dhe më e rëndësishmja, ndërhyrjet e Rusisë së Putin në arkitekturën Euro – Atlantike në ish hapësirën Sovjetike (duke përfshirë Ukrainën, vendin kyç të transitit të gazit natyror), me qëllim rifitimin e influencës në Europën Qendrore dhe Lindore, nëpërmjet përdorimit të eksportit të energjisë si një instrument për të përmbushur këto qëllime (Stern, 2005).

Pavarësisht intensifikimit të bashkëpunimit energjetik në nivel European, “vendet anëtare vazhdojnë të ndjekin politika të ndryshme të jashtme energjetike, veçanërisht kundrejt Rusisë, dhe disa vende evropiane mbeten ende ngurruese për të dorëzuar kontrollin kombëtar mbi tregjet e energjisë” (Belkin, 2010: 7). Sjellja e shteteve anëtare të BE-së në politikën e tyre të jashtme energjetike, është drejtpërdrejtë e varur nga faktorët e brendshëm. Por cila është situata energjetike në vendet e BE-së?

Grafiku 8: Kërkesa totale për energji në vendet e BE-së (në ktoe)




Burimi: KE, 2014

Sikurse shihet nga të dhënat e grafikut të mësipërm, kërkesa totale për energji në vendet e BE në periudhën nga 1996 deri në 2012 shfaq disa luhatje, por mbetet në vlera të larta krahasuar me mesataren globale. Në një vështrim të kujdesshëm të grafikut, vihet re se në vitin 2009 shënohet vlera më e ulët e kërkesës për dhjetë vitet e fundit. Kjo shpjegohet me krizën ekonomike të asaj periudhe dhe dëshmon për lidhjen midis zhvillimit ekonomik dhe kërkesës për energji. Në këtë mënyrë, rishfaqet dimensionimi ekonomik i sigurisë dhe energjia si fenomen ndër sektorial, në termat e Shkollës së Kopenhagenit.

Një tjetër e dhënë e rëndësishme që shfaqet në grafik është dhe përbërja e ‘energy mix’ e BE, e mbizotëruar nga nafta dhe gazi natyror. Një trend i ngjashëm me kërkesën totale për energji, shfaqet dhe në të dhënat mbi importin e energjisë.

Grafiku 9: Treguesit e importit neto në raport me kërkesën totale për energji (në %)



Burimi: KE, 2014.


Dy ndër arsyt kryesore të këtij trendi janë: ulja e sasisë së prodhimit të brendshëm të energjisë dhe rritja e importit për të kompensuar këtë diferencë (KE, 2014). Ndër llojet e produkteve energjetike më të përdorura janë nafta dhe gazi natyror. Vendet e BE-së importojnë rreth 90% të naftës së përdorur, duke e karakterizuar BE si një aktor konsumator i energjisë. Në këtë mënyrë, vendet e BE fokusohen në sigurizimin e furnizimit me energji [naftë]. Në funksion të sigurizimit, diversifikimi i burimeve sikurse dhe i rrugëve të transportit kthehen në prioritet të BE-së, duke synuar minimizimin e varësisë e cila perceptohet si kërcënim ekzistencial për zhvillimin e BE-së në tërësi por edhe vendeve anëtare në veçanti. Nëse i referohemi mënyrës së transportit të naftës, e cila zhvillohet nëpërmjet rrugëve detare, mund të themi se në rastin e këtij produkti diversifikimi është relativisht më i thjeshtë, krahasuar me gazin natyror.

“Duke marrë në konsideratë historikun e furnizimit me naftë dhe luhatjen e çmimeve, masa të rëndësishme janë ndërmarrë për të diversifikuar furnizimin dhe për t’u përgatitur për kriza afat – shkurtra. Shteteve anëtare të BE-së u kërkohet të ruajnë rezerva emergjence të naftës ekuivalente me importet neto të 90 ditëve” (KE, 2014: 6). Në terma të

procesit të sigurizimit, këto mund të konsiderohen si masa të jashtëzakonshme, të cilat janë artikuluar (nëpërmjet aktit ligjërimit) si masa të domosdoshme nga ana e KE (aktori sigurizues), si një lloj mbrojtje nga kërcënimi që mund të vijë nga ndërprerja e furnizimit për vendet anëtare (objekti referues). Kjo tregon se BE, nëpërmjet këtij rasti dëshmon jo vetëm prioritizimin e çështjeve energjetike, por edhe sigurizimin e tyre. Lidhur me situatën për gazin natyror, situata paraqitet akoma dhe më problematike. “Rritja e varësisë së BE-së nga importi i gazit përbën një sfidë dhe shton rreziqet e sigurisë së furnizimit” (KE, 2014: 8). Është e rëndësishme të theksohet se disa vende të BE-së, kanë një varësi prej 100% nga importi i gazit duke u përballur në këtë mënyrë me varësinë që vjen nga mbështetja tek një aktor i vetëm furnizues.

Gazi natyror, sikurse tregohet dhe nga treguesit energjetik të BE-së ka një rëndësi jetike për vendet e BE-së, të cilat e kanë bazuar zhvillimin e tyre ekonomik dhe mirëqenien sociale të popullatës tek sektorë të cilët vihen në lëvizje pikërisht nga ky burim energjie. Në mënyrë skematike, varësia e vendeve të BE-së nga importi i gazit rus, do të paraqitej në këtë mënyrë:

Figura 6: Varësia e vendeve Europiane nga gazi rus




Burimi: Komisioni European <http://ec.europa.eu/energy/>

Të gjendur përballë kësaj situatë, institucionet e BE-së dhe vendet anëtare nisën të rishikonin politikat e tyre energjetike me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë energjetike, gjë e cila demonstron nga Green Paper i Komisionit Europian i 2006, në të cilin theksohej nevoja e “të folurit me një zë të vetëm në nivelin ndërkombëtar” (KE, 2006: 14). Një qasje e tillë nënkuptonte nevojën për unifikimin e politikave energjetike, ku integrimi i tregut energjetik dhe diversifikimi i burimeve konsideroheshin si instrumentet e domosdoshëm në këtë drejtim. Sikurse theksohet dhe në Komunikatën e Komisionit Europian të 2014, “Krizë në Ukrainë me të gjitha rreziqet e saj për sigurinë e furnizimit demonstroi dhe një herë se çfarë mund të përfitojë BE nga tregjet energjetike të mirë integruara dhe të mirë lidhura me furnizues të diversifikuar dhe solidaritet në rast krizash” (KE, 2014: 3).

Situata energjetike në Europë karakterizohet nga një varësi e lartë nga importi. Vetëm në vitin 2013, BE importoi rreth 65% të gazit natyror të konsumuar për të plotësuar kërkesën e saj, e përlogaritur në rreth 432 bcm (BP, 2014). Sipas parashikimeve, në vitin 2035 pritet që varësia e BE-së nga importi i gazit natyror të shkojë në 80% (KE, 2014). Rritja e varësisë pritet të ketë si implikime ekonomike ashtu edhe gjeopolitike.

Grafiku 10: Burimet e importit të gazit natyror (2012)



Burimi: KE, 2014

Varësia e BE-së karakterizohet nga aksesit tek një numër i kufizuar i burimeve. Në 2012, BE ka importuar rreth 32% të gazit natyror nga Rusia, 31% nga Norvegjia dhe 14% nga Algjeria (KE, 2014). Sipas të dhënave të Komisionit, gjashtë vende anëtare të BE-së janë 100% të varura nga burimet ruse të gazit natyror, dhe gjashtë vende të tjera kanë një varësi mbi 50% (KE, 2014). Këto të dhëna dëshmojnë për rolin dhe rëndësinë e Rusisë në sektorin energjetik dhe ekonomik të Europës, rol i cili lidhet dhe me aspekte gjeopolitike.

Rusia është ndër prodhuesit kryesor të energjisë, duke bërë që të jetë një ndër aktorët kryesor të tregut energjetik në përgjithësi dhe atij të gazit në veçanti. Rusia ka rezervat më të mëdha të gazit, zë vendin e dytë në prodhim pas SHBA-së dhe është eksportuesi kryesor, me një volum prej 170-200 bcm (BP, 2013). Rusia shpeshherë e ka përdorur energjinë si instrument të politikës së saj të jashtme. Krizat e gazit midis Rusisë dhe Ukrainës në 2006 dhe 2009, pavarësisht justifikimit ekonomik, ishin në thelbin e tyre një çështje politike. Nëpërmjet këtyre veprimeve, Rusia po përdorte energjinë si instrument imponimi në politikën e saj të jashtme. Kjo nuk është një gjë e re për Rusinë, e cila nëpërmjet energjisë ka arritur shpeshherë të kombinojë element të ‘soft power’ dhe ‘hard power’.

Për të ruajtur influencën e saj në shtetet që dikur kanë qenë pjesë e BS, Rusia ka aplikuar element të ‘soft power’ nëpërmjet asistencave financiare dhe teknike, sikurse dhe nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale apo multilaterale për furnizimin e tyre me energji me çmime më të ulëta. Një qasje të tillë Rusia e ka ndjekur dhe në marrëdhëniet e saj me Bjellorusinë. Nga ana tjetër, marrëdhëniet midis Ukrainës dhe Rusisë në një pjesë të mirë të tyre kanë qenë të karakterizuara nga element të ‘hard power’. Situata aktuale në Ukrainë është një shembull demonstrativ për një gjë të tillë.

4.3. Kriza Rusi – Ukrainë si dëshmi e domosdoshmërisë së diversifikimit të burimeve energjetike të BE-së¹⁴

Kriza Rusi – Ukrainë (2014) ri solli në vëmendjen e aktorëve të sferës politike, ekonomike sikurse dhe asaj akademike rëndësinë e sigurisë energjetike, duke e renditur në krye të axhendave të tyre. Si kundërpërgjigje ndaj agresionit Rus, SHBA dhe BE vendosën një sërë sanksionesh ekonomike ndaj Rusisë, sanksione të cilat prekën në një masë të madhe sektorin e energjisë. Ky sektor ka një rëndësi të veçantë për Rusinë, e cila eksporton pjesën më të madhe të naftës dhe gazit të saj drejtë vendeve Europiane, pasi të ardhurat nga eksporti i energjisë zënë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave në buxhetin e Rusisë. Ukraina luan një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim pasi rreth gjysma e gazit rus që transportohet në drejtim të tregut European kalon nëpërmjet territorit të saj. Kjo është dhe një ndër arsyet kryesore përse konflikti Rusi – Ukrainë ka një rëndësi të veçantë për BE-në. Implikime e këtij konflikti nuk shtrihen vetëm në nivelin makro, në nivelin sistematik dhe shtetëror, por shkojnë deri në nivelin mikro pasi ka efekt të drejtpërdrejtë tek jetesa e qytetarëve European, të cilët mund të preken nga mungesa e burimeve energjetike, sikurse dhe nga rritja e çmimit të tyre.

14 Ky seksion është botuar më parë në: Morina, F. & Fuga, P. (2015). The importance of transit countries in ensuring EU energy security: the case of Ukraine. *International Journal of Academic Research and Reflection*, 3 (4), 72-75. <http://www.idpublications.org/ijarr-vol-3-no-4-2015/>

Figura 7: Harta e gazsjellësve rus që kalojnë nëpërmjet Ukrainës



Burimi: EIA, 2015

Figura 8: Harta e gazsjellësve Rus drejtë Europës



Burimi: BBC, 2014.

Çështja e gazit nuk është e re në marrëdhëniet midis Ukrainës dhe Rosisë por e ka zanafillën e saj që në momentin e shpërbërjes së ish-BS. Për shkak të afërsisë gjeografike, një qasje pro perëndimore e Ukrainës dhe mundësia e anëtarësimit të saj në NATO dhe integrimi në BE, perceptohen si kërcënime për interesat e Rosisë dhe pengesa për hegjemoninë e saj rajonale. “Një Ukrainë jashtë sferës ruse të influencës e transformon Rusinë në një fuqi defensive, me pak shpresë për t’i rezistuar presionit nga jashtë. Por një

Ukrainë e ‘Rusifikuar’ i bën të mundur Rusisë të projektojë forcën e saj jashtë, të jetë një fuqi rajonale dhe globale” (Zeihan, 2009: 1). Nga njëra anë Rusia është e interesuar në përfitimet ekonomike që i vijnë nga transporti i gazit të saj nëpërmjet Ukrainës drejt Europës, ndërsa nga ana tjetër Ukraina është e interesuar për gazin rus si një ndër të ardhurat kryesore të ekonomisë së saj. Në tetor 2014, Rusia dhe Ukraina nënshkruan një marrëveshje të re gazi 6 mujore, negociatat për të cilën u ndërmjetësuan nga BE.

Periodha e nënshkrimit të kësaj marrëveshje kishte një rëndësi të veçantë pasi përkonte me afrimin e dimrit, periudhë në të cilën kërkesa për gaz arrin nivelet maksimale. Në këtë mënyrë u arrit të shmangej një krizë potenciale e furnizimit me gaz si për Ukrainën ashtu dhe për vendet Europiane. Pavarësisht kësaj zgjidhje afat shkurtër, historia dhe konteksti dëshmojnë për domosdoshmërinë e gjetjes së zgjidhjeve afat gjata si për Ukrainën ashtu dhe për BE pasi varësia ndaj gazit rus mbetet në nivele shumë të larta dhe një trend i tillë ka gjasa të vazhdojë dhe për dekada të tjera. Duke pasur parasysh rëndësinë e Ukrainës, BE duhet të fokusohet në reformimin e sektorit jo eficient dhe të korruptuar energjetik në Ukrainë sikurse dhe në kryerjen e vlerësimeve mbi kapacitetet potenciale të përdorimit të burimeve alternative të energjisë, me qëllim reduktimin e vulnerabilitetit ndaj ndërprerjeve të gazit nga ana e Rusisë (Verrastro & Ebinger, 2014).

Sektori i energjisë në Ukrainë është karakterizuar nga një sërë problematikash të cilat kanë implikime si në zhvillimet e brendshme ashtu dhe të jashtme. Monopolet e krijuara në sektorin energjetik në këtë vend kanë inkurajuar korrupsionin e elitave politik, të cilat kanë përdorur përfitimet që u kanë ardhur nga transiti i gazit rus për të mbajtur në këmbë sistemin e korruptuar për përfitime personale. Duke qenë se energjia ka ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë dhe politikën e Ukrainës por dhe në sigurinë energjetike të Europës, ky sistem ka nevojë për një reformë sistematike ku të përfshihen reforma e çmimeve,


krijimi i një organi rregullator të pavarur, ristrukturimin e monopolit shtetëror të naftës dhe gazit, përmirësimin e kushteve për investime në prodhimin e brendshëm të energjisë, stabilizimin e furnizimit me gaz dhe transitin me Rusinë në bazë të standardeve të biznesit ndërkombëtar (Chow, 2014).

Ndjekja e një strategjie gjithëpërfshirëse, e cila duhet të integrojë elementët e mësipërm sikurse dhe asistencën e drejtpërdrejtë të BE-së, do të ndikonte pozitivisht jo vetëm në zhvillimin e sektorit energjetik të Ukrainës por edhe në garantimin e furnizimit me gaz të BE-së. Pasojat e problematikave të brendshme të Ukrainës, si niveli i lartë i korrupsionit dhe influenca ruse, duhet të shërbejnë si mësim për BE-në e cila duhet të kujdeset që një situatë e tillë të mos përsëritet dhe në vendet ballkanike, nëpër territoret e të cilave janë planifikuar të kalojnë një sërë gazsjellësish të cilët do të ndikojnë në nivelin e sigurisë energjetike të BE-së. Një gjë të tillë BE mund ta realizojë nëpërmjet dhënies së garancive konkrete për perspektivën e integritit në BE të këtyre vendeve, ndihmave financiare dhe asistencës teknike. Nga ana tjetër, kriza Rusi – Ukrainë dëshmon qartë domosdoshmërinë e diversifikimit të burimeve energjetike të BE-së, ku rajoni i Kaspikut mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim.

4.3.1. Rajoni i Kaspikut si alternativë e diversifikimit të burimeve energjetike të BE-së

Rajoni i Kaspikut, për shkak të rezervave të konsiderueshme në burime energjetike të naftës dhe gazit natyror, mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm në garantimin e sigurisë energjetike për Europën e më gjerë, duke u shoqëruar me një sërë implikimesh.

Figura 9: Rezervat e gazit natyror, 2012 (tcm).



Burimi: BP Statistical Review of World Energy, 2012.

Sikurse shihet dhe nga të dhënat e BP, rajoni i Kaspikut së bashku me Lindjen e Mesme kanë një total të përllogaritur të rezervave të gazit natyror prej 101.3 tcm. Kjo sasi është më shumë se 3-fishi i rezervave të gazit natyror rus. Kthimi i rajonit të Kaspikut në një burim alternativ të furnizimit me burime energjetike për Europën, veçanërisht me gaz natyror, do të ndikonte në uljen e varësisë nga Rusia. Nga ana tjetër, një ndërveprim i tillë midis BE-së dhe vendeve të Kaspikut do të ndikonte në sigurinë e këtyre vendeve, për të cilët “problemi kryesor i sigurisë është forcimi dhe garantimi i pavarësisë politike dhe ekonomike” (Belet, 2014, 89).

Tabela 1: Gazi Natyror: Rezervat dhe prodhimi në rajonin e Kaspikut

<i>Shtetet</i>	<i>Rezervat (tcm)</i>	<i>Në raport me rezervat globale (%)</i>	<i>Prodhimi (bcm)</i>	<i>Në raport me prodhimin global (%)</i>
Azerbajxhan	0.9	0.5	16.2	0.5
Kazakistan	1.5	0.8	18.5	0.5
Turkmenistan	17.5	9.4	62.3	1.8
Uzbekistan	1.1	0.6	55.2	1.6
Rajoni Kaspikut	21	10.8	152.2	4.4

Burimi: BP Statistical Review of World Energy, 2014.

Totali i rezervave të gazit në katër vendet e Kaspikut; Azerbajxhan, Kazakistan, Turkmenistan dhe Uzbekistan, përbën rreth 11% të rezervave globale të gazit të provuara. Por sikurse shihet dhe nga të dhënat e mësipërme, aktualisht sasia e prodhimit mbetet akoma në nivele të ulëta. Infrastruktura e vjetruar është një ndër faktorët kryesorë në këtë drejtim, prandaj një asistencë e mundshme nga ana e BE-së mund të sillte përfitime reciproke për të dyja palët. Në terma afatgjatë, këto të dhëna mbi sasinë e konsiderueshme të rezervave të gazit natyror në rajonin e Kaspikut marrin një rëndësi akoma më të madhe për shkak se në dekadat e ardhshme është parashikuar se kërkesa për gaz do të rritet ndjeshëm, duke e konsideruar shekullin XXI si periudhën e artë të gazit (IEA, 2011). Ky do të jetë një trend i cili do të prekë pjesën më të madhe të globit, kryesuar nga Kina, India dhe BE.

Vendet me rezerva të konsiderueshme në burime energjetike po zhvillojnë një sërë projektesh për të mundësuar një transport të sigurtë të naftës dhe gazit natyror drejtë vendeve konsumatorë, duke bërë që siguria energjetike të jetë variabël kryesor në politikat energjetike të shek. XXI (Belet, 2014, 91). Për transportin e gazit natyror nga rajoni i Kaspikut drejtë tregjeve Europiane, janë projektuar një sërë gazsjellësish të cilët do të kalojnë nëpërmjet territoreve të disa shteteve Ballkanike. Një ndër gazsjellësit kryesor, i cili do të transportojë gazin nga Azerbajxhani drejtë tregut Europian, është Trans Adriatik Pipeline (TAP).

4.4. Siguria energjetike në diskurin dhe dokumentet kryesor strategjik të BE-së

“Implikimet e sigurisë të situatës së furnizimit me gaz natyror të Europës, janë një temë kryesore në diskurin ndërkombëtar mbi sigurinë energjetike në periudhën e pas Luftës së Ftohtë” (Noël, 2013: 169). Kjo tregon se çështjet e sigurisë energjetike përbëjnë një sfidë për të gjithë aktorët e sistemit ndërkombëtar, duke zënë vend qendror në axhendat e tyre

politike. “Varësia Europës nga gazi natyror i Rusisë, është i ngjashëm me varësinë e Shteteve të Bashkuara nga nafta në Lindjen e Mesme, duke u kthyer në pikëtakimin kryesor midis situatës energjetike dhe sfidave të politikës së jashtme, duke e kthyer energjinë në një pjesë integrale të qasjeve në politikën e jashtme dhe të sigurisë – e njohur ndryshe dhe si sigurizim i energjisë” (Noël, 2013: 169). Në kontekstin e politikave europiane të energjisë, një ndër momentet më kryesore që mund të shërbejë si rast studimor, ku shfaqet më së miri procesi i sigurizimit të energjisë është dhe pasqyrimi i konfliktit Rusi – Ukrainë, si në diskurin e aktorëve ashtu dhe në dokumentet e tyre kryesore.

Në 10 Prill 2014, Presidenti Rus u dërgoi një letër të hapur liderëve kryesor evropian, të cilët furnizimin me gazin rus e garantojnë nëpërmjet gazsjellësve që kalonin nga territori ukrainas¹⁵. Duke e nisur letrën e tij me analizën e situatës ekonomike në të cilën po kalonte Ukraina, ai shprehet se *“dikush mund të krijojë përshtypjen se partnerët European kërkojnë të fajësojnë në mënyrë të njëanshme Rusinë për pasojat e krizës ekonomike të Ukrainës”* (Putin, 2014: Paragrafi III). Kjo është një fjali e shprehur me një gjuhë të kujdesshme diplomatike, por me një mesazh të fortë kërcënues. Duke përdorur energjinë si instrument imponimi, Rusia i dërgon një sinjal të fortë, kryesisht vendeve të cilat furnizohen me gazin rus nëpërmjet tubacioneve që kalojnë nga territori i Ukrainës.

Duke ri sjellë në vëmendje kontratën e nënshkruar me Ukrainën, Presidenti Putin nga njëra anë thekson sigurinë energjetike në terma ekonomik, por nga ana tjetër deklaron se *“Në kushte të tilla... Gazprom është i detyruar që në rast vazhdimi të shkeljeve të kushteve, të kufizojë ose ndërpresë plotësisht shpërndarjen e gazit. Pa dyshim që kjo është një masë ekstreme... që ndikon konsumatorët evropian... në periudhën e vjeshtës dhe dimrit* (Putin,

15 Letër e hapur e Presidentit Rus, Vladimir Putin drejtuar liderëve evropian, 10 Prill 2014. Aksesuar në: <http://en.kremlin.ru/events/president/neës/20751>

2014: Paragrafi XI-XIV). Sinjalet e dërguara në formën e kërcënimeve janë një tregues i qartë i përdorimit të energjisë si instrument i politikës së jashtme, çka mund të përkthehet në një lloj sigurizimi të energjisë. Për më tepër ai i dërgoi një tjetër sinjal vendeve të BE-së pas vendimit të tyre për të caktuar një të dërguar special në Ukrainë, duke deklaruar se *“Sa më shumë ndërmjetës të jenë, aq më shumë probleme janë... Nuk jam i sigurtë nëse Ukraina ka nevojë për ndërmjetës... Unë mund të imagjinoj reagimet që do të shkakttoheshin nëse në mesin e krizës në Greqi apo Qipro, ministri ynë i jashtëm të fillonte t’u tregonte njerëzve se çfarë duhet të bëjnë. Kjo nuk do të ishte diçka e mirë”*¹⁶.

Në një kohë që vendet europiane karakterizohen nga një varësi e lartë nga energjia ruse edhe Rusia karakterizohet nga varësia ndaj BE-së, në terma të eksportit të energjisë. Nëse rikujtojmë idenë se siguria energjetike merr kuptim në bazë të kontekstit ku aplikohet, dhe është pozita e aktorëve ndaj burimeve energjetike (prodhues, konsumator ose transit) që përcakton qasjen ndaj saj, mund të themi se Rusia kërcënohet nga përpjekjet e BE-së për të diversifikuar importin e energjisë. Në këtë mënyrë, përpjekjet e aktorëve të ndryshëm për të garantuar sigurinë e tyre energjetike, mund të jenë konfliktuale me përpjekjet e aktorëve të tjerë të cilit kanë të njëjtin qëllim. Në këtë mënyrë “varësia është një koncept me dy kahe: BE importon një të tretën e gazit nga Rusia, ndërsa Rusia eksporton 61.7 % të gazit të saj drejtë BE-së. Ndryshimi i kësaj situate është i vështirë në terma afat shkurtër, pavarësisht se Rusia ka treguar se është e gatshme për ta bërë diçka të tillë; në Maj 2014, Moska firmosi kontratën më të rëndësishme në histori në sektorin e gazit që nga koha e ish – BRSS, me Pekinin” (De Micco, 2014: 5).

16 ‘Vladimir Putin tells Brussels to stay out of Ukraine's political crisis’. Aksesuar në: <http://www.theguardian.com/world/2014/jan/28/vladimir-putin-ukraine-crisis-eu>

Si kundërpërgjigje ndaj qëndrimit Rus, vendet perëndimore reagues si në formë deklarative por edhe duke marrë masa konkrete nëpërmjet përdorimit të diplomacisë imponuese. Një sërë sanksionesh u ndërmorën kundër individëve privat, zyrtarëve dhe kompanive ruse por edhe disa ukrainase. Në deklaratën e Këshillit Europian, më 6 Mars 2014, ndër të tjera deklarohet se *“Energjia dhe siguria energjetike janë një pjesë e rëndësishme e marrëdhënieve të jashtme të Bashkimit. Ne do të vazhdojmë të mbështesim garantimin e sigurisë së furnizimit. Në gjithashtu kërkojmë implementimin efikas dhe konsistent të Paketës së Tretë të Energjisë nga të gjithë aktorët e tregut energjetik Europian. Bashkimi Europian është i gatshëm për të asistuar Ukrainën në sigurimin e furnizimit me energji nëpërmjet diversifikimit, efikasitetit energjetik dhe interkonjeksioneve efektive me Bashkimin Europian”*¹⁷.

Nëpërmjet kësaj deklarate, dalin në pah disa nga elementët kryesor të sigurisë energjetike dhe implikimeve të saj në sigurinë ndër/kombëtare. Së pari, Këshilli deklaron për rolin dhe rëndësinë e sigurisë energjetike në politikën e BE-së. Kjo shpreh implikimin rajonal dhe ndërkombëtar të sigurisë energjetike. Së dyti, shprehet pozicioni i BE-së në raport me burimet energjetike, duke dëshmuar për fokusin e saj tek ‘siguria e furnizimit’. Së treti, theksohet rëndësia e integritetit të tregut rajonal energjetik dhe operimin e aktorëve sipas këtyre rregullave. Së katërti, diversifikimi shihet si një zgjidhje me mundshme e cila ndikon në nivelin e sigurisë energjetike. Së fundmi, nëpërmjet evidentimit të rëndësisë së interkonjeksioneve efektive, dëshmohet qartë fakti se siguria e një aktori në aspektin energjetik, nuk mund të jetë i pavarur nga siguria energjetike e aktorëve të tjerë.

¹⁷ Deklarata e Krerëve të Shteteve dhe Qeverive mbi Ukrainën, 6 Mars 2014. Aksesuar në: <http://www.eliamap.gr/wp-content/uploads/2014/03/Statement-of-the-Heads-of-State-or-Government-on-Ukraine-6.3.2014.pdf>

Liderët botëror anuluan Samitin e G-8 në Rusi pas krizës në Ukrainë. Presidenti Amerikan Obama, mbledhi samitin e G-7 në Hagë, Samiti i Sigurisë Nukleare, me qëllim rritjen e presionit mbi Rusinë pas veprimeve të saj në Ukrainë. Në Deklaratën e Hagës, më 24 Mars 2014, ndër të tjera theksohej se *“Ne, liderët e Kanadasë, Francës, Gjermanisë, Italisë, Japonisë, Mbretërisë së Bashkuar, Shteteve të Bashkuara, Presidenti i Këshillit European dhe Presidenti i Komisionit European takohemi në Hagë për të ri afirmuar mbështetjen tonë ndaj sovranitetit, integritetit territorial dhe pavarësisë së Ukrainës... Ne qëndrojmë të bashkuar në angazhimin tonë për të mbështetur financiarisht Ukrainës, për të koordinuar asistencën tonë teknike, dhe të ofrojmë asistencë në fusha të tjera, duke përfshirë masa për të garantuar tregtinë dhe për të forcuar sigurinë energjetike”*¹⁸.

Sikurse vihet re dhe nga deklarata, siguria energjetike shihet si ngushtësisht e lidhur me sigurinë kombëtare. Garantimi i saj konsiderohet si prioritet dhe nga aktorët kryesor të sistemit ndërkombëtar. Kjo dëshmon për implikimet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë energjetike. Siguria energjetike e një vendi, nuk mund të kuptohet jashtë kornizës rajonale të saj, duke çuar në këtë mënyrë në atë që Shkolla e Kopenhagenit e emërton si ‘energy complex’. Në këtë deklaratë, sikurse në situatën në tërësinë e saj, përveç elementëve të ‘energy complex’, identifikohen dhe elementët e tjerë të kësaj qasje si nivelet e analizës, energjia si një fenomen ndër sektorial dhe procesi i sigurizimit. Kjo deklaratë, nuk mund të kuptohet jashtë këtij konteksti.

Përveçse në diskurin e BE-së, siguria energjetike zë një vend të rëndësishëm dhe në dokumentet kryesor strategjik dhe dokumentet e tjera mbështetës. Këshilli European duke evokuar problematikat e sigurisë energjetike të BE-së, mbështeste përpjekjet për reduktimin

¹⁸ Deklarata e Hagës (G7), 24 Mars 2014. Aksesuar në: www.whitehouse.gov/the-press-office/2014/03/24/hague-declaration

e varësisë nga gazi rus. Çështjet kyçe që lidheshin me këtë aspekt ishin eficaenca energjetike, diversifikimi i burimeve, zhvillimi i burimeve vendase dhe interkonjeksioneve. Një ndër dokumentet më të rëndësishme është Strategjia Europiane e Sigurisë Energjetike, e publikuar në Maj 2014¹⁹. Ky është një dokument shumë i rëndësishëm, pasi ofron një kornizë në të cilën krijohet konteksti i përshtatshëm për bashkëpunimin midis aktorëve për të identifikuar problematikat dhe për të dhënë zgjidhjet më të përshtatshme. *“Prosperiteti dhe siguria e Bashkimit European varet nga furnizimi i qëndrueshëm dhe i bollshëm me energji”* (SESE, 2014: 2). Kjo është fjalia e parë në dokumentin e strategjisë, në të cilën shprehet qartë rëndësia e sigurisë energjetike në sigurinë në tërësi.

Në këtë dokument theksohet se ishin krizat e vitit 2006 dhe 2009 të cilat ndërgjegjësuat vendet anëtare për rëndësinë e një politike energjetike të përbashkët. *“BE mbetet vulnerabël nga goditjet e jashtme të energjisë... Për këtë arsye, BE ka nevojë për një ‘hard-headed strategy’ për sigurinë energjetike... e cila redukton varësinë nga burime të caktuara, furnizues të ndryshëm dhe rrugët e transportit në terma afat-gjatë. Politik bërësit në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së duhet t’i bëjnë të qartë qytetarëve implikimet që do të kenë zgjedhjet e bëra për uljen e varësisë”* (SESE, 2014: 2).

Për më tepër, përveçse theksohet identifikimi i varësisë si kërcënim ndaj sigurisë, shprehen dhe disa element të sigurizimit. Me fjalinë ‘Politik bërësit në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së duhet t’i bëjnë të qartë qytetarëve implikimet që do të kenë zgjedhjet e bëra për uljen e varësisë’, mund të kuptohet një ndër fazat e procesit të sigurizimit (bindja e audiencës) në të cilën argumentohet se një proces i suksesshëm sigurizimi mund të kryhet vetëm në ato raste kur aktori sigurizues (politik bërësit), nëpërmjet një akti ligjërimi, bindin

19 Strategjia Europiane e Sigurisë Energjetike, Maj 2014. Aksesuar në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52014DC0330&from=EN>

audiencën (qytetarët europian) për ekzistencën e një kërcënimi ekzistencial (varësia e lartë) dhe nevojën e marrjes së masave të jashtëzakonshme (diversifikimi, reduktimi i konsumit, taksat mbi produktet energjetike, rritja e çmimit të energjisë, etj.).

Në këtë dokument, evidentohet dhe dimensionin ekonomik i sigurisë energjetike, në të cilin theksohet se “Fatura e furnizimit me energji nga jashtë për BE-në përlllogaritet në më shumë se 1 miliard dollar në ditë, çka përbën më shumë se një të pestën e importeve të BE-së” (SESE: 2014: 2). Strategjia identifikon dhe tetë shtyllat kryesore në të cilën BE duhet të fokusohet me qëllim garantimin e sigurisë energjetike, të cilat janë:

- Veprime të menjëhershme me qëllim rritjen e kapaciteteve të BE-së për të tejkaluar ndërprerje të mëdha gjatë periudhave të dimrit;
- Forcimin e mekanizmave të emergjencës/solidaritetit duke përfshirë koordinimin e vlerësimit të riskut dhe planet e emergjencës; dhe mbrojtja e infrastrukturës energjetike;
- Moderimi i kërkesës për energji;
- Ndërtimin e një tregu mirë-funksional dhe plotësisht të integruar energjetik;
- Rritjen e prodhimit në Bashkimin Europian;
- Zhvillimin e mëtejshëm të teknologjisë energjetike;
- Diversifikimin e furnizuesve të jashtëm dhe infrastrukturën përkatëse;
- Përmirësimi i koordinimit të politikave kombëtare energjetike dhe të folurit me një zë në politikën e jashtme energjetike.

Të gjitha këto janë masa shumë të rëndësishme të cilat BE duhet t’i ndërmarrë me qëllim minimizimin e varësisë, e cila perceptohet si një kërcënim, dhe diversifikimin e burimeve dhe aktorëve, e cila konsiderohet si një prioritet. Në dokumentin shoqërues të

Strategjisë Europiane të Sigurisë Energjetike²⁰, të vitit 2014, paraqitet një analizë e detajuar e sigurisë energjetike europiane. Ky është një dokument shumë i rëndësishëm i cili jo vetëm identifikon dhe analizon situatën e sigurisë energjetike në nivelin e BE, por ofron dhe projeksione për të ardhmen dhe zgjidhjet e mundshme për tejkalimin e situatës. Dy fjalët kyçe të këtij dokumenti të lidhura me sigurinë energjetike janë: varësia nga importi dhe nevoja për diversifikim. Qëllimi i këtij dokumenti është të “ofrojë një gamë të gjerë të informacioneve dhe analizës rreth burimeve, diversifikimit, varësisë dhe kostot e energjisë për shtetet në veçanti dhe BE në tërësi” (KE, 2014: 3). Hartimi i tij u bë nga Komisioni European me kërkesë të Këshillit, i cili kërkonte zhvillimin e një analize të hollësishme dhe një plan për uljen e varësisë energjetike të BE-së.

Që në hyrjen e tij, në dokument evidentohet fakti se “pavarësisht masave të ndërmarra në nivel kombëtar dhe të BE-së, ngjarjet e fundit në kufijtë lindor të BE kanë rritur shqetësimet mbi vazhdimësinë e furnizimit me energji” (KE, 2014: 3). Duke pasur në konsideratë kontekstin e hartimit të këtij dokumenti, është e nevojshme të kujtojmë se bëhet fjalë për periudhën e rritjes së tensioneve dhe përshkallëzimit të tyre në konflikt të armatosur midis Rusisë dhe Ukrainës, të cilët ndikuan në sigurinë energjetike të BE-së dhe perceptimet e aktorëve ndaj kësaj situatë. “Sjellja e Rusisë në Ukrainë në vitet e fundit, mungesa e besimit në një partner ekonomik afat gjatë dhe shqetësimet mbi mbështetjen në një partner tregtar i cili nuk respekton normat ndërkombëtare kanë lënë gjurmët e tyre” (Hedberg, 2015: 1). Këto të gjitha janë element të cilët përforcojnë akoma dhe më shumë nevojën për diversifikimin e burimeve energjetike, si garantues i sigurisë energjetike në BE.

20 http://ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/20140528_energy_security_study.pdf

“Problemi kryesor me të cilën përballlet Europa dhe që duhet ta adresojë, është mungesa e një tregu pan – European të gazit natyror” (Noël, 2013: 170). Krijimi i këtij tregu pan – European, shoqërohet me implikime për të gjithë vendet anëtare të BE-së por edhe vendet aspirante për integrim. Kjo është një nga arsyet kryesore që përcakton domosdoshmërinë e vendeve të BE-së për t’u angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në situatën e sigurisë energjetike në vendet e Ballkanit, sikurse nga ana tjetër këto vende duhet që të hartojnë dhe implementojnë politikat e tyre energjetike dhe strategjitë në përputhje me objektivat e BE-së. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e kësaj situatë, është e nevojshme që në proces të përfshihen dhe partnerë të tjerë të sistemit ndërkombëtar.

“Shtetet e Bashkuara mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mbështetjen e përpjekjeve të BE-së për të garantuar sigurinë e furnizimit dhe Bashkimin Energjetik” (Riley, 2015: 10). SHBA mund të luajë rol si eksportues i drejtpërdrejt i LNG drejt vendeve Europiane, apo i teknologjive të reja të lidhura me aksesin në burime energjetike. Shtetet e Bashkuara mund të ndihmojnë aktorët e tjerë për zhvillimin e teknologjisë për shfrytëzimin e burimeve të brendshme. Kështu mund të ndihmojë në zgjerimin e furnizimit global me energji dhe reduktimin e vulnerabilitetit ndaj monopoleve. SHBA mund të ndihmojë vendet e Europës Lindore në zhvillimin e kornizave rregullatore për tërheqjen e investimeve të huaja, duke thyer monopolin e Gazprom-it (Kalicki & Goldwyn, 2013: 6 – 7).

Gjithashtu mbështetja e SHBA-ve mund të bëhet dhe brenda kornizës së NATO-s. “Ne duhet ta bëjmë diversifikimin e energjisë një prioritet strategjik transatlantik dhe të reduktojmë varësinë e Europës nga energjia Ruse” (Rasmussen, 2014). Ky është një pasazh nga fjalimi i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen në ‘Forum in Brukselit’, në Mars 2014. Fjalimi mbahet në kontekstin e konfliktit midis Rusisë dhe Ukrainës, prandaj ka një rëndësi të veçantë. Implikimet kryesore të këtij fjalimi janë: nga

njëra anë shprehet angazhimi i NATO-s për të ndihmuar BE-në në garantimin e sigurisë energjetike dhe nga ana tjetër shfaq rëndësinë që siguria energjetike ka për aktorët kryesor në sistemin ndërkombëtar. Përfshirja e sigurisë energjetike në axhendën e NATO-s, është një tregues i rëndësisë së këtij fenomeni dhe implikimeve ndërkombëtare të saj.

Në dokumentin ‘2030 Energy Strategy’²¹, të Komisionit European, vendet e Bashkimit bien dakord për një kornizë të re mbi klimën dhe energjinë, ku përfshihen objektivat për periudhën 2020 – 2030. “Këto objektiva synojnë të ndihmojnë BE-në të arrijë një sistem energjetik më konkurrues, të sigurtë e të qëndrueshme dhe të përmbushë objektivat e 2050 për reduktimin e gazrave serë” (Paragrafi I).

Objektivat për 2030, bazuar në këtë dokument, janë:

- Një reduktim prej 40 % të emetimit të gazrave serë krahasuar me nivelet e 1990;
- Të paktën një konsum prej 27 % të energjisë së rinovueshme;
- Të paktën 27 % kursim i energjisë krahasuar me modelet e zakonshme të biznesit.

Politikat për 2030, të cilat duhet të ndërmerren në kuadrin e Bashkimit, janë:

- Një skemë të reformuar të emetimit të BE-së;
- Indikatorë të rinj për konkurrueshmërinë dhe sigurinë e sistemeve energjetike, si çmimet, diversifikimi i furnizimit dhe kapacitetet ndërlidhëse midis BE-së dhe vendeve të tjera.
- Ide për një sistem të ri qeverisës bazuar në planet kombëtare për konkurrueshmërinë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë energjetike. Këto plane do të ndjekin një qasje të përbashkët të BE-së.

21 2030 Energy Strategy. Aksesuar në: <http://ec.europa.eu/energy/en/topics/energy-strategy/2030-energy-strategy>

Në këto objektiva shprehet qartë një tjetër dimension i sigurisë energjetike, mjedisi. Ndryshimet klimaterike, emetimi i gazrave serë, ndotja e mjedisit dhe prishja e ekosistemeve janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me sigurinë energjetike. Si siguria energjetike, ashtu edhe ajo mjedisore shoqërohen me implikime përtej kufijve politiko – gjeografik të Bashkimit. Përmbushja e këtyre objektivave ka një rëndësi të veçantë si për Bashkimin Europian, ashtu edhe për aktorë të tjerë të sistemit ndërkombëtar. Implikimet e tyre lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rajonin e Ballkanit, në të cilin aspiratat e sotme integruese shërbejnë si promotorët e zhvillimit të nesërm. Kjo nënkupton se këto objektiva duhet të kthehen dhe në objektiva për vendet të cilat e shohin të ardhmen e tyre brenda këtij Bashkimi, por mund të shtrihen dhe në një plan akoma më të gjerë.

4.5. Konkluzione

Në këtë kapitull zhvillohet niveli i parë i analizës së këtij punimi. Nëpërmjet aplikimit të premisave teorike dhe dimensioneve të sigurisë energjetike, kapitulli ka si qëllim identifikimin dhe analizimin e implikimeve të sigurisë energjetike në rastin e Bashkimit Europian. Kapitulli nis me një vështrim të përgjithshëm mbi situatën dhe aktorët kryesor energjetik në nivel global. Kjo bëhet për arsyen se siguria energjetike e BE-së nuk mund të analizohet jashtë kontekstit ndërkombëtar në tërësi, dhe kontekstit të sigurisë energjetike ndërkombëtare në veçanti. Si pasojë e ndërveprimit midis aktorëve, siguria energjetike në BE nuk mund të kuptohet jashtë kontekstit të marrëdhënieve të saj me aktorët e tjerë, ku Rusia është aktori me ndikimin më themelor. Të gjithë aktorët, pavarësisht pozitës së tyre në raport me burimet energjetike, ndikohen nga aksioma bazë në sigurinë energjetike ndërkombëtare, sipas së cilës kërkesa për energji është në rritje të vazhdueshme, në një kohë që burimet fosile të energjisë janë të kufizuara. Nga një situatë e tillë preken të gjithë aktorët

e sistemit ndërkombëtar. çështjet e energjisë nisën të trajtohen përtej politikave normale, për shkak të perceptimit të tyre si kërcënim ekzistencial duke u fokusuar më shumë në aspektin politik sesa ekonomik të energjisë.

Vendet eksportuese, nën këndvështrimin e sigurizimit, përdorin energjinë si instrument të politikës së jashtme. Vendet importuese, përdorin instrumentet politik, ekonomik dhe ushtarak për të garantuar aksesin në burimet ekzistuese por edhe për të garantuar burime të reja. Ndërsa vendet transit, fokusohen në vazhdimësinë e projekteve energjetike ekzistuese dhe përfshirjen në projekte të reja. Të gjithë këto objektiva, mund të bëhen pjesë e procesit të sigurizimit. Sigurizimi i energjisë lidhet me sjelljet politike të shteteve drejtë tregjeve energjetike të pa balancuara, të cilat mund të konsiderohen si kërcënime ekzistenciale për objektin referent në lidhje me politikat energjetike të aktorëve prodhues, konsumator dhe transit të energjisë. Siguria energjetike është një ndër prioritetet themelore të BE-së, duke u renditur në majat e axhendave politike Europiane kryesisht që në periudhën e pas krizës së parë Rusi-Ukrainë të vitit 2006, dhe kryesisht pas krizës së 2014. Kjo krizë rriti ndërgjegjësimin e BE-së lidhur me kërcënimin potencial dhe real që sillte një varësi e lartë nga importi i energjisë nga Rusia, sikurse dhe nga burime të tjera të ‘paqëndrueshme’.

Disa nga arsyet kryesore të cilat e bënë pjesë të politikave të larta energjinë në Europë, duke e bërë në këtë mënyrë pjesë të procesit të sigurizimit, ishin: Rritja e shpejtë e konsumit të gazit natyror; Rritja e importeve, si pasojë e rritjes së kërkesës dhe uljes së prodhimit vendas; Mbështetja tek një numër i vogël furnizuesish; Dominanca e kontratave bilaterale afat – gjata midis aktorëve shtetëror; Varësia asimetrrike vendeve të Europës Lindore dhe Qendrore nga Rusia; Dhe më e rëndësishmja, ndërhyrjet e Rosisë së Putin në arkitekturën Euro – Atlantike në ish hapësirën Sovjetike (duke përfshirë Ukrainën, vendin

kyç të transitit të gazit natyror), me qëllim rifitimin e influencës në Europën Qendrore dhe Lindore, nëpërmjet përdorimit të eksportit të energjisë si një instrument për të përmbushur këto qëllime. Pavarësisht disa hapave konkrete drejtë një qëndrimi të përbashkët të vendeve të BE-së mbi politikat energjetike, lidhur me politikën e jashtme energjetike vendet anëtare hezitojnë të çdojnë sovranitetin e tyre. Një dyzim i tillë, midis nevojës për ‘të folur me një zë të vetëm’ dhe prioritizimit të sigurisë energjetike në nivel kombëtar, sjell pasoja në nivelin e sigurisë energjetike për BE-në në tërësi.

Nga ana tjetër, kriza Rusi – Ukrainë dëshmon qartë domosdoshmërinë e diversifikimit të burimeve energjetike të BE-së, ku rajoni i Kaspikut mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim. Për transportin e gazit natyror nga rajoni i Kaspikut drejtë tregjeve Europiane, janë projektuar një sërë gazsjellësish të cilët do të kalojnë nëpërmjet territoreve të disa shteteve Ballkanike. Një ndër gazsjellësit kryesor, i cili do të transportojë gazin nga Azerbajxhani drejtë tregut European, është Trans Adriatik Pipeline (TAP). Kjo dëshmon për implikimet e sigurisë energjetike të Bashkimit European në rajonin e Ballkanit.

Si përfundim, në analizimin e situatës energjetike të BE-së dhe implikimeve të saj, e parë në këndvështrimin e krizës Rusi – Ukrainë, dalin në pah dimensionet ndër sektoriale të sigurisë, sigurizimi i çështjeve energjetike nga aktorët kryesor të BE-së dhe implikimet shumë nivelore të saj. Kjo pasqyrohet si në diskurin e aktorëve ashtu edhe në dokumentet kryesore strategjike. Siguria energjetike në BE karakterizohet nga varësia e lartë e perceptuar si kërcënim ekzistencial dhe nevoja për diversifikimin e burimeve energjetike si prioritet.

Kapitulli V: Siguria energjetike në Ballkan

5.1. Një qasje analitike mbi situatën energjetike në rajonin e Ballkanit²²

Siguria energjetike në Ballkan ka dy aspekte kryesore, “nga njëra anë, zhvillimi ekonomik i rajonit po ndërkombëtarizohet gjithnjë e më shumë dhe këto vende mund të përfitojnë nga ndërveprimi me fqinjët. Nga ana tjetër, strategjitë për përballjen me sfidat ekonomike, mjedisore dhe ato të sigurisë në sektorin energjetik kërkojnë zhvillimin e politikave kombëtare më efektive” (Cehulic et.al., 2013: 114). Në këtë mënyrë, garantimi i sigurisë energjetike në nivelin rajonal, kërkon domosdoshmërisht dhe zhvillimin e kapaciteteve të brendshme energjetike. Për më tepër, rajoni i Ballkanit ka një rëndësi të veçantë për Europën e më gjerë, për vetë pozitën e tij gjeostrategjike, duke qenë një urë lidhëse midis rajoneve të ndryshme të botës. Për këtë arsye, si avantazhet ashtu edhe disavantazhet e këtyre vendeve, kanë implikime të drejtpërdrejta përtej kufijve gjeografik të këtij gadishulli.

Profili energjetik i vendeve të Ballkanit ka rëndësi të njihet për tre arsye themelore:

- Vendet e Ballkanit janë shumë të varura nga importi i energjisë për qëllime konsumi të brendshëm dhe për pasojë janë të ndikuara nga pasojat ekonomike për shkak të çrregullimeve në furnizim.
- Vendet e Ballkanit janë të pozicionuara gjeografikisht në territore që lidhin Europën, Euroazinë dhe Lindjen e Mesme, shumë kritikë për transportin e lëndës djegëse për prodhim energjinë tregun europian.
- Si konsumatorë, por edhe si pjesë e korridorit të transitit, vendet e Ballkanit bashkëveprojnë me vendet e Europës dhe Euroazisë (Cehulic et.al., 2013: 114).

²² Ky seksion mbështetet në: Morina, F. & Fuga, P. (Pranverë 2014). Një Qasje Analitike mbi Sigurinë Energjetike në Ballkan, në: *Economicus* 11 UET Revistë Shkencore e Fakultetit Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit ISSN 2223-6295

Ky rajon ka një të kaluar problematike (tranzicioni dhe konfliktet etnike) e cila ka lënë gjurmë dhe në zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturën energjetike të këtyre vendeve. Është e rëndësishme të theksohet se rajoni përbëhet nga shtete anëtare, candidate dhe candidate potenciale për integrimin në BE duke dëshmuar në këtë mënyrë vlerën e shtuar të këtyre vendeve. Në këtë rajon ndodhen dhe dy shtete, Turqia dhe Greqia, të cilat janë anëtare të vendeve të OECD-s. Ndërsa shtetet e tjera karakterizohen nga tregues ekonomik relativisht të dobët. Në mënyrë të përmblodhur, në tabelën e mëposhtme pasqyrohen dhe treguesit kryesor ekonomik të vendeve të cilat janë objekt i analizës së këtij kapitulli.

Tabela 2: Treguesit kryesor ekonomik (2012)

<i>Shtetet</i>	Popullsia (ne milion)	GDP (miliard USD,2005)	GDP PPP (miliard USD,2005)	GDP PPP/banor (mije USD,2005)	Shkalla e rritjes se GDP (%)
<i>Shqipëria</i>	3.16	11.22	25.69	8.123	1.6
<i>Kosova</i>	1.81	5.13	N/A	N/A	2.7
<i>Maqedonia</i>	2.2	7.32	19.63	9.329	-0.3
<i>Mali I Zi</i>	0.62	2.88	6.58	10.602	-0.5
<i>Bosnja & Hercegovina</i>	3.83	12.88	28.2	7.356	-0.7
<i>Bullgaria</i>	7.3	33.85	88.95	12.178	0.8
<i>Kroacia</i>	4.27	44.94	68.29	16.005	-2
<i>Greqia</i>	11.28	209.56	236	20.922	-6.4
<i>Serbia</i>	7.22	27.85	69.95	9.683	-1.7
<i>Rumania</i>	21.33	119.19	244.05	11.444	3.1
<i>Turqia</i>	74	628.43	1.016.51	13.737	2.2
<i>Holanda</i>	16.77	680.92	610.99	36.438	-1.2
<i>Austria</i>	8.46	337.67	306.34	36.200	0.9
<i>Italia</i>	60.92	1.727.41	1.602.78	26.310	-2.5
<i>Mesatarja e Ballkanit</i>		91.94	180.38	11.938	-0.2
<i>Totali I Ballkanit</i>	137.02	1103.25	1803.85		

Burimi: Banka Botërore (www.worldbank.org)

Gadishulli i Ballkanit ka një popullsi prej afro 137 milion banorë, me një total të GDP të përlllogaritur në rreth 1.1 trilion dollarë, ku shkalla e rritjes së GDP vlerësohet në -0.2%. Ndërsa mesatarja e GDP PPP/banor është 11.938 dollarë, e cila është shumë herë më

e ulët krahasuar me vendet e OECD. Tregjet në këtë rajon janë të ndryshme si nga përmasat, mirëqenia, ashtu dhe nga zhvillimi. Turqia është shteti me popullsinë më të madhe (74 milion), e ndjekur nga Rumania (21.33 milion) dhe Greqia (11.28 milion), ndërsa shteti me popullsinë më të vogël është Mali i Zi me 0.62 milion banorë. Shteti me GDP më të madhe është Turqia, ndërsa GDP/frymë më të lartë e ka Greqia dhe më të ulët Bosnja & Hercegovina. Kosova (2.7%) dhe Shqipëria (1.6%) kanë shkallën më të lartë të rritjes së GDP, ndërsa Greqia (-6.4%) atë më të ulët. Këto tregues kanë një rëndësi të veçantë, pasi sektori i energjisë është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me ekonominë. Për pasojë, sa më i pasur të jetë një vend aq, më e lartë do të jetë dhe kërkesa për energji, por në të njëjtën kohë edhe mundësitë e tij për të garantuar aksesin në këto burime janë relativisht më të mëdha krahasuar me vendet që kanë tregues të dobët të zhvillimit ekonomik.

Përpos diferencave midis këtyre vendeve, ekzistojnë dhe disa problematika të cilat janë të përbashkëta, ku nevoja për garantimin e sigurisë energjetike mbetet një ndër prioritet kryesore. Teknologjia e vjetërsuar, ndërvarësia dhe nevoja për diversifikimin e burimeve të energjisë, janë elemente të cilët përbëjnë sfida reale për garantimin e furnizimit me energji të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë për këto vende.

Tabela 3: Treguesit kryesor energjetik (2011).

<i>Mtoe</i>	Prodhimi Energjisë	Importi Neto	Import	Export	Konsumi Total Final	GDP/KWh	Konsumi Importit neto (%)
<i>Shqipëria</i>	1.49	0.71	1.5	0.8	1.93	11.6	36.8
<i>Kosova</i>	1.8	0.7	0.9	0.2	1.32	N/A	40.2
<i>Maqedonia</i>	1.78	1.43	1.8	0.3	1.97	6.3	72.6
<i>Mali I Zi</i>	0.79	0.4	0.5	0.1	0.82	5.6	48.8
<i>Bosnja & Hercegovina</i>	4.62	2.36	3.6	1.2	3.34	4	70.6
<i>Bullgaria</i>	12.37	7.14	11.9	4.8	9.61	4.6	74.3
<i>Kroacia</i>	3.79	4.68	6.8	2.1	6.75	8.3	69.3

<i>Greqia</i>	9.6	19.59	29.6	10	19	9.4	103.1
<i>Serbia</i>	11.17	4.87	5.8	0.9	9.78	4.4	49.8
<i>Rumania</i>	27.57	7.63	11.9	4.3	23.85	6.6	32
<i>Turqia</i>	32.06	80.16	88.5	8.4	81.46	8.8	98.4
<i>Holanda</i>	64.4	29.24	179.5	150	59.63	8	49
<i>Austria</i>	11.51	23.51	30.6	7.1	26.82	9.3	87.6
<i>Italia</i>	31.56	141.12	169.2	28.1	126.75	9.8	111.3

Pavarësisht problematikave të përbashkëta, këto vende ndryshojnë midis tyre në një sërë aspektesh; në sasinë e energjisë së prodhuar, raportit midis importit dhe eksportit, konsumit apo energjisë mix. Sikurse pasqyrohet dhe në tabelën e mësipërme, ndër vendet e rajonit, Turqia zë vendin e parë në lidhje me sasinë e energjisë së prodhuar (32.06 Mtoe), e ndjekur nga Rumania (27.57 Mtoe) dhe Bullgaria (12.37 Mtoe). Ndërsa nivelin më të ulët të prodhimit të energjisë e kanë respektivisht Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova. Importuesi, por edhe eksportuesi më i madh në rajonin e Ballkanit është Turqia, ndërsa shteti me nivelin më të ulët të importit/eksportit është Mali i Zi. Për shkak dhe të numrit të popullsisë, por edhe të nivelit të zhvillimit ekonomik, Turqia është konsumatori më i madh i energjisë në këtë rajon.

Nëse bazohemi mbi raportin Import neto/Konsum, Greqia dhe Turqia shfaqen si shtetet që kanë vlerën më të lartë, ndërsa Rumania dhe Shqipëria me vlerën më të ulët. Kjo tregon se Greqia dhe Turqia, konsumin e tyre të energjisë e kanë shumë të varur nga importi, apo e thënë ndryshe vlera e varësisë energjetike për këto vende është shumë e lartë. Ndërsa për Rumaninë dhe Shqipërinë, vlera e këtij raporti tregon se bazuar tek konsumi respektiv, këto vende kanë një varësi relativisht më të ulët. Një varësi e ulët jo domosdoshmërisht nënkupton se vendi konsumon një sasi energjie optimale për të, pasi varësia shpreh vetëm një raport midis importit neto/konsumit në një moment të caktuar.

Sasia e energjisë së konsumuar është e lidhur ngushtësisht si me sasinë e energjisë në dispozicion, ashtu dhe me nivelin e zhvillimit ekonomik dhe treguesit e mirëqenies së një vendi. Një paraqitje grafike e lidhjes midis GDP dhe sasisë së energjisë së konsumuar për disa nga vendet e marra në analizë, pasqyrohet në grafikët e mëposhtëm.

Grafiku11: Ecuria e GDP-së dhe konsumit të energjisë



Sikurse vihet re dhe nga grafiku i mësipërm, ekziston një lidhje e qartë midis GDP-së së një vendi dhe sasisë së energjisë së konsumuar prej tij. Sa më e lartë GDP, aq më e lartë është dhe sasia e energjisë së konsumuar. Ndër vendet e rajonit të Ballkanit, Turqia është shteti me GDP-në më të lartë dhe me sasinë më të madhe të energjisë së konsumuar, e ndjekur nga Greqia dhe Rumania. Ndërsa vendi me GDP-në më të ulët dhe sasinë më të pakët të energjisë së konsumuar është Mali i Zi, i ndjekur nga Kosova. Duke qenë se vendet e Ballkanit janë kryesisht vende në zhvillim, atëherë në terma afatmesëm dhe afatgjatë, garantimi i energjisë do të jetë një nga problematikat me të cilat këto vende do të përballen akoma dhe më shumë. Një lidhje e tillë dëshmon faktin se sasia e energjisë së konsumuar është një tregues i zhvillimit dhe i mirëqenies së një vendi. Për më tepër, kjo lidhje tregon se vendet në zhvillim do të vijnë gjithnjë duke shtuar kërkesën për energji për sektorët e tyre të ekonomisë. Një gjë e tillë do prekte në mënyrë të drejtpërdrejtë sigurinë energjetike të vendeve në mbarë globin.

Lidhur me energjinë mix, apo diversifikimin e burimeve të energjisë, është e nevojshme analizimi i situatës për secilin shtet. Prodhimi i energjisë në rastin e Shqipërisë

bazohet mbi burime të tilla si nafta bruto dhe burimet hidrike. Importi mbizotërohet nga nafta dhe nënproduktet e saj, ndërsa eksporti mbizotërohet nga nafta bruto. Prodhimi i energjisë në Kosovë bazohet tek qymyrguri dhe biokarburet. Greqia importon naftë dhe nënproduktet e saj, sikurse dhe eksporton energji elektrike. Maqedonia e bazon prodhimin e energjisë tek qymyrguri. Importon naftë bruto dhe eksporton naftë dhe nënproduktet e saj. Mali i Zi e bazon prodhimin e energjisë tek qymyrguri dhe biokarburet. Importon naftë dhe nënprodukte të saj, sikurse dhe energji elektrike.

Prodhimi i energjisë në Bosnje & Hercegovinë është i bazuar tek qymyrguri, importon naftë bruto dhe eksporton energji elektrike. Bullgaria e bazon prodhimin e energjisë tek qymyrguri, energjia nukleare dhe biokarburet. Importon naftë bruto dhe gaz natyror; eksporton naftë dhe nënproduktet e saj, sikurse dhe energji elektrike. Ndërsa Kroacia prodhimin e saj të energjisë e ka të bazuar tek gazi natyror. Importi i energjisë mbizotërohet nga nafta bruto ndërsa eksporti mbizotërohet nga nafta dhe nënproduktet e saj. Ndërsa Greqia prodhimin e ka të bazuar tek qymyrguri dhe biokarburet, importon naftë bruto dhe eksporton naftë dhe nënproduktet e saj. Serbia prodhimin e ka të bazuar tek qymyrguri, importon naftë dhe nënproduktet e saj, dhe eksporton energji elektrike. Rumania e ka bazuar prodhimin e energjisë tek gazi natyror, qymyrguri dhe energjia bërthamore. Importon naftë bruto dhe gaz natyror, ndërsa eksporti mbizotërohet nga nafta dhe nënproduktet e saj sikurse dhe energjia elektrike.

Turqia prodhimin e energjisë e ka bazuar mbi burime të tilla si qymyrguri, burimet hidrike, gjeotermale/solar dhe biokarburet. Importi mbizotërohet nga gazi natyror dhe nafta bruto, ndërsa eksporton naftë dhe nënprodukte të saj sikurse dhe gaz natyror. Sikurse shihet dhe nga të dhënat e mësipërme, shumë shtete arrijnë të kompensojnë kufizimet e tyre në resurse me anë të importit dhe zhvillimit të sektorit të përpunimit të produkteve energjetike,

një pjesë të së cilës e përdorin si burim energjie për sektorët e ndryshëm të ekonomisë së tyre, ndërsa një pjesë tjetër e eksportojnë sërish në vende të tjera.

Turqia është 'lojtari' kryesor ndër vendet e Ballkanit. Për të fuqizuar pozitën e saj rajonale, ajo po zgjeron bashkëpunimin me vendet e Azisë Qendrore në fushën energjetike. Duke qenë një vend me rezerva të kufizuara të naftës dhe gazit natyror, Turqia plotëson kërkesat e brendshme energjetike nëpërmjet importit të përlogaritur në rreth 75 % të totalit të energjisë së konsumuar. Strategjia e Turqisë për të garantuar sigurinë energjetike fokusohet në diversifikimin e burimeve energjetike, zhvillimin e burimeve alternative energjetike, investimin lokal të prodhimit të qymyrit dhe ndërtimit të centraleve bërthamore dhe gjithashtu shpreson në zbulimin e hidrokarbureve në Detin e Zi dhe nxjerrjen e gazit argjilor (Winrow, 2014). Për më tepër roli i saj si vend transit për transportin e gazit natyror nga rajoni i Kaspikut dhe Gjiri Persik drejtë Europës, planet për t'u kthyer në një qendër të depozitimit dhe tregtimit të energjisë elektrike dhe gazit, janë element shumë të rëndësishëm të cilët do të ndikojnë si në rritjen e rolit të Turqisë në gjeopolitikën energjetike ashtu edhe në garantimin e sigurisë së saj energjetike.

Partnerët kryesor energjetik të Turqisë janë Rusia, Azerbajxhani dhe Irani. Turqia importon rreth 60 % të gazit natyror nga Rusia, naftë dhe qymyr. Midis dy vendeve janë nënshkruar një sërë marrëveshesh për ndërtimin e tubacioneve të rinj. Për më tepër ndërtimi i centrali bërthamor në Turqi do të bëhet nga një kompani ruse. Turqia importon gaz nga Azerbajxhani, volumi i të cilit do të rritet me vënien në funksion të TANAP dhe kompania SOCAR operon në rafineritë e naftës në Turqi duke investuar në ekonominë e saj. Irani është një tjetër partner i rëndësishëm për Turqinë, prej së cilës importon gaz, naftë dhe energji elektrike (Winrow, 2014).

Situata në të cilën gjenden këto vende lidhur me diversifikimin e burimeve energjetike, është larg standardeve të vendeve të zhvilluara. Nëse analizohen Italia, Austria dhe Holanda do shikohet se ato kanë akses në një numër shumë më të lartë të burimeve energjetike, çka nënkupton se energjia mix e tyre është në nivele shumë më optimale. Në rastin e Italisë, prodhimi i energjisë është i bazuar kryesisht tek biokarburet, burimet gjeotermale/solare, gazi natyror dhe burimet hidrike. Italia importon naftë bruto, gaz natyror, qymyrguri. Eksporti mbizotërohet nga nafta dhe nënproduktet e saj. Austria e ka bazuar prodhimin e saj të energjisë tek biokarburet, burimet hidrike dhe gazi natyror. Ajo importon gaz natyror, naftë bruto dhe qymyrguri. Eksporti mbizotërohet nga nafta dhe nënproduktet e saj dhe energjia elektrike. Ndërsa Holanda prodhimin e saj të energjisë e ka bazuar tek gazi natyror dhe biokarburet. Importon naftë bruto, gaz dhe qymyrguri, ndërsa eksporton naftë dhe nënprodukte të saj.

Asnjë nga vendet e listuar më sipër nuk është i pasur me burime të brendshme të mjaftueshme energjetike, e thënë ndryshe ato janë të gjithë vende të varura nga importi i energjisë, pavarësisht se shkalla e varësisë është e ndryshme nga njëri vend në tjetrin. Në mënyrë të përmbledhur, mund të themi se varësia nga importi i energjisë dhe pozita gjeografike në të cilën këto vende janë të lokalizuara, bën që vendet e Ballkanit të jenë të implikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga situata globale e tregut të energjisë. Duke qenë se janë vende shumë të varura nga importi i energjisë për qëllime konsumi të brendshëm, ato janë të ndikuara nga pasojat ekonomike për shkak të çrregullimeve të mundshme në furnizim. Për më tepër, pozita e tyre gjeografike, si një urë lidhëse midis Europës, Euroazisë dhe Lindjes së Mesme, rrit rolin dhe rëndësinë e tyre për transportin e lëndëve djegëse drejtë tregut European të energjisë.

Sikurse dhe në sektorin e energjisë në tërësi, edhe në sektorin e energjisë elektrike situata në rajonin e Ballkanit shfaqet problematike edhe pse varion nga një vend në tjetrin. Dallimet variojnë nga sasia e energjisë elektrike të prodhuar, raporti midis importit dhe eksportit, niveli i konsumit dhe gjithashtu dhe nga niveli i varësisë së konsumit në raport me energjinë elektrike të importuar. Kujtojmë se sa më e lartë vlera e varësisë, aq më i pasigurte është sektori i energjisë elektrike në atë vend. Ky është një tregues shumë i rëndësishëm për shkak se pavarësia e energjisë është një nga treguesit kryesor të sigurisë dhe zhvillimit të një vendi.

Tabela 4: Treguesit e energjisë elektrike(2011)

<i>Shtetet</i>	Prodhi mi Total i Elektri citetit (GWh)	Importi Elektricit etit (GWh)	Eksporti Elektricit etit (GWh)	Import i Neto (GWh)	Prodhim i Vendit (GWh)	Konsumi Elektricit etit (GWh)	Konsumi Elektricit etit / popullata (KWh/cap ita)	Varësia (%)
<i>Shqipëria</i>	4159	3662	0	3662	7421	6380	1980	65
<i>Kosova</i>	5801	2135	2717	-582	6219	5280	2940	-12
<i>Maqedonia</i>	6876	2676	0	2676	9552	8170	3960	35
<i>Mali I Zi</i>	2656	1993	431	1562	4218	3570	5640	45
<i>Bosnja & Hercegovina</i>	15280	4171	5660	-1489	13791	12240	3260	-13
<i>Bullgaria</i>	50797	1449	12110	-10661	40136	35740	4780	-38
<i>Kroacia</i>	10831	8730	1033	7697	18528	16700	3790	49
<i>Greqia</i>	59436	7180	3948	3232	62668	59850	5290	6
<i>Serbia</i>	38600	6701	6979	-278	38322	32480	4470	-1
<i>Rumania</i>	62216	3410	5316	-1906	60311	53170	2490	4
<i>Turqia</i>	229393	4556	3645	911	230304	197940	2680	1
<i>Holanda</i>	112968	20620	11531	9089	122057	117450	7040	8
<i>Austria</i>	65699	24972	16777	8195	73894	70390	8360	13
<i>Italia</i>	302581	47519	1787	45732	348313	327470	5390	15

Burimi: IEA (www.iea.org)

Prodhuesi, por edhe konsumatori kryesor i energjisë elektrike në rajonin e Ballkanit është Turqia, e cila e bazon prodhimin e saj tek burime të tilla si gazi natyror, qymyrguri, burimet hidrike dhe era. Turqia arrin të mbulojë kërkesën për energji elektrike pothuajse plotësisht nga prodhimi i brendshëm, me një vlerë të varësisë nga importi shumë të ulët, e llogaritur në vetëm rreth 1%. Në vend të dytë lidhur me sasinë e energjisë së prodhuar në

rajon renditet Rumania, e ndjekur nga Greqia dhe Bullgaria. Rumania e bazon prodhimin e energjisë elektrike tek qymyrguri, burimet hidrike dhe energjia bërthamore. Rumania zë vendin e parë në rajonin e Ballkanit për eksportin e energjisë elektrike në raport me importin, me një vlerë neto të importit të përlllogaritur në -1906 GWh. Greqia, e cila e bazon prodhimin e energjisë elektrike tek qymyrguri, gazi natyror dhe burimet hidrike, është ndër vendet me konsumin për frymë më të lartë në rajon, duke u renditur e dyta pas Malit të Zi (5640 kwh/capita). Prodhimi i energjisë elektrike në Malin e Zi bazohet tek qymyrguri dhe burimet hidrike, me një varësi të ndjeshme nga importi i energjisë elektrike nga vendet e tjera. Një varësi të lartë nga importet kanë gjithashtu Kroacia (49%) dhe Maqedonia (35%). Në pozitat më të favorshme janë Bullgaria, Bosnje & Hercegovina sikurse dhe Kosova, e cila prodhimin e energjisë elektrike e ka të bazuar tek qymyrguri.

Shqipëria shfaqet si vendi me varësinë më të lartë nga importet, e llogaritur në rreth 65 % dhe me normën më të ulët të konsumit të energjisë elektrike për frymë, e cila llogaritet në vetëm 1980 kwh. Së bashku me Maqedoninë, janë të vetmet shtete në rajonin e Ballkanit të cilët nuk janë eksportues të energjisë elektrike. Sistemi energjetik në Shqipëri është relativisht i vogël, me një prodhim të elektricitetit të bazuar në burimet hidrike. Për shkak të konsumit të lartë dhe në rritje, edhe importi i energjisë elektrike është i lartë si pasojë e mos plotësimit të kërkesës nga burimet e brendshme energjetike. Investimet e kufizuara në sektorin e energjisë dhe humbjet e mëdha në rrjet, bëjnë që garantimi i sigurisë energjetike për Shqipërinë të jetë i vështirë dhe i kushtueshëm. Në këtë situatë, është i domosdoshëm vazhdimi i reformimit të sektorit energjetik dhe përmirësimi i furnizimit me energji. Diversifikimi i burimeve energjetike dhe reduktimi i varësisë nga elementët klimaterik janë çështje për të cilat duhet të tregohet një kujdes i veçantë. Një siguri energjetike e kërcënuar dhe nevoja për shtimin e importeve ka implikim të drejtpërdrejtë në çdo sektor të

ekonomisë, pasi ndikon në buxhetin e shtetit në tërësi. Ndërtimi i HEC-ve të vegjël, përmirësimet në rrjetin e transmetimit dhe përpjekjet e vazhdueshme për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike janë disa elemente pozitive, por të cilët nuk kanë arritur të zgjidhin problematikën e energjisë në Shqipëri.

Çdo vend, nëpërmjet përdorimit të modeleve të ndryshme të analizimit të sigurisë energjetike, duhet të kuptojë profilin e tij energjetik me qëllim identifikimin e prioriteteve të politikave që duhet të ndërmerret për garantimin e sigurisë energjetike. Diversifikimi i burimeve energjetike dhe minimizimi i varësisë nga importet duhet të jenë prioritetet kryesore të qeverive të këtyre vendeve. Është e nevojshme të merret në konsideratë jo vetëm importi i energjisë, por edhe prodhimi i brendshëm dhe infrastruktura. Hartimi i një strategjie efikase dhe vizionare është një domosdoshmëri në këtë drejtim. Është e nevojshme që kjo strategji të garantojë elementin e gjithë përfshirjes, si mënyrën më të përshtatshme për t'u përballur me një shqetësim që ka implikime ndërkombëtare, rajonale, kombëtare, lokale por edhe individuale. Për këtë qëllim shtetet duhet të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, pasi asnjë shtet nuk mund të garantojë sigurinë energjetike, pavarësisht nëse është një shtet eksportues apo importues i energjisë. Si pasojë e rritjes së vazhdueshme të ndërvësisë energjetike, ka shumë rëndësi mënyra sesi shtetet do t'i menaxhojnë marrëdhëniet e tyre, si ato dypalëshe ashtu edhe shumëpalëshe. Krijimi i një tregu global apo rajonal të integruar dhe efikas të energjisë është një aspekt shumë i rëndësishëm në këtë drejtim. Gjithashtu duhet që edhe brenda shtetit, bashkëpunimi të përfshijë si strukturat shtetërore, ashtu edhe sektorin privat që operon në të.

Garantimi i sigurisë energjetike kërkon dhe kushtimin e një vëmendje të veçantë në lidhje me faktorët kohë dhe çmim. Duhet që të mbahet në konsideratë fakti se shtimi i kapaciteteve të reja energjetike kërkon një kohë relativisht të gjatë, dhe koha në këtë drejtim

merr dhe vlerë financiare, pasi sa më shumë kohë të kalojë aq më e shtrenjtë bëhet energjia, por edhe kostot e instalimeve të prodhimit të energjisë sa vijnë dhe rriten. Qeveritë duhet të jenë në gjendje të menaxhojnë efektet makroekonomike të një ndërprerje të mundshme të furnizimit me energji. Për më tepër, siguria energjetike duhet parë e lidhur ngushtë jo vetëm me politikat ekonomike të një vendi, por edhe me politikat mjedisore, pasi çështjet e energjisë janë të lidhura drejtpërdrejtë dhe me çështjet mjedisore. Ndër karakteristikat kryesore të sektorit të energjisë në vendet e Ballkanit, janë: varësia e lartë nga importi, domosdoshmëria e diversifikimit të burimeve energjetike, varësia nga lëndët djegëse dhe fosile, shterimi i burimeve të brendshme të energjisë, infrastruktura e vjetër dhe niveli i ulët i investimeve në këtë sektor (CSIS, 2010). Këto vende duhet të përfitojnë nga avantazhet që i krijon pozita e tyre gjeostrategjike si urë lidhëse midis rajoneve shumë të rëndësishme të tregut të energjisë; midis Europës, Euroazisë dhe Lindjes së Mesme.

Por cilët janë aktorët kryesor që ndikojnë në sigurinë energjetike rajonale? Cilat janë implikimet e situatës energjetike në sigurinë energjetike dhe si është pasqyruar kjo në marrëdhëniet midis shteteve? Cili është niveli i perceptimit të aktorëve kryesor në nivel rajonal mbi sigurinë energjetike? Si është pasqyruar kjo në ligjërimin publik të këtyre aktorëve dhe në dokumentet strategjik? Cili është raporti i këtyre vendeve me politikat energjetike në nivel të BE-së dhe cilat janë implikimet e pozitës së rajonit si një vend transit i energjisë? Të gjitha këto janë element të rëndësishëm për të identifikuar dhe analizuar implikimet e sigurisë energjetike në nivelin rajonal dhe atë europian, sikurse dhe për të kuptuar nëse këto vende kanë arritur të perceptojnë një ‘energy security complex’ dhe çfarë efektesh ka kjo për to. Këto çështje do të trajtohen në seksionet vijuese të këtij punimi.

5.2. Ndikimi i Rusisë në sigurinë energjetike të Ballkanit

Për shkak të pozitës së tij gjeografike, historisë dhe lidhjeve socio-kulturore, rajoni i Ballkanit tradicionalisht ka qenë në vëmendjen e Rusisë. Për të analizuar ndikimin e Rusisë në sigurinë energjetike të Ballkanit, duhet të mbajmë në konsideratë tre faktorët kryesorë që përcaktojnë këtë rol, respektivisht:

- Rusia është një ndër aktorët kryesor të sistemit ndërkombëtare për prodhimin e naftës dhe të gazit natyror dhe gjithashtu është furnizuesi kryesor me energji elektrike i vendeve të Ballkanit (pjesës më të madhe të tyre);
- Ballkani është rruga kryesore e transportit të naftës dhe gazit natyror rus, përmes porteve të Adriatikut dhe gazsjellëseve për në vendet perëndimore;
- Rusia është shumë e interesuar për ndërtimin e impianteve për prodhimin e energjisë elektrike në këtë rajon (Cehulic et.al., 2013: 120).

Këto janë disa ndër faktorët kryesor të cilët ndikojnë në rolin e Rusisë në rajonin e Ballkanit. Disa aspekte të tjera të rëndësishme mbi analizimin e rolit të Rusisë në Ballkan, lidhen me aspektin ekonomik dhe gjeopolitik.

Së pari, vendet e Ballkanit karakterizohen nga tregues të ulët të zhvillimit ekonomik dhe niveleve të larta të korrupsionit. Situata e vështirë ekonomike krijon hapësira për rritjen e investimeve Ruse në këtë rajon, influencë e cila ka si dimensionin ekonomik ashtu edhe atë politik. Nga ana tjetër, nivelet e larta të korrupsionit reduktojnë mundësitë për investime nga aktorët perëndimor, duke minimizuar në këtë mënyrë konkurrencën midis aktorëve të huaj të ndryshëm.

Së dyti, perspektiva integruese e vendeve të Ballkanit në BE, përbën cenim të interesave Ruse në këtë rajon pasi integrimi i këtyre vendeve do të minimizonte influencën Ruse. Në një periudhë kur BE ka shfaqur shenjat e 'lodhjes nga zgjerimi', Rusia e

shfrytëzon hapësirën e krijuar duke rritur ndikimin e saj në këtë rajon, kryesisht në Serbi, Mal i Zi dhe Bosnje Hercegovinë (Republika Srpska).

Rusia ka tentuar gjithmonë të luajë një rol në Ballkan, por interesi i saj në këtë rajon është rritur në mënyrë të ndjeshme në vitet 2007-08, ku faktori energjetik shihet si arsyeja kryesore në këtë drejtim. Për më tepër, faktori energjetik shihet si një ndër elementet përcaktuese të pozitës aktuale Ruse në arenën ndërkombëtare. Pozita e saj unike në furnizimin me gaz, naftë dhe elektricitet të Europës janë “faktorët kryesorë që shërbejnë për të kuptuar se si energjia ka transformuar Rusinë dhe natyrën e rolit të saj në arenën ndërkombëtare” (Pascual & Elkind, 2010: 19). Brenda këtij kuadri, Rusia luan një rol vendimtar në situatën e sigurisë energjetike në pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit. Duke qenë një ndër prodhuesit kryesorë të naftës dhe gazit në rang botëror, Rusia e sheh me një interes të veçantë rajonin e Ballkanit si një urë lidhëse për transportin e energjisë së saj drejtë tregut europian.

Në fjalën e tij në Samitin Ballkanik për Energjinë në Zagreb në Qershor 2007, Putin do të shprehej se: *“Objektivi strategjik i bashkëpunimit tonë në këtë fushë është sigurimi i besueshëm i aksesit mbi furnizimin me energji për të gjithë vendet e këtij rajoni. Politikat tona mbajnë parasysh faktin e përfshirjes së këtyre vendeve në procesin e integritetit, dhe ne jemi të gatshëm të zhvillojmë marrëdhëniet tona në bashkëpunim me Bashkimin Europian”* (Putin, 2007). Nëpërmjet kësaj deklarate theksohet rëndësia e Ballkanit për Rusinë, sikurse dhe roli i Rusisë në sigurinë energjetike të Ballkanit. Pavarësisht se Presidenti Putin artikulon gatishmërinë e Rusisë për të zhvilluar marrëdhëniet me këto vende në bashkëpunim me BE-në, situatat e mëvonshme do të dëshmonin për një dallim midis asaj që artikullohet dhe mënyrës sesi veprohet. Rusia e përdor Ballkanin si një instrument të ndikimit të saj në Europë. Duke përdorur energjinë si instrument në politikën e saj të

jashtme, Rusia arrin t'i imponohet atyre vendeve të cilat kanë një varësi të lartë energjetike prej saj. Nëpërmjet këtij imponimi, Rusia cenon pavarësinë politike të këtyre vendeve, e cila mund të konsiderohet si kërcënim për sigurinë kombëtare. Ky është një tregues i implikimeve të sigurisë energjetike në sigurinë ndër/kombëtare. Por, që një varësi energjetike të konsiderohet si kërcënim, duhet që të perceptohet dhe artikulohet si e tillë nga aktorët, duke çuar në këtë mënyrë në krijimin e një 'energy security complex'. Nëse aktorët nuk e perceptojnë varësinë si negative, atëherë ajo nuk konsiderohet si kërcënim.

Ndikimi i Rusisë në Ballkan, mund të identifikohet si nëpërmjet analizës së diskurit të aktorëve, ashtu edhe nëpërmjet analizimit të të dhënave sasiore dytësore në këtë aspekt. Kompania Ruse Gazprom garanton rreth 95% të furnizimit me energji për disa nga shtetet Ballkanike, zotëron 51 % të 'Bosphorus Gaz Corporation' dhe 41 % të 'Turusgas' në Turqi, 50 % të 'Ovegaz Inc.' në Bullgari dhe 50 % të 'Prometheus Gas' në Greqi (Cehulic et.al., 2013: 120). Këto të dhëna tregojnë jo vetëm ndikimin 'nga jashtë' por edhe ndikimin 'nga brenda' të Rusisë në vendet e Ballkanit. Duke qenë aksioner në këto kompani, Gazpromi arrin të kontrollojë dhe politikat e ndjekura nga to, ku ruajtja e *status quos* në situatën energjetike në Ballkan (vazhdimësia e varësisë nga Rusia) është në interesin ekonomik dhe politik të Gazpromit e Rusisë. Për më tepër, nëpërmjet territorit të Ballkanit kalojnë një sërë gazsjellësish dhe janë projektuar të ndërtohen dhe disa të tjerë në vitet në vazhdim.

Kompanitë e tjera ruse si Lukoil dhe Gazprom Neft kontrollojnë një pjesë të konsiderueshme të sektorit të naftës në Ballkan, duke shtrirë aktivitetin e tyre në Bullgari, Rumani, Serbi, Kroaci, Mali Zi, Maqedoni dhe Turqi (Cehulic et.al., 2013: 120). Midis vendeve të Ballkanit, Shqipëria është i vetmi vend që nuk ka zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi me investitorët rus të gazit dhe naftës. Arsyet për këtë mungesë bashkëpunimi janë të pa qarta; mund të aludohet se kjo ka ardhur si pasojë e presionit të vendeve

Perëndimore për të minimizuar influencën Ruse në Ballkan, si pasojë e mos interesimit të kompanive Ruse për tregun energjetik në Shqipëri ose si mungesë e aftësisë së palës shqiptare për të hyrë në marrëdhënie me këto kompani. Të gjitha këto janë hipoteza të cilat kërkojnë një studim më të thellë të çështjes dhe nuk janë pjesë e qëllimit të këtij punimi. Gjithsesi, operimi i kompanive serbe në sektorin energjetik shqiptar, mund të përbëjë një ndikim të tërthortë të Rusisë në Shqipëri, duke marrë në konsideratë varësinë e kompanive serbe nga Rusia.

Përdorimi i energjisë si instrument në politikën e jashtme nga Rusia, është i dukshëm dhe në deklaratën e shefit ekzekutiv të Gazprom-it, pas vendimit për mbylljen e projektit South Stream, i cili deklaroi se: *“Parimet e strategjisë tonë në lidhje me tregun European po ndryshojnë... ky moment përbën ndryshimin e modelit të veprimit tonë në tregje, të cilin ne e kishim orientuar në furnizimin me gaz të konsumatorëve fundor në tregun European... Nuk mund të fitohet dashuria me forcë. Nëse blerësi nuk dëshiron që porosia t'i dërgohet në shtëpi, ndoshta ai duhet të vishet dhe të shkojë në dyqan, dhe nëse ndodh në dimër, duhet të vishet akoma më trashë”* (Miller, 2014: Paragrafi II-III). Kjo deklaratë ka implikim të drejtpërdrejtë në sigurinë energjetike në kontekstin European. Pavarësisht se ajo i drejtohet vendeve të BE-së, edhe vendet e Ballkanit mund të ndikohen nga ndryshimi i parimeve të strategjisë Ruse. Përdorimi i një diskuri të tillë nga ana e shefit ekzekutiv të Gazprom-it, në një kontekst të acaruar të marrëdhënieve midis Rusisë dhe vendeve Europiane përbën një kërcënim për sigurinë energjetike dhe atë ndër/kombëtare. Në këtë mënyrë, Rusia kërcënon nëpërmjet rritjes së çmimit të gazit, duke nxjerrë në pah dimensionin ekonomik dhe politik të sigurisë energjetike.

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë, Rusia humbi kontrollin ndaj vendeve dikur pjesë të Bashkimit Sovjetik. Nëse deri në atë periudhë, ideologjia, ekonomia dhe fuqia ushtarake

ishin ndër instrumentet kryesore të influencës, pas viteve '90 Rusia nuk mund të përdorte më asnjë nga këto instrumente. Në mungesë të tyre, duket se Rusia nisi të përdorë energjinë si instrument influence në politikën e saj të jashtëm ndaj këtyre vendeve. Efikasiteti i një politike të tillë varej dhe nga kontrolli shtetëror i sektorit të energjisë. Për këtë arsye, në vitin 2005 Putin zgjeroi kontrollin e Kremlinit mbi Gazprom-in (Goldman, 2008). Gazprom ka një rëndësi jetike pasi prodhon rreth 80 % të gazit natyror, kontrollon më shumë se 65 % të rezervave të gazit natyror dhe për më tepër ka kontrollin e tubacioneve ruse (Kamilla, 2015). Kontrolli shtetëror i kompanisë Gazprom, mund të shihet si një moment i sigurizimit të energjisë nga ana e Rusisë. Për më tepër, sulmet e Putin ndaj kompanisë Yukos dhe burgosja e Mikhail Khodorovsky-it, mund të shihen në vazhden e vendosjes së kontrollit shtetëror ndaj sektorit energjetik.

Në këtë mënyrë, Rusia arriti të vetë ofrohej si një alternative për vendet ish komuniste, përballë ofertës Europiane të mbështetur në terma të integritetit dhe mbështetjes ekonomike. Ruajtja e monopolit energjetik është një ndër arsyet kryesore e cila shpjegon mos ratifikimin e Traktatit të Komunitetit Energjetik nga Rusia, traktat i cili do të rregullonte çështjet e transitit të energjisë në bazë të parimeve të lirisë së tregut dhe mos diskriminimit, parime të cilat do të pengonin Rusinë për të përdorur energjinë si instrument në politikën e jashtme.

5.3. Implikimet e Trans Adriatic Pipeline (TAP) në sigurinë energjetike rajonale²³

Sipas faqes zyrtare të projektit²⁴, TAP është një projekt energjetik me një rëndësi të veçantë, i cili do të shërbejë për transportimin e gazit natyror nga rajoni i Kaspikut në drejtim të

23 Ky seksion mbështetet në: Morina, F. & Fuga, P. (2015). The importance of transit countries in ensuring EU energy security: the case of Balkan region. *European Journal of Research in Social Sciences*, 3 (4), 50-54. <http://www.idpublications.org/ejrss-vol-3-no-4-2015/>

tregut europian. Duke u lidhur me Trans Anatolian Pipeline (TANAP) në kufirin Greko-Turk, TAP do të kalojë nëpërmjet Greqisë veriore, Shqipërisë dhe Detit Adriatik deri në Italinë jugore ku do të lidhet me rrjetin Italian të gazit natyror. Projekti është akoma në fazën e implementimit dhe ndërtimi është planifikuar të nisë në 2016. “Rrjeti i gazsjellësve në korridorin jugor akoma duhet të ndërtohet, dhe e ardhmja e tij varet nga stabiliteti politik i vendeve nëpër të cilat ai kalon” (Nanay & Kalicki, 2013: 197). Në këtë mënyrë, siguria energjetike është e lidhur drejtpërdrejt me sigurinë politike, duke evidentuar edhe një herë ndërvlerësinë midis sektorëve të ndryshëm të sigurisë. Krijimi i ndërvlerësisë midis vendeve mund të ndikojë në intensifikimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit si një sistem i tërë. Në mungesë të harmonizimit të politikave midis vendeve, shanset për bashkëpunim mund të pengohen nga ndjekja e politikave konfliktuale. Prandaj është e nevojshme që aktorët të ndërjegjësohen se përfitimet nga bashkëpunimi janë në interes të të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë marrëdhënie.

Projekti TAP ishte një ndër projektet konkurruese të Korridorit Jugor të Gazit, të cilat do të ndikonin në diversifikimin e energjisë në BE. Ky korridor përfshinte fillimisht tre gazsjellës kryesor: Interkonektorin Turqi-Greqi-Itali (Interconnector Turkey-Greece-Italy – ITGI), TAP dhe Nabucco. Nabucco do të ishte një gazsjellës me një gjatësi prej 3.300 km, me një kapacitet rreth 31 miliard metër kub në vit prej Azisë Qendrore duke kaluar nëpërmjet Turqisë, Rumanisë, Bullgarisë dhe Hungarisë në Austri në vitin 2020 (Kamilla, 2015).

Ky gazsjellës do të transportonte gaz natyror drejtë Europës Qendrore, duke anashkaluar Rusinë. Në këtë mënyrë do të reduktohej varësia e këtij rajoni nga gasi rus duke pasur kështu një rëndësi gjeopolitike dhe mbështetjen e BE-së. Mos realizimi i këtij projekti

erdhi si pasojë e faktorëve ekonomik dhe politik. Përkrahja e Hungarisë për projektin e ri të Rusisë shërbeu si një ndër faktorët themelor politik, duke çuar në ri konceptimin e projektit fillestar dhe krijimin e projektit Nabucco West dhe TANAP (Kamilla, 2015). Nabucco West dhe TAP, mbetën në këtë mënyrë dy projektet konkurruese për transportimin e gazit natyror nga rajoni i Kaspikut në drejtim të vendeve të Europës. Përzgjedhja e projektit fitues nga ana e Azerbajxhanit dhe konsorciumit të Shah Deniz, u bë duke krahasuar një sërë parametrash si mundësitë e tregut, koha e ndërtimit, kapaciteti dhe çështjet politike.

Tabela 5: Treguesit kryesor të Nabucco West dhe TAP

Key Features	Nabucco West	TAP
Length	1329 km	867 km
Capacity	10-23 bcma	10-20 bcma
Estimated cost	2.7 bilion \$	1.5 bilion \$
Construction to begin	2013	2013
Gas to be delivered by	2018	2019
Transit Countries	Bulgaria, Romania, Hungary (Austria)	Greece, Albania, (Italy)
Partners and owners	OMV (24%), MOL (17%), Transgaz (17%), Bulgargaz (17%), BOTAS(17%), GDF (9%)	BP (20%), SOCAR (20%), Statoil (20%), Fluxys (16%), Total (10%), E.ON (9%), Axpo (5%)

Burimi: Kamilla, 2015

Në fund të procesit, TAP u shpall si projekti fitues i cili argumentohet se do të ketë implikime të drejtpërdrejta për vendet të cilat ai përshkon, duke rritur investimet e huaja direkte dhe duke nxitur zhvillimin ekonomik (Kamilla, 2015). Të ndërgjegjshëm për përfitimet që mund të vijnë nga një projekt i tillë, vendet transit (Shqipëria, Italia dhe Greqia) kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në mbështetje të këtij projekti.

Arsyet e përzgjedhjes së këtij projekti, mund të klasifikohen në:

- Arsye ekonomike – të lidhura si me koston e ndërtimit ashtu edhe me çmimin e shitjes së gazit natyror. Sikurse vihet re dhe në tabelën e mësipërme, kosto e ndërtimit të TAP përllogaritet në rreth 50 % më pak krahasuar me Nabucco West. Gjithashtu, duke qenë se Nabucco West do të lidhej në Austri me tregun energjetik europian ku çmimet janë më të ulëta, në ndryshim nga TAP i cili do të lidhet në Itali ku çmimet janë më të larta, atëherë çmimi i shitjes së gazit natyror mund të konsiderohet si një arsye e rëndësishme në përzgjedhjen e projektit TAP.
- Arsye politike – vendet transit të projektit TAP ofrojnë një garanci më të madhe të stabilitetit politik, krahasuar me vendet transit nga të cilat do të kalonte projekti Nabucco West, në të cilat ndikimi i Rusisë është më i ndjeshëm.
- Arsye gjeopolitike – Rusia ishte shprehur kundër projektit Nabucco West, krahasuar me projektin TAP, pasi Nabucco përbënte cenim të drejtpërdrejtë të interesave Ruse duke qenë se do të kalonte në një territor ku influenza Ruse mbetet akoma e lartë.

Në këtë mënyrë, projekti TAP është një arritje e rëndësishme në rrugën e diversifikimit të burimeve energjetike dhe uljen e varësisë së Bashkimit Europian nga Rusia. TAP gjithashtu është një arritje e rëndësishme për vendet transit nëpërmjet të cilave ajo kalon, por varësia e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore do të vijojë të mbetet e lartë duke vijuar të përbejë një kërcënim për sigurinë energjetike në kontekstin Europian. Avancimi i mëtejshëm i projektit TAP, nëpërmjet implementimit të projektit IAP (Ionian Adriatic Pipeline) dhe ndërtimit të infrastrukturës depozituese në Shqipëri, përbën një domosdoshmëri në funksion të uljes së varësisë energjetike të Europës Juglindore nga Rusia, e cila do të reduktonte influencën ruse në këtë rajon.

TAP, si pjesë e korridorit jugor të gazit, do të ofrojë një rrugëkalim direkt dhe me kosto efektive të transportit të gazit nga Deti Kaspik në Europë. TAP është një projekt në të cilin janë përfshirë një sërë kompanish të rëndësishme si SOCAR, Statoil, BP, Fluxys, Enagas dhe Axpo. Kapaciteti fillestar i këtij projekti do të jetë 10 bcm në vit, i cili është projektuar të dyfishohet me kalimin e kohës. “Pavarësisht se gazi nga Azerbajxhani ka gjasa të konkurrojë Gazprom-in në Europën Juglindore & Qendrore dhe në Ballkan, Statoil synon të transportojë pjesën më të madhe të gazit nga Turqia në Itali nëpërmjet projektit TAP” (Nanay & Kalicki, 2013: 196). Përveç rëndësisë që TAP do të ketë për tregun europian, ky projekt do të ketë ndikim dhe në vendet transit. Greqia, Shqipëria dhe Italia do të kenë përfitime strategjike nga TAP, duke siguruar një pozitë të rëndësishme në hartën europiane të energjisë. Përfitimet do të jenë dhe në nivele të tjera, sikurse në të ardhurat nga taksat, punësimet dhe investimet në zonat ku do të kalojë projekti. Për Shqipërinë TAP do të jetë Investimi i Huaj Direkt më i madh deri në këto momente dhe gjithashtu do të ndikojë në integrimin në BE nëpërmjet rritjes së rëndësisë rajonale dhe gjeostrategjike. TAP gjithashtu mund të ndikojë në përmirësimin e tregut të brendshëm të energjisë në Shqipëri.

Një projekt i tillë do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në diversifikimin e burimeve energjetike të BE-së dhe në uljen e varësisë nga gazi rus, element të domosdoshëm për rritjen e nivelit të sigurisë energjetike për BE-në. Kjo nuk nënkupton se BE do të jetë e pavarur nga gazi rus në të ardhmen, por mund të shërbejë si një instrument për të negociuar çmimet, për të zbehur monopolin dhe influencën e Rusisë, sikurse do të ndikonte në të njëjtën kohë në rritjen e rëndësisë gjeopolitike të Ballkanit. Reduktimi i rezervave të gazit në Detin e Veriut, si një ndër burimet kryesore të energjisë për Europën, e bën të domosdoshme diversifikimin e burimeve të energjisë dhe rajoni i Kaspikut mund të luajë një rol primar në këtë drejtim.

Projektet energjetike të planifikuara, të cilat do të transportojnë gazin e këtij rajoni drejtë Europës, do të kalojnë nëpërmjet territorit të Ballkanit. Kjo do të sillte rritjen e rolit dhe rëndësisë së Ballkanit në hartën energjetike europiane. Këto projekte do të kenë implikime në dy aspekte kryesore, implikime gjeopolitike dhe implikime ekonomike. Implikimet gjeopolitike lidhen me rritjen e rëndësisë së Ballkanit për BE-në, gjë e cila do të shërbejë si një shtysë për një afrim akoma e më të madh midis dy palëve duke shkuar drejtë integritit të plotë. Nga ana tjetër, lidhur me aspektet ekonomike duhet të theksojmë se pozita si vende transit të vendeve të Ballkanit, do të shoqërohet me të ardhura të drejtpërdrejta si pasojë e taksave, aksesit në një burim energjie me një çmim më të favorshëm, punësimet afatmesme dhe afatgjata, etj. Implikimet gjeopolitike dhe ekonomike do të shoqërohen me ndikim të drejtpërdrejtë dhe në aspekte të tjera të lidhura me stabilitetin, zhvillimin dhe mirëqenien e këtyre vendeve.

Situata në Ukrainë dhe pasojat që ajo ka për garantimin e sigurisë energjetike për Europën mund të shërbejë për rritjen e vëmendjes së BE-së për rëndësinë e vendeve transit të energjisë. Për BE-në tashmë është e qartë se siguria e infrastrukturës së transportit të energjisë, si një ndër elementët kryesor në garantimin e sigurisë energjetike, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me stabilitetin e vendeve nga ku kalon kjo infrastrukturë, me problemet politike, ekonomike, sociale dhe mjedisore të tyre. Duke marrë në konsideratë gjithë këto elemente, BE duhet të tregohet e kujdesshme në marrëdhëniet me vendet e Ballkanit dhe një strategji e qartë dhe realiste integruese do të shërbente si një instrument shumë i rëndësishëm në këtë drejtim. Në këtë mënyrë, BE do të mundësonte zbehjen e influencës Ruse në këtë rajon. Një kompozim i tillë gjeopolitik, do të përmirësonte si pozitën e BE-së ashtu edhe të Ballkanit në arenën ndërkombëtare, me implikim të drejtpërdrejtë në garantimin e sigurisë energjetike për BE-në.

Strategjia e Rusisë si furnizuesi kryesor i energjisë, për të ruajtur pozitën e saj monopol në rajon dhe për ta përdorur si instrument në sferën politike, dhe dobësia e BE-së për t'iu kundërvënë influencës Ruse janë faktorë të rëndësishëm që kanë ndikuar në situatën energjetike në Ballkan (Ralchev, 2012). Përtej problematikave, vendet e rajonit kanë disa avantazhe gjeostrategjike, të cilat nuk janë shfrytëzuar akoma siç duhet. Ballkani shtrihet në një zonë e cila shërben si urë lidhëse midis vendeve prodhuese të energjisë dhe vendeve europiane të cilat janë konsumatorë të rëndësishëm të produkteve energjetike. Avancimi në rrugën drejtë integritit në BE dhe ndërtimi i gazsjellësve të planifikuar të cilat do të reduktojnë ndikimin Rus në këtë rajon, do të kenë implikime të drejtpërdrejta si për vendet e Ballkanit ashtu dhe për BE-në.

Sistemi energjetik në vendet e Ballkanit, i cili vazhdon të jetë në pjesën dërrmuese të tij monopol shtetëror, është shumë i varur nga kushtet atmosferike dhe ka nevojë për investime të cilat i tejkalojnë mundësitë reale të këtyre vendeve. Për këtë arsye privatizimet, liberalizimi i tregut, bashkëpunimi rajonal, ndihma e BE-së dhe SHBA-së, dhe investimet e huaja do të shërbenin si instrumente efikas për përmirësimin e kësaj situate. Për vendet perëndimore duhet të jetë e qartë se e vetmja mënyrë për reduktimin e influencës Ruse në këtë rajon është një angazhim më konkret dhe i prekshëm i tyre, ku ndihma në garantimin e sigurisë energjetike do të luante një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim. Me qëllim garantimin e sigurisë energjetike, vendet e Ballkanit duhet të forcojnë dhe kapacitetet e tyre të brendshme prodhuese.

Rafineritë kryesore të naftës në këtë rajon janë të lokalizuara në Kroaci dhe Serbi. Shqipëria dhe Maqedonia kanë gjithashtu rafineri të prodhimit të naftës, sikurse dhe Bosnje-Hercegovina që ka një rafineri e cila zotërohet nga rusët. Nafta importohet nga Rusia nëpërmjet tubacionit Druzhba dhe në rrugë detare ndërsa gazi nëpërmjet gazsjellësve që

kalojnë në Bullgari nga lindja dhe në Hungari nga veriu. Këto janë tregues të varësisë energjetike të vendeve ballkanike nga Rusia, varësi e cila përkthehet dhe në një varësi të konsiderueshme politike dhe ekonomike. Rusia e ka implementuar strategjinë e saj nëpërmjet kërcënimit për ndërprerjen e furnizimit me energji, investimet në sektorin energjetik, financimin e partive politike apo individëve të caktuar (Ralchev, 2012). Nëpërmjet kësaj strategjie Rusia arrin të ruajë dhe të forcojë influencën e saj në këtë rajon, si në sferën energjetike ashtu dhe në atë ekonomike dhe politike.

Duke ndjekur një politikë të tillë kundrejt këtij rajoni, Rusia arrin të garantojë praninë e saj në Ballkan, të ruajë dhe forcojë pozitat e saj monopol në sektorin energjetik, të pengojë liberalizimin e tregut dhe diversifikimin e burimeve energjetike në vendet Ballkanike. Kalimi i TAP nëpër territoret e Ballkanit nuk nënkupton një zgjidhje të këtyre problematikave. Nëse projekti nuk avancon më tej nëpërmjet lidhjeve me projekte të tjera energjetike, atëherë rëndësia e tij për vendet Ballkanike do të jetë më minimale dhe nga ana tjetër vendet e Europës Lindore dhe Qendrore do të mbeten nën varësinë energjetike të Rusisë, duke mos pasur akses në burimet energjetike të Rajonit Kaspik.

Figura 10: Korridori Jugor i Gazit



Burimi: TAP (<http://www.tap-ag.com/the-pipeline>).

Për të tejkaluar këto problematika, vendet e Ballkanit dhe BE duhet të bashkëpunojnë në mënyrë intensive dhe strategjike, gjë e cila do të shoqërohej me përfitime reciproke për të dyja palët. Ndër hapat kryesor që duhet të ndërmerren në këtë drejtim janë: Së pari, operacionalizimi i Korridorit Jugor të Gazit, pjesë e të cilit është edhe TAP. Kjo nënkupton që ky korridor të lidhet jo vetëm me burimet energjetike të rajonit Kaspik por edhe me burimet e Lindjes së Mesme dhe Mesdheut. Së dyti, ndërtimi i infrastrukturës magazinuese të gazit natyror në Shqipëri, lidhja e TAP me rrjetet rajonale dhe gazifikimi i sektorit energjetik në këtë vend. Ndërtimi i Ionian Adriatic Pipeline (IAP), i cili është projektuar për t'u lidhur me TAP do të kishte implikime jo vetëm në sigurinë energjetike të BE-së, por edhe në sigurinë e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore. Në këtë mënyrë, varësia e tyre nga burimet ruse do të ulej ndjeshëm, gjë e cila nënkupton dhe një minimizim të influencës ruse në këto vende.

Turqia është një ndër aktorët kryesor energjetik në Ballkan, pozita e së cilës do të fuqizohet me operacionalizimin e korridorit jugor. “E pozicionuar në afërsi të rajoneve të pasura me burime energjetike, e përshtatshme si vend transit drejtë tregjeve europiane për shkak se është një vend anëtar i NATO-s... Turqia është përkushtuar ekonomikisht dhe politikisht në këtë projekt” (Bak, 2014: 6). Nëpërmjet këtij ‘investimi’, Turqia arrin të garantojë sigurinë e saj energjetike por edhe të fuqizojë rolin e saj brenda rajonit por edhe më gjerë. Duke kombinuar instrumentet ekonomik, kulturor dhe energjetik, Turqia do të mund të jetë akoma edhe më prezente në rajon, i cili është një ndër qëllimet kryesore të saj në politikën e jashtme.

Pavarësisht se BE duhet të jetë më prezente në sektorin energjetik në Ballkan, ajo ka marrë disa hapa konkrete në këtë drejtim të cilat do të kenë ndikim në perspektivën afatgjatë të rajonit por dhe të vetë BE-së. Traktati i Komunitetit Energjetik i 2005, i cili u firmos si

pjesë integrale e Procesit të Athinës, është një moment i rëndësishëm në këtë drejtim. Synimi i tij është krijimi dhe vendosja e rregullave të njëjta për tregun energjetik në rajon, duke e përgatitur për t'u bërë pjesë e tregut europian të energjisë.

5.4. Drejtë integritit energjetik rajonal apo vazhdimësi e fragmentarizmit?

Në Tetor 2005, nëpërmjet një traktati ndërkombëtar i cili hyri në fuqi në Korrik 2006, u krijua Komuniteti energjetik. Qëllimi kryesor i këtij komuniteti është shtrirja e politikave energjetik të BE-së në vendet jo anëtare (Riley, 2013). Traktati i Komunitetit Energjetik u nënshkrua midis Bashkimit Europian dhe vendeve të Europës Jug-Lindore; Shqipërisë, Kosovës, Kroacisë, Bosnje-Hercegovinës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Objektivi i tij është “vendosja e një kornize rregullatore të përbashkët për një treg rajonal të liberalizuar bazuar në modelin Europian” (Riley, 2013: 3). Nevoja e krijimit të një Komuniteti Energjetik në Europën Jug-Lindore, vinte si pasojë e karakteristikave të sektorit energjetik në këto vende, për pasojë dhe nivelit të sigurisë energjetike. Si një rajon i përfshirë nga konflikte në periudhën e pas viteve '90 dhe krijimit të shteteve të reja pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë, sektori energjetik karakterizohet nga një fragmentarizim i thellë me pasoja në sigurinë energjetike ndër/kombëtare. Këto problematika, të cilat përbëjnë kërcënim për sigurinë energjetike të BE-së, i hapën rrugë abuzimeve të brendshme dhe ndikimit të aktorëve të jashtëm, si Rusia e cila e pa si mundësi për të shtrirë influencën e saj në këtë rajon.

Për të tejkaluar këto problematika, nëpërmjet krijimit të këtij Komuniteti synohet të nxitet komunikimi dhe integrimi midis këtyre vendeve, nëpërmjet një qasje neo funksionaliste (Deitz et.al, 2008). Bashkëpunimi në sektorin energjetik, në terma të bashkëpunimit ekonomik, mund të shihet si zanafilla drejtë intensifikimit të bashkëpunimit

politik ndërmjet vendeve, duke u përgatitur në këtë mënyrë për stadin final të integritit, integritit në Bashkimin Europian. Për të mbështetur aspiratat e integritit europian të këtyre vendeve, një sërë organizmash ndërkombëtare sikurse dhe shtete të ndryshme janë përfshirë në këtë proces. Sektori energjetik dhe çështjet e lidhura me energjinë në tërësi, kanë qenë në fokusin e këtyre aktorëve. “Siguria e furnizimit dhe përmirësimi i balancës ndërmjet furnizimit dhe kërkesës për energji janë thelbësore për zhvillimin ekonomik të këtij rajoni” (Deitz et.al, 2008: 4). Kalimi nga ekonomia e centralizuar drejtë ekonomisë së tregut, nëpërmjet reformave neo liberale u shoqërua me një sërë problematikash të cilat ndihen akoma dhe në këtë periudhë, duke penguar në këtë mënyrë procesin e reformimit të sektorit energjetik në veçanti dhe integritit europian në tërësi.

Projektet dhe iniciativat komunitare për këtë rajon kanë qenë të shumta, ku ndër më kryesoret mund të përmendim Iniciativën e Bashkëpunimit të Europës Jug Lindore të 1995 (South East European Cooperative Initiative – SECI), Procesi i Bashkëpunimit të Europës Jug Lindore të 1996 (South East European Cooperative Process – SEECP), Pakti i Stabilitetit i vitit 1999, Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit dhe fondet IPA. Të gjithë këto mekanizma kishin si qëllim promovimin e sigurisë dhe zhvillimit rajonal. Por realiteti ka dëshmuar se këto iniciativa nuk kanë arritur të tejkalojnë problematikat e këtyre vendeve, kryesisht të problematikave të lidhura me çështjet e energjisë. Kjo ka ardhur si pasojë e faktit se “zhvillimi i politikave energjetike konkrete në vendet në tranzicion është vonuar si pasojë e konkurrencës nga reformat urgjente në fushat e tjera. Kushtet paraprake të programeve financiare të donatorëve do të ndikojnë në mënyrën e kryerjes dhe prioritizimit të reformave në të ardhmen” (Deitz et.al, 2008: 4). Duke i dhënë prioritet reformave të lidhura me sektorët e tjerë politik, juridik, ekonomik dhe social, këto vende nuk kanë arritur të prioritojnë çështjet e lidhura me sigurinë energjetike, duke mos i përfshirë ato në

procesin e sigurizimit. Kjo ka bërë që problematikat jo vetëm të mos gjenin zgjidhje por edhe të thelloheshin me kalimin e kohës. Sigurizimi i çështjeve energjetike për rajonin mund të vijë si pasojë e dy faktorëve kryesorë. Faktori i parë lidhet me ndërgjegjësimin e vendeve për rëndësinë e sigurisë energjetike dhe implikimet e saj në sigurinë ndër/kombëtare. Duke perceptuar varësinë energjetike si kërcënim dhe diversifikimin si prioritet, vendet e rajonit (si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal) do të siguronin çështjet e energjisë. Në pritje të ndërgjegjësimin, aktorët e tjerë dhe kryesisht BE-ja mund të ndikojnë në përshtetimin e këtij procesi nëpërmjet vendosjes së parakushteve për mbështetjen financiare dhe aspiratat integruese në këmbim të sigurizimit të çështjeve energjetike, çka do të përbënte dhe faktorin e dytë. Krijimi i Komunitetit Energjetik mund të shihet si një nismë nën këtë këndvështrim.

Situata aktuale, sikurse dhe historia, dëshmon se këto vende do të arrijnë më shpejtë sigurizimin e çështjeve energjetike nëpërmjet ndikimit të faktorit të dytë. Arsye përse faktori i parë, vet ndërgjegjësimi, nuk ka arritur të përmbushë nevojën për sigurizimin e çështjeve energjetike lidhet me faktorë të tillë si:

- Së pari, e kaluara historike problematike e lidhur me ndryshimin e sistemeve qeverisëse, tranzicionin dhe konfliktet e shumta, e komplikuan situatën e këtyre vendeve, duke bërë që të prioritizoheshin çështje të tjera dhe jo çështjet e lidhura me energjinë.
- Së dyti, këto problematika patën impakt të drejtpërdrejt në sektorin energjetik si pasojë e treguesve të ulët ekonomik, dëmtimit të infrastrukturës energjetike ekzistuese e cila mbështetet në një teknologji të vjetruar, nivelit të lartë të korrupsionit dhe reformave jo të përshtatshme.
- Së treti, mungesa e ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e energjisë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe implikimit të sigurisë energjetike në sigurinë ndër/kombëtare kanë

penguar sigurizimin e këtyre çështjeve. Mungesa e ndërgjegjësimit dhe vizionit vihet re si nga analiza historike e këtij procesi ashtu edhe nga analiza e dokumenteve strategjike të kaluar.

- Së katërti, mos sigurizimi i çështjeve energjetike në rajonin e Ballkanit, si në nivel rajonal ashtu edhe kombëtar ka ardhur si pasojë e qasjeve dhe perceptimeve të ndryshme të këtyre vendeve ndaj varësisë energjetike. Ky është dhe faktori me ndikimin më të rëndësishëm lidhur me mos sigurizimin e çështjeve të energjisë. Sikurse u analizua dhe më lart, vendet e Ballkanit karakterizohen nga problematika të ngjashme në sektorin e energjisë, ku nevoja për diversifikimin e burimeve është e pranishme në të gjitha rastet. Ky rajon varësinë më të lartë energjetike e ka nga burimet e Rusisë, por për shkak se perceptimi i tyre i marrëdhënieve me të është i ndryshëm, atëherë nuk është arritur të krijohet një ‘energy security complex’. Për shkak të mos perceptimit të varësisë nga Rusia si varësi negative nga pjesa më e madhe e vendeve të Ballkanit, pengon sigurizimin e kësaj çështje.

Për më tepër, sigurizimi i energjisë nëpërmjet diversifikimit përveç dimensionit politik ka dhe një dimension ekonomik. Duke qenë se këto vende karakterizohen nga tregues ekonomik të ulët, atëherë kapacitetet e tyre për të përmbushur këtë objektiv janë relativisht të kufizuara. Në këtë mënyrë, sigurizimi i çështjeve energjetike në rajonin e Ballkanit duhet mbështetur më shumë në ndikimin e aktorëve të jashtëm sesa në ndërgjegjësimin e aktorëve të rajonit dhe kryesisht në ndërthurjen e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Krijimi i Komunitetit Energjetik shërben si një platformë e rëndësishme në këtë drejtim, por nuk është akoma në nivelin optimal. Intensifikimi i bashkëpunimit rajonal, brenda këtij Komuniteti do të shoqërohet me implikime të dyfishta. Nga njëra anë vendet e Ballkanit do të rrisin nivelin e sigurisë energjetike dhe nga ana tjetër përfitimi do të jetë

reciprok edhe për BE-në. Pozita gjeografike dhe e ardhmja e tyre brenda BE-së, janë element thelbësor që përcaktojnë rëndësinë e rajonit të Ballkanit për BE-në në funksion të garantimit të sigurisë energjetike.

5.5. Konkluzione

Në këtë kapitull zhvillohet niveli i dytë i analizës, i fokusuar në situatën e sigurisë energjetike në rajonin e Ballkanit. Gjetjet kryesore të këtij kapitulli fokusohen në:

- Treguesit energjetik – Ky rajon ka një të kaluar problematike (tranzicioni dhe konfliktet etnike) e cila ka lënë gjurmë dhe në zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturën energjetike të këtyre vendeve. Rajoni i Ballkanit karakterizohet nga tregues energjetik problematik për shkak të:
 - Varësisë së lartë nga importi, kryesisht nga Rusia dhe mbështetjes tek një numër i kufizuar burimesh (llojesh) energjetike, çka përbën një problem në ‘energjinë mix’.
 - Infrastrukturës dhe teknologjisë së vjetërsuar sikurse dhe reformat problematike, korrupsioni dhe humbjet teknike dhe jo teknike.
- Ndikimin e aktorëve të jashtëm – aktorët kryesor që ndikojnë më shumë në situatën e sigurisë energjetike në rajonin e Ballkanit janë Rusia dhe Bashkimi Europian. Rusia përdor energjinë si instrument ndikimi në politikën e saj të jashtme, për shkak të kontrollit dhe ndikimit që ka në këtë rajon. Ndërsa BE-ja ndikon në Ballkan nëpërmjet fuqisë së butë; nëpërmjet asistencës financiare, teknike dhe perspektivës integruese të rajonit në BE.
- Pozitën gjeografike - Rajoni i Ballkanit ka një rëndësi të veçantë si për Europën ashtu edhe për Rusinë, për vetë pozitën e tij gjeostrategjike duke qenë një urë lidhëse

midis rajoneve të ndryshme të botës. Për këtë arsye, si avantazhet ashtu edhe disavantazhet e këtyre vendeve, kanë implikime të drejtpërdrejta përtej kufijve gjeografik të këtij gadishulli. Rajoni i Ballkanit ka një rëndësi të veçantë për BE-në, pasi shërben si rajon transit i infrastrukturës energjetike (projekti TAP) e cila do të ndikojë në diversifikimin e burimeve energjetike të BE-së, duke ndikuar në nivelin e sigurisë energjetike. Për më tepër, rajoni i Ballkanit përbëhet nga vende anëtare dhe kandidatë për anëtarësim në BE, duke rritur akoma më shumë rëndësinë e tij. Nga ana tjetër, për shkak të pozitës së tij gjeografike, historisë dhe lidhjeve socio-kulturore, rajoni i Ballkanit tradicionalisht ka qenë në vëmendjen e Rusisë. Duke qenë një ndër prodhuesit kryesorë të naftës dhe gazit në rang botëror, Rusia e sheh me një interes të veçantë rajonin e Ballkanit si një urë lidhëse për transportin e energjisë së saj drejt tregut europian. Rusia e përdor Ballkanin si një instrument të ndikimit të saj në Europë. Duke përdorur energjinë si instrument në politikën e saj të jashtme, Rusia arrin t'i imponohet atyre vendeve të cilat kanë një varësi të lartë energjetike prej saj.

- Nivelin e sigurizimit të çështjeve energjetike dhe ‘energy security complex’ – Si pasojë e problematikave historike dhe periudhës së tranzicionit, vendet e Ballkanit nuk kanë arritur të sigurojnë çështjet energjetike. Duke krahasuar mundësitë e një sigurizimi që vjen nga ‘jashtë’ me atë që mund të vijë nga ‘brenda’, rruga më e përshtatshme do të ishte nëpërmjet ndikimit të ‘jashtëm’ por gjithmonë të ndërthurur me ndikimin e ‘brendshëm’. Krijimi i Komunitetit Energjetik shërben si një platformë e përshtatshme në këtë drejtim. Për më tepër, perceptimet e ndryshme të vendeve të Ballkanit ndaj varësisë energjetike nga Rusia, kanë penguar krijimin e një

‘energy security complex’, i cili do të kishte ndikuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë energjetike për rajonin e Ballkanit në tërësi.

Kapitulli VI: Siguria energjetike në Shqipëri

Situata energjetike në Shqipëri, sikurse në pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit, vijon të mbetet problematike si pasojë e periudhës së tranzicionit, vështirësive ekonomike dhe mungesës së reformave të përshtatshme për tejkalimin e problematikave. Kufizimet e brendshme të lidhura me resurset energjetike të kufizuara ose të keq përdorura, nuk kanë arritur të tejkalohen nëpërmjet ndjekjeve të strategjive afatgjata efikase të lidhura kryesisht me diversifikimin. Infrastruktura energjetike e vjetruar, niveli i ulët i modernizimit, kapacitetet e kufizuara prodhuese, mungesa e diversifikimit të burimeve dhe llojeve energjetike, humbjet e larta teknike dhe jo teknike, treguesit e ulët ekonomik, niveli i lartë i korrupsionit dhe reformat jo të përshtatshme të privatizimit janë disa ndër shkaqet kryesore të cilat kanë përcaktuar situatën energjetike në Shqipëri.

Por cilat janë karakteristikat e sektorit energjetik? Cilat janë potencialet e vendit? Cilat janë strategjitë e hartuara dhe implementura në këtë sektor? Çfarë vendi zënë çështjet energjetike në diskurin dhe dokumentet strategjik kryesor? Cili është niveli i sigurizimit të energjisë në Shqipëri dhe cilët kanë qenë faktorët pengues apo promovues të këtij procesi? Të gjithë këto momente, të cilat do të trajtohen në seksionet vijuese të kapitullit, kanë një rëndësi të veçantë për të identifikuar dhe analizuar situatën e sigurisë energjetike në Shqipëri dhe implikimet rajonale të saj.

6.1. Analizë e situatës energjetike në Shqipëri


6.1.1. Treguesit kryesor energjetik në Shqipëri

Për të analizuar situatën energjetike në Shqipëri është e nevojshme të ndalemi në dy momente kryesore; tek treguesit kryesor energjetik dhe karakteristikat e këtij sektori. Të dhënat për këtë seksion mbështeten kryesisht te IEA, INSTAT dhe Strategjia Kombëtare e

Energjisë. Treguesit kryesor energjetik lidhen me prodhimin e energjisë, konsumin e saj dhe balancat e përgjithshme të energjisë. Të dhënat mbi treguesit energjetik të Shqipërisë paraqiten në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tabela 6: Treguesit kryesor energjetik në Shqipëri

<i>Mtoe</i>	Prodhimi Energjisë	Importi Neto	Import	Export	Konsumi Total Final	GDP/KWh	Konsumi Importit neto (%)
<i>Shqipëria</i>	1.49	0.71	1.5	0.8	1.93	11.6	36.8



Sikurse vihet re nga tabela dhe grafiku i mësipërm, prodhimi i energjisë në Shqipëri bazohet mbi burime të tilla si nafta bruto dhe burimet hidrike. Shqipëria karakterizohet nga vlera të larta të importit dhe nga një nivel i ulët i eksportit të produkteve energjetike. Importi mbizotërohet nga nafta dhe nënproduktet e saj, ndërsa eksporti mbizotërohet nga nafta bruto. Si prodhimi i energjisë ashtu edhe vlerat e import/eksportit janë në nivel të ulët duke qenë se flitet për një vend në zhvillim. Treguesit energjetik janë tregues për zhvillimin e një vendi.

Bazuar në të dhënat e SKE, Shqipëria ka këto rezerva energjetike:

- **Hidroenergja** – Shqipëria është një vend me pasuri ujore të konsiderueshme në raport me popullsinë. Edhe pse rreth 98% e energjisë elektrike prodhohet nga hidrocentralet, deri tani është shfrytëzuar vetëm 35 % e potencialit hidroenergjetik të vendit. Kapaciteti hidroenergjetik ekzistues i instaluar është rreth 1433 MW. Rezervat totale të hidroenergjisë mundësojnë instalimin e një fuqie prej rreth 4500 MW dhe potenciali vjetor i prodhimit mund të arrijë në rreth 16-18 TWh.
- **Hidrokarburet** - Rezervat gjeologjike të vendburimeve të vendit vlerësohen rreth 437 Milion ton naftë. Në varësi të natyrës së rezervuarit natyror të vendburimeve të naftës rezulton se, në vendburimet ranore janë depozituar 77,7% të rezervave totale gjeologjike. Deri tani janë nxjerrë rreth 50 milion ton dhe ndodhen ende në nëntokë edhe rreth 386 milion ton naftë (rezerva gjeologjike). Rezervat e gazit në vendburimet e njohura të gazit natyror e të naftës të vendit tonë llogariten të jenë 3 miliardë e 630 milion m³N. Ato i përkasin vendburimeve të gazit natyror dhe vendburimeve të naftës e gazokondensatit në trajtën e gazit të tretur në naftë apo të kondensuar dhe të gazit të lirë në kapelet gazore të disa vendburimeve.
- **Qymyri** - Qymyret e vendit kanë fuqi kalorifike që varion nga 2000 kkal/kg në 3000 kkal/kg dhe nxirren nga një thellësi që shkon deri në 300m, me trashësi shtrese 0.7-1m. Rezervat e parashikuara të qymyrit janë 794 milionë ton. Ato përqendrohen kryesisht në zonën e Tiranës, me rreth 86% të rezervave, në zonën e Korçë-Pogradecit me 10% dhe në zonën e Memaliajt me 4%. Përdorimi i qymyrit të vendit në të ardhmen e afërt nuk është parashikuar, për arsye të kostos së lartë të përfitimit të tij dhe karakteristikave fiziko-kimike jo të favorshme. Sidoqoftë, nisur nga rezervat e limituara të hidrokarbureve në botë, opsioni i përdorimit të qymyrit të importit, për

nevojat energjetike është lënë i hapur. Natyrisht, që përdorimi i tij do të bëhet duke respektuar rregulla të forta mjedisore të impianteve, që do të përdorin këtë lëndë energjetike.



- ***Energjitë e rinovueshme*** - Shqipëria ka potenciale të konsiderueshme të burime të rinovueshme.
 - *Energjia nga burimet hidrike.* Në fushën e HEC-ve të vegjël është duke u punuar me intensitet për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve hidrike (HEC-et e vegjël dhe të mesëm), por gjithashtu dhe për rritjen e mundshme të kapaciteteve të atyre ekzistuese. Aktualisht, janë paraqitur shumë projekt-propozime të pa kërkuara për ndërtim hidrocentralesh të vegjël me koncesion. Janë miratuar 112 kontrata koncesionare për HEC, me fuqi të instaluar totale prej rreth 1740 MW.
 - *Energjia Diellore* në vend shfrytëzohet kryesisht për prodhimin e ujit të ngrohtë dhe fare pak për prodhim energjie elektrike. Ajo shfrytëzohet kryesisht në shtëpitë e veçuara si dhe në hotele, pranë zonave bregdetare. Potenciali teorik për shfrytëzimin e energjisë diellore shkon nga 1200 kWh/m² në pjesën verilindore deri në mbi 1600 kWh/m² në zonën e Myzeqesë. Nga një vlerësim i ditëve me diell rezulton, se Shqipëria ka një mesatare të orëve me diell në të gjithë vendin me rreth 2400 orë/vit. Kurse, në zonën e Fierit, janë regjistruar dhe rreth 2815 orë/vit me diell.
 - *Energjia e Erës* është duke u studiuar në Shqipëri nga kompani të ndryshme, të cilat kanë marrë autorizime për studimin e zonave të ndryshme të vendit tonë. Nga vlerësimet paraprake konstatohet, se erëra me shpejtësi mbi 5 m/s për lartësinë 10 m, rezultojnë të jenë rreth 2200 orë, kurse për lartësitë nga 50

deri 75 m orë në vit, me shpejtësi mbi 5 m, rezultojnë të jenë rreth 3000 orë. Është konstatuar, se vendet më të përshtatshme për ndërtimin e parqeve me erë, për prodhimin e energjisë elektrike janë zona bregdetare, duke filluar nga Lezha deri në Butrint, Gryka e Vjosës, Masivi malor Qendror dhe zona e Devollit. Deri në tremujorin e parë të vitit 2012, nga ERE dhe nga METE, janë licencuar 15 kompani të ndryshme për të ndërtuar parqe eolike, që shfrytëzojnë energjinë e erës, me një fuqi të instaluar prej rreth 1600 MW. Ato shtrihen kryesisht në zonën bregdetare të vendit, duke filluar nga qarku i Lezhës në veri e deri në rajonin e Sarandës.

- *Energjia e biomasës* përftohet si energji e pastër nga përpunimi i nënprodukteve të drurit ose të agrikulturës, nëpërmjet teknologjive të ndryshme. Në Shqipëri biomasa, si lëndë energjetike përdoret në formën e saj tradicionale për ngrohje dhe gatim, nëpërmjet druve të zjarrit apo mbetjeve të tjera të agrikulturës. Sipas vlerësimeve paraprake të përafërta, energjia e biomasës në vendin tonë është rreth 7 Mtoe, kurse energjia e biomasës e siguruar nga mbetjet bujqësore është llogaritur në rreth 130 toe/vit.
- *Energjia gjeotermale*. Sipas studimeve në Shqipëri ekzistojnë disa zona në të cilat ka mundësi shfrytëzimi i energjive gjeotermale. Në qendrën e Ultësirës Perëndimore, dendësia e fluksit të nxehtësisë është 41.3 mW/m², në Masivin Malor, duke filluar nga jugu deri në verilindje të vendit, dendësia e fluksit të nxehtësisë luhetet nga 40 mW/m² deri në 61.8 mW/m². Mundësia për prodhimin e energjisë elektrike, në disa vendburime ka afërsisht këto kapacitete: Llixhat e Elbasanit kanë fuqi të mundshme për tu instaluar në rreth 2700 kW. Pusi gjeotermal Kozani-8 ka fuqi të mundshme për tu

instaluar rreth 2000 kW. Burimet termale të Peshkopisë vlerësohen me rreth 1600 kW, pusi Ishmi-1/b me rreth 644 kW, etj. Aktualisht, në Shqipëri, energjia gjeotermale përdoret vetëm për qëllime kurative (SKE, 2013: 19 – 20).

Grafiku 12: Furnizimi primar me energji



Furnizimi primar me energji në Shqipëri, i njohur ndryshe dhe si energjia mix, mbizotërohet nga nafta e cila përbën rreth 58 % të totalit në vitin 2013, e ndjekur nga burimet hidrike me një vlerë rreth 28 %. Pjesa tjetër e totalit përbëhet nga biokarburet, qymyrguri, gjeotermale dhe gazi natyror. Këto të dhëna dëshmojnë për nevojën e diversifikimit të burimeve energjetike, nëpërmjet pasurimit të tyre dhe ndryshimit të raporteve me totalin e energjisë.



Tabela 7: Bilanci i përgjithshëm i energjisë (në ktøe)

Emërtimi	Vitet - Years													Discription
	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014*		
Konsumi i brendshëm bruto	2,058	2,284	2,279	2,220	2,175	2,159	2,104	2,106	2,162	2,014	2,346	2,340	Gross inland consumption	
Prodhimi i produkteve primare	1,016	1,179	1,149	1,237	1,080	1,159	1,263	1,643	1,494	1,676	2,041	2,021	Primary production	
Import	1,164	1,148	1,175	935	1,264	1,287	1,299	1,306	1,456	1,277	1,768	1,898	Import	
Ndryshimi i gjendjeve	0	26	0	157	75	56	0	-90	0	30	-235	-308	Stock change	
Eksport	121	69	46	109	244	343	458	754	788	957	1,201	1,245	Export	
Depozituar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12	27	27	Bunkers	
Konsumi në degën e energjisë	93	73	100	78	117	81	33	29	93	64	53	59	Consumption of the energy sector	
Humbje në shpërndarje	85	49	50	208	165	100	105	82	90	96	168	95	Distribution losses	
Disponibël për konsum final	1,802	2,079	2,050	1,827	1,809	1,915	1,945	1,968	1,952	1,848	2,123	2,157	Available for final consumption	
Konsumi final joenergjetik	11	68	84	52	93	93	76	88	39	31	152	87	Final non-energy consumption	
Konsumi final i energjisë	1,791	2,011	1,966	1,775	1,716	1,822	1,869	1,879	1,913	1,817	1,971	2,070	Final energy consumption	

Burimi: INSTAT (www.instat.gov.al)

Sikurse vihet re nga të dhënat mbi bilancin e përgjithshëm të energjisë, konsumi i brendshëm bruto ka ardhur në një rritje graduale me kalimin e viteve, duke shënuar në vitin 2014 një vlerë prej 2,340 ktøe, por duke mbetur larg nevojave reale të vendit. Vlerat e raportit midis prodhimit dhe importit janë me një diferencë minimale. Ajo që bie në sy është vlera e lartë e humbjeve në shpërndarje dhe konsumi final i energjisë, i përlogaritur në 2,070 ktøe.

Tabela 8: Pavarësia energjetike kombëtare

Emërtimi	Viti / Year													Description
	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014*		
Prodhim i produkteve parësore	1,016	1,179	1,149	1,237	1,080	1,159	1,263	1,643	1,494	1,676	2,041	2,021	Production of primary products	
- Qymyr	19	19	15	15	15	20	3	3	2	2	2	0	- Lignite	
- Naftë	360	444	418	500	564	578	577	744	895	1,031	1,207	1,368	- Crude oil	
- Gaz natyror	12	9	10	10	16	8	8	13	15	15	16	28	- Natural gas	
- Energji elektrike	422	472	469	475	258	327	450	666	358	406	598	406	- Electric power	
- Dru zjarri	198	233	230	230	215	215	213	205	208	207	202	202	- Fuelwood	
- Të tjera	5	2	8	8	12	12	12	12	18	17	17	17	- Others	
Disponibël për konsum final	1,802	2,079	2,050	1,827	1,809	1,915	1,945	1,968	1,952	1,848	2,123	2,157	Available for final consumption	
- Qymyr	18	21	18	18	18	23	53	58	71	83	73	93	- Lignite	
- Naftë	1,208	1,366	1,352	1,281	1,256	1,261	1,207	1,207	1,172	1,044	1,235	1,287	- Crude oil	
- Gaz natyror	0	0	0	0	0	0	1	1	0	4	5	8	- Natural gas	
- Energji elektrike	377	458	447	296	314	410	462	487	486	495	593	561	- Electric power	
- Dru zjarri	198	233	230	230	215	215	213	205	208	207	202	193	- Fuelwood	
- Të tjera	2	1	2	2	6	7	9	9	14	15	15	16	- Others	
Pavarësia energjetike (në %)	56.36	56.69	56.06	67.72	59.68	60.54	64.94	83.50	76.54	90.72	96.16	93.70	Energy independency (in %)	

Burimi: INSTAT (www.instat.gov.al)

Lidhur me pavarësinë energjetike kombëtare, të përlogaritur sipas formulës $PEK=PPP/DKF*100\%$, të dhënat dëshmojnë për një pavarësi energjetike relativisht të lartë, kryesisht në vitet e fundit. Përdorimi i një metodologjie të tillë është problematik për dy arsye kryesore. Së pari, rezultatet finale nuk janë tregues real i gjendjes së sigurisë energjetike të vendit. Sipas logjikës së kësaj metodologjie, Shqipëria rezulton një vend i pavarur në aspektin energjetik, duke pasur një pavarësi mbi 90%, në një kohë që realiteti dëshmon të kundërtën. Së dyti, duke u bazuar në rezultate jo të sakta, e gjithë strategjia dhe politikat energjetike që mund të formulohen dhe implementohen do të jenë problematike.

Nga ana tjetër, kjo matje i referohet konsumit real të energjisë dhe jo konsumit optimal. Aktorët mund të kenë një vlerë pozitive të pavarësisë energjetike, por kjo nuk nënkupton se konsumi është i mjaftueshëm, si në terma të kërkesës së brendshme ashtu edhe në raport me vendet e tjera të zhvilluara. Ky është një moment i rëndësishëm i cili dëshmon nevojën e sigurizimit të çështjeve energjetike, ku hapi i parë që duhet ndërmarrë lidhet me ndërgjegjësimin e aktorëve mbi nevojat energjetike dhe njohjen me metodologjitë bashkëkohore të matjes së pavarësisë energjetike dhe treguesve të tjerë energjetik.

Tabela 9: Bilanci i energjisë elektrike, 2000 – 2014 (në MWh)


Emërtimi	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Description
Enërgji në dispozicion	5,711,957	5,408,933	5,348,925	5,745,480	5,870,959	5,878,201	6,053,896	5,726,635	6,296,215	6,629,130	6,772,750	7,210,731	7,619,409	7,857,033	7,793,736	Available electricity
Prodhiimi neto vendas	4,709,870	3,659,025	3,122,405	4,829,688	5,392,439	5,354,244	5,448,830	2,898,706	3,831,014	5,201,014	7,673,728	4,036,309	4,724,800	6,959,326	4,726,246	Net domestic production
Termocentrale	143,589	136,905	106,712	81,275	76,001	76,987	92,630	72,380	0	0	0	0	0	0	0	Thermo
Hidrocentrale	4,566,281	3,522,120	3,015,693	4,748,413	5,316,438	5,277,257	5,356,200	2,826,326	3,831,014	5,201,014	7,673,728	4,036,309	4,724,800	6,959,326	4,726,246	Hydro
Importi bruto (energjii në marrje)	1,223,898	1,819,244	2,279,078	1,241,943	868,827	1,253,484	1,242,300	2,934,515	2,758,600	1,964,480	1,004,571	3,474,966	3,230,144	2,322,528	3,355,987	Gross Import (including exchanges)
Eksporti bruto (energjii në dhënie)	221,811	69,336	52,558	326,151	390,307	729,527	637,234	106,586	293,399	536,364	1,905,549	300,544	335,535	1,424,821	288,497	Gross Export (including exchanges)
Konsumi i energjisë elektrike	5,711,957	5,408,933	5,348,925	5,745,480	5,870,959	5,878,201	6,053,896	5,726,635	6,296,215	6,629,130	6,772,750	7,210,731	7,619,409	7,857,033	7,793,736	Consumption of electricity
Humbjet në rrjet	2,479,399	2,058,358	1,886,012	2,254,525	2,193,886	2,404,615	2,481,174	2,085,184	2,139,985	2,328,322	2,167,199	2,179,157	3,250,039	3,305,622	2,783,182	Electrical losses
Përdorimi nga konsumatorët	3,232,558	3,350,575	3,462,913	3,490,955	3,677,073	3,473,586	3,572,722	3,641,451	4,156,230	4,300,808	4,605,551	5,031,574	4,369,370	4,551,411	5,010,554	Consumption of electricity by

Të dhënat mbi bilancin e energjisë elektrike për periudhën 2000 – 2014, dëshmojnë për një trend pozitiv të energjisë në dispozicion; me një vlerë prej 7,793,736 MWh në 2014 prej të cilës 4,726,246 MWh plotësohen nga prodhimi neto vendas, importi bruto përlllogaritet në 3,355,987 MWh dhe eksporti bruto përlllogaritet në 288,497 MWh. Implikimet kryesore të të dhënave kanë të bëjnë me:

- Së pari, prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri mbështetet plotësisht në burime hidrike. Kjo dëshmon për një varësi të lartë energjetike si pasojë e mungesës së diversifikimit të llojeve të burimeve energjetike, të lidhura me energjinë mix. Varësia në burime hidrike nënkupton varësi të lartë nga kushtet klimaterike, duke ndikuar në rritjen e varësisë nga importi i energjisë elektrike kryesisht në periudhën e mungesës së reshjeve.
- Së dyti, Shqipëria importon mbi 40% të energjisë elektrike, e cila demonstroi dimensionin ekonomik dhe rajonal të sigurisë energjetike. Importi i energjisë ndikon në rritjen e kostos së furnizimit me energji, kosto të cilat varen nga konfigurimet rajonale të aktorëve energjetik, të lidhura me sasinë e energjisë në dispozicion, shpërndarjen e tyre dhe çmimin e energjisë.
- Së treti, të dhënat dëshmojnë për nivelin e lartë të humbjeve në rrjet, e përlllogaritur në 2,783,182 MWh, duke bërë që konsumi final i energjisë elektrike të përlllogaritet në 5,010,554 MWh, larg mesatares rajonale dhe asaj të vendeve të OECD-s. Totali i humbjeve përbëhet nga humbjet teknike dhe humbjet jo teknike. Niveli i humbjeve teknike është një tregues i zhvillimit teknologjik i infrastrukturës energjetike. Minimizimi i humbjeve teknike mund të arrihet vetëm nëpërmjet modernizimit të sistemit dhe politikave të efikasitetit energjetike. E gjitha kjo përkthehet në dimensionin ekonomik të sigurisë energjetike. Lidhur me humbjet jo teknike, aksioni

i ndërmarrë kohët e fundit nga institucionet përkatëse do të shërbejë në minimizimin e këtij fenomeni, i cili historikisht ka përbërë një kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë energjetike në Shqipëri, i shoqëruar me implikime ekonomike dhe sociale.

Grafiku 13: Konsumi final i burimeve energjetike sipas çdo sektori (ktoe)



Burimi: AKBN

Sikurse vihet re nga grafiku i mësipërm, raporti midis sektorëve lidhur me konsumin final të burimeve energjetike ka mbetur përgjithësisht i pa ndryshuar. Sektori i transportit mban peshën kryesore të konsumit, i ndjekur nga sektori i banesave, industria dhe sektori i shërbimeve. Të dhënat e këtij grafiku janë tregues i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit. Nga njëra anë, totali i energjisë së konsumuar tregon nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit, pasi sa më i lartë të jetë konsumi aq më i lartë është edhe zhvillimi. Nga ana tjetër, pesha e sektorëve të veçantë në raport me totalin e energjisë së konsumuar, është një tregues tjetër i karakteristikave ekonomike të vendit.

6.1.2. Karakteristikat e sektorit të energjisë në Shqipëri

Sektori i energjisë në Shqipëri karakterizohet nga një infrastrukturë problematike, efikasitet i ulët, varësi e lartë dhe nivel i ulët i diversifikimit të burimeve, element të cilët kanë impakt të drejtpërdrejtë në sigurinë energjetike. Kjo situatë shoqërohet me implikime multidimensionale, me efekt jo vetëm në nivelin e sigurisë energjetike por ndikon në perspektivën e zhvillimit dhe prosperitetit ekonomik e social të Shqipërisë.

Dimensioni ekonomik i sigurisë energjetike përbëhet nga element të shumtë të cilët variojnë që nga kostoja e blerjes/prodhimit të energjisë e deri tek fatura financiare e konsumatorit fundor të këtij produkti. Duke qenë se Shqipëria karakterizohet nga një nivel i lartë i varësisë energjetike dhe humbje të shumta të natyrës teknike dhe jo teknike, kostoja sa vjen dhe rritet. Duke pasur në konsideratë nivelin e zhvillimit ekonomik në Shqipëri, atëherë rritja e kostove prek ekonominë si në nivel kombëtar ashtu dhe atë individual/familjar. *Dimensioni social* është ngushtësisht i lidhur me dimensionin ekonomik. Nëse aktorët ndikohen drejtpërdrejt nga rritja e kostove, atëherë kushtet e tyre sociale do të ndikohen njëkohësisht. Kanalizimi i të ardhurave drejtë përballimit të kostove të rritura nënkupton kufizimin e shpenzimeve lidhur me aspektet sociale. *Dimensioni mjedisor* është një tjetër dimension i rëndësishëm kur analizohet niveli i sigurisë energjetike në Shqipëri.

Duke qenë se burimi i prodhimit të energjisë bazohet tek burimet hidrike, atëherë shfrytëzimi i lumenjve ndikon në balancat ekologjike të zonave ku ndërtohen hidrocentralet por dhe më tej. Ndërtimi i HEC-eve të vegjël në kaskadat e lumenjve ndikon në ekosistem. Për më tepër, duke qenë se prodhimi i energjisë bazohet në burimet hidrike, kjo nënkupton varësinë e lartë ndaj kushteve klimaterike. Periudhat e thatësirës shoqërohen me uljen e prodhimit vendas dhe rritjen e importit, e përkthyer në rritje të kostove të furnizimit me energji. Dimensionin teknik i sigurisë energjetike lidhet me kapacitetet infrastrukturore për

prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e energjisë. Kapacitetet e kufizuara infrastrukturore në rastin e Shqipërisë ndikojnë në nivelin e ulët të sigurisë energjetike. Humbjet teknike zënë një vend të konsiderueshëm në humbjet totale në rrjet. Shpërdorimi i energjisë, mungesa e termoizolimit dhe linjat e vjetruar ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurinë energjetike.

Shqipëria shfaqet si vendi me varësinë më të lartë nga importet, e llogaritur në rreth 65 % dhe me normën më të ulët të konsumit të energjisë elektrike për frymë, e cila llogaritet në vetëm 1980 kwh. Së bashku me Maqedoninë, janë të vetmet shtete në rajonin e Ballkanit të cilët nuk janë eksportues të energjisë elektrike. Sistemi energjetik në Shqipëri është relativisht i vogël, me një prodhim të elektricitetit të bazuar në burimet hidrike. Për shkak të konsumit të lartë dhe në rritje, edhe importi i energjisë elektrike është i lartë si pasojë e mos plotësimit të kërkesës nga burimet e brendshme energjetike. Investimet e kufizuara në sektorin e energjisë dhe humbjet e mëdha në rrjet, bëjnë që garantimi i sigurisë energjetike për Shqipërinë të jetë i vështirë dhe i kushtueshëm. Në këtë situatë, është i domosdoshëm vazhdimi i reformimit të sektorit energjetik dhe përmirësimi i furnizimit me energji. Diversifikimi i burimeve energjetike dhe reduktimi i varësisë nga elementët klimaterik janë çështje për të cilat duhet të tregohet një kujdes i veçantë. Një siguri energjetike e kërcënuar dhe nevoja për shtimin e importeve ka implikim të drejtpërdrejtë në çdo sektor të ekonomisë, pasi ndikon në buxhetin e shtetit në tërësi. Ndërtimi i HEC-ve të vegjël, përmirësimet në rrjetin e transmetimit dhe përpjekjet e vazhdueshme për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike janë disa elemente pozitive, por të cilët nuk kanë arritur të zgjidhin problematikën e energjisë në Shqipëri.

Nëse i referohemi statistikave që raporton Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Banka Botërore, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë por edhe INSTAT-i, Shqipëria ka një

kapacitet të instaluar të prodhimit të energjisë elektrike prej rreth 1800 MW, nga të cilat rreth 1500 MW nga burimet hidrike, ndonëse në shfrytëzim realisht janë edhe më pak. Mbi këtë bazë, Shqipëria ka prodhimin e saj të energjisë elektrike, kryesisht nga burime hidrike, i cili në varësi të kushteve klimatike është luhatur nga vlera më e ulët prej 2.9 TWh në vitin 2007 në vlerën më të lartë prej 7.9 TWh në vitin 2010, duke dëshmuar qartë ndikimin e kushteve klimatike në prodhimin e energjisë në vend. Gjatë viti 2012 ky prodhim arriti në rreth 5.5 TWh, ndërkohë që kërkesa për konsum ka qenë atë vit rreth 7 TWh. Gjatë vitit 2012 kanë munguar rreth 2 TWh ndaj kërkesës për energji elektrike në vend, që është përballuar me import.

Lidhur me konsumin e energjisë elektrike, dihet se ka një lidhje, një raport të drejtë mes energjisë së prodhuar, energjisë së konsumuar dhe prodhimit të përgjithshëm vendas (GDP). Nëse krahasojmë kapacitetet prodhuese, rezulton se vendet me zhvillim të ulët, me GDP rreth 3000 euro/banorë, kanë një fuqi të instaluar të prodhimit të energjisë elektrike prej rreth 0.8 kW/banorë. Ndërkohë, vendet me GDP rreth 6000 euro/banorë, kanë një kapacitet të instaluar të prodhimit të energjisë elektrike prej rreth 1 kW/banorë. Vendet e rajonit të Europës Juglindore, GDP e të cilave luhaten nga 6000 deri në 9000 euro/banorë, kanë kapacitet të instaluar të prodhimit të energjisë elektrike rreth 1 kW/banorë. Shqipëria ka një GDP përafërsisht të po këtij niveli, ndërsa referuar popullsisë së saj prej 3 milion banorësh, kapaciteti i instaluar i saj rezulton të jetë rreth 0.5 kW/banor, shumë më i ulët edhe se ai i vendeve të pazhvilluara.

Të gjendur përballë kësaj situate, është e domosdoshme që aktorët shtetëror dhe jo shtetëror fillimisht të ndërgjegjësohen për rëndësinë e sigurisë energjetike për zhvillimin dhe prosperitetin e vendit, dhe të merren masa në këtë drejtim. Masat e marra së fundi janë kryesisht masa të natyrës afatshkurtër dhe afatmesme, por garantimi i sigurisë ka nevojë për

marrjen e masave afatgjata nëpërmjet hartimit dhe implementimit të strategjive vizionare dhe realiste.

Një nga problemet madhore që shtrohet në lidhje me energjinë, kryesisht me atë elektrike, është se si do të përballohen nevojat e vendit në të ardhmen? Sigurisht, ka një sërë dokumentash që tregojnë se cili do të jetë trendi i zhvillimeve në këtë drejtim, duke filluar nga ndërtimi i hidrocentraleve të mëdhenj në lumin Drin, Vjosa dhe Devoll; shfrytëzimi i potencialeve të erës dhe asaj diellore, përdorimi i gazit natyror jo vetëm për djegie dhe ngrohje por edhe për prodhim të energjisë elektrike, e pse jo, si një alternativë e hapur, edhe i energjisë bërthamore. Sigurisht, duke mbajtur parasysh potencialet e vendit dhe kërkesën për energji, një nga rrugët që do vazhdojë të mbetet aktive është përmes importit, çka do të kërkonte edhe përmirësimin teknologjik të linjave ekzistuese dhe rritjen e numrit të tyre, për të siguruar importin nga më shumë se një drejtim. Dhe, thuajse po aq i rëndësishëm sa prodhimi në vend i energjisë elektrike, është edhe efica e përdorimit të kësaj energjie, ulja e humbjeve të çdo lloji në rrjet, sikurse kursimi i energjisë dhe përdorimi i paisjeve të teknologjisë së lartë në industri e kudo gjetkë.

Shumë nga sa përmendim më sipër pasqyrohen në dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë, që daton në vitin 2004, dhe që projekton zhvillimet në sektorin e energjetikës deri në vitin 2020. Një dokument më i përditësuar, që nga viti 2013 mbetet ende si një projekt në përpunim dhe kërkon patjetër një version përfundimtar, por edhe që të projektojë më larg në kohë, ndoshta drejt viti 2050. Gjithësesi, në një këndvështrim më konkret, në stad të fundit pyetja shtrohet: sa energji do na duhet në të ardhmen? Pa pretenduar për llogaritje të sakta, janë disa parametra që në një mënyrë të përafërtë na lejojnë të vlerësojmë se sa energji elektrike do të na duhet të konsumojmë në vend, për të përballuar kërkesat në rritje.

Një nga parametrat është konsumi i energjisë elektrike/frymë, që aktualisht është rreth 1900 KWh/frymë, rreth dy herë më pak se mesataria e konsumit në vendet e Ballkanit dhe rreth 3 herë më pak se konsumi mesatar në vendet e BE. Në një farë mënyrë, ky parametër na lejon të pretendojmë se konsumi i energjisë elektrike në vend, për pasojë edhe prodhimi dhe importi i energjisë elektrike, duhet të jetë në vlera të përafërta me vendet e tjera të Ballkanit, mesatarja e të cilëve është rreth 4000 KWh/frymë. E llogaritur për një popullsi prej rreth 3 milion banorë, në këtë rast do konsumohej një energji elektrike prej rreth 12 TWh. Ndërsa nëse do i referohemi vendeve të BE, me një konsum mesatar të energjisë elektrike prej rreth 6000 KWh/frymë, për të njëjtën popullsi prej 3 milion banorësh do të duheshin rreth 18 TWh. Thënë ndryshe, për të ardhmen, që të garantojmë kërkesat në rritje për energji elektrike do të duhet një 2–3 fishim i konsumit aktual.

Një mënyrë tjetër që mund të ndihmojë në parashikimin për të ardhmen mbështetet në disa konsiderata që lidhin vlerën e GDP/frymë me kapacitetin gjenerues për frymë të vendeve, të ndara në tre kategori: me të ardhura të larta, të ardhura të mesme të ulta, dhe të ardhura të ulta. Kapacitetet gjeneruese të energjisë elektrike/frymë për vendin tonë rezultojnë shumë të ulta; ato janë mjaft nën nivelin e vendeve me të ardhura të ulta, që duhet të na shqetësojë seriozisht. Nëse i referohemi nivelit të vendeve me GDP të mesme të ulët, llogaritjet për një popullsi prej 3 milionë banorësh kërkojnë që ky kapacitet të dyfishohet. Ndërsa nëse i referohemi vendeve me GDP të lartë (si vendet e BE), llogaritjet tregojnë se ky kapacitet gjenerues duhet të rritet me së paku 3 herë në krahasim me ato egzistueset. Sipas këtyre llogaritjeve, për të përballuar nevojat në rritje për energji elektrike, Shqipëria duhet të rrisë kapacitete gjeneruese të energjisë elektrike përtej vlerës 3000 MW, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron potenciali hidrik i vendit si edhe të investimeve me leverdi në lloje të tjera të burimeve potenciale energjetike të vendit.

Dimensioni mjedisor i sigurisë energjetike është një element shumë i rëndësishëm në rastin e Shqipërisë, si pasojë e mbështetjes së saj në burimet hidrike për prodhimin e energjisë elektrike. Në një raport të mbështetur nga Programi ESMAP (Energy Sector Management Assistance), Banka Botërore dhe TFESSD (Trust Fund for Environmentally and Socially Sustainable Development), është zhvilluar studimi mbi rreziqet klimaterike ndaj sektorit energjetik në Shqipëri dhe të aksioneve prioritare të cilat duhen ndërmarrë me qëllim reduktimin e vulnerabilitetit dhe risqeve (Ebinger, 2010). Konkluzionet kryesore të këtij raporti janë:

- Burimet ujore janë një aset kombëtar për Shqipërinë: lumi Drin gjeneron rreth 90 % të elektricitetit të përdorur nga industria dhe konsumatorët familjar në Shqipëri.
- Varësia e lartë në burime hidrike sjell sfida: prodhimi i elektricitetit varion nga 6,000 GWh deri në më pak se gjysma në periudhat e thatësirës.
- Ndryshimet klimaterike do të kenë ndikim në prodhimin e energjisë elektrike: në vitin 2050 prodhimi mund të reduktohet me 15 – 20 %.

Për të garantuar sigurinë energjetike, Shqipëria duhet të fokusohet në përshtatjen me ndryshimet klimaterike. Në Strategjinë Kombëtare të Energjisë, mbështetja tek burimet e rinovueshme të energjisë, përcaktohet si një ndër drejtimet kryesore të sektorit të energjisë për vitet e ardhshme. Duke qenë se këto burime do të ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ndryshimet klimaterike atëherë Strategjia duhet të trajtojë me kujdes këtë dimension mjedisor të sigurisë energjetike. Ndryshimi i regjimit ujqor do të ndikojë drejtpërdrejtë në prodhimin e energjisë në Shqipëri, të mbështetur tek burimet hidrike. Në terma afat gjatë, ndryshimet klimaterike do të shoqërohen me rritjen e temperaturave çka nënkupton se në periudhën e dimrit sasia e energjisë së nevojshme për ngrohje do të reduktohet por nga ana tjetër, rritja e temperaturave do të rrisë kërkesën për energji në periudhën e ngrohtë, për

shkak të nevojës për t'u freskuar (si mjedisi ashtu edhe produktet ushqimore). Ngritja e temperaturave mund të shërbejë pozitivisht për prodhimin e energjisë solare, por përdorimi i saj ka nevojë për ndërtimin dhe funksionimin e një infrastrukture të re, duke shfaqur dimensionin ekonomik të sigurisë energjetike.

Ndryshimet klimaterike do të ndikojnë dhe në vendet e tjera të rajonit, të cilat rreth 1/4 e prodhimit të energjisë elektrike e mbështesin në burimet hidrike (Ebinger, 2010). Kjo tregon se mbështetja tek linjat e interkonjeksionit përbën vetëm një nga alternativat diversifikuese, pasi si pasojë e ndryshimeve klimaterike kërkesa për energji elektrike do të rritet në nivelin rajonal, e shoqëruar dhe me rritjen e çmimit të energjisë në tregun rajonal. Në këtë mënyrë, është e nevojshme t'i kushtohet një rëndësi e veçantë politikave të lidhura me eficientësinë e energjisë. Të gjitha këto masa kanë nevojë për ndërthurjen e faktorëve vizion, kohë dhe financa.

Shqipëria, sikurse dhe vendet e tjera, duhet të tregojë një vëmendje të veçantë lidhur me garantimin e sigurisë energjetike. Diversifikimi i burimeve energjetike, duke mos u bazuar vetëm tek burimet hidrike për prodhimin e energjisë elektrike të cilat janë të varura nga situata klimaterike, duhet të jetë një ndër prioritetet kombëtare. Masat kryesore që duhen marrë në këtë drejtim janë të lidhura me zhvillimin e infrastrukturës energjetike, ku linjat e interkonjeksionit do të luanin një rol shumë të rëndësishëm. Gjithashtu, është e nevojshme mirëmbajtja e hidrocentraleve ekzistuese, por edhe ndërtimi i hidrocentraleve të reja të mëdha, pasi ndërtimi i hidrocentraleve të vegjël jo vetëm që nuk e garanton sigurinë energjetike, por mund të kthehen dhe në çështje problematike pasi mund të dëmtojnë zonën përreth vendit ku ndërtohen, përkeqësojnë përdorimin e ujit dhe sidomos përdorimin e tij për vaditje, etj. Një masë tjetër e rëndësishme që duhet të ndërmerret është dhe vënia në funksionim e TEC-it të Vlorës, ku gazi natyror mund të jetë një burim optimal. Një kujdes i

veçantë duhet të tregohet lidhur me humbjet në rrjet dhe nivelin e arkëtimeve të faturave të energjisë së konsumuar. Shoqëria në tërësi duhet të ndërgjegjësohet në lidhje me përdorimin optimal të energjisë, ku pagesa e energjisë së konsumuar duhet parë jo vetëm si një detyrim ligjor, por dhe si një detyrim moral, duke e konsideruar energjinë si një të mirë të përbashkët jo vetëm për brezin tonë, por edhe për brezat që do të vijnë.

6.2. Vendi dhe roli i Shqipërisë në gjeopolitikën rajonale të energjisë

Shqipëria, për shkak të burimeve të kufizuara energjetike dhe karakteristikave të një tregu të vogël, ka qenë jashtë konfigurimeve gjeopolitike të energjisë. Vitet e fundit situata ka filluar të ndryshojë si pasojë e projekteve të reja energjetike dhe intensifikimit të bashkëpunimit rajonal. Anëtarësia në Komunitetin Energjetik, projekti TAP dhe IAP sikurse dhe projekti mbi ndërtimin e kapaciteteve depozituese, janë disa nga momentet kryesore të cilat do të ndikojnë në rritjen e rolit dhe rëndësisë së Shqipërisë në gjeopolitikën rajonale të energjisë, duke ndikuar në këtë mënyrë në rritjen e nivelit të sigurisë energjetike për Shqipërinë.

6.2.1. Anëtarësimi i Shqipërisë në Komunitetin Energjetik

Shqipëria u bë anëtare e Komunitetit Energjetik në 1 Korrik 2006. Si anëtare e këtij organizmi, Shqipëria merr përsipër të përmbushë detyrimet lidhur me²⁵:

1. Zgjerimin e *acquis communautaire*;
2. Mekanizmin për funksionimin e rrjetit të tregjeve të energjisë;
3. Krijimin e një tregu të vetëm të energjisë.

Anëtarësimi në një organizëm të tillë shoqërohet me dimensione legale, teknike dhe rajonale. Lidhur me dimensionin legal, është e nevojshme të theksohet se *acquis*

²⁵ www.energy-community.org

communautaire e Komunitetit Energjetik përbëhet nga 25 akte legale, duke përfshirë aktet e BE-së në fusha të tilla si elektriciteti, gazi, nafta, mjedisi, efienca energjisë, burimet e rinovueshme, statistikat sikurse dhe politikat e konkurrencës. Përafrimi i legjislacionit në fushën e energjisë është i një rëndësie të veçantë për dy arsye kryesore. Së pari, nëpërmjet asistencën së Komunitetit, Shqipëria mund të përmirësojë kuadrin e saj rregullator në sektorin e energjisë, duke u mbështetur në parimet dhe modelet bashkëkohore. Së dyti, përafrimi i legjislacionit dhe standardizimi i kuadrit ligjor, ndikon në lehtësimin e ndërveprimit midis aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sektorin e energjisë. Në të njëjtën logjikë, Shqipëria do të përfitojë nga anëtarësimi në Komunitet në aspektin teknik. Garantimi i sigurisë energjetike kërkon jo vetëm vullnetin për ta bërë një gjë të tillë, por kërkon gjithashtu dhe njohuritë e duhura në këtë drejtim. Asistenca teknike do të ketë një impakt pozitiv në sektorin energjetik, duke ndikuar në nivelin e sigurisë energjetike të Shqipërisë.

Dimensioni rajonal i përfshirjes së Shqipërisë në Komunitetin Energjetik lidhet me bashkëveprimin me aktorët e tjerë rajonal dhe ndërkombëtarë. Sikurse është theksuar dhe më parë, siguria energjetike e një aktori nuk mund të garantohet nëse kontesti rajonal nuk është i përshtatshëm. Një aktor, pavarësisht resurseve energjetike në dispozicion, mund të jetë i kërcënuar nëse vendet përreth tij nuk karakterizohen nga qëndrueshmëria në sektorin energjetik. Për më tepër, duke qenë se Shqipëria është një treg relativisht i vogël dhe me interes të kufizuar për investitorët e huaj, nëpërmjet integritit në një treg rajonal mund ta tejkalojë një problematikë të tillë. Gjithashtu, integrimi rajonal në fushën energjetike do të ndikojë pozitivisht në përmbushjen e perspektivës së integritit të Shqipërisë në BE.

Anëtarësimi në Komunitet kërkon liberalizimin gradual të tregut energjetik, ristrukturimin e kompanive energjetike, aplikimi i tarifave të drejta, zbatimin e pagesave dhe

ngritjen e enteve rregullatore të pavarura të cilët do të shqyrtojnë qasjen në rrjet të palëve të treta (Deitz et.al, 2008). Komuniteti Energjetik i kushton një rëndësi të veçantë dimensionit mjedisor të energjisë, sikurse dhe rregullave të konkurrencës të lidhura me privatizimet në sektorin e energjisë dhe procedurat e prokurimit. Pavarësisht se këto obligime mund të shihen si kufizues të opsioneve të mundshme për garantimin e sigurisë energjetike (si p.sh. përdorimi i qymyrgurit), plotësimi i tyre nga ana e Shqipërisë do të ndikojë pozitivisht në sektorin e energjisë dhe sigurinë energjetike në përgjithësi. Mos ndjekja e rregullave të tilla ka përbërë një ndër arsyt kryesore të situatës problematike të sektorit të energjisë në Shqipëri.

Në këtë mënyrë, anëtarësimi i Shqipërisë në Komunitetin Energjetik ka implikime të dyfishta. Nga njëra anë, Shqipëria mund të përfitojë në aspektin teknik, financiar dhe rregullator nga anëtarësimi në Komunitet dhe nga ana tjetër do të luajë një rol më të rëndësishëm në gjeopolitikën rajonale të energjisë. Për më tepër, nëpërmjet integritit në një treg të vetëm rajonal, Shqipëria do të mundësojë diversifikimin e burimeve të energjisë, e cila përbën një ndër kushtet themelore në funksion të garantimit të sigurisë energjetike. Përtej të gjitha mundësive që ofron anëtarësimi në këtë organizëm, është e nevojshme të theksohet se ai nuk mund të zgjidhë të gjithë problemet e lidhura me sektorin energjetik. Komuniteti Energjetik krijon mjedisin e përshtatshëm për harmonizimin e politikave energjetike, rrit presionin pozitiv nga lart – poshtë dhe anasjelltas dhe rrit rëndësinë e rajonit për investorët e huaj por të gjitha këto nuk mund të zgjidhin problemet energjetike për aq kohë sa çështjet energjetike nuk do të prioritetizohen në axhendën politike dhe të bëhen pjesë e një procesi të suksesshëm sigurizimi.

6.2.2. Implikimet e projekteve energjetike në sigurinë energjetike të Shqipërisë

Implikimet strategjike të projekteve energjetike dhe përfitimet e Shqipërisë nga përfshirja në to është theksuar në një sërë analizash. Në një analizë të Ian Brzezinskit mbi marrëdhëniet Shqipëri – SHBA, ndër të tjera theksohet dhe siguria energjetike si një ndër çështjet themelore të cilat duhet të trajtohen brenda këtij bashkëpunimi për shkak të rëndësisë strategjike të kësaj çështje. Ai shprehet se: *“Shqipëria ka depozita gazi dhe naftë me një rëndësi rajonale... por ndërlidhjet energjetike midis vendeve të rajonit dhe pjesës tjetër të Europës janë problematike... projektet energjetike të planifikuara kanë implikime të rëndësishme strategjike për Shqipërinë dhe rajonin. Siguria energjetike duhet të plotësojë mbrojtjen dhe demokracinë, si një shtyllë kryesore në marrëdhëniet dypalëshe SHBA – Shqipëri. Objektivat e këtyre shtyllave duhet të përfshijnë nxitjen e investimeve amerikane në Shqipëri dhe të garantojnë që interesat e sigurisë të Shqipërisë të zhvillohen brenda evoluimit të infrastrukturës energjetike të Ballkanit”* (Brzezinski, 2012: Paragrafi XI).

Në pasazhin e mësipërm theksohen si potencialet ashtu edhe problematikat e lidhura me sigurinë energjetike në rastin e Shqipërisë. Rëndësia e energjisë në marrëdhëniet ndërkombëtare, është e krahaseshme me mbrojtjen dhe demokracinë, duke u kthyer në këtë mënyrë në promotorët kryesor të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zhvillimit. Pasuria energjetike në Shqipëri mbetet pjesërisht e shfrytëzuar sikurse është edhe keq shfrytëzuar. Për një shfrytëzim optimal të burimeve energjetike kërkohet një teknologjia sa më e përparuar, një aspekt problematik në rastin e Shqipërisë. Kjo mund të tejkalohet dhe të përkthehet në një aspekt pozitiv nëpërmjet intensifikimit të bashkëpunimit me aktorë të huaj, sikurse dhe nëpërmjet zhvillimit të partneritetit midis aktorëve publik dhe privat. Dimensioni rajonal, si parakusht i garantimit të sigurisë energjetike, është thelbësor në këtë drejtim. Ndër projektet kryesore energjetike, të cilat do të kenë impakt në sigurinë

energjetike dhe në fuqizimin e rolit të Shqipërisë në gjeopolitikën rajonale të energjisë, janë: TAP, IAP dhe ndërtimi i kapaciteteve depozituese.

Në një artikull shkencor të titulluar ‘Gjeopolitika energjetike, si gjeografi e burimeve’, ndër të tjera argumentohet se: “Përveç pjesës së furnizimit vendas me gaz, ky projekt e fut Shqipërinë në hartën e vendeve transit për furnizimin e Europës. Ky fakt i mundëson Shqipërisë rritjen e industrisë së rëndë, investimeve të huaja, rrjetëzimit me Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë dhe projektin Ionian-Adriatik Pipeline. Investimi në rrjetet energjetike ndërshtetërore Shqipëri-Kosovë, Shqipëri-Maqedoni, Shqipëri-Greqi dhe Shqipëri-Mali i Zi do të ishte më i frytshëm dhe konkret në arritjen e rezultateve të prekshme dhe do t’i largonte ambiciet e mëdha të lidhura me projekte gjeopolitike (Nabucco, Southstream) duke e fokusuar vëmendjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në interesat e përbashkëta dhe duke krijuar një mjedis sigurie të qëndrueshëm. Kjo nevojë lind si kriter i përbashkët, i vendosur ndaj rajonit për Integrimin Rajonal dhe përfundimisht në Integrimin European, sipas Direktivave Europiane për Energjinë” (Ribaj & Qendro, 2012: 43).

Sipas faqes zyrtare të projektit, Gjurma e TAP-it përmes Shqipërisë është rreth 215 kilometra në pjesën tokësore dhe 37 km në pjesën detare në ujërat territoriale shqiptare të Detit Adriatik. Seksioni fillon në Bilisht Qendër në Qarkun e Korçës në kufirin shqiptar me Greqinë dhe mbërrin në Detin Adriatik 17 km në veriperëndim të Fierit, 400 metra në tokë nga vija bregdetare. Përfitimet e para, të cilat do të kenë kryesisht impakt rajonal (në zonat ku kalon projekti), lidhen me punësimet dhe përmirësimin e infrastrukturës përreth. Por përfitimet e përllogaritura shkojnë përtej kësaj. Sikurse shprehet dhe analisti për energjinë Michael Ratner *“për vendet si Shqipëria, përgjatë gazsjellësit TAP, kjo do të sillte mundësi të reja, së pari sepse këto vende do të mund të konsumonin më tepër gaz, por gjithashtu*

*sepse gazi i Azerbajxhanit do të mund të shkonte në tregje të reja si për shembull në Maqedoni dhe vende të tjera të ish-Jugosllavisë duke ndërtuar degë prej gazsjellësit TAP”.*²⁶

Shqipëria do të ketë përfitime strategjike nga TAP, duke siguruar një pozitë të rëndësishme në hartën europiane të energjisë. Përfitimet do të jenë dhe në nivele të tjera, sikurse në të ardhurat nga taksat, aksesit në një burim energjie me një çmim më të favorshëm, punësimet dhe investimet në zonat ku do të kalojë projekti. Për Shqipërinë TAP do të jetë Investimi i Huaj Direkt më i madh deri në këto momente dhe gjithashtu do të ndikojë në integrimin në BE nëpërmjet rritjes së rëndësisë rajonale dhe gjeostrategjike. TAP gjithashtu mund të ndikojë në përmirësimin e tregut të brendshëm të energjisë në Shqipëri. Në një raport të universitetit të Oksfordit mbi impaktin e projektit në ekonominë e Shqipërisë, argumentohet se duke filluar nga viti 2019, përfitimet direkte në Prodhimin e Brendshëm Bruto përlllogariten në 7.6 milionë euro në vit dhe hapja e rreth 200 vendeve të punës. Ndërsa pjesa i përket impaktit indirekt, ndikimi në Prodhimin e Brendshëm Bruto vlerësohet në 2.1 milionë euro të tjera në vit dhe hapjen e 260 vendeve të punës. Gjatë gjithë periudhës së funksionimit të tij, gazsjellësi do të kontribuojë minimalisht një vlerë shtesë prej 743 milion euro në prodhimin e brendshëm të Shqipërisë. Ndërkohë, që vetëm në fazën e ndërtimit të rrugëve të aksesit ndaj kësaj veprë është parashikuar një fond prej 60 milionë euro me impakt të madh në zhvillimin rural të vendit²⁷.

Implikimet gjeopolitike dhe ekonomike do të shoqërohen me ndikim të drejtpërdrejtë dhe në aspekte të tjera të lidhura me stabilitetin, zhvillimin dhe mirëqenien e këtyre vendeve. Nëpërmjet përfshirjes në këtë projekt, bashkëpunimi ndërkombëtar për këto vende do të ngrihet në një nivel akoma më të lartë, duke u shoqëruar me përfitime reciproke.

²⁶ <http://energija.al/tag/siguria/page/2/>

²⁷ <http://www.javanews.al/studimi-tap-efekte-pozitive-per-te-pakten-50-vjet/>

Zëvendës Ndhmës Sekretari i Shtetit Hochstein, i pyetur për implikimet e projektit TAP në marrëdhëniet midis SHBA-së dhe vendeve nga të cilat do të kalojë projekti, u shpreh se: *“Shtetet e Bashkuara mbështetën Korridorin e Jugut si koncept sepse ofron siguri energjetike për Europën, duke bërë të mundur transportin e gazit natyror nga deti Kaspik për në Europë. Mendoj se zgjedhja e TAP-it krijon mundësi unike rritjeje ekonomike për vendet e përfshira, pra Turqia, Greqia, Shqipëria dhe Italia. Marrëdhëniet tona me vendet përgjatë TAP-it janë të mira dhe ne presim që ato të vazhdojnë të mbeten marrëdhënie të mira dhe bashkëpunuese”²⁸.*

Projekti TAP është një ndër momentet kryesore të cilat kanë intensifikuar diskurin politik mbi çështjet e sigurisë energjetike. Kryeministri Rama, në samitin e Këshillit Atlantik për Energjinë dhe Ekonominë, i mbajtur në Stamboll, që shërben si një platformë për bashkërendimin e strategjive ekonomike, politike dhe energjetike, u shpreh se: *“Gazsjellësi TAP, i cili do të sjellë gazin kaspik nga fusha e Azerbajxhanit në Bashkimin Europian përmes Shqipërisë, e vë për herë të parë vendin tonë në qendër të politikës gjeo-strategjike të Bashkimit Europian. Përfundimi i projektit TAP, fillimi i projektit Joniano-Adriatik, duke pasur parasysh zbulime të rëndësishme në lindje të Detit Mesdhe që mund të transformojnë Izraelin dhe Qipron në furnizuesit e rinj për tregun europian të gazit, në një periudhë afatgjatë do bëjnë që Shqipëria të ketë më shumë potencial për të luajtur një rol jetik në sektorin e energjisë në rajon”²⁹.* Ky është vetëm një nga momentet e shumta të artikulimit të çështjeve energjetike të fokusuara në nevojën për diversifikimin e burimeve energjetike dhe implikimet gjeopolitike të këtyre projekteve. Por garantimi i sigurisë energjetike kërkon shumë më shumë se artikulimin publik dhe politik të fenomenit;

²⁸ <http://energija.al/tag/siguria/page/2/>

²⁹ Fjala e Kryeministrit Rama në Këshillin Atlantik për Energjinë dhe Ekonominë. Aksesuar në: <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=313458>

garantimi i sigurisë energjetike kërkon njohjen e situatës, të avantazheve por edhe disavantazheve të mundshme dhe inkuadrimin e tyre në strategji dhe politika energjetike eficiente dhe realiste.

Kur analizohen përfitimet nga projekti TAP, është e nevojshme që të tregohemi sa më objektiv dhe realist. Së pari, përfitimi kryesor është në nivelin strategjik. Nëpërmjet përfshirjes në këtë projekt, Shqipëria bëhet pjesë e gjeopolitikës rajonale të energjisë duke përforcuar rolin dhe pozitën e saj. Por ky nuk është një përfitim shkak-pasojë, pasi për të maksimizuar përfitimin është e nevojshme ndjekja e një politike të jashtme më aktive për të intensifikuar bashkëpunimin, rritjen e përfitimeve dhe përmbushjes së interesit kombëtar.

Së dyti, përfitimet ekonomike që vijnë si pasojë e faktit se projekti do të jetë Investimi i Huaj Direkt më i rëndësishëm në Shqipëri, punësimit dhe taksave janë të rëndësishëm por duhen analizuar në mënyrë më objektive. Punësimi do të jetë kryesisht i përkohshëm (për kohë zgjatjen e punimeve) dhe do kërkohej një nivel i caktuar kualifikimi për punët që do të zhvillohen nga shqiptarët. Përfitimi konkret nga taksat nuk është i qartë dhe duket se pala shqiptare ka pranuar përfitimet e ofruara dhe jo të negociuara (kujtojmë negociatat me palën Greke të cilët arritën të shtojnë përfitimet e tyre nga projekti).

Së treti, maksimizimi i përfitimit nga projekti do të vijë nëpërmjet përdorimit të gazit në ekonominë vendase, ndërtimin e kapaciteteve depozituese dhe ndërtimin dhe operacionalizimin e IAP. Lidhur me gazifikimin, një sërë masash kanë filluar të ndërmerren por ato janë akoma në nivelin e diskutimeve dhe hartimit të dokumenteve. Në terma afat-mesëm, përfitimi do të rritej nga përdorimi i gazit në sektorët e industrisë ndërsa gazifikimi i plotë dhe përdorimi nga konsumatorët familjar është një proces i cili mund të arrihet në terma afat-gjatë.

Përtej përfitimeve, kalimi i projektit TAP në territorin e Shqipërisë duhet të analizuar dhe në aspektin e kërcënimeve të mundshme ndaj infrastrukturës kritike të energjisë. Këto kërcënime mund të vijnë nga sulmet terroriste, sabotazhi, gabimet njerëzore, incidentet teknologjike dhe fatkeqësitë natyrore. E gjithë gama e kërcënimeve të mundshme ndaj infrastrukturës energjetike është e domosdoshme të trajtohet në mënyrën më optimale të mundshme.

6.3. Siguria energjetike në dokumentet kryesore strategjike

6.3.1. Siguria energjetike në Strategjinë Kombëtare të Energjisë, 2013 – 2020

Strategjia Kombëtare e Energjisë (SKE) e hartuar në Prill 2012, është dokumenti kryesor strategjik i cili fokusohet në çështjet e lidhura me energjinë. Dokumenti në fjalë është akoma në fazën e një drafti, pasi nuk është miratuar ende. Duke qenë se në të shfaqet vizioni dhe objektivat e lidhur me sektorin energjetik, dokumenti është i përshtatshëm për t'u analizuar në funksion të punimit. Për më tepër, strategjia e fundit e miratuar është ajo e vitit 2003. Dokumenti nis me një analizë të situatës aktuale të sektorit të energjisë dhe sfidat kryesore ndaj tij, duke vijuar me vizionin, prioritetet, qëllimet strategjike dhe politikat energjetike. *“Strategjia Kombëtare e Energjisë shpreh në thelb përcaktimin e drejtimeve kryesore të zhvillimit të sektorit energjetik, si një sektor mbështetës për zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë... Rritja e sigurisë së furnizimit, krijimi i një ekonomie kompetitive dhe respektimi i normave mjedisore, janë qëllimet bazë të kësaj strategjie”* (SKE, 2012: 6). Nëpërmjet analizimit të këtij pasazhi, vihen re disa nga dimensionet kryesore të sigurisë energjetike, si dimensionin ekonomik, social dhe ai mjedisor. Duke qenë se energjia është një fenomen ndër sektorial, ajo nuk mund të garantohet nëse nuk trajtohet si e ndikuar dhe me ndikim në të gjithë sektorët e tjerë

të sigurisë. Është e nevojshme të theksohet se siguria është një sistem, i përbërë nga një sërë sektorësh, ku prishja e raporteve brenda këtij sistemi përbën kërcënim për sigurinë në tërësi.

Aktorët të cilët kanë nivel relativisht të lartë të zhvillimit ekonomik, karakterizohen si nga niveli i lartë i kërkesës dhe konsumit të energjisë, ashtu edhe nga aftësia për t'i përmbushur këto kërkesa, krahasuar me aktorët me nivel më të ulët të zhvillimit ekonomik. Kjo është një lidhje e cila dëshmon dimensionin ekonomik të sigurisë energjetike. Nga ana tjetër, aksesit i aktorëve dhe i popullatës në burime të mjaftueshme energjetike me një çmim të përshtatshëm, është një moment i cili dëshmon dimensionin social të sigurisë energjetike. Zhvillimet bashkëkohore shoqërore janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me konsumin e energjisë, prandaj mungesa e furnizimit me energji përbën kërcënim për zhvillimin e shoqërisë në aspektin social. Për më tepër, garantimi i sigurisë energjetike nuk mund të arrihet nëse aspektet mjedisore të lidhura me të, nuk trajtohen në mënyrë të përshtatshme.

Elementi tjetër i cili theksohet në këtë pasazh, është rritja e sigurisë së furnizimit. Duke qenë se siguria energjetike e një aktori, përcaktohet nga raporti i tij me burimet energjetike, Shqipëria si një vend importues fokusohet në sigurinë e furnizimit me burime energjetike. Prandaj, për të garantuar sigurinë energjetike vend duhet të fokusohet në prioritizimin e diversifikimit të burimeve energjetike. Diversifikimi duhet të mbështetet në dy linja kryesore. Linja e parë lidhet me diversifikimin e burimeve energjetike, diversifikimin e aktorëve prej të cilëve importohet energji. Mbështetja tej një burim i vetëm apo tek një numër i kufizuar burimesh, përbën kërcënim për sigurinë energjetike. Ndërsa linja e dytë, lidhet me diversifikimin e llojeve të energjive të përdorura, e njohur ndryshe dhe si energjia mix. Sa më i diversifikuar të jetë sistemi, aq më e garantuar është siguria energjetike e një aktori.

Dimensioni i jashtëm i energjisë, është i përcaktuar dhe në këtë dokument ku ndër të tjera thuhet se *“Strategjia Kombëtare e Energjisë përbën një detyrim të Qeverisë... si dhe të angazhimeve që Shqipëria ka marrë në kuadër të integritit të saj në Bashkimin European”* (SKE, 2012: 6). Në këtë mënyrë, Shqipëria duhet të harmonizojë politikat e saj energjetike si në funksion të përmbushjes së nevojave të brendshme, ashtu edhe në përafrimin me standardet dhe objektivat e BE-së. Objektivat e BE-së në sektorin energjetik, variojnë nga ato social, mjedisor dhe ekonomik deri tek objektivat rregullator dhe ligjor. Si një fenomen shumë kompleks, siguria energjetike mund të arrihet vetëm nëpërmjet përdorimit të një qasje multi dimensionale me qëllim garantimin e saj.

Strategjia thekson situatën aktuale të sigurisë energjetike dhe problematikat e saj, duke u shprehur se *“Mungesa e burimeve primare të energjisë, mungesa e burimeve dhe rrjeteve të gazit, kapacitete të limituara të prodhimit dhe të interkonjeksionit, si dhe varësi e plotë e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet hidrike, janë disa nga vështirësitë, që kanë pasur impaktin e tyre në mënyrë direkte dhe indirekte në jetën ekonomike dhe në cilësinë e kushteve të jetesës të vendit tonë”* (SKE, 2012: 6). Në këtë mënyrë, siguria energjetike në Shqipëri kërcënohet nga burimet e brendshme energjetike të kufizuara, mungesa e ‘energjisë mix’ dhe varësia e lartë nga një burim i vetëm, nga ai hidrik. Të gjitha këto janë problematika të cilat duhen adresuar në mënyrën më të përshtatshme të mundshme. Dimensioni ekonomik dhe ai social i energjisë, pasqyrohen në mënyrë të qartë në këtë pasazh. Të gjendur përballë kësaj situate, strategjia përcakton dhe objektivat e mundshëm për përmirësimin e situatës. *“Për këto arsye, kjo strategji, pasi analizon situatën aktuale të sektorit energjetik në tërësi, parashtrohet politikat energjetike, që duhet të ndjekë qeveria në këtë sektor, ku përmendim: përmirësimin dhe harmonizimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor me direktivat e Bashkimi European, ristrukturimin institucional, diversifikimin*

e burimeve duke promovuar burimet e rinovueshme dhe rritjen e efikasitetit të energjisë, vendosjen e tarifave reale për energjinë elektrike” (SKE, 2012: 6). Sikurse vihet re, strategjia operon në bazë të koncepteve dhe modeleve bashkëkohore të sigurisë energjetike, duke u fokusuar në harmonizimin e politikave energjetike kombëtare me direktivat e Bashkimit Europian.

Si një tregues i dimensionit rajonal të sigurisë energjetike dhe për të mbështetur argumentin se siguria energjetike e një vendi nuk mund të analizohet dhe operojë jashtë kontekstit rajonal, strategjia i kushton një seksion të veçantë këtij aspekti. *“Përmirësimi i performancës të sektorit energjetik është thelbësor... por ajo duhet parë dhe në kontekst të situatës energjetike në vendet e Europës Juglindore. Situata e furnizimit me energji elektrike është vështirësuar shumë nga viti 2006, pas mbylljes së centraleve bërthamore në Bullgari, rritjes së kërkesës për energji elektrike dhe krijimit të nyjeve të ngushta të transmetimit në rajonin tonë” (SKE, 2012: 6). Siguria energjetike në nivelin kombëtar, ndikon dhe ndikohet nga siguria energjetike në nivel rajonal. Rritja e kërkesës për energji në nivelin rajonal, shoqërohet me implikime kombëtare pasi të gjithë aktorët e sistemit rajonal rrisin kërkesën e tyre në një kohë që oferta është e kufizuar. Të gjendur përballë kësaj situatë, aktorët mund të ndjekin politika për garantimin e sigurisë së tyre energjetike ose nëpërmjet bashkëpunimit rajonal ose nëpërmjet vendosjes së marrëdhënieve me burime të reja të furnizimit, përtej rajonit. Lëvizja e dytë ka kosto të shtuara për shkak të largësisë gjeografike (rriten kostot e transportit) por nga ana tjetër është e vështirë që aktorët e Europës Juglindore të veçuara, të jenë tërheqës për aktorët kryesor të sistemit ndërkombëtar energjetik. “Duke njohur përfitimet që rrjedhin nga një treg rajonal, krahasuar me ato që vijnë nga tregjet e veçuara nacional, lidhur me furnizimin me energji elektrike, vendet e rajonit nënshkruan Traktatin e Komunitetit të Energjisë” (SKE, 2012: 23). Duke qenë tregje relativisht të vogla, edhe*

kërkesa në terma relativ është e vogël. Bashkëpunimi rajonal mund të shërbejë si një mekanizëm për të tejkaluar këtë problematikë, pasi një treg i integruar rajonal nënkupton nivele më të larta të kërkesës për burime energjetike, duke rritur kështu interesin e aktorëve kryesor global.

Strategjia vijon me përcaktimin e vizionit, prioriteteve dhe qëllimeve strategjike. Vizioni i strategjisë përcakton se *“Qeveria Shqiptare synon të zhvillojë një sistem energjetik të mbështetur në parimet e tregut, i aftë, që të mbulojë kërkesën për energji, për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e mirëqenies me një kosto minimale sociale”* (SKE, 2012: 24). Sikurse vihet re, vizioni përfshin disa ndër dimensionet kryesore të sigurisë energjetike të fokusuara në mirë funksionimin e tregut energjetik dhe zhvillimin e qëndrueshëm, i cili lidhet si me dimensionin ekonomik ashtu edhe me atë mjedisor e social të energjisë. Përmbushja e vizionit, do të arrihet nëpërmjet realizimit të disa objektivave strategjik të lidhura me: ristrukturimin e sektorit energjetik, kuadrin ligjor, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, rritjen e kapaciteteve gjeneruese dhe diversifikimin e tyre, ndërtimin e linjave të reja të interkonjeksionit duke u angazhuar në realizimin e projekteve rajonale të interkonjeksionit me linjat e gazit, përdorimin e burimeve alternative dhe krijimin e tregut të brendshëm dhe integrimin e tij në tregun rajonal (SKE, 2012).

Si përfundim, Strategjia Kombëtare e Energjisë është e ndërtuar në bazë të koncepteve dhe modeleve bashkëkohore mbi sigurinë energjetike. Ajo përfshin si identifikimin dhe analizimin e situatës aktuale, problematikat dhe kufizimet kryesore, ashtu dhe vizionin dhe prioritetet strategjike, me qëllim garantimin e sigurisë energjetike në Shqipëri. Duke theksuar multi dimensionalitetin e fenomenit, nevojën për diversifikimin e energjisë dhe domosdoshmërinë e integritit në tregun rajonal dhe atë ndërkombëtar,

strategjia arrin të përmbushë pritshmërinë nga një dokument i tillë. Kritikrat kryesore që mund t'i bëhen këtij dokumenti strategjik, lidhen me projeksionin kohor të tij dhe fokusimit tek ndryshimet klimaterike. Për sa i përket projeksionit kohor, vlerësimi për strategjinë mund të bëhet vetëm në terma afat shkurtër. Në terma afat mesëm dhe afat gjatë, një strategji e cila përfshin një periudhë shtatë vjeçare, nga 2013 deri në 2020, nuk është një strategji e përshtatshme për të garantuar sigurinë energjetike të një aktori. Strategjitë bashkëkohore të energjisë, por jo vetëm, projektohen për një periudhë nga 25 deri në 50 vite. Është e domosdoshme të theksohet se qasja ndaj sigurisë energjetike kërkon kombinimin e vizionit, faktorëve ekonomik por edhe kohor. Në këtë drejtim, kjo strategji është e pa mjaftueshme. Kritika e dytë lidhet me fokusimin e strategjisë tek ndryshimet klimaterike. Duke marrë në konsideratë faktin se prodhimi i energjisë mbështetet tek burimet hidrike, e cila do të vazhdojë edhe në të ardhmen, atëherë strategjia duhet të trajtojë me kujdes ndryshimet klimaterike. Ky është një problem i cili haset në pjesën më të madhe të politikave dhe dokumenteve strategjike ekzistuese mbi sektorin e energjisë. Garantimi i sigurisë energjetike në Shqipëri nuk do të jetë i mundur nëse ndryshimet klimaterike nuk do të trajtohen me vëmendjen dhe kujdesin e duhur.

6.3.2. Siguria energjetike në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë

Në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (SSK) të Republikës së Shqipërisë, të vitit 2014, çështjet e energjisë zënë një vend të rëndësishëm. Në seksionin 'Domosdoshmëritë Strategjike', çështjet energjetike trajtohen si të lidhura ngushtë me ekonominë dhe pozitën gjeografike të Shqipërisë. Në pikën 3 të këtij seksioni 'Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik' ndër të tjera argumentohet se "*Përzgjedhja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) është tregues i qartë i përparësive të kësaj pozite. Strategjia synon shfrytëzimin efektiv të*

kësaj pozite të favorshme në interes të zhvillimit kombëtar” (SSK, 2014: 7). Nga një pasazh i tillë demonstron perceptimi i aktorëve shtetëror mbi rëndësinë e energjisë si faktor i lidhur me pozitën gjeografike, e cila shërben si një urë lidhëse midis rajoneve të ndryshme. Për më tepër, siguria energjetike shihet si ngushtësisht e lidhur me zhvillimin kombëtar, e për pasojë dhe me interesin kombëtar të Shqipërisë. Sikurse është përmendur dhe më parë në këtë punim, sigurizimi i çështjeve energjetike nga vendet transit, ndër të tjera ka të bëjë me fokusimin në vazhdimësinë e projekteve energjetike ekzistuese dhe përfshirjen në projekte të reja pasi “sigurizimi i energjisë lidhet me sjelljet politike të shteteve drejtë tregjeve energjetike të pa balancuara, të cilat mund të konsiderohen si kërcënime ekzistenciale për objektin referent në lidhje me politikat energjetike të aktorëve prodhues, konsumator dhe transit të energjisë” (Ozcan, 2013: 13). Shqipëria, në mungesë të kapaciteteve për të qenë një prodhues i rëndësishëm dhe në të njëjtën kohë duke qenë një konsumator relativisht i vogël i energjisë, sigurizimin e çështjeve energjetike mund ta fokusojë në raport me transitin e burimeve energjetike. Për pasojë, rëndësia që i është dhënë përfshirjes në projektin TAP, e cila është bërë pjesë e diskurit politik mund të shihet brenda kontekstit të sigurizimit.

Në vazhdim të po këtij seksioni të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, argumentohet se *“për të zhvilluar interesat e sigurisë kombëtare të RSH-së dhe ulur brishtësinë ndaj çrregullimeve të ekonomisë globale, strategjia ekonomike do të qaset drejt diversifikimit të burimeve dhe të kapaciteteve...ne do të ndërthurim elementët kryesorë të fuqisë tonë ekonomike dhe do të nxisim zhvillimin, duke u përqendruar në sektorët strategjikë të energjisë”* (SSK, 2014: 7). Nga një argumentim i tillë, konstatohet se qasja ndaj sigurisë energjetike është e lidhur jo vetëm me pozitën gjeografike, por edhe me dimensionin ekonomik të saj. Fakti se energjia qëndron në themel të zhvillimit të një shoqërie, është e

pasqyruar specifikisht dhe në SSK. Diversifikimi i burimeve, i cili është dhe një nga kushtet themelore për garantimin e sigurisë energjetike, del në mënyrë të qartë në këtë pasazh. Energjia, si një fenomen ndër sektorial i sigurisë, është ngushtësisht e lidhur me sektorin ekonomik të sigurisë. Marrëdhënia midis tyre është reciproke, pasi një aktor i cili karakterizohet nga tregues makroekonomik të ulët, përgjithësisht karakterizohet dhe nga tregues të ulët energjetik dhe anasjelltas. Përveç analizës sektoriale të sigurisë të Buzan, për të identifikuar dhe analizuar dimensionin ekonomik të energjisë na ndihmon dhe qasja e 4-A, ndër të cilat *Accessibility* [Aksesi lidhet me kapacitetet reale dhe potenciale të një aktori për t'u furnizuar me burimet energjetike të disponueshme] dhe *Affordability* [Përballueshmëria është e lidhur kryesisht me kostot financiare të aksesit në burimet e disponueshme energjetike] luajnë rol të rëndësishëm në këtë aspekt. Edhe pse këto element nuk i gjejmë të specifikuar në SSK, fryma e përgjithshme e saj kur trajton çështjet energjetike i ka pjesë integrale të saj.

Përsa i përket *Acceptability* [Pranueshmëria e përdorimit të burimeve dhe llojeve të ndryshme të energjisë, lidhet me impaktin e tyre social dhe mjedisor] (APEREC, 2007), në SSK argumentohet se “*Strategjia nxit një shfrytëzim të balancuar, të kursyer dhe të kujdesshëm të burimeve natyrore duke mbajtur në konsideratë karakterin e fundëm të tyre dhe interesat e ligjshme të brezave të ardhshëm*” (SSK, 2014: 8). Nëpërmjet këtij formulimi demonstrohen disa nga elementët dhe karakteristikat kryesore të energjisë. Shfrytëzimi optimal i burimeve energjetike, është një ndër parakushtet kryesore për të garantuar sigurinë energjetike. Pavarësisht sasive të burimeve energjetike në dispozicion, çdo aktor duhet të kujdeset për t'i shfrytëzuar ato në mënyrë të balancuar, të kursyer dhe të kujdesshme. Këto element pasqyrojnë dimensionin ekonomik, mjedisor dhe social të energjisë. Dimensionin ekonomik lidhet me kostot e aksesit dhe përdorimit të energjisë, e cila duke qenë një

produkt i kërkuar ka dhe një çmim relativisht të lartë. Dimensioni mjedisor lidhet me pasojat që vijnë nga një keq përdorim i energjisë. Pasojat negative në mjedis mund të lidhen si me emetimin e gazrave të dëmshëm në atmosferë ashtu edhe me dëmtimet mjedisore si pasojë e ndërtimit të hidrocentraleve të reja në ato zona ku mund të dëmtohet ekosistemi apo keq menaxhimi i mbetjeve të burimeve energjetike. Dimensioni social i energjisë lidhet me aksesin jo të barabartë të popullsisë në burimet energjetike. Kufizimi i aksesit mund të lidhet me kufizimet financiare (individët nuk janë në gjendje të paguajnë energjinë) por dhe me kufizime infrastrukturore (zona të caktuara nuk kanë akses në energji si pasojë e amortizimit të infrastrukturës energjetike ose mungesës së saj). Burimet energjetike, duke qenë një e mirë publike dhe të kufizuara [karakteri i fundëm i tyre], duhet të përdoren në mënyrë optimale pasi janë pjesë e trashëgimisë për brezat e ardhshëm.

Në përcaktimin e objektivave për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, SSK përfshin disa nga elementet themelore të sigurisë energjetike. Së pari, Strategjia thekson dimensionin ndërkombëtar dhe rajonal të sigurisë energjetike. Duke përcaktuar si objektiv themelor *“nxitjen e projekteve strategjike për ndërtimin e një aksi të rëndësishëm ndërkombëtar që lidh një port në bregun shqiptar të Detit Adriatik (Mesdheun) me Detin e Zi, përmes lidhjes rrugore, hekurudhore, energjetike dhe të telekomunikacionit* (SSK, 2014: 8), ajo dëshmon faktin se siguria energjetike, si një fenomen përtej kufijve kombëtar, është një çështje e cila për t’u trajtuar ka nevojë për një bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar. Pavarësisht fuqisë energjetike që mund të ketë një aktor në sistemin ndërkombëtar, është në interesin e tij primar për t’u përfshirë në marrëdhënie me aktorë të tjerë. Lloji i marrëdhënies, si një marrëdhënie varësie apo ndërvarësie, është një moment i rëndësishëm për të analizuar ndikimin e energjisë në politikat kombëtare dhe ndërkombëtare. Nëse Shqipëria, do të perceptojë një marrëdhënie të caktuar energjetike si një marrëdhënie të

varësisë negative, atëherë është e nevojshme që çështja të sigurohet me qëllim tejkalimin e kërcënimeve që mund të vijnë nga një situatë e tillë.

Në të njëjtën linjë, SSK përcakton dhe objektivin tjetër për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, sipas së cilit *“nxitja e projekteve për ndërtimin e një korridori të rëndësishëm rrugor, hekurudhor dhe energjetik veri-jug në Shqipëri, i cili do të lidhë Europën Qendrore me jugun e gadishullit ballkanik përmes Shqipërisë, duke përshkruar vijën bregdetare shqiptare”* (SSK, 2014: 8). Sikurse vihet re, edhe ky objektivi ndërtohet mbi bazën e të njëjtës logjikë sikurse dhe të objektivit të parë. Objektivi i parë dhe i dytë, duket sikur ndërtojnë dy korridore imagjinare energjetike, të cilët jo vetëm që e përfshijë Shqipërinë në sistemin energjetik ndërkombëtar, por i japin asaj një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim. Përmbyllja e një objektivi të tillë do të jetë e varur si nga faktorët e brendshëm ashtu edhe të jashtëm. Duke qenë se aftësia për të kontrolluar faktorët e jashtëm është relativisht e kufizuar, është e nevojshme që të bëhen përpjekjet maksimale për të përmbyllur këtë objektivi në pjesën e faktorëve të brendshëm. Realizimi i saj mund të arrihet vetëm nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe vullnetit të aktorëve të brendshëm. Kjo nënkupton se çështjet energjetike duhet të kalojnë nëpërmjet një procesi të suksesshëm sigurizimi.

Objektivi i tretë përcakton se duhet *“inkurajuar rritja e vlerës së burimeve natyrore përmes përpunimit sa më të thellë të tyre në vend dhe dekurajimit të eksporteve të lëndëve të para të papërpunuara”* (SSK, 2014: 8). Një qëndrim i tillë lidhet me atë që në aspektin teorik i referohemi si nacionalizimi i burimeve vendase. Kjo nuk nënkupton shtetëzimin e resurseve, ato energjetike në rastin konkret, por thekson rëndësinë e maksimizimit të përfitimeve nga shfrytëzimi i pasurive kombëtare. Vetëm nëpërmjet vlerësimit dhe trajtimit korrekt të pasurive kombëtare, aktorët do të hyjnë në marrëdhënie me aktorë të tjerë ku

përfitimi do të jetë reciprok. Një ndër arsyt kryesore që shpjegon vështirësitë me të cilat përballen disa aktorë, pavarësisht pasurive të shumta energjetike të tyre, lidhet me mos zbatimin e këtij parimi shumë të rëndësishëm.

“Zbatimi i një strategjie kombëtare, transparente dhe të integruar, për garantimin e sigurisë energjetike, duke shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme pasuritë ujore, diversifikuar burimet e prodhimit të energjisë dhe realizuar lidhje efektive me rrjetet rajonale dhe Europiane të transmetimit bashkë me krijimin e rrjetit dhe tregut të brendshëm të gazit” (SSK, 2014: 9), është një tjetër objektiv i Strategjisë në të cilën ngërthehen disa nga parimet dhe elementët kryesor të sigurisë energjetike, të cilat dëshmojnë dhe karakteristikat e sistemit energjetik të Shqipërisë dhe masat e nevojshme që duhen ndërmarrë. Karakteristikë e sistemit energjetik shqiptar është mbështetja tek një burim i vetëm energjetik, tek burimet hidrike. Mbështetja tek një burim i vetëm është problematik, dhe përbën kërcënim për sigurinë energjetike, pasi burimet hidrike janë të varura ndër të tjera dhe nga kushtet klimaterike. Mungesa e kapaciteteve depozituese të periudhave me reshje të shumta, dhe niveli i ulët i prodhimit të energjisë në periudha thatësire, dëshmojnë nga njëra anë lidhjen midis prodhimit të energjisë dhe faktorëve klimaterik dhe nga ana tjetër dëshmojnë rëndësinë e diversifikimit të burimeve energjetike. Sikurse vihet re një domosdoshmëri e tillë theksohet dhe në këtë objektiv të SSK. Diversifikimi i burimeve ka dy dimensione. Dimensioni i parë lidhet me diversifikimin e aktorëve nga të cilët importohet energjia, ndërsa dimension i dytë lidhet me diversifikimin e llojeve të energjive që një aktor ka në dispozicion dhe përdor. Ky dimension lidhet me atë që njihet si ‘energji mix’. Të dy dimensionet janë element shumë të rëndësishëm në garantimin e sigurisë energjetike të një vendi.

Element të tjerë të cilët theksohen në këtë objektiv lidhen me përfshirjen në rrjetet rajonale dhe Europiane të transmetimit, sikurse dhe me krijimin e rrjetit dhe tregut të brendshëm të gazit. Këto objektiva janë pjesë të procesit të diversifikimit të energjisë. Nëpërmjet përfshirjes në rrjetet rajonale dhe Europiane, Shqipëria do të arrinte të përmbushte kërkesat e saj energjetike nga njëra anë, por nga ana tjetër do të përforconte pozitat e saj brenda sistemit energjetik dhe për pasojë të përforconte dhe pozitat e saj në aspektin gjeopolitik, ku përfshirja në gazsjellësin TAP do të ndihmonte në arritjen e këtij objektivi. Përfshirja e Shqipërisë në TAP, nuk lidhet vetëm me aspektet ekonomike dhe energjetike, por ka dhe një dimension gjeopolitik brenda saj. Është në dorën e aktorëve të brendshëm për të maksimizuar përfitimet multidimensionale që vijnë nga një projekt i tillë. Këto përfitime nuk vijnë vetvetiu, është e nevojshme që aktorët e brendshëm të identifikojnë, analizojnë dhe ndërgjegjësohen për përfitimet e mundshme, e cila mund të bëhet nëpërmjet një procesi të suksesshëm sigurizimi.

Një tjetër objektiv, po kaq i rëndësishëm i SSK, thekson domosdoshmërinë për *“zbatimin dhe monitorimin e politikave për të zhvilluar burimet natyrore në mënyrë transparente, të qëndrueshme dhe të kontrolluar”* (SSK, 2014: 9). Sikurse është argumentuar dhe më parë, politikat energjetike kanë qëllime ekonomike, mjedisore dhe sigurie (Holdren, 2007). Këto qëllime janë në interesin kombëtar të aktorëve, prandaj çdo abuzim me pasuritë kombëtare, veçanërisht ato energjetike, përbën një kërcënim për sigurinë energjetike në veçanti dhe atë kombëtare në përgjithësi, pa përmendur implikimet rajonale dhe ndërkombëtare që mund të vijnë nga një situatë e tillë. Historia dhe të dhënat dëshmojnë se burimet energjetike në Shqipëri janë keqpërdorur, pasi prioritet ka qenë interesi ekonomik i individëve apo kompanive të cilat kanë (keq)përdorur këto burime dhe jo interesi kombëtar. Duke qenë se në sistemin energjetik veprojnë aktor shtetëror dhe jo

shtetëror, të cilët veprojnë në bazë të logjikave dhe interesave të ndryshme, për aq kohë sa këto interesa nuk do të harmonizohen, siguria energjetike dhe ajo kombëtare do të jenë në kërcënim të vazhdueshëm.

Kërcënimet ndaj sigurisë energjetike, janë çështje të cilat janë e evidentuar në shtojcën e SSK, Analiza e Rreziqeve. Ndër të tjera argumentohet se *“Kapacitetet aktuale të sistemit energjetik kombëtar nuk garantojnë siguri të qëndrueshme energjetike për vendin. Kostot e larta që Shqipëria detyrohet të përballojë, duke ju drejtuar tregut ndërkombëtar për të siguruar energjinë, pengojnë investimet e domosdoshme në përmirësimin e rrjetit elektroenergjetik shqiptar. Sistemi elektroenergjetik ka një borxh të brendshëm të konsiderueshëm, duke e rënduar edhe më shumë brishtësinë e sigurisë energjetike. Problematika e sistemit të energjisë ndikon negativisht në interesin e investitorëve të huaj për të investuar në Shqipëri, veçanërisht në fushat e industrisë dhe turizmit. Elementë kritikë të infrastrukturës, të natyrës energjetike, informatike, e telekomunikimit, rrugore apo aeroportuale mbeten të cenueshme. Mbrojtja e inventarit aktual të kësaj infrastrukture dhe përgatitja për mbrojtjen e infrastrukturës së re nga aktet e vandalizmit, sabotazhit, terrorizmit dhe të pakujdesisë njerëzore përbën investim të domosdoshëm për sigurinë e vendit”* (SSK, 2014: 21). Në këtë pasazh ritheksohen dhe njëherë si rëndësia e sigurisë energjetike për sigurinë kombëtare, ashtu dhe situata aktuale dhe sfidat e saj. Disa nga elementët kryesor të lidhura me sigurinë energjetike, janë:

- ***Qëndrueshmëria*** – është një ndër kriteret themelore të sigurisë energjetike, e cila përfshihet në pjesën më të madhe të përkufizimeve mbi sigurinë energjetike (IEA 2008; APERC 2007; Yergin 2006; Ebinger 2011). Çdo ndërprerje e furnizimit të vazhdueshëm me energji, përbën kërcënim për sigurinë energjetike.

- ***Kostot e larta, borxhi i brendshëm dhe investimet e huaja*** – çmimi i energjisë dhe kostot financiare të aksesit në burime energjetike, janë element të cilët i gjejmë në përkufizimet e termit, së bashku me qëndrueshmërinë. Ky element është një tregues i lidhjes midis sigurisë energjetike me atë ekonomike, por shoqërohet dhe me një dimension social, duke pasur në konsideratë se rritja e çmimit të energjisë mund të provojë aktorët nga aksesit në të.
- ***Tregu ndërkombëtar*** – dëshmon implikimet rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë energjetike. Pavarësisht rolit të aktorit në sistemin ndërkombëtar si prodhues, konsumator apo vend transit, ai duhet të bëhet pjesë e një tregu energjetik, përfshirje e cila mund të krijojë varësi negative ose ndërvarësi. Situatat të cilat mund të karakterizohen si ndërvarësi negative janë një kërcënim themelor për sigurinë energjetike dhe kombëtare dhe për pasojë menaxhimi i situatës mund të arrihet nëpërmjet sigurizimit.
- ***Infrastruktura kritike*** – e varur nga siguria energjetike, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë sektorët e sigurisë. Kërcënimi ndaj infrastrukturës kritike nënkupton kërcënim të sigurisë kombëtare dhe komponentëve të saj.
- ***Kërcënimet që vijnë nga vandalizmi, sabotazhi dhe terrorizmi*** – përbëjnë një kategori të veçantë të kërcënimeve ndaj sigurisë energjetike. Sulmet ndaj infrastrukturës energjetike janë atraktive për aktorët që përdorin teknika të tilla, pasi ato e shohin sigurinë energjetike si një komponent shumë të rëndësishëm të sigurisë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Kjo nënkupton se infrastruktura energjetike nuk është qëllimi final, por është mjeti që i çon ata drejtë përmbushjes së qëllimit të tyre, i cili lidhet me kërcënimin ndaj sigurisë kombëtare. Kjo kategori e kërcënimeve

ndaj sigurisë energjetike, është trajtuar gjerësisht në literaturën mbi çështjet e sigurisë energjetike (Redegwell 2004; Yergin 2006; APERC 2007).

Në SSK, një vend të veçantë zë dhe shtojca Klasifikimi i Rreziqeve. Sikurse shpjegohet dhe në këtë dokument, metodologjia e përdorur për të klasifikuar rreziqet bëhet duke shqyrtuar dy parametra kryesore që janë: gjasat e shfaqjes së rrezikuar dhe pasojat që mund të shkaktojnë për sigurinë kombëtare (SSK, 2014: 25). Duke i kategorizuar rreziqet në tre nivele, në bazë të kombinimit të dy parametrave të mësipërme, në SSK rreziqet e nivelit të parë, të cilat kanë prioritetin më të lartë për sigurinë dhe gjasat e shfaqjes e pasojat e tyre vlerësohen të larta, përfshihen:

- Korrupsioni dhe krimi i organizuar;
- Kriza energjetike, që kërcënon sigurinë e furnizimit të RSH-së dhe cenon rritjen ekonomike;
- Mangësitë në kontrollin dhe administrimin e territorit, që kërcënojnë sigurinë individuale dhe favorizojnë trafiket e ndryshme;
- Sulmet kibernetike nga aktorë shtetërorë ose jo shtetërorë;
- Degradimi mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore; shkatërrimi i mjedisit, shpyllëzimi, ndotja e lumenjve dhe fatkeqësitë natyrore industriale apo të shkaktuara nga ndikimi i njeriut (SSK, 2014: 25).

Sikurse vihet re, siguria energjetike bën pjesë në kategorinë e parë të kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare të Shqipërisë. Kërcënimet ndaj saj, të emërtuara si kriza energjetike kanë gjasa të larta për t'u shfaqur sikurse dhe pasoja të larta për sigurinë kombëtare. Sikurse theksohet, siguria energjetike lidhet ngushtësisht me rritjen ekonomike. Në një analizë më të hollësishme, mund të themi se siguria energjetike është e lidhur drejtpërdrejtë dhe me kërcënimet e tjera të kësaj kategorie. Nivelet e larta të korrupsionit, në sektorin energjetik

kanë pasoja të dëmshme për sigurinë energjetike. Në Shqipëri, ky është një fenomen i cili është bërë pjesë e diskurit në shumë raste. Mjaftojmë të përmendim, raste të tilla si prishja e kontratës me CEZ, apo aferën CEZ-DIA, si raste të veshura me hijen e korrupsionit. Këto raste kanë implikim të drejtpërdrejtë në sigurinë energjetike, për pasojë dhe në atë kombëtare, duke ndikuar dhe në sektorët e tjerë të sigurisë e kryesisht në atë ekonomik. Sektori energjetik, mund të kthehet në një objektiv dhe për krimin e organizuar, i cili mund ta përdorë përfshirjen në të si një mënyrë për pastrimin e parave. Nga ana tjetër, sulmet kibernetike nga aktorë shtetëror dhe jo shtetëror ndaj infrastrukturës energjetike, sikurse u përmend dhe më lart, përbëjnë një kërcënim serioz për sigurinë energjetike. Për më tepër, degradimi mjedisor përbën një tjetër kërcënim ndaj sigurisë energjetike, e cila lidhet ngushtësisht me sigurinë mjedisore. Në rastin e Shqipërisë, prodhimi energjetik i së cilës bazohet në burimet hidrike, lidhja mjedis – energji kthehet akoma në më problematike.

Përpos aspekteve pozitive të këtij dokumenti, janë disa momente të cilat mund të kërkonin një kujdes më të veçantë. Në seksionin ‘Domosdoshmëritë Strategjike’, pika 7 i referohet Forcimit të rolit rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë. Nga analiza e kësaj pike, konstatohet se çështjet energjetike nuk evidentohen në mënyrë të drejtpërdrejtë si të lidhura me forcimin e rolit rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë. Kjo mund të klasifikohet si një mangësi apo kritikë e këtij dokumenti, pasi sikurse u theksua dhe më lart çështjet energjetike kanë dimension rajonal dhe ndërkombëtar. Është e nevojshme që aktorët të ndërgjegjësohen për rëndësinë e këtij fenomeni, i cili nëse trajtohet në mënyrën e duhur, mund të shërbejë si promotor i fuqizimit të Shqipërisë. Dikush mund të argumentojë se çështjet energjetike në këtë seksion përfshihen brenda sektorit ekonomik pasi strategjia ndër të tjera e lidh fuqizimin me *“marrëdhëniet e konsoliduara dypalëshe me partnerët tradicionalë dhe zgjerimi i rrjetit të partnerëve Europeanë dhe globalë, në funksion të*

integritit European dhe zhvillimit ekonomik... Forcuar bashkëpunimin ndërshtetëror për të hequr barrierat dhe lehtësuar shkëmbimet në funksion të krijimit të tregu të hapur dhe të lirë rajonal, si parakusht për integrimin European dhe euroatlantik të rajonit... Orientuar politikën e jashtme edhe drejt qendrave të reja të zhvillimit dhe vendimmarrjes globale, me qëllim zgjerimin e partnerëve ekonomikë dhe tregtar, thithjen e investimeve të huaja dhe rritjen e shkëmbimeve.” (SSK, 2014: 13-14).

Dikush tjetër mund të argumentojë se strategjia e përfshin sigurinë energjetike në seksionin vijues, në pikën 8 Përshpejtimi i procesit të integritit në Bashkimin European, si pjesë përbërëse të sektorit mjedisor të sigurisë, objektiv i cili argumenton se do të përmbushet nga *“Parandalimi i degradimit mjedisor dhe reduktimi i pasojave të ndryshimeve klimatike, duke menaxhuar me efektivitet basenet ujore, shtuar sipërfaqet pyjore, trajtuar në mënyrë të integruar mbetjet urbane, si dhe duke bashkëpunuar me shoqërinë civile për ndërgjegjësimin e opinionit publik për ruajtjen e mjedisit* (SSK, 2014: 15). Të tjerë mund të argumentojnë se SSK, duke qenë një dokument gjithëpërfshirës dhe i hartuar në vetëm 25 faqe, nuk mundet të prekë çështjet energjetike në çdo seksion të saj. Por, duke u nisur nga rëndësia e sigurisë energjetike, multi dimensionaliteti i saj, implikimet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, dhe mundësitë që ofron për Shqipërinë, mund të themi se energjia duhet të ishte një ndër pikat themelore në lidhje me fuqizimin rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë. Përfshirja në projektet energjetike rajonale dhe ndërkombëtare, sikurse është argumentuar dhe më parë, do të forconin pozitën gjeopolitike të Shqipërisë. Identifikimi, vlerësimi, ndërgjegjësimi dhe sigurizimi i çështjeve energjetike do të shërbenin për arritjen e këtij objektiv.

Si përfundim mund të themi se Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë e vitit 2014, trajton në mënyrë të detajuar vendin dhe rolin e sigurisë energjetike,

si një ndër komponentët kryesor të sigurisë kombëtare. Ky është një dokument i ndërtuar mbi parimet dhe dimensionet bashkëkohore të sigurisë energjetike në veçanti dhe asaj ndër/kombëtare në përgjithësi. Por, sikurse dhe në tërësinë e politikave kombëtare, problematika kryesore nuk qëndron në hartimin por në implementimin e politikave dhe strategjive. Duke marrë në konsideratë dinamikën e zhvillimeve kombëtare, rajonale dhe globale, rishikimi i SSK duhet bërë me një frekuencë 2- vjeçare dhe jo pas 5 vitesh. Në shtojcën D – Përgjegjësitë Institucionale për Zbatimin e SSK-së, nuk specifikohet siguria energjetike si objektiv, dhe për pasojë nuk identifikohet institucioni/et përgjegjëse dhe ato mbështetëse. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e sigurisë energjetike, është e domosdoshme që çështjet e energjisë të kthehen në prioritet të axhendave politike, dhe të jenë pjesë e procesit të sigurizimit duke qenë se energjia është një çështje ndër sektoriale dhe me implikime kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

6.3.3. Siguria energjetike në Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë

Strategjia Ushtarake (SU) e Republikës së Shqipërisë, e miratuar në vitin 2015, “*bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe në Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë... dhe hartohet në përputhje me Konceptin Strategjik të NATO-s*” (SU, 2015: 8). Pavarësisht se ky dokument fokusohet kryesisht në aspektin e mbrojtjes dhe të forcave të armatosura, në të trajtohen një sërë aspektesh të sigurisë bashkëkohore, ku siguria energjetike zë një vend të rëndësishëm. Duke theksuar rëndësinë e pozitës gjeografike dhe të bashkëpunimit rajonal, në dokument argumentohet se “*pozicioni gjeostrategjik i Ballkanit i ka dhënë shansin të kthehet në nyje lidhëse të projekteve ekonomike, energjetike, të infrastrukturës...*” (SU, 2015: 13). Në këtë mënyrë, dokumenti thekson si rëndësinë e pozitës gjeografike në sigurinë kombëtare dhe

rajonale ashtu edhe krijimin e ndërvarrësisë rajonale në funksion të garantimit të mbrojtjes dhe të sigurisë.

Një tjetër element i rëndësishëm i cili theksohet në këtë dokument lidhet me ndikimin e aktorëve të ndryshëm në rajonin e Ballkanit. *“Rajoni i Ballkanit, nga pikëpamja gjeostrategjike, përfaqëson një zonë të diversitetit kulturor, fetar, ideologjik, si dhe të konkurrencës për influenca politiko-ekonomike”* (SU, 2015: 14). Nëse ky argument vendoset në kontekstin e sigurisë energjetike në rajonin e Ballkanit, dy mund të jenë implikimet kryesore. Implikimi i parë lidhet me konkurrencën e brendshme në nivelin rajonal, ku shtete të ndryshme e bazojnë garantimin e sigurisë energjetike në instrumente individual dhe jo rajonal. Një qasje e tillë është problematike, pasi garantimi i sigurisë energjetike i një aktori nuk mund të arrihet jashtë kontekstit rajonal në të cilin ai është i pozicionuar. Implikimi i dytë lidhet me ndikimet që vijnë në rajonin e Ballkanit, si pasojë e influencave politiko-ekonomike të aktorëve të tillë si Rusia, BE-ja dhe SHBA-të. Nga njëra anë Rusia kërkon të ruajë dhe të shtojë ndikimin e saj në rajonin e Ballkanit, ndikim të cilin e ushtron nëpërmjet përdorimit të energjisë si instrument i politikës së jashtme. Nga ana tjetër, perspektiva euroatlantike e vendeve të Ballkanit mund të konsiderohet si ushtrim i ndikimit të SHBA-së dhe BE-së, nëpërmjet përdorimit të ‘soft power’.

Në një tjetër seksion të dokumentit, ‘Kërcënime, rreziqe dhe sfida jo konvencionale’, theksohet në mënyrë të tërthortë dimensionin mjedisor i sigurisë energjetike, duke argumentuar se *“fatkeqësitë e mundshme natyrore, si tërmetet, përmytjet... përbëjnë një tjetër rrezik për sigurinë kombëtare... Ato mund të vijnë edhe nga veprimtaria njerëzore aksidentale apo edhe nga veprimet kriminale, terroriste... Ndotja e mjedisit, kufizimi i burimeve, ndryshimet e klimës, mungesa e ujit përbëjnë rrezik për sigurinë”* (SU, 2015: 15). Një deklaram i tillë nxjerr në pah kompleksitetin e sigurisë energjetike dhe dimensionet e

shumta të saj. Së pari, fatkeqësitë natyrore mund të jenë si produkt i synimit për të prodhuar energji ashtu edhe kërcënim për sigurinë energjetike. Nëpërmjet keqpërdorimit të ekosistemit për të garantuar prodhimin e energjisë, aktorët mund të sjellin pasoja degraduese për mjedisin. Nga ana tjetër, fatkeqësitë natyrore mund të përbëjnë kërcënim për sigurinë energjetike pasi dëmtojnë si infrastrukturën e prodhimit të energjisë, ashtu edhe transmetimin e saj. Në rastin e Shqipërisë, ku prodhimi i energjisë është i bazuar tek burimet hidrike, lidhja midis sigurisë mjedisore dhe sigurisë energjetike është akoma dhe më e rëndësishme. Kombinimi i kërcënimeve ndaj këtyre sektorëve të energjisë, përbën kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë kombëtare.

Një tjetër kërcënim potencial ndaj sigurisë energjetike dhe asaj kombëtare, i evidentuar në SU, është kërcënimi nga sulmet kibernetike pasi *“objektiva të këtyre sulmeve mund të jenë... sistemet e transportit dhe furnizimit, sistemi energjetik...”* (SU, 2015: 15). Zhvillimi i teknologjisë dhe modernizimi i infrastrukturës energjetike përveç ndikimit pozitiv në garantimin e sigurisë energjetike, ndikojnë dhe në rritjen e vulnerabilitetit të këtyre sistemeve nga sulmet kibernetike. Këto kërcënime ndaj sigurisë energjetike, përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare pasi ndikojnë në efikasitetin e sistemeve dhe institucioneve të mbrojtjes. Përveç kërcënimeve të qëllimshme, siguria energjetike nën optikën e zhvillimit teknologjik, mund të kërcënohet dhe nga aksidentet apo gabimet njerëzore.

Në të njëjtën logjikë, në po këtë seksion të SU evidentohet si kërcënim ndaj sigurisë kombëtare, cënimi ndaj infrastrukturës transportuese dhe transituese. *“Cënimi i linjave kryesore të komunikimit dhe furnizimeve, si: siguria e linjave të energjisë, konkurrenca për naftë dhe burime të tjera strategjike përbëjnë kërcënim për sigurinë. Varësia e Shqipërisë nga një numër i kufizuar furnizuesish rrit nivelin e cënueshmërisë, i cili mund të shkaktohet*

nga shkaqe teknike apo edhe politike” (SU, 2015: 16). Në këtë pasazh dalin në pah disa ndër elementët kryesor të sigurisë energjetike. Së pari, rëndësia e infrastrukturës së transportit dhe transitimit të energjisë në sigurinë energjetike. Kur analizohet gjendja e sigurisë energjetike dhe kërcënimeve ndaj saj, duhet të mbahet në konsideratë e gjithë infrastruktura energjetike, nga prodhimi tek transmetimi dhe deri tek konsumatori fundor. Kërcënimi ndaj një hallke të këtij sistemi, përbën kërcënim për sistemin në tërësi. Së dyti, konkurrenca për produktet energjetike. Duke qenë se të gjithë aktorët janë të interesuar për burimet energjetike, të cilat janë të kufizuara, dy janë implikimet e mundshme të situatës. Implikimi i parë është vajtja drejtë konfliktit (ekonomik, politik e deri tek ai ushtarak) nëse aktorët nuk arrijnë të ndërtojnë ura bashkëpunimi. Implikimi i dytë i mundshëm është intensifikimi i bashkëpunimit në sektorin energjetik, i cili mund të ndihmojë në intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik dhe atij politik. Kjo do bëhej e mundur vetëm nëse aktorët do të ndërjegjësoheshin mbi domosdoshmërinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të sigurisë energjetike, në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Së treti, kërcënimi që vjen si pasojë e varësisë së lartë. Duke qenë se Shqipëria karakterizohet nga varësia tek një numër i vogël furnizuesish, atëherë një gjendje e tillë përbën kërcënim si për sigurinë energjetike, ashtu edhe për sigurinë kombëtare. Për të tejkaluar këtë problematikë është e nevojshme që çështjet e energjisë të sigurohen dhe diversifikimi të përcaktohet si prioritet në axhendën politike. Së katërti, kërcënimet teknike dhe politike. Gama e kërcënimeve ndaj sigurisë energjetike lëviz në një spektër shumë të gjerë. Kërcënimet teknike, të cilat variojnë nga humbjet teknike në rrjet e deri tek niveli i zhvillimit teknologjik i sistemit energjetik, mund të përbëjnë kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj sigurisë energjetike. Po kaq problematike mund të jenë dhe kërcënimet e natyrës teknike, të cilat variojnë nga mungesa e strategjive të

përshtatshme për garantimin e sigurisë energjetike dhe deri tek mosmarrëveshjet apo konfliktet e natyrës politike midis aktorëve të ndryshëm të tregut energjetik.

Sikurse vihet re, Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë është formuluar mbi parimet dhe konceptet bashkëkohore të sigurisë dhe të mbrojtjes. Duke ndjekur linjën e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, ajo identifikon dhe analizon problematikat kryesore të sigurisë, ku siguria energjetike zë një vend të rëndësishëm në këtë aspekt. Duke qenë një dokument strategjik, SU vendos prioritetet kombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, prandaj bazuar në qëllimet e një dokumenti të tillë, mund të arrihet në konkluzionin se dokumenti trajton në mënyrë të përshtatshme sfidat ndaj sigurisë kombëtare, bazuar në modelet bashkëkohore dhe në harmoni me parimet themelore të mbrojtjes dhe sigurisë së përbashkët me vendet aleate.

6.4. (Mos) Sigurizimi i çështjeve energjetike

Një proces i suksesshëm sigurizimi nënkupton përmbushjen e një sërë etapash, të cilat kanë të bëjnë me: identifikimin e problematikës dhe objektin referues; aktorin sigurizues; aktin e ligjërimit; sigurizimin dhe marrjen e masave; dhe desigurizimin. Suksesi i këtij procesi varet dhe nga aftësia e aktorit sigurizues për të bindur audiencën për ekzistencën e kërcënimit ekzistencial. Sikurse është trajtuar dhe më parë në këtë punim, çështjet e energjisë mund të përfshihen në procesin e sigurizimit, për shkak të implikimit të tyre në sigurinë kombëtare të një vendi. Sigurizimi i energjisë ka shërbyer në një sërë rastesh si alternativë e përshtatshme për garantimin e sigurisë energjetike. Por si shfaqet situata në Shqipëri? A janë përfshirë çështjet energjetike në procesin e sigurizimit, si mënyrë për të minimizuar kërcënimet ndaj sigurisë energjetike dhe asaj kombëtare? Cilat kanë qenë arsyet e një sjellje të tillë, duke ditur se siguria energjetike në Shqipëri kërcënohet nga një sërë problematikash?

Në periudhën kohore nga 2005 deri në 2015, e cila përbën dhe fokusin kohor të punimit, momenti kryesor në të cilën shfaqen shenja të procesit të sigurizimit dhe që mund të shërbejë si rast studimor për këtë seksion, lidhet me aksionin e dy viteve të fundit të ndërmarrë nga qeveria. Ky mund të shërbejë si rasti më i përshtatshëm studimor, pasi janë ndërmarrë disa hapa të cilat e bëjnë rastin më të veçantë, duke nisur nga fushata sensibilizuese për rëndësinë e pagesës së faturave të energjisë e deri tek burgosja e individëve për lidhje të paligjshme. Për të analizuar rastin studimor, duhen ndjekur fazat e një procesi sigurizimi.

Identifikimi i problematikës dhe objekti referues – problematika e procesit të sigurizimit në këtë rast lidhet me energjinë elektrike. Fakti se problemet energjetike përbëjnë kërcënim si për sigurinë energjetike ashtu edhe atë kombëtare, është trajtuar dhe më parë si në aspektin teorik ashtu edhe të rasteve të tjera të marra në analizë, si në rastin e BE-së ashtu edhe të Ballkanit si nivele analize. Implikimet e sigurisë energjetike janë multi dimensionale dhe si të tilla ato prekin çdo hallkë të shoqërisë. Prandaj objekti referues është shteti, sektorët e ndryshëm shoqëror dhe individët. Mungesa e diversifikimit dhe varësia e lartë nga një burim i vetëm, infrastruktura energjetike e vjetruar, niveli i lartë i humbjeve teknike dhe jo teknike, dimensionimi ekonomik, social dhe mjedisor i energjisë, përbëjnë kërcënim për sigurinë energjetike dhe atë kombëtare.

Aktori sigurizues – aktori sigurizues në këtë rast ka qenë qeveria dhe institucionet në varësi të saj. Duke qenë një çështje e cila prek në mënyrë të drejtpërdrejtë sigurinë kombëtare, zhvillimin dhe prosperitetin e vendit, atëherë roli i qeverisë si aktor sigurizues është më se i përshtatshëm pasi supozohet se veprimet e saj të mbështeten në logjikën e interesit kombëtar. Mbështetja tek një logjikë e tillë ka implikim të drejtpërdrejt pozitiv në shoqëri si një e tërë. Disa sektor mund t'i ndjejnë efektet pozitive në terma afat shkurtër e

disa të tjerë në terma afatgjatë, por në kompleksitetin e fenomenit e gjithë shoqëria ndikohet pozitivisht.

Akti i ligjërimit – çështjet e energjisë kanë qenë pjesë e diskurit politik të qeverisjes aktuale që në periudhën e fushatës elektorale, por formalizimi i këtyre çështjeve do të niste pas ardhjes në pushtet, në 2013. Në konferencën “Takimi kombëtar, Mbrojtja e energjisë dhe lufta ndaj krimit urban dhe mjedisor, sfida të përgjegjësisë publike”, të mbajtur më 27 Tetor 2014, Kryeministri Rama do të deklaronte nisjen e aksionit kundër vjedhjes së energjisë elektrike. Në fjalën e tij, Kryeministri Rama deklaroi se: “Aleanca për Shqipërinë Europiane, qoftë në procesin legjislativ, qoftë në procesin ekzekutiv synon me patjetër të bëjë një kapërcim historik nga një Shqipëri, ku vjedhja e energjisë është legalizuar dhe pranuar botërisht, politikisht dhe madje edhe ligjërisht, përderisa është bërë e pandëshkueshme për 20 vjet me radhë, në një Shqipëri ku vjedhja e energjisë të përfshihet njësoj si gjithë vjedhjet e tjera, një krim i dënueshëm dhe në rast përsëritjeje përsëri i dënueshëm edhe më shumë... Shqipëria sektorin energjetik e ka burimin kryesor të problemit të vet me të ardhmen... Arsyeja pse ne jemi këtu është për të çelur një operacion masiv, një operacion të thellë që synon të kthejë përfundimisht faqen në këtë sektor, duke kthyer përfundimisht energjinë nga një pasuri që mund të vidhet lirisht, në një burim mirëqenieje dhe rritje ekonomike, një burim përfitimi për Shqipërinë dhe shqiptarët, me premisën që kushdo që e konsumon e paguan... Të gjitha këto janë konstatime që ne i kemi adresuar përmes ndryshimeve që kemi propozuar dhe kemi arritur të bëjmë qoftë në Kodin Penal, qoftë në legjislacion, qoftë në akte nënligjore dhe sot, ne jemi të gatshëm që të shkojmë më tutje, sepse kemi vendosur një bazë mbi të cilën ta bëjmë operacionin jo një fushatë që fillon sot dhe mbaron pas një muaji, por një proces që do të duhet të ndalet vetëm atëherë, kur gjithçka të jetë vendosur në binarët e ligjshmërisë dhe kur askujt të mos i

shkojë ndërmend që duke vjedhur energjinë elektrike ka shpëtim”³⁰. Në të njëjtën linjë, si kryeministri ashtu edhe ministrat kanë deklaruar rëndësinë e çështjeve të energjisë. Duke qenë se sukcesi i procesit të sigurizimit varet dhe nga aftësia e aktorit sigurizues për të bindur audiencën për ekzistencën e kërcënimit ekzistencial, atëherë shtrohet çështja nëse në këtë rast është arritur apo jo bindja e audiencës.

Reagimi i audiencës, i shoqërisë shqiptare ishte jo kompakt, pasi pavarësisht se të gjithë bien dakord se çështjet energjetike duhen trajtuar me një kujdes të veçantë, palët ndahen në mënyrat e menaxhimit të çështjes. Nga njëra anë qëndrojnë ata të cilët argumentojnë se masat nuk janë të përshtatshme dhe kryesisht për shkak të gjendjes ekonomike të popullsisë. Në këtë grupim përfshihen parti politike (kryesisht partitë opozitare), individët të cilët nuk e kanë paguar energjinë elektrike por edhe individë të tjerë të cilët bashkohen nën të njëjtin grupim. Nga ana tjetër qëndrojnë qeveria dhe individët të cilët kanë paguar në mënyrë të rregullt për këtë shërbim.

Sigurizimi dhe marrja e masave – Për të identifikuar dhe analizuar masat e marra në funksion të menaxhimit të çështjeve të energjisë, i referohemi të dhënave të ofruara nga institucionet përkatëse mbi bilancin e kësaj nisme. Masat kishin të bënin kryesisht me ndërprerjen e lidhjeve të paligjshme, procedimin penal ndaj individëve që vjedhin energjinë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, skemat lehtësuese për pagesën e detyrimeve të prapambetura, etj. Në analizën “Një vjetori i rezultateve të aksionit kundër vjedhjes në sektorin e energjisë”, u prezantuan rezultatet e aksionit në sektorin e energjisë³¹. Treguesit sasior të këtij aksioni janë: 358,361 konsumatorë familjar kanë nënshkruar aktmarrëveshje. Në

³⁰ Fjala e Kryeministrit Edi Rama gjatë konferencës “Takimi kombëtar, Mbrojtja e energjisë dhe lufta ndaj krimit urban dhe mjedisor, sfida të përgjegjësisë publike”. Aksesuar në:

<http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/per-nje-kapercim-historik-kunder-vjedhjes-se-energji-se>

³¹ Fjala e Kryeministrit Edi Rama në 1 vjetorin e rezultateve të aksionit kundër vjedhjeve në sektorin e energjisë. Aksesuar në: <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/rezultatet-e-nje-viti-ligjshmerie-ne-energji>

nëntëmujorin e parë të vitit 2015 janë mbledhur 503 milion dollarë, nga 297 në të gjithë vitin 2013. Nga një kompani shpërndarje energjie me 52 % humbje nga vjedhjet, abuzimet dhe nga mungesa e investimeve në vite, humbjet në 9 mujorin e parë të 2015-s janë 31 % dhe në shtator 25 %. Janë arrestuar 1210 persona, 842 ndiqen në gjendje të lirë dhe 825 janë shpallur në kërkim. Ky është rezultat i aksioneve të përbashkëta OSHEE – Polici, ku nga rreth 145 grupe të përbashkëta në terren, janë kryer mbi 164,000 aksione. Këto të dhëna dëshmojnë për marrjen e masave, të cilat nuk ishin marrë ndonjëherë në një shkallë të tillë.

Desigurizimi – desigurizimi është faza finale e procesit të sigurizimi dhe nënkupton të ndodhë pas një procesi të suksesshëm sigurizimi dhe çështja të trajtohet brenda kuadrit normal, si pjesë e sektorit të politizuar apo depolitizuar. Duke qenë se në rastin e çështjeve të energjisë në Shqipëri aksioni është në vazhdim, nuk mund të analizohet kjo etapë e procesit.

Pas analizës në bazë të etapave të një procesi të suksesshëm sigurizimi, pyetja që shtrohet është: A janë sigurizuar çështjet e energjisë në rastin e Shqipërisë? Pavarësisht se aksioni i analizuar shfaq shenja të procesit të sigurizimit, konkluzioni është se çështjet e energjisë në rastin e Shqipërisë nuk janë sigurizuar, sepse:

- Së pari, aksioni i fundit i qeverisë është fokusuar vetëm tek energjia elektrike dhe jo siguria energjetike në tërësi.
- Së dyti, në një logjikë të ngjashme me aksionin për energjinë elektrike është nisur dhe për sektorin e hidrokarbureve, por shkalla e tij është shumë më minimale.
- Së treti, sigurizimi i energjisë kërkon kombinimin e elementëve vizion, kohë dhe dimensionin ekonomik. Elementi i parë, vizioni, është deri diku i përmbushur nëse i referohemi diskurit politik dhe dokumenteve strategjike. Elementi i dytë, kohë, kërkon një periudhë me të gjatë studimore e cila e tejkalon objektivin e këtij studimi.

Elementi i tretë, i lidhur me dimensionin ekonomik, është një element vështirësisht i zgjidhshëm për Shqipërinë, treguesit ekonomik të së cilës janë problematik.

- Së katërti, mungesa e koherencës në politikat energjetike në periudhën 2005 – 2015, kanë penguar një proces të suksesshëm sigurizimi. Kujtojmë këtu objektivat, kryesisht të natyrës retorike, të një superfuqie energjetike herë hidrike dhe herë bërthamore.

Konkluzione

Çështjet e energjisë, të lidhura ngushtësisht me sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, përbëjnë sot një ndër çështjet themelore në debatet akademike por edhe në proceset vendimmarrëse. Të gjithë aktorët, pavarësisht pozitës së tyre në arenën ndërkombëtare dhe raporti që kanë me burimet energjetike (konsumator, prodhues apo transit) e kanë bërë energjinë pjesë të dokumenteve kryesore strategjike dhe të diskurit politik. Faktorët që kanë ndikuar në formësimin e situatës energjetike dhe masave të marra me qëllim garantimin e sigurisë energjetike, variojnë nga aktorë dhe rajone të ndryshme. Duke u nisur nga këto dallime, qëllimi i punimit lidhet me analizimin e situatës energjetike në kontekstin europian dhe implikimeve të saj në nivelin e sigurisë së aktorëve, duke u ndalur në shkaqet që kanë ndikuar në nivelin e sigurisë energjetike dhe masën e prioritizimit të kësaj çështje në tre nivele analize; BE, Ballkan dhe Shqipëri. Në funksion të përmbushjes së qëllimit, objektivat e paracaktuar fokusohen në identifikimin dhe analizimin e treguesve kryesor energjetik në të tre nivelet e analizës dhe i shkaqeve që kanë përcaktuar situatën energjetike; faktorët që kanë përcaktuar masën e prioritizimit të çështjeve energjetike në funksion të garantimit të sigurisë energjetike dhe implikimeve të saj në sigurinë kombëtare të aktorëve; dhe nivelin e bashkëpunimit midis aktorëve në funksion të garantimit të sigurisë energjetike.

Pyetjet kërkimore që ngrihen në punim janë: Cilët janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në situatën energjetike në kontekstin europian? A ndikon niveli i sigurisë energjetike në nivelin e sigurisë së aktorëve dhe cilat janë shkaqet që përcaktojnë nivelin e sigurizimit të çështjeve energjetike? Metodologjia e përdorur për t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe për të përmbushur qëllimin e punimit, është metodologjia analitike e bazuar tek rasti studimor (konteksti europian), duke kombinuar qasjen cilësore dhe atë sasiore. Korniza teorike e punimit bazohet kryesisht tek Shkolla e Kopenhagenit; me një

theks të veçantë në sektorët e sigurisë, ‘security complexes’ dhe procesi i sigurizimit. Të dhënat fokusohen në treguesit energjetik, dokumentet strategjike dhe diskuri i aktorëve. Një ndër shqetësimet kryesore në momentin e vendosjes së kufijve gjeografik të rastit studimor lidhej me problematikën nëse mund të flitet për kontekstin europian si një rast studimor, duke ditur diferencat midis aktorëve brenda rastit. Por si nga aspekti teorik ashtu dhe nga ai praktik, konteksti europian si rast studimor është i përshtatshëm, duke e lidhur atë me ndarjen e globit në rajone, ku Europa është njëri prej tyre.

Hipotezat kryesore, të cilat vërtetohen në punim, janë: 1) Resurset energjetike të kufizuara, varësia e lartë dhe nevoja për diversifikim, mos ekzistenca e një tregu të brendshëm energjetik të unifikuar, problematikat e brendshme dhe marrëdhëniet midis aktorëve janë ndër faktorët kryesorë të cilët kanë ndikuar në situatën energjetike në kontekstin europian. 2) Niveli i sigurisë energjetike ndikon në nivelin e sigurisë kombëtare të aktorëve, por pavarësisht se çështjet energjetike janë artikuluar dhe prioritetizuar në axhendën e aktorëve, sigurizimi ose jo i tyre është përcaktuar nga mënyra e perceptimit të varësisë energjetike, problematikat e brendshme, vizioni dhe politikat energjetike të ndjekura. Pavarësisht diferencave, si në nivelin e BE-së, ashtu dhe atë të Ballkanit dhe Shqipërisë, karakteristika kryesore e përbashkët është varësia e lartë dhe nevoja për diversifikimin e burimeve. Nëse në rastin e BE-së çështjet e energjisë janë përfshirë në procesin e sigurizimit, në Ballkan dhe në Shqipëri diçka e tillë nuk ka ndodhur, si pasojë e ndërthurjes midis elementëve vizion, kohë dhe çmim.

Implikimet për secilin nivel të analizës, të cilat përbëjnë dhe konkluzionet finale të punimit, janë: Së pari, resurset energjetike të kufizuara dhe mungesa e një tregu të brendshëm energjetik të unifikuar në BE, kanë ndikuar në rritjen e varësisë energjetike nga

Rusia e cila për shkak se perceptohet si varësi negative dhe ndikon në nivelin e sigurisë së aktorëve, është përfshirë në procesin e sigurizimit. Së dyti, perceptimet e ndryshme ndaj varësisë energjetike, e kaluara historike dhe problematikat e brendshme në vendet e Ballkanit kanë ndikuar në nivelin e sigurisë energjetike të këtij rajoni. Së treti, varësia e lartë, mungesa e diversifikimit, treguesit e ulët ekonomik dhe mungesa e politikave energjetike koherente kanë qenë faktorët kryesor të cilët kanë ndikuar në nivelin e ulët të sigurisë energjetike në rastin e Shqipërisë.

Lidhur me rastin e Shqipërisë, i cili përbën dhe risinë dhe rëndësinë kryesore të studimit është e nevojshme të theksohet fakti se Në rastin e Shqipërisë, e cila ka prej shumë vitesh një varësi 100% nga burimet hidrike, duhet të tregohet një vëmendje e veçantë lidhur me garantimin e sigurisë energjetike. Diversifikimi i burimeve energjetike duhet të jetë një ndër prioritetet kombëtare. Masat kryesore që duhen marrë në këtë drejtim janë të lidhura me zhvillimin e infrastrukturës energjetike, ku linjat e interkonjeksionit do të luanin një rol shumë të rëndësishëm. Krahas mirëmbajtjes së hidrocentraleve ekzistuese, përparësi mbetet ndërtimi i hidrocentraleve të reja të mëdha, pasi ndërtimi i hidrocentraleve të vegjël jo vetëm që nuk e garanton sigurinë energjetike, por mund të kthehen dhe në çështje problematike me impakt mbi mjedisin në zonën ku ndërtohen. Një alternativë tjetër drejt diversifikimit mund të jetë edhe vënia në funksionim e TEC-it të Vlorës, ku gazi natyror mund të jetë një burim optimal. Një kujdes i veçantë duhet të tregohet lidhur me humbjet në rrjet, të cilat në vendet e Ballkanit janë të larta. Në rastin e Shqipërisë këto humbje vijnë si rezultat i atyre teknike, por edhe nga niveli i ulët i arkëtimeve të faturave të energjisë së konsumuar.

Në rastin e Shqipërisë çështjet e energjisë nuk janë sigurizuar, si pasojë e mungesës së kombinimit të elementëve vizion, kohë, dimensionin ekonomik dhe koherencë politikash energjetike. Elementi i parë, vizioni, është deri diku i përmbushur nëse i referohemi diskurit

politik dhe dokumenteve strategjike. Elementi i dytë, kohë, kërkon një periudhë me të gjatë studimore e cila e tejkalon objektivin e këtij studimi. Elementi i tretë, i lidhur me dimensionin ekonomik, është një element vështirësisht i zgjidhshëm për Shqipërinë, treguesit ekonomik të së cilës janë problematik; Së katërti, mungesa e koherencës në politikat energjetike në periudhën 2005 – 2015, kanë penguar një proces të suksesshëm sigurizimi. Elementi i katërt ka një rëndësi të veçantë dhe implikim të drejtpërdrejtë në situatën energjetike. Për aq kohë sa modeli ekonomik që do të aplikohet në sektorin e energjisë do të jetë i paqëndrueshëm, gjasat për garantimin e sigurisë energjetike do të jenë shumë të ulëta. Në funksion të përmirësimit të situatës energjetike, e për pasojë dhe nivelit të sigurisë kombëtare të aktorëve, duhen marrë një sërë masash të cilat shërbejnë dhe si rekomandime në funksion të qëllimit të këtij studimi.

Rekomandime

Për të trajtuar në mënyrë të përshtatshme problematikat e lidhura me sigurinë energjetike në kontekstin European është e nevojshme që:

- Aktorët të identifikojnë dhe analizojnë situatën e sigurisë energjetike në nivel kombëtar, duke marrë në konsideratë dimensionet ekonomike, politike, sociale dhe mjedisore të saj.
- Prioritizimi i çështjeve energjetike dhe sigurizimi i tyre është mënyra më e përshtatshme për tejkalimin e problematikave, dhe diversifikimi duhet të përcaktohet si objektiv primar. Diversifikimi duhet të fokusohet si tek burimet energjetike ashtu edhe llojet e tyre. Për më tepër, aktorët duhet të ndërgjegjësohen për rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, në funksion të garantimit të sigurisë energjetike.

- Vendet anëtare të BE-së duhet të menaxhojnë me kujdes varësinë e lartë nga Rusia dhe të fokusohen në diversifikimin e burimeve, ku rajoni i Kaspikut mund të jetë një opsion i përshtatshëm në terma afat mesëm. Gjithashtu është e nevojshme koordinimi dhe unifikimi i politikave energjetike në nivelin e Bashkimit.
- Vendet e Ballkanit duhet të fokusohen si në reformat e brendshme në sektorin energjetik, ashtu edhe në intensifikimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Këto vende duhet të maksimizojnë përfitimet nga pozita e përshtatshme gjeostrategjike, si një rajon transit i energjisë. Projekti TAP, i ndjekur dhe nga projekte të tjera në të ardhmen, duhet të shërbejë si promotor i bashkëpunimit rajonal.
- Shqipëria, si pjesë përbërëse e Ballkanit, duhet të fokusohet në të gjithë elementët e mësipërm. Fokusimi nuk duhet të jetë vetëm në hartimin e dokumenteve kryesore strategjike por në implementimin efikas të tyre. Reforma strukturore dhe ligjore, ndjekja e politikave të efikasitetit energjetik dhe diversifikimi i burimeve energjetike duhet të jenë prioritete të axhendave politike.
- Thelbi i këtyre reformave duhet të jetë përzgjedhja e një modeli ekonomik të përshtatshëm në sektorin e energjisë dhe të synojnë vendosjen e një koherence lidhur me politikën energjetike.

Bibliografia

- Alsaad, M. (2014). Energy security in International Relations Indians energy security. Telangana: Osmania University Press. Aksesuar në: <http://hdl.handle.net/10603/25150>
- American Energy Independence (<http://www.americanenergyindependence.com/security.aspx>)
- APERC. (2007). A quest for energy security in the 21st century. Asia Pacific Energy Research Center. Aksesuar në: http://aperc.ieej.or.jp/file/2010/9/26/APERC_2007_A_Quest_for_Energy_Security.pdf
- Attila, F. (2012). Energy Security from a Regional Perspective – the Concept of Regional Energy Security Complexes. CEU eTD Collection. Aksesuar në: www.etd.ceu.hu/2013/farkas_attila.pdf
- Bak, O. (2014). European Energy Security: The Southern Gas Corridor. Raport. Aksesuar në: www.nato-pa.int
- Baldwin, D. (1997). The concept of security. Review of International Studies, Vol. 23, (5 – 26).
- Barroso, J. (2007). Our Energy Future in an Interdependent World. World Energy Congress Rome.
- Baumann, F. (2008). Energy Security as multidimensional concept. CAP, Policy Analysis, No.1, March.
- Belfer Center for Science and International Affairs (www.belfercenter.org)
- Belkin, P. (2010). Sfidat e Sigurisë Energjetike të Bashkimit Europian. Çështje Europiane dhe të Sigurisë. Nr.17.
- Belyi, A. (2012). Energy security in International Relations Theories. Cathedra on political issues of international energy, Higher School of Economics.
- BP Statistical Review of World Energy June 2014. Aksesuar në: www.bp.com/statisticalreview

- Brzezinski, I. (2012). Albania-US Relations: A Pillar of Stability in an Increasingly Uncertain World. Aksesuar në:
www.mbrojtja.gov.al/arkiv/eng/index.php?option=com_content&view=article&id=1638:albania-us-relations-a-pillar-of-stability-in-an-increasingly-uncertain-world&catid=320:aktivitis-a-analysis&Itemid=661
- Buzan, B. (1991). New Patterns of Global Security in the Twenty-First Century. International Affairs.
- Buzan, B. (1991). People, States, and Fear – The National Security Problem in International Relations. New York: Harvester Wheatsheaf.
- Buzan, B., & Waever, O. (2003). Regions and Powers: The structure of International security. Cambridge: Cambridge University Press.
- Buzan, B., Waever, O., & Wilde, J. (1998). Security: A new framework for analysis. London: Lynne Rienner.
- Carr, E. H. (1946). The Twenty Year's Crisis: an introduction to the study of International Relations. London: Macmillan.
- Cehulic, L., Kuznetsov, A., Celikpala, M., & Gleason, G. (2013). Energy Security in South East Europe. In Cross, Sh. Shaping South East Europe's Security Community for the Twenty-First Century. Palgrave Macmillan.
- CIEP. (2004). Study EU Energy Supply Security and Geopolitics. Hague, Netherlands.
- Clare, M. (2009). There will be blood: Political violence, regional warfare, and the risk of great-power conflict over contested energy resources. Në Korin, A., & Luft, G. (eds). Energy security challenges for the 21st century: A reference handbook. Westport: Praeger Publ.
- Collins, A. (2013). Studime Bashkëkohore të Sigurisë. Tirane: UET Press.
- CSIS (2014). Re-linking the Western Balkans: The Energy Dimension. Policy Report Three, Shtator 2010.

- Dalby, S. (1997). Contesting an Essential Concept: Reading the Dilemmas in Contemporary Security Discourses. Në Krause, K., & Williams, M. (eds.), Critical Security Studies. Concepts and Cases. London: UCL Press.
- Dannreuther, R. (2010). International Relations Theories: Energy, Minerals and Conflict. POLINARES working paper n. 8.
- De Micco, P. (2014). A cold winter to come? The EU seeks alternatives to Russian gas (Study). DG EPPD, European Parliament. Aksesuar në: [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2014/536413/EXPO_STU\(2014\)536413_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2014/536413/EXPO_STU(2014)536413_EN.pdf)
- Deitz, L., Stirton, L., & Wright, K. (2008). The Energy Community of South East Europe: Challenges of, and Obstacles to, Europeanisation. Centre for Competition Policy: Working Paper 08-4. Aksesuar në: https://www.uea.ac.uk/polopoly_fs/1.104657!ccp08-4.pdf
- Deklarata e Hagës (G7), 24 Mars 2014. Aksesuar në: www.whitehouse.gov/the-press-office/2014/03/24/hague-declaration
- Deklarata e Krerëve të Shteteve dhe Qeverive mbi Ukrainën, 6 Mars 2014. Aksesuar në: <http://www.eliamep.gr/wp-content/uploads/2014/03/Statement-of-the-Heads-of-State-or-Government-on-Ukraine-6.3.2014.pdf>
- Dempsay, J. (2006). EU urges an energy pact with Russians – But Poland objects and offers plan that excludes Moscow. International Herald Tribune, no. 3.
- Ebinger, C. (2011). ‘The Meaning of Energy Security Depends on Who You Are’. Brookings. Aksesuar në: <http://www.brookings.edu/research/opinions/2011/10/10-energy-security-ebinger>
- Ebinger, J. (2010). Albania’s Energy Sector: Vulnerable to Climate Change. ECA, Knowledge Brief, September, Vol.29. Aksesuar në: http://siteresources.worldbank.org/INTECALEA/Resources/ECA_KB_29_Albania_Energy.pdf
- EC. (2014). Communication from the Commission to the Council and the European Parliament: European energy security strategy’. Aksesuar në: http://ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/20140528_energy_security_study.pdf

- EC. (2014) 2030 Energy Strategy. Aksesuar në:
<http://ec.europa.eu/energy/en/topics/energy-strategy/2030-energy-strategy>
- EC. (2014). World energy, technology and climate policy outlook 2030. Aksesuar në:
www.ec.europa.eu/research/energy/pdf/weto_final_report.pdf
- Emmers, R. (2013). Sigurizimi. Në Collins, A. (eds). Studime Bashkëkohore të Sigurisë. Tirane: UET Press.
- Energy Supply Security – Emergency Response of IEA Countries 2014. Aksesuar në:
<https://www.iea.org/publications/freepublications/publication/energy-supply-security-the-emergency-response-of-iea-countries-2014.html>
- European Commission. (2000). Green Paper - Towards a European Strategy for the Security of Energy Supply. Aksesuar në:
www.eurlex.europa.eu/smartapi/cgi/sga_doc?smartapi!celexapi!prod!DocNumber&lg
- Faqja zyrtare e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë (www.iea.org)
- Faqja zyrtare e projektit TAP (<http://www.trans-adriatic-pipeline.com/al/>)
- Fjala e Kryeministrit Edi Rama gjatë konferencës “Takimi kombëtar, Mbrojtja e energjisë dhe lufta ndaj krimit urban dhe mjedisor, sfida të përgjegjësisë publike”. Aksesuar në: <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/per-nje-kapercim-historik-kunder-vjedhjes-se-energji>
- Fjala e Kryeministrit Edi Rama në 1 vjetorin e rezultateve të aksionit kundër vjedhjeve në sektorin e energjisë. Aksesuar në:
<http://www.kryeministria.al/al/newsroom/lajme/rezultatet-e-nje-viti-ligjshmerie-ne-energji>
- Fjala e Kryeministrit Rama në Këshillin Atlantik për Energjinë dhe Ekonominë. Aksesuar në: <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=313458>
- Fjala e Putin në Konferencën e Zagrebit, 2007. Aksesuar në:
http://www.kremlin.ru/eng/speeches/2007/06/24/1214_type82912type82914_135740.shtml
- Fjala hapëse e Presidentit Putin në ‘Takimi i Këshillit të Sigurisë mbi Çështjen e Rolit të Rusisë në Garantimin e Sigurisë Energjetike Ndërkombëtare’. Aksesuar në:
<http://www.rusembassy.ca/ru/node/318>

- Fjalim i Presidentit Obama, 26 Janar 2009. Aksesuar në:
<http://www.americanenergyindependence.com/security.aspx>
- Fjalimi i Presidentit të Komisionit European Barroso në Kongresin Global të Energjisë, 12 Nëntor 2007. Aksesuar në: http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-07-703_en.htm?locale=en
- General Energy Council - GEC. (2005) Energised Foreign Policy – Security of Energy Supply as a New Key Objective. Hague. Aksesuar në: <http://aiv-advises.nl/download/a32c80b3-85d3-48f3-9f7a-5caa7d480fa8.pdf>
- Gilpin, R. (1987). The Political Economy of International Relations. Princeton: Princeton University Press.
- Goldman, M. (2008). Petrostate: Putin, Power, and the New Russia. New York: Oxford University Press.
- Goldthau, A. (2010). Energy Diplomacy in Trade and Investment of Oil and Gas. Në Goldthau, A., & Witte, J. (eds.). Global Energy Governance: The New Rules of the Game, Baltimore: Brookings Institute Press.
- Gupta, E. (2008). Oil Vulnerability Index of Oil-Importing Countries. Energy Policy, 36 (3).
- Haas, E. (1958). Uniting Europe: political, social and economic forces. London: Stevens & Sons.
- Haftendorn, H. (1991). The Security Puzzle: Theory-Building and Discipline-Building in International Security. International Studies Quarterly, Vol. 35.
- Hancher, L., & Jansen, S. (2004). Shared Competences and Multi-Faceted Concepts – European Legal Framework for Security of Supply. New York : Oxford University Press.
- Hedberg, A. (2015). Europe's energy security – is the Energy Union the answer? European Policy Centre. Aksesuar në:
http://www.epc.eu/documents/uploads/pub_5256_europes_energy_security.pdf

- Hengel, D. (2015). TTIP Presents Opportunity for U.S.-EU Energy Cooperation. GMF. Aksesuar në: <http://www.gmfus.org/blog/2015/10/08/ttip-presents-opportunity-us-eu-energy-cooperation>
- Holdren, J. (2007). Energy Policy in Theory & Practice. Presentation for the AGI Leadership Forum on Communicating Geoscience to Policymakers Washington, DC, 30 April.
- Holz, F. (2009). Perspectives of the European Natural Gas Markets until 2025. The Energy Journal 30.
- Instituti i Statistikave (www.instat.gov.al)
- International Energy Agency. World Energy Outlook of 2007. Aksesuar në: www.iea.org/w/bookshop/add.aspx?id=365
- James A. Baker III Institute for Public Policy, Rice University (www.bakerinstitute.org)
- Jewell, J. (2011). The IEA Model of Short-term Energy Security. IEA Publications. Aksesuar në: https://www.iea.org/media/freepublications/2011/moses_paper.pdf
- Kalicki, J., & Goldwyn, D. (eds.). Energy & Security – Strategies for a World in Transition. Washington: Woodrow Wilson Center Press.
- Keohane, R. (1984). After Hegemony: Cooperation and Discord in the world political economy. Princeton: Princeton University Press.
- Klare, M. (2013). Energy Security. Në Williams, P. (eds.) Security Studies: An Introduction. 2nd edition. London: Routledge, Taylor & Francis Group.
- Krasner, S. (1983). International Regimes. Ithaca: Cornell University Press.
- Kruyt, B., Vuuren, D., Vries, M., & Groenenberg, H. (2009). Indicators for Energy Security. Energy Policy.
- Letër e hapur e Presidentit Rus, Vladimir Putin drejtuar liderëve europian, 10 Prill 2014. Aksesuar në: <http://en.kremlin.ru/events/president/neës/20751>
- Matthws, B. & Ross, L. (2010). Metodatat e Hulumtimit; Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Tiranë: CDE.

- McDonald, M. (2013) .Constructivisms. Në (eds) Williams, P. Security Studies; An introduction. Oxon: Routledge.
- McKeown, T. (2004). Case Studies and the Limits of the Quantitative Worldview. Në Collier, E. Rethinking Social Inquiry: Diverse Tools, Shared Standards. London: Rowman and Littlefield Publishers.
- Mearsheimer, J. (2001). The Tragedy of Great Power Politics. New York: W.W. Norton.
- Miller, A. (2014). Europe will have to care about delivering Russian gas from Turkish border – Gazprom. Aksesuar në: <http://www.interfax.com/newsinf.asp?id=557212>
- Moran D., & Russell J. (2009). Energy security and global politics: The militarization of resource management. New York: Routledge Publ.
- Moravcsik, A. Liberal International Relations Theory: Social Scientific Assessment, Paper No,1.
- Morgenthau, H. (1960). Politics Among Nations: The struggle for power and peace. New York: Knopf
- Morina, F. & Fuga, P. (2015). The importance of transit countries in ensuring EU energy security: the case of Balkan region. European Journal of Research in Social Sciences, 3 (4),50-54. <http://www.idpublications.org/ejrss-vol-3-no-4-2015/>
- Morina, F. & Fuga, P. (2015). The importance of transit countries in ensuring EU energy security: the case of Ukraine. International Journal of Academic Research and Reflection, 3 (4), 72-75. <http://www.idpublications.org/ijarr-vol-3-no-4-2015/>
- Morina, F. & Fuga, P. (Pranverë 2014) Një Qasje Analitike mbi Sigurinë Energjetike në Ballkan, në: Economicus 11 UET Revistë Shkencore e Fakultetit Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit ISSN 2223-6295
- Mukhametshina, K. (2015). Russia and European Energy Security. Outcomes of the Nabucco, South Stream and Turkish stream projects. Helsinki Metropolia University of Applied Sciences (Thesis).
- Mutimer, D. (2013). Studime kririke te sigurisë: një histori skizmatike. Në Collins, A. Studime Bashkëkohore të Sigurisë. Tirane: UET Press.

- Nanay, J., & Kalicki, J. (2013). Russia and Eurasia. Në Kalicki, J., & Goldwyn, D (eds.). Energy and Security; Strategies for a World in Transition. Washington: Woodrow Wilson Center Press.
- National Energy Policy Development Group [NEPDG]. (2001). Reliable, Affordable, and Environmentally Sound Energy for America's Future. Aksesuar në: <http://www.wtrg.com/EnergyReport/National-Energy-Policy.pdf>
- Newell, R., & Iler, S. (2013). The Global Energy Outlook. Në Kalicki, J., & Goldwyn, D (eds.). Energy and Security; Strategies for a World in Transition. Washington: Woodrow Wilson Center Press.
- Noël, P. (2013). European Gas Supply Security: Unfinished Business. Në Kalicki, J., & Goldwyn, D (eds.). Energy and Security; Strategies for a World in Transition. Washington: Woodrow Wilson Center Press.
- Nye, J. (2004). Soft Power: The Means to Success in World Politics. Public Affairs, New York.
- Obradovic, J., & Wochnik, A. (2013). EUT Doctoral training in research methods. Class notes and course pack.
- Ozcan, S. (2013). Securitization of Energy Through the Lenses of Copenhagen School. Paper prepared for the 2013 Orlando International Conference, 21-23 March, 2013, West East Institute, Orlando/USA.
- Palonkorpi, M. (2009). Matter over Mind? Securitizing Regional Energy Interdependencies. Helsinki: University of Helsinki Press.
- Percival, B. (2008). The Risk of Energy Securitization on the Eurasian Continent. Clingendael International Energy Programme.
- Philo, G. & Happer, C. (2013). Communicating climate change and energy security : new methods in understanding audiences. New York: Routledge.
- Portali i Energjisë (<http://energija.al/tag/siguria/page/2/>)
- Rachel, T. (2008). Neo-Liberal Ideology: History, Concepts and Policies. Edinburgh: Edinburgh University Press.

- Radoman, J. (2007). Securitization of Energy as a Prelude to Energy Security Dilemma. Western Balkans Security Observer issue: 4 / 2007.
- Rasmussen, A. (2014). "A strong NATO in a changed world" Speech by NATO Secretary General Anders Fogh Rasmussen at the "Brussels Forum" 21 Mar. 2014. Aksesuar ne http://www.nato.int/cps/en/natohq/opinions_108215.htm
- Redgwell, C. (2004). International Energy Security. New York : Oxford University Press.
- Reynolds, J. (2009). An Empirical Application of Regional Security Complex Theory. Securitization Discourse in China's Relations with Central Asia and Russia. Aksesuar në: www.etd.ceu.hu/2009/reynolds_julius.pdf.
- Ribaj, P., & Qendro, E. (2012). Gjeopolitika Energjetike si gjeografi e burimeve. Revista Ushtarake, Nr. 1/2012.
- Riley, A. (2013). Deploying the Energy Incentive: Reinforcing EU Integration in South-East Europe. CEPS Policy Brief
- Riley, A. (2015). Prioritization in EU Energy Policy Energy Security First, then Energy Union. Aksesuar në: http://www.atlanticcouncil.org/images/publications/Prioritization_in_EU_Energy_Policy_web.pdf
- Roli i NATO-s në sigurinë energjetike. Aksesuar në: http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49208.htm#
- Russia's gas fight with Ukraine, By Paul Kirby, BBC News, 31 October 2014 <http://www.bbc.com/news/world-europe-29521564>
- Smith, M. (2008). Russian Energy Interests in the Balkans. Defence Academy of the United Kingdom, Balkan Series 08/07.
- Snyder, J. (2004). One World, Rival Theories. Foreign Policy, 145.
- Sovacool, B. (2009). Evaluating energy security in the Asia pacific: Towards a more comprehensive approach. Energy Policy (in press).
- Stern, J. (2002). Security of European natural gas supplies. London: Royal Institute of International Affairs.

- Stern, J. (2005). The Future of Russian Gas and Gazprom. Oxford: Oxford University Press.
- Strange, S. (1991). States, Rival Firms: Competition for world market shares. JSTOR. Aksesuar në: www.jstor.org/stable/258909
- Strategjia Europiane e Sigurisë Energjetike, Maj 2014. Aksesuar në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52014DC0330&from=EN>
- Strategjia Kombëtare e Energjisë (2013 – 2020) [Draft]. Aksesuar në: <http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/06/Strategjia-Kombetare-Energjise-2013-2020-draft.pdf>
- Strategjia Sigurisë Kombëtare (2014). Aksesuar në: http://www.parlament.al/web/pub/teksti_17880_1.pdf
- Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë (2015). Aksesuar në: http://www.parlament.al/web/pub/strategjia_ushtarake_e_rsh_e_ripunuar_fina_22511_1.pdf
- Sweet, B. (2011). A tale of Two Pipelines. Aksesuar në: <http://spectrum.ieee.org/energywise/energy/fossil-fuels/a-tale-of-two-pipelines>
- Traktati i NATO-s, 4 Prill 1949. Aksesuar në: http://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_17120.htm
- U.S. Energy Information Administration. (2015). Annual Energy Outlook. Aksesuar në: [http://www.eia.gov/forecasts/aeo/pdf/0383\(2015\).pdf](http://www.eia.gov/forecasts/aeo/pdf/0383(2015).pdf)
- UNDP. (1994). Human Development Report. Oxford: Oxford University Press.
- US Department of Energy, Energy Information Administration, International Energy Outlook. (<http://www.energy.gov/>)
- Verrastro, F., & Ladislaw, S. (2007). Providing Energy Security in an Interdependent World. Washington Quarterly 30 (4): 95.
- Victor, D. (2007). Natural Gas and Geopolitics. CESSA Working Paper 14, Coordinating Energy Security in Supply Activities.

- Vivoda, V. (2010). Evaluating Energy Security in the Asia-Pacific Region: A Novel Methodological Approach. *Energy Policy* Volume 38, Issue 9.
- Vladimir Putin tells Brussels to stay out of Ukraine's political crisis'. Aksesuar në: <http://www.theguardian.com/world/2014/jan/28/vladimir-putin-ukraine-crisis-eu>
- Von Hippel, D., Suzuki, T., Williams, J.H., Savage, T., & Hayes, P. (2009). Energy security and sustainability in Northeast Asia. *Energy Policy* [article in press].
- Waltz, K. (1979). *Theory of International Politics*. New York: McGraw-Hill.
- Wendt, A. (1992). Anarchy is What States Make of It: the Social Construction of Power Politics. *International Organization* 46(2).
- Winrow, G. (2014). Turkey Positions Itself as Regional Energy Player. *World Politics Review*. Aksesuar në: <http://www.worldpoliticsreview.com/trend-lines/13847/turkey-positions-itself-as-regional-energy-player>
- Wolfers, A. (1952). National Security as an Ambiguous Symbol. *Political Science Quarterly*, 67.
- World Energy Outlook, 2007. Aksesuar në: http://www.worldenergyoutlook.org/media/weowebiste/2008-1994/WEO_2007.pdf
- Yergin, D. (2006). EnsuringEnergySecurity. *Foreign Affairs*, Volume 85(2), 69-82. Aksesuar në: <http://www.foreignaffairs.com/articles/61510/daniel-yergin/ensuring-energy-security>
- Yergin, D. (2013). *Energy Security and Markets*. Në Kalicki, J., & Goldwyn, D. (eds.) *Energy & Security – Strategies for a World in Transition*. Washington: Woodrow Wilson Center Press.
- Zelensky, M. (2009). *Changing the Energy Security Balance in the Baltic Sea Region: Building Regional Energy Security Complex and Community*. University of Tampere Press. Aksesuar në: www.tampub.uta.fi/bitstream/handle/10024/81304/gradu04082.pdf